

**INSTITUTI I HISTORISË “*ALI HADRI*”-PRISHTINË
KOMUNA E SKENDERAJT**

**RIPUSHTIMI JUGOSLLAV I VISEVE
SHQIPTARE DHE LUFTA E DRENICËS
(1944/1945)**

Prishtinë, 2016

Kryeredaktor:
Prof. assoc. dr. Sabit SYLA

Redaktor shkencor:
Prof. dr. Izber HOTI

Sekretar i redaksisë:
Dr. sc. Gjon BERISHA

Redaksia:
Akademik Beqir META
Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA
Akademik i assoc. Marenglen VERLI

Redaktore gjuhësore:
Ma. sc. Shqipe DODA

Konferenca Shkencore

**“Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe Lufta e
Drenicës (1944/1945)”**

(30 tetor 2015)

Prishtinë, 2016

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE

Sabit Syla - Fjala e hapjes

Fadil Nura - Fjalë përshëndetëse

1. Sabile Keçmezi-BASHA

Kuvendi i Prizrenit dhe vendimet e tij (8-10 korrik 1945.....19

2. Beqir META

Rrethanat ndërkombëtare të ripushtimit të Kosovës.....29

3. Ibrahim GASHI

Shaban Polluzha, drejtues i Luftës së Drenicës në dimrin e viteve 1944-1945.....41

4. Marenglen VERLI

Disa konsiderata për ngjarjet kulmore politiko-ushtarake në Kosovë në muajt e fundit të Luftës së Dytë Botërore.....51

5. Izber HOTI

Lufta e Drenicës dhe Shaban Polluzha në rrjedhat politike e ushtarake.....65

6. Hakif BAJRAMI

Si u okupua Kosova nga Jugosllavia dhe me kërkesë të kujt, më 1945?.....81

7. Hamit KABA

Vështrim i britanikëve dhe amerikanëve për ripushtimin e Kosovës.....111

8. Proletar HASANI

Ndihmesa dhe ndikimi i brigadave të Ushtrisë acionalçlirimtare nga Shqipëria në çlirimin e Kosovës, në përfundim të Luftës së Dytë Botërore.....123

9. Halim PURELLKU

Pushtimi i Trevave Lindore shqiptare nga fuqitë jugosllave/partizane në gjysmën e dytë të vitit 1944.....143

10. Sabit SYLA

Qëndrimi i Partisë Komuniste të Shqipërisë ndaj ripushtimit të Kosovës.....167

11. Muhamet SHATRI

Përqendrimi dhe veprimtaria antishqiptare e forcave të armatosura jugosllave në Kosovë në fillim të vitit 1945.....175

12. Muharrem DEZHGIU

Ballafaqimi midis njësive të UNÇSH-së dhe nacionalistëve shqiptarë në Kosovë në fund të Luftës së Dytë Botërore.....193

13. Fehmi REXHEPI

Masakra e Tivarit në historiografinë shqiptare.....205

14. Haki KASUMI

Masakra e Tivarit - shkaqet dhe pasojat.....213

15. Qerim LITA

Rrethanat politike e ushtarake në trevat verilindore shqiptare,
nëntor 1944-nëntor 1945.....219

16. Marenglen KASMI

Politika gjermane ndaj Kosovës 1943-1944.....247

17. Zeliqe SHALA

Organizimi i vullnetarëve për mbrojtjen e kufijve të Kosovës,
më 1944-1945.....259

18. Mrika LIMANI

Avancimi i trupave partizane krahas tërheqjes së trupave
gjermane në territorin e Kosovës në fund të 1944.....269

19. Haxhi ADEMI

Interpretimi i literaturës historiografike shqiptare për
ripushtimin jugosllav të Kosovës dhe Luftën e Drenicës
(1944/1945.....277

PARATHËNIE

Në tetor të vitit 2015 Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë në bashkëpunim me Komunën e Skenderajt organizuan Konferencën Shkencore: *“Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe Lufta e Drenicës (1944-1945)”*, që përputhej me 70-vjetorin e ripushtimit të viseve shqiptare dhe Luftës së Drenicës.

Kjo Konferencë kishte synim ta ndriçojë rezistencën gjithëshqiptare kundër ripushtimit jugosllav, në veçanti atë të Drenicës, në fund të Luftës së Dytë Botërore, kur zgjedha mbi popullsinë shqiptare e nacionalizmit agresiv sllav u kombinua me diktaturën komuniste në aspekte të shumta.

Konferenca i filloi punimet më 30 tetor dhe u përcoll me mjaft interes nga shumica e medieve vendore dhe opinioni publik. Në dy seancat e saj me kumtesat e tyre dhanë kontribut shkencor 19 studiues nga hapësira gjithëshqiptare.

Këshilli Organizativ i Konferencës, duke vlerësuar cilësinë e kumtesave me prurje të reja shkencore, vendosi që t’i publikojë ato në vëllim të veçantë, ku veç tjerash, hidhet dritë mbi çështje të paprekura deri më sot në historiografinë shqiptare për ripushtimin jugosllav dhe rezistencën shqiptare dhe luftën për çlirim kombëtar. Besojmë se me botimin e kësaj përmbledhjeje shkencore historike po plotësohet një zbrazëti në historiografinë shqiptare.

**Sabit SYLA - Drejtor i Institutit të Historisë
“Ali Hadri”-Prishtinë**

**FJALA E HAPJES NË KONFERENCËN
SHKENCORE “RIPUSHTIMI JUGOSLLAV I VISEVE
SHQIPTARE DHE LUFTA E DRENICËS (1944/1945)”**

*I nderuar Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Z.
Qemal Minxhozi,*

*I nderuar Akademik Beqir Meta, drejtor i Institutit të Historisë
në Tiranë,*

*I nderuar Z. Skënder Asani, drejtor i Institutit të Trashëgimisë
Shpirtërore e Kulturore të Shqiptareve në Shkup,*

I nderuar Z. Hysen Matoshi, drejtor i Instituti Albanologjik,

*Të nderuar kryetarë të komunave, Z. Izet Mexhiti, kryetar i
Komunës së Çairit, Z. Nevzat Bejta, kryetar i Komunës së
Gostivarit, Z. Fadil Nura, nënkryetar i Komunës së
Skenderajt,*

*Të nderuar profesorë, studentë, përfaqësues të institucioneve
shkencore, arsimore e kulturore, të medieve të shkruara dhe
elektronike, kolegë e gjithë ju të pranishëm,*

Më lejoni fillimisht t’ju përshëndes në emër të Institutit të Historisë dhe në emrin tim personal me përgëzimet dhe urimet më të sinqerta për pjesëmarrjen tuaj në Konferencën Shkencore: “Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe Lufta e Drenicës

1944/1945”, organizuar nga Instituti i Historisë në bashkëpunim me Komunën e Skenderajt.

Të nderuar, zonja dhe zotërinj,

Lufta e Dytë Botërore kishte riaktualizuar çështjen e Kosovës si një çështje e cila që shndërruar në një pikë objeksionesh për shqiptarët, e ndikuar në shkallën e rezistencën e tyre, qoftë në zgjerimin apo ngushtimin e koalicionit antifashist apo fashist e si një problem i rëndësishëm zgjidhjeje i vetë shqiptarëve të Kosovës, i forcave politike dhe ushtarake të Shqipërisë së pushtuar, i forcave politike dhe ushtarake të Jugosllavisë, por edhe i vendimeve të Aleatëve të Mëdhenj. Por në mbarim të luftës Kosova u kthye në një poligon të vërtetë të masakrave, ekzekutimeve, dhunimeve, burgosjeve individuale e kolektive nga faktori jugosllav, qoftë ai nacionalist apo komunist, që e shihte të ardhmen e Kosovës brenda shtetit jugosllav. Platformat e tyre ndryshonin vetëm në metodë dhe në praktikën e realizimit.

Situata e tillë e krijuar shkaktoi një indinjatë të thellë si te të gjithë popullsia shqiptare, ashtu edhe të krerët e prijësit e Drenicës. Në fund të dhjetorit 1944 u formua Brigada e Drenicës me komandant Shaban Palluzhën, e cila kishte këto qëllime parësore: ndalimin e menjëhershëm të dhunës e terrorit serb në Drenicë e vise të tjera shqiptare, respektimin e të drejtës së popullit shqiptar për vetëvendosje - bashkim me Shqipërinë dhe largimin e menjëhershëm të forcave partizane-çetnike nga vendi. Luftë e rreptë do të zhvillohet ndërmjet forcave shqiptare dhe atyre pushtuese jugosllave. Këto të fundit, do të përdorin artileri të rëndë e korpuse të tëra ushtarake. Bazuar edhe në urdhrin e Josip Broz Titos të datës 8 shkurt 1945 në Kosovë vendoset Administrimi Ushtarak me epiqendër Drenicën. Ndërkohë, rrjedha e ngjarjeve dhe zhvillimeve politike ndërkombëtare në

Evrope, ishin në disfavor të kryengritësve shqiptarë. Shumë çështje tashmë ishin vendosur në Jaltë.

Në viset shqiptare u intensifikua dhuna e terrori. Dimër dhe pranverë të përgjakshme do të përjetojë populli shqiptar (1944-1945). U pushkatuan e u burgosën dhe u dërguan në kampe, u izoluan, u shpërngulën për Turqi e shumë do të vriten jashtë kufijve të Kosovës. Tivari që një tragjedi tjetër që u ndodhi shqiptarëve, mbase një ndër më të rëndat. Ky varr kolektiv nuk që një rastësi. Çdo gjë ishte planifikuar e detajuar me kohë, si ekzekutuesi ashtu edhe vendi, duke u bërë kështu pjesë e politikës shfarosëse të hegjemonisë serbe.

Nën Administrimin Ushtarak u mbajt edhe Sesioni i Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës, i njohur si Kuvendi i Prizrenit, në korrik të vitit 1945. Nga gjithsej 142 delegatë e mysafirë të Kuvendit, 78 prej tyre kanë qenë serbë e malazezë, ndërsa vetëm 33 shqiptarë, kryesisht funksionarë të rretheve të Kosovës. Në këtë kuvend u nënshkrua Rezoluta për bashkimin e Kosovës me Serbinë. Kështu, alternativa e bashkimit të viseve shqiptare me Shqipërinë, me gjithë përpjekjet e luftës për çlirim dhe bashkim kombëtar, fatkeqësisht mbeti një alternativë e parealizuar në mbarim të luftës. Ringritja e shtetit jugosllav të pasluftës do të përfshinte edhe Kosovën. As, faktori ndërkombëtar, ndonëse gjatë luftës kishte hap një dritë të zbehtë përmes Kartës së Atlantikut, nuk e artikuloi të drejtën e popullit shqiptar për t'u bashkuar me Shqipërinë.

Të nderuar të pranishëm,

Konferenca që sot po i nis punimet ka një rëndësi të veçantë në historinë më të re shqiptare. Në dy sesione do të lexohen 19 kumtesa të ndryshme, duke ofruar materiale të reja, mbështetur në metodat e hulumtimit bashkëkohor, me një gjuhë shkencore të bazuar dhe të argumentuar më dokumente relevante e metodën krahasuese dhe analitike. Andaj, kemi

bindjen se kjo konferencë do të shërbejë pjesë dhe kontribut real i studimeve historike. Pasi kumtesat e paraqitura më pas edhe do të botohen, jemi edhe më optimistë që do të mbushet një boshllëk në historiografinë shqiptare, ngase botimi do të trajtojë në mënyrë të plotë e shkencërisht të mbështetur ripushtimin jugosllav të viseve shqiptare dhe Luftën e Drenicës më 1944/1945.

Historiografia shqiptare, tanimë e pavarur nga diktatet ideologjike dhe politike, është në gjendje të përmbush këtë nevojë të vetëdijes sonë kombëtare, të kulturës e kujtesës sonë historike. Ajo në këtë drejtim ka shënuar hapa të vlefshëm, me gjithë vështirësitë nëpër të cilat kanë kaluar shqiptarët. Megjithatë, jo të gjitha çështjet që lidhen me historinë e kombit shqiptar janë të trajtuara në mënyrë të plotë dhe të bollshme. Andaj, si për tërë historiografinë shqiptare, ashtu edhe për këtë pjesë të historisë, në të kaluarën që koha në të cilën arritjet e historianit në fushën e mendimit filozofik e social, sidomos liria politike dhe ideja e zgjedhjes së lirë, nuk rrodhën nga nocioni i qenies së tij njerëzore në formën e tij të pastër, por që produkt i një zhvillimi të procesit historik që përbënte një hapësirë të kufizuar për ta.

Sot, në këtë fillim të shekullit të ri, qasjet më ndryshe nga e kaluara dhe metodologjitë më të avancuara për bërjen e historisë, janë një arsye më tepër për të qenë optimistë se do të hedhet dritë mbi çështje të panjohura e të pastudiuara sa duhet. Kosova me viset e tjera shqiptare pret më shumë vlerësime shkencore në këtë drejtim. Ne, në këtë drejtim, nuk kemi përmbushur ende disa nga objektivat tona. Megjithatë, Instituti i Historisë mbetet i angazhuar që kërkimit shkencor t'i japë rolin merituar që i takon.

Në fund, duke Ju dëshiruar punë të mbarë e të frytshme dhe qëndrim të këndshëm, të gjithë studiuesve mysafirë dhe

atyre vendës, i shpall të hapura punimet e Konferencës Shkencore: “Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe Lufta e Drenicës (1994/1945)”.

Ju faleminderit!

Prishtinë, më 30 tetor 2015

Fadil NURA - Nënkyetar i Komunës së Skenderajt

**FJALA PËRSHENDETESE NË KONFERENCËN
SHKENCORE “RIPUSHTIMI JUGOSLLAV I VISEVE
SHQIPTARE DHE LUFTA E DRENICËS (1944-1945)”**

*Të nderuar përfaqësues të Institutit të Historisë “Ali Hadri”,
I nderuar Ambasador Minxhozi,
Të nderuar historianë të trevave shqiptare,
Shumë të respektuar të pranishëm,*

Kam kënaqësinë e posaçme që sot jam pjesë e një konference shkencore që mëton të hedhë dritë mbi një pjesë të rëndësishme të historisë së popullit të Kosovës, dhe kush do ta bënte më mirë këtë gjë, sasa historianët e nderuar të pranishëm sot këtu. Trajtimi profesional dhe shkencor i ngjarjeve historike ka një rëndësi të madhe, pasi çdo ditë po shohim trajtime joadekuate dhe amatore të ngjarjeve të caktuara të historisë sonë kombëtare. Pjesa e historisë që trajton kjo konferencë shkencore padyshim është pjesë e rëndësishme dhe e begatshme e saj, por e cila sipas bindjes sime nuk ka qenë aq sa duhet e trajtuar nga shkencëtarët.

Shpreh po ashtu kënaqësinë time dhe të institucioneve të Skenderajt që jemi pjesë e organizimit të kësaj konference, duke u munduar që sadopak të japim kontributin tonë në drejtim të zbardhjes së fakteve historike, ngjarjeve dhe personazheve të Luftës së Drenicës 1944/1945. Pa dashur që të lëshohem dhe të ndërhyjë në vlerësimet shkencore për këtë periudhë historike,

më lejoni të them se ekziston bindje e përgjithshme se kjo pjesë e historisë, pra Lufta e Drenicës, nuk është trajtuar deri më tani në mënyrën e duhur nga shkencëtarët historianë. Madje ajo është trajtuar me anime politike të kohës, të cilat e kanë dëmtuar rëndë atë. Sa për ilustrim të këtij fakti po ju sjell një shembull se si dhe në ç'masë kjo pjesë e historisë ka qenë e keqtrajtuar dhe e devijuar. Një nxënës i shkollës fillore në Drenicën e para viteve '90-ta, mësonte në lëndën e historisë në shkollë, sipas së cilës Shaban Polluzha dhe Mehmet Gradica paskan qenë tradhtarë, në anën tjetër në familjen e tij mësohej e kundërta, se ata ishin heronj dhe patriotë. Ky afërsisht ka qenë ambient në të cilën mësohej kjo pjesë e përpjekjeve të shqiptarëve për liri gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në këtë kontekst duhet përgëzuar iniciativën e Institutit të Historisë për ta trajtuar këtë temë shumë të rëndësishme, pasi besoj që rezultat i kësaj Konference do të jetë vënia në dritë e fakteve historike në lidhje me Luftën e Drenicës. Faktet historike i nxjerrin në dritë vetëm historianët e nderuar të cilët do të referojnë gjatë punimeve të kësaj konference.

Të nderuar dhe shumë të respektuar historianë,

Duke i dëshiruar sukses konferencës, më lejoni që ta mbyllë fjalën time me një fjali: "Historinë e bëjnë heronjtë, ndërsa e shkruajnë historianët".

Ju faleminderit!

Sabile KEÇMEZI - BASHA

KUVENDI I PRIZRENIT DHE VENDIMET E TIJ (8-10 KORRIK 1945)

Kuvendi i Prizrenit nuk ishte as i pari e as i fundit, i cili solli vendime që Kosova të aneksohej nga Serbia e Jugosllavia. Aneksimi nga kjo njësi federale kishte filluar qysh më herët, ndërsa nga Kuvendi i Prizrenit pushtetarët jugosllavë kërkonin formalisht vetëm një “verdict të popullit”.

Në të vërtetë, më 9-12 nëntor 1944 në Beograd, në mbledhjen e Kuvendit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Serbisë, para se Tito të priste një grup shqiptarësh nga Kosova që vinin për t’u interesuar për fatin e saj jetik¹, u bë fjalë për Kosovën. Thënë më drejtë, për Kosovën ishte bërë fjalë edhe më 2 shtator të vitit 1944, kur Shtabi Kryesor i UNÇ-së dhe AP-së së Kosovës, (SHK i UNÇ dhe AP) me urdhrin e Shtabit Suprem (SHS) të UNÇ-së dhe Armatës Popullore të Jugosllavisë (APJ) u vu nën komandën e Shtabit Kryesor të UNÇ-së dhe AP-së së Serbisë. Prej kësaj kohe, Shtabi Kryesor i UNÇ-së së Kosovës, u bë Shtab Operativ (SHO) i UNÇ-së dhe AP-së së Kosovës.²

¹ Shaban Braha, *Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare (1844-1990)*, Gjakovë, 1991, f. 472.

² Hakif Bajrami, *Kosova prej Bujanit në Kaçanik*, Prishtinë 1997, f. 269.

Në shkurt të vitit 1945 në Komitetin Qendror (KQ) të Partisë Komunistët të Jugosllavisë (PKJ) u organizua një mbledhje, ku veç debateve tjera, u fol edhe për Kosovën dhe statusin e ardhshëm të saj. Nga e tërë kjo doli se, zgjidhja më e mirë dhe më e drejtë ishte se “Kosova e Metohija t’i bashkohen Shqipërisë, kurse Shqipëria të hyjë në Federatën Jugosllave”, por, *meqenëse rrethanat ndërkombëtare nuk janë të favorshme për një hap të tillë - për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë dhe hyrjen e Shqipërisë në Federatën Jugosllave, Kosova dhe Metohija si autonomi duhet t’i bashkohen Serbisë*³, por kishte edhe aso propozime që Kosova t’i takojë vetëm Malit të Zi, ngase kishin një histori të ngjashme dhe një mentalitet të përafërt me shqiptarët.

Në dokumentet e Kuvendit Antifashist të Çlirimit Kombëtar (KANÇ) të Serbisë, që u mbajt më 7-9 prill të vitit 1945 në Beograd, nga Kosova merrnin pjesë si mysafirë, Dushan Mugosha dhe Mehmet Hoxha, të cilët në seancë diskutuan dhe sipas dokumentit thuhej se shprehën dëshirën në emër të popullit të Kosovës që “Kosova të jetë nën Serbinë federale”⁴, dhe nga këto diskutime që u bënë në Beograd mund të konkludohet se Kosova iu bashkua Serbisë në mënyrë arbitrare, në bazë të diskutimeve që u bënë nga dy mysafirë, e dihej mirë në bazë të dokumenteve historike se Kosova dhe populli i saj asnjëherë nuk diskutoi, u pyet dhe votoi që ajo të ngeli në kuadrin e Serbisë federale. Andaj, për të dal vendimet e ligjshme u thirr Kuvendi i Dytë i Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar i Kosovës e i Rrafshit të Dukagjinit.

Mbledhja e Kuvendit u mbajt më 8-10 korrik 1945 dhe i tërë ky tubim kaloi me presione nga më të ndryshmet, ngase aty merrnin pjesë shumë atdhetarë e patriotë të shquar të cilët as me çmimin e jetës nuk pranonin që tokat shqiptare të ngelnin nën ish-Jugosllavi.

³ Branko Horvat, *Kosovsko pitanje*, Zagreb 1988, f. 62.

⁴ *Rezoluta e Kuvendit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Serbisë lidhur me vendimin e KAÇK të Sanxhakut dhe deklaratat e delegatëve të KKNÇ të Vojvodinës dhe të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit*, Gazeta “Borba”, 9 prill 1945.

Ata që e kundërshtuan një hap të tillë, më vonë u ndoqën, u burgosën pa arsytim, e disa edhe u likuiduan tinëzisht nga organet e OZN-së (Organizacija za zaštitu naroda - Organizata për Mbrojtjen e Popullit). Të tillët ishin shumë, por po përmendim vetëm disa nga ata që i përkisnin anës së Gjilanit, si: Ramiz Cërrnica, Adem Stanqiqi, Hasan Dylgjeri e ndonjë tjetër. Por, me këtë rast do të ndalesha vetëm tek reagimi i patriotit të shquar të Anamoravës, Ramiz Cërrnicës, i cili në Kuvend doli haptas kundër qëndrimeve gllabëruese të Serbisë, duke thënë: “Ne jemi shqiptarë, kemi një gjuhë e një gjak me shqiptarët e Shqipërisë... Ku keni parë ju në historinë e njerëzimit që fëmija t’ia kthej shpinën nënës e ta përqafojë njerëkn? Kjo s’është as e logjikshme e as e pranueshme për ne shqiptarët”.⁵ Pas këtij diskutimi në sallë pasoi një tollori i paparë. Disa nga udhëheqësit kërkuan që t’i ndërpritet fjala, disa kërkuan që të nxirret jashtë dhe dolën shumë propozime të tjera. Por, kalvari i Ramiz Cërrnicës nuk përfundoi me kaq, ai më vonë u ndjek dhe u arrestua nga organet e OZN-së, kur u dënua me 20 vjet burg të rëndë. Edhe pas daljes nga burgu, atë nuk e lanë të qetë, siç ndodhi edhe me anëtarët e tjerë që morën pjesë në Kuvend dhe nuk u pajtuan me vendimet që u morën në të, u përcollën nga udbashët dhe disa nga ta kaluan vite të tëra nëpër burgjet jugosllave.

Aneksimi i Kosovës nga Serbia - do të shohim më vonë - ishte vetëm maja e Ajsbergut të padrejtësive që u bëhej shqiptarëve në Jugosllavinë komuniste. Çështja e Kosovës nuk ishte krejt çështja shqiptare. Padrejtësia që i bëhej popullit shqiptar në ish-Jugosllavi e rëndonte edhe më tepër, copëtimi i trevave në të cilat shqiptarët ishin popullatë e vetme apo shumicë dërrmuese në tri republika jugosllave: në Republikën e Serbisë, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi.⁶ Kosova, jo vetëm që u shkëput nga trugu amë, por asaj iu shkoqën jo vetëm trevat e banuara kryekëput ose kryesisht me popullatën shqiptare në Maqedoninë Perëndimore dhe në Mal të Zi, por edhe Presheva,

⁵ Afërdita Halimi-Cërrnica, *Raif Halim Cërrnica (veteran i luftës dhe i demokracisë në Kosovë)*, Tiranë 2000, f. 21.

⁶ Rexhep Qosja, *Çështja shqiptare, historia dhe politika*, Prishtinë 1994, f. 195.

Bujanoci dhe Medvegja, në të cilat shqiptarët ishin shumicë dërmuese.

Në mbarim të vitit 1945, menjëherë pas mbarimit të Luftës, të gjitha problemet që lidheshin me Kosovën dhe të ardhmen e saj, u shtruan dhe u tentuan të zgjidhen në kuadër të Jugosllavisë së Titos. Gjatë Luftës, udhëheqësit e PKJ-së kishin premtuar se e ardhmja e Kosovës do të zgjidhej nga vetë popujt që jetonin atje, me mirëkuptim, nga partitë e regjimet demokratike popullore, që do të vendoseshin në Shqipëri e në Jugosllavi, pas fitores mbi fashizmin⁷. Ishte folur e shkruar vazhdimisht se pas Luftës do të respektohet Deklarata e Moskës,⁸ Karta e Atlantikut,⁹ Deklarata e Teheranit,¹⁰ Letra e Titos,¹¹ e botuar në gazetën “Proleter”, Rezoluta e Bujanit,¹² e shumë dokumente të tjera me rëndësi historike.

⁷ Udhëzime të S. V. Tempos për KK të PKJ-së për Kosovë, më 2 tetor 1943, f. 2.

⁸ Deklarata e Moskës u miratua në tetor 1943, e cila kërkonte të “zbatohej bashkëpunimi më i ngushtë në udhëheqjen e luftës dhe në të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me kapitullimin dhe çarmatimin e shteteve armike.

⁹ Karta e Atlantikut, u nënshkrua ndërmjet V. Çerçilit dhe F. D. Ruzveltit. Në këtë dokument të rëndësishëm në mes tjerash thuhet se do të respektohet “kthimi i të drejtave sovraane dhe të vetadministrimit atyre popujve, të cilëve u janë marrë ato dhe respektimi i të drejtave të të gjithë popujve, që të zgjedhin formën e vet të qeverisjes (14 gusht 1941).

¹⁰ Deklarata e Teheranit u soll më 1 tetor 1943 dhe u nënshkrua ndërmjet Ruzveltit, Çerçillit dhe Stalinit. Kjo deklaratë garantonte se të gjithë popujve aleatë në Luftën Antifashiste do t’u njihet e drejta për të rregulluar marrëdhëniet e veta “sipas aspiratave të tyre të ndryshme dhe sipas ndërgjegjes së tyre vetanake”.

¹¹ Letra e Titos u botua në dhjetor të vitit 1942 në gazetën “Proleter” me titull “Çështja kombëtare në Jugosllavi në dritën e Luftës Nacionalçlirimtare”. Në mes tjerash, në lidhje me çështjen e shqiptarëve thuhej se “Çështja e Maqedonisë, çështja e Kosovës e Metohisë, çështja e Malit të Zi, çështja e Kroacisë, çështja e Sllovenisë, çështja e Bosnjës e Hercegovinës, do të zgjidhet lehtë ashtu siç dëshirojnë të gjithë, sepse do ta zgjidhë populli, kurse këtë të drejtë e fiton çdo popull, me pushkë në dorë, në këtë Luftën e sotme Nacionalçlirimtare”

¹² Rezoluta e Bujanit, u miratua më 31 dhjetor 1943 dhe më 1 e 2 janar 1944, në fshatin Bujan të Malësisë së Gjakovës. Në Mbledhjen Themeluese të Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar të Kosovës e Dukagjinit. Në këtë mbledhje merrnin pjesë 49 delegatë (43 shqiptarë, 6 serbë e malazezë). Përveç Rezolutës që është një dokument me një rëndësi të madhe historike, u soll edhe Proklamata e Kryesisë së

Pas aneksimit të Kosovës për popullin shqiptar filloi një etapë e errët, një kalvar i vërtetë. Filluan përsëri masakrat masive mbi popullatën e pafajshme dhe likuidoheshin patriotët dhe intelektualët e shumtë. Në Drenicë, Gjilan, Podujevë dhe në shumë vende të tjera të Kosovës, bëhej gjenocid i vërtetë. U likuidua Jusuf Ibrahimimi nga Gjilani, i cili ishte komandant i Batalionit të Rinisë, e shumë të tjerë. Edhe pse ishte e pushtuar Kosova, ajo edhe më tej trajtohej si zonë e rrezikshme dhe e pasigurt për shkak se banohej me një popullsi shumicë jo sllave, e shtypur dhe e diskriminuar¹³, andaj edhe ekzistonte frika tek okupuesi.

Kosova pas Kuvendit të Prizrenit (10 korrik 1945)

Pozita e Kosovës pas vitit 1945 ishte okupuese dhe kolonizuese. Kjo gjendje u legjitimua më 10 korrik 1945 në Kuvendin e saj që në popull më tepër njihet si Kuvendi i Prizrenit. Kuvendi i Prizrenit, ishte një tubim i një trupi jo të zgjedhur¹⁴ nga populli në të cilin morën pjesë 137 delegatë dhe të ftuar të tjerë, nga të cilët vetëm 32 ishin shqiptarë. Në të nuk kishin marrë pjesë përfaqësuesit e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë dhe të aleatëve të tjerë të luftës që ishin garantë, se pas përfundimit të luftës çështja e Kosovës do të zgjidhej në bazë të dëshirës dhe vullnetit të lirë të popullsisë shumicë. Siç dihej, në këtë Kuvend u vendos që Kosova t'i bashkohej Serbisë dhe po ashtu në këtë tubim u miratua Rezoluta që në një mënyrë mund të quhej dokument i parë zyrtar që legjitimoi aneksimin e saj nga Serbia. Sipas të dhënave thuhej se rreth rezolutës dhe përmbajtjes së saj nuk u hap ndonjë debat. Shumë pak delegatë diskutuan në mbledhje. Ata që ishin kundër dhe

KNÇ-së së Kosovës, në të cilën thuhet se “Liria e juaj, qëndron në luftën tuaj, sepse vetëm lufta e armatosur, e përbashkët kundër okupuesit dhe ndihmësve të tij është rruga me të cilën sigurohet liria dhe e drejta për vetëvendosje dhe shkëputje”. Në këtë mbledhje u zgjodh edhe udhëheqja e re prej 9 vetave (7 shqiptarë, 2 serbë e malazezë).

¹³ Fehmi Agani, *Demokracia, Kombi, Vetëvendosja*, Pejë 1994, f. 77.

¹⁴ Lulzim Mjeku, “Të gjitha Kushtetutat e Kosovës”, 1 (?).

shprehën pakënaqësinë dhe kundërshtimin e bashkimit me Serbinë, më vonë patën pasoja të mëdha. Ata u përcollën nga organet e UDB-së (Unutrašnja državna bezbednost - Sigurimi i Brendshëm Shtetëror), më vonë u arrestuan, u dënuan me vite të shumta burgu, bile disa nga ata edhe u likuiduan fizikisht. Njëri ndër ta padyshim se ishte atdhetari e patrioti i Anamoravës, Ramiz Cërrnica, por, ajo që e karakterizon dhe i siguron vendin e respektuar në panteonin atdhetar ishte fjalimi i tij në Kuvendin “e famshëm” të Prizrenit më 1945. Me trimërinë, guximin dhe mençurinë që kishte, doli hapur kundër qëndrimeve aneksioniste serbe dhe hapur e shprehu dëshirën dhe dëshpërimin e tij, duke iu thënë të pranishmëve se kjo është tradhti dhe se: “Jugosllavia e re, për popullin shqiptar nuk ka asnjë ndryshim nga Jugosllavia e vjetër. Ju ende nuk e keni bërë vetëm edhe një punë, dëbimin e këtij populli për në Turqi për të bërë në këtë mënyrë spastrimin etnik të Kosovës nga popullata shqiptare. Prandaj, unë nuk po shoh kurrë një dallim, sepse kjo luftë shqiptarëve nuk u solli liri, por një robëri të re edhe më të keqe...”. Për të vazhduar më vonë edhe me tone më të ashpra. Pas këtij reagimi në sallë krijohet një tollovi e paparë. Delegatët e Kuvendit, fillojnë të shqetësohen për jetën e tij. Disa nga ata ishin të informuar dhe e dinin se çfarë kishin përgatitur dhe çfarë i priste jashtë sallës. Pushtetarët ishin përgatitur se në rast të ndonjë të papriture të kësaj natyre, personi do të nxirrej jashtë dhe t’i humbej gjurma. Por, reagimi i Ramiz Cërrnicës i zuri të befasuar, andaj edhe arrestimi i tij i menjëhershëm ishte i pamundur, ngase ata e dinin rrezatimin e tij që kishte të pranishmit, dhe çdo gjë e pamenduar mirë do të krijonte situata me pasoja të mëdha në Kuvend. Megjithatë, Kuvendi përkohësisht e ndërprente punën që të konsultoheshin se çka do të ndërmarrin më tej. Për situatën dhe përgatitjet antishqiptare që ishin përgatitur në këtë Kuvend, dëshmon edhe atdhetari i madh Rifat Berisha pas mbledhjes së Prizrenit, kur ishte kthyer në shtëpi dhe e kishte pyetur axha i tij, Tahir Berisha, se çfarë u vendos në Prizren, ai i kishte treguar se si është “votuar”: “sepse pushkët na rrinin ngrehur nëpër dritare gjatë gjithë kohës sa zgjati Kuvendi”, “Këq paskeni ba, më mirë të vriteshin 40 veta sa ishit aty, se sa më vonë të vriten 40 mijë për të fituar të drejtën e vet

Kosova” - iu ishte përgjigjur plaku i mençur i Drenicës, Tahir Berisha.¹⁵

Kosova dhe populli i saj pa dashje dhe me dhunë ngeli nën okupimin serb e jugosllav. Që nga ky Kuvend, asaj iu desh që vazhdimisht të zhvillojë një politikë rezistuese si në aspektin legal po ashtu edhe në atë ilegal. Pas vendimit të ndërmarr nga ana e Beogradit populli shqiptar ishte i dëshpëruar dhe i pakënaqur me statusin e imponuar. Atdhetarët intelektualë, pas kësaj nuk qëndruan duarkryq. Populli i dëshpëruar tej mase, menjëherë filloi organizimet në terren dhe gjatë kësaj kohe u formuan dhe vepruan shumë individë, grupe e organizata ilegale që qëllim suprem patën çlirimin nga okupimi dhe bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare që kishin ngel nën ish-Jugosllavi me shtetin amë.

Vitet që kaloi Kosova nën ish-Jugosllavi, ishin vite të mbarsura me plotë dhunë e terror. Viti 1945, startoi me burgosje e likuidime të shumta që bëheshin ndaj shqiptarëve. Por, vitet e mëvonshme karakterizohen me dhunë edhe më të shtuar. Koha e Byrosë Informative, përsëri në burg hedhë intelektualët e pakët shqiptarë, duke i dënuar me vite marramendëse burgu. Aksioni i Mbledhjes së Armëve në historinë e popullit shqiptar shënohet me dhunë të intensifikuar, duke bërë nga ana e udbashëve përgjimin e elitës udhëheqëse shqiptare, duke i bastisur shtëpitë, duke i shkallmuar dajak, duke i gjymtuar e mbytur zajave e përroskave. Aksioni i Mbledhjes së Armëve sipas të gjitha dokumenteve thuhej se u organizua nga pushteti dhe u aplikua vetëm ndaj shqiptarëve, gjoja se ata po përgatitnin kryengritje kundër Jugosllavisë.

¹⁵ Ragip Megjuani, “A kanë qenë udhëheqësit e vjetër shqiptarë të Kosovës të viteve 1945-1989 më kombëtar”, www.forumishqiptar.com/threads/80520-A-kanë-genë-udhëheqësit-e (6 maj 2016).

Rezoluta e Kuvendit Popullor të Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit Prizren, 10 korrik 1945

Kuvendi Popullor i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit konstaton faktin e gëzueshëm se rrethanat në Krahinë janë rregulluar dhe janë normalizuar deri në atë masë sa është bërë e mundshme që të zhvillohet puna e përshtatshme në fusha të ndryshme të jetës shoqërore, ekonomike e kulturore. Ky fakt pasurohet edhe në ngritjen e të gjitha organeve të pushtetit popullor, në zgjedhjen e këshillave popullore të vendit, këshillave popullore të rrethit dhe të Kuvendit Popullor, si dhe në mbledhjen e këtij Kuvendi Popullor, në organizimin e gjykatave dhe të organeve të tjera të pushtetit civil që i kanë marrë përsipër të gjitha punët në Krahinë pas heqjes së Pushtetit Ushtarak. Popullsia e kësaj Krahine gëzon sot begatitë e veta të demokracisë së re jugosllave dhe të pushtetit me të vërtetë popullor, i cili ka dalë nga lufta shumëvjeçare e të gjithë popujve të Jugosllavisë kundër okupatorit fashist. Meqenëse puna në përforcimin e mëtejshëm dhe në zhvillimin të organeve të tashme të pushtetit popullor dhe puna në lidhjen e tyre me masat e gjera popullore është kusht për mbrojtjen dhe përforcimin e mëtejshëm dhe në zhvillimin e mëtejshëm të fitoreve të Luftës Nacionalçlirimtare, edhe pse të gjitha këto, janë ndihma jonë për Jugosllavinë Demokratike Federative, atëherë detyra e çdo qytetari është që t'i ndihmojë Këshillit Popullor dhe t'i kontrollojë në punën e tyre.

Fakti më i ndritshëm në jetën e sotme të kësaj Krahine është ndryshimi me themel që është bërë në marrëdhëniet midis popullsisë së kombësisë shqiptare dhe serbëve e malazezëve në saje të Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe të politikës së saj për barazinë dhe vëllazërimin midis të gjithë popujve të Jugosllavisë. I është dhënë fund njëherë e përgjithmonë politikës së zhvillimit të përçarjes dhe të luftës së ndërsjellë të shqiptarëve dhe serbëve, të cilën, në dëm të njërit dhe të popullit tjetër, e kanë përkrahur dhe e kanë nxitur regjimet e mëparshme antipopullore, si në Perandorinë e dikurshme turke, ashtu edhe në Jugosllavinë e vjetër, e gjithashtu edhe pushtetit i okupatorit gjatë viteve të fundit. Për këtë arsye, zhvillimi i

mëtejshëm, thellimi dhe përforcimi i vëllazërimit dhe i bashkimit që tashmë është arritur, është detyrë e shenjë e çdo qytetari të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit pa marrë parasysh përkatësin fetare e kombëtare, dhe parim prijës në punën e të gjitha organeve të pushtetit popullor të ne.

Popullsia shqiptare gëzon sot barazi të vërtetë dhe ka të gjitha mundësitë që, në bashkëpunim me popullsinë serbe e malazeze dhe me ndihmën e Serbisë demokratike dhe të mbar Jugosllavisë Demokratike Federative, t'i angazhojë të gjitha forcat për zhvillimin e vet të plotë kulturor dhe përparimin ekonomik e shoqëror. Popullsia shqiptare e ka sot organizatën e vet politike kombëtare - Komitetin Shqiptar¹⁶, i cili është pjesë përbërëse e Frontit të Përbashkët Nacionalçlirimtar në Krahinë. Një prej fitoreve më të rëndësishme që gëzojnë sot shqiptarët në Jugosllavi është barazia e gjuhës shqipe në administratën shtetërore dhe shkollat në gjuhën mësimore shqipe. E vetëdijshme për këtë pozitë të barabartë, popullsia shqiptare ka dhënë me mija bijë të vet në Armatën e lavdishme jugosllave, kurse shumë shqiptarë që, të mashtruar nga reaksioni, kanë qenë në shërbim të okupatorit, janë çliruar nga ndikimi i dëmshëm i reaksionarëve dhe sot po bashkëpunojnë me gjithë zemër në ndërtimin e jetës së re të

¹⁶ Bëhet fjalë për Komitetin Nacional të Shqiptarëve të Kosovës (KNSHK), i cili ishte formu me urdhrin e KQ-së të PKJ-së dhe punonte në kuadër të FPN-së (Fronti i Përbashkët Nacionalçlirimtar). Këtë vendim e kishte zbatuar Komiteti Krahinorë i PKJ-së për Kosovë. Në mars të vitit 1945 në të gjitha komitetet e rretheve, komunave dhe nëpër fshatra u formuan komitetet e shqiptarëve. Konferenca Themeluese e KNSHK, u mbajt në Prishtinë, më 27 e 28 mars 1945. Konferenca kishte zgjedhur Plenumin e KNSHK dhe Sekretariatit prej 10 anëtarësh. Detyrat primare të KSH ishin: të ndihmonte popullin shqiptar për shfrytëzimin e fryteve të LNÇ-së, për afirmim kombëtar, për çlirim social, për ngritjen politike, kulturo-arsimore, të mësonte për historinë dhe kulturën e popullit shqiptar, të ndihmonte organet e pushtetit popullor për zgjidhjen e të gjitha problemeve në frymën e interesave dhe të kërkesave të popullit etj.

Formimi i Komitetit Nacional i Shqiptarëve të Kosovës mbi të gjitha u formua me të vetmin qëllim që tek popullata shqiptare të krijonte huti se në të vërtetë organet e atëhershme e dinin se sa me sukses po vepronte në ilegalitet Komiteti i NDSH-së, andaj donin të krijonin huti tek popullata shqiptare në Kosovë dhe mund të thuhej se deri diku, kishte pasur sukses.

Krahinës sonë. Prandaj, puna në rindërtimin e vendit, në ndërtimin dhe forcimin ekonomik, është vazhdim i pandashëm i luftës çlirimtare, kusht për krijimin e jetës më të mirë e më të lumtur dhe, për këtë arsye, i bënë të obliguar të gjithë qytetarët e Krahinës sonë që të marrin pjesë në të. Për shkak të rrethanave të vështira, që kanë mbretëruar para një viti e gjysmë në Krahinë, popullsia e kësaj Krahine nuk ka pasur mundësi që të përfaqësohet në seancën e dytë të Këshillit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë në Jajce në nëntor të vitit 1943. Për këtë arsye, populli i kësaj Krahine, me anë të Kuvendit të vet Popullor, të zgjedhur lirisht, vetëm tash mund ta shprehë në mënyrë të lirë pajtimin e vet të plotë me vendimet historike të KAÇKAJ-së, me të cilat i është vënë themeli i fortë Jugosllavisë së re Demokratike Federative dhe lirisë e barazisë së popujve dhe pakicave kombëtare të saj. Kuvendi Popullor Krahinor i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit deklaroi unanimisht se popullsia e kësaj Krahine, si edhe të gjithë popujt e Jugosllavisë, nuk e ka pranuar copëtimin e Krahinës së vet, që kanë bërë okupatorët, as copëtimin e Jugosllavisë, dhe shfaq dëshirën e tërë popullsisë së Krahinës që kjo t'i bashkohet Serbisë federale si pjesë përbërëse e saj. Populli i kësaj Krahine është i bindur se në qeverinë popullore të Serbisë do të gjejë mbrojtje të plotë dhe se nga pushteti popullor i mbarë Jugosllavisë do të jetë i ndihmuar me gjithë zemër në ngritjen e vet politike, kombëtare, ekonomike e kulturore, kurse përfaqësuesit e kësaj Krahine në Kuvendin Popullor të Serbisë dhe në KAÇKJ do të kontribuojnë me të gjitha forcat e veta për ndërtimin e Serbisë demokratike dhe të Jugosllavisë Demokratike Federative¹⁷.

¹⁷ Këshilli Popullor i Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë, 1943-1953, Prishtinë 1954, f. 46-48.

Beqir META

RRETHANAT NDËRKOMBËTARE TË RIPUSHTIMIT TË KOSOVËS

Rrethanat ndërkombëtare që ndikuan në ripushtimin e Kosovës mund të përfshihen në tre elementë kryesorë: në raportet midis Fuqive të Mëdha në Ballkan, në pozitën ndërkombëtare të shtetit shqiptar dhe politikën së tij të jashtme dhe në ndikimin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave.

Raportet midis Fuqive të Mëdha në Ballkan

Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, Fuqitë e Mëdha po skiconin ndarjen e influencave të tyre në botë dhe në Evropë. Në Ballkan shquhej rritja e ndikimit sovjetik. Jugosllavia u la në masën 50% me 50% të influencave perëndimore dhe lindore¹. Rritja e ndikimit rus dhe mbështetjes ruse për Jugosllavinë komuniste, që ishte një risi tërësisht negative dhe e rrezikshme për çështjen shqiptare, do të kishte pasoja dramatike dhe një inkurajim i madh jo vetëm për mbajtjen e Kosovës brenda suazave të Jugosllavisë dhe Serbisë, por edhe për shpërthimin e dhunës dhe terrorit të paparë ndaj popullsisë së saj.

¹ Misha Glenny, *Histori e Ballkanit, 1804-1999*, Toena, Tiranë, 2007, f. 522.

Sikur të mos mjaftonte rreziku i ndërhyrjes sovjetike dhe i objektivave rusomëdha të Bashkimit Sovjetik (BS), çështja e Kosovës kërcënohej edhe nga limitet e interesave dhe mospërputhjet e politikës anglo-amerikane në rajon.

Fuqitë Perëndimore nuk parashikonin ndryshime territoriale në Jugosllavi në favor të shqiptarëve. Për më tepër, ato kishin dallime midis tyre edhe për statusin e ardhshëm territorial të Shqipërisë politike të vitit 1939 dhe disa prej tyre i vinin në diskutim ato.

Nuk mund të anashkalohet kritika për pikëpamjen e shprehur nga ndonjë studiues se Fuqitë Perëndimore qysh në fund të luftës dhanë garanci për ekzistencë e Shqipërisë së pavarur dhe u shprehën qartë për ruajtjen e kufijve të shtetit shqiptar.²

Shtete e Bashkuara të Amerikës (SHBA) gjatë Luftës nuk kishin pranuar të shpreheshin zyrtarisht ose të diskutonin kufijtë e Shqipërisë, ndërsa pas Luftës ata ishin fuqia e vetme që mbështeste rivendosjen e kufijve të vitit 1939 për Shqipërinë.

Britanikët kishin projektuar një copëtim të territoreve jugore shqiptare në favor të Greqisë.³ Kjo politikë ishte formësuar zyrtarisht qysh me Deklaratën e sekretarit të Jashtëm, Eden, më 17 dhjetor 1942. Ajo vijoi e pandryshuar gjatë gjithë Luftës dhe në përfundim të saj deri në Konferencën e Paqes në Paris, në verën e vitit 1946.

Edhe BS-ja nuk e mbështeste ruajtjen e paprekur të kufijve të Shqipërisë. Stalini, qysh më 16 dhjetor 1941, në një takim me Çerçillin ishte shprehur se Shqipëria mund të rimëkëmbej si shtet i pavarur, duke garantuar pavarësinë e saj nga fuqitë e tjera, ose nën garancinë ndërkombëtare. Por, në Protokollin Plotësues dhe Konfidencial të kësaj Marrëveshjeje parashikohej që kufijtë e shtetit shqiptar të paraluftës të mos respektoheshin⁴. Duhet pasur parasysh se ky kontest negativ për kufijtë e Shqipërisë bëhej nga Stalini në dhjetor 1941, kur Moska ishte nën kërcënimin e pushtimit gjerman,

² Paskal Milo, *Fuqitë e Mëdha dhe çështja e Kosovës gjatë dhe në përfundim të Luftës së Dytë Botërore*, në: Konferenca e Bujanit, Tiranë, 1999, f. 46.

³ Beqir Meta, *Tensioni greko-shqiptar, 1939-1949*, Geer, Tiranë, 2002, f. 244-298.

⁴ Ethem Çeku, *Kosova në sfondin e diplomacisë së Jugosllavisë dhe të Shqipërisë 1945-1981*, Prishtinë, 2009, f. 36.

pra kur ai e kishte thikën në fyt. Në të njëjtin takim u ra dakord që shtetit jugosllav t'i njihej e drejta e rimëkëmbjes në kufijtë e paraluftës, madje dhe zgjerimi i tyre drejt Italisë. Pra, rrënjët e mbështetjes ruse për përfshirjen e Kosovës nën Jugosllavi shtriheshin qysh në këtë fazë të hershme të Luftës, kur ende nuk kishte triumfuar majta komuniste në këtë vend ballkanik.

Pas ardhjes në pushtet të komunistëve, të udhëhequr nga Tito, sigurisht që vendosmëria dhe interesi i BS-së për të rikrijuar dhe ruajtur një Jugosllavi të pacenuar nga pikëpamja territoriale dhe sa më të fortë politikisht, u shumëfishuan. Kjo do t'i siguronte avantazhe të mëdha komunistëve jugosllavë dhe në radhë të parë atyre serbë për ta zgjidhur çështjen e Kosovës dhe të shqiptarëve në Jugosllavi në mënyrën më të favorshme për aspiratat e tyre nacionaliste dhe më të disfavorshme për shqiptarët.

Në përgjithësi studimet e organizmave të ndryshme britanike dhe amerikane në fund të Luftës nuk rekomandonin bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Amerikanët në ndonjë rast sugjeronin rektifikime të vogla kufitare, ndërsa britanikët, ndryshe nga ata, ishin më kategorikë që të mos njihnin përfshirjen e Kosovës në Shqipëri dhe sugjeronin se Londra duhej të bënte gjithçka që të parandalonte këtë bashkim⁵.

Midis studimeve amerikane që bëheshin për të ardhmen e Kosovës spikat për sensin më pozitiv kundrejt respektimit të të drejtave kombëtare shqiptare një raport i shefit të Misionit Amerikan në Shqipëri, Jacobs, dërguar Departamentit të Shtetit më 16 gusht 1945⁶. Ky rekomandonte që një pjesë e Kosovës t'i jepej Shqipërisë, por jo e gjithë krahina pasi ajo historikisht kishte qenë e shenjtë për serbët, të cilët ndonëse ishin minoritetet në këtë rajon, kurrë nuk do ta harronin dhënien e gjithë zonës shqiptarëve. Sipas këtij sugjerimi Shqipëria do ta rriste popullsinë e saj me 1/3 e banorëve ekzistues, duke arritur në 1.5 milionë banorë. Në kohën e Konferencës së Jaltës

⁵ Paskal Milo, *Fuqitë e Mëdha...*, f. 49-51.

⁶ United States National Archives, (USNA), Department of State (DS), 875.00/539. Jacobs për Departamentin e Shtetit, 16 gusht 1945.

(4-11 shkurt 1945), Ushtria e Kuqe kishte depërtuar thellë në Evropë. Më 8 shkurt 1945, Tre të Mëdhenjtë në këtë Konferencë i njohën kufijtë e paraluftës së Jugosllavisë, çka u dha forcave jugosllave mbështetjen e duhur legale për të rianeksuar Kosovën dhe për të vendosur regjimin ushtarak atje.

Në Konferencën e Jaltës, Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike (BRSS) dhe Britania e Madhe gjatë diskutimeve midis tyre nuk e përmendën fare çështjen e Shqipërisë, ndërsa Kosovën e konsideronin si çështje të brendshme të Jugosllavisë.

Ndërkohë, gjatë muajve që pasuan në vitin 1945 Jugosllavia kaloi gjithnjë e më shumë drejt BS-së. Kjo solli dhe përplasjen midis Aleatëve Perëndimorë dhe BS në Konferencën e Potsdamit (17 korrik-2gusht 1945), ku Çërcilli deklaroi me zemërim se tashtë raporti i influencës në Jugosllavi kishte ndryshuar 90% me 10%, në favor të rusëve, madje edhe influenca e reduktuar perëndimore ishte bërë subjekt i presioni të fortë të Mareshalit Tito.⁷

Pozita ndërkombëtare e Jugosllavisë

Jugosllavia në fund të Luftës doli një shtet me pozita të konsoliduara në arenën ndërkombëtare. Ajo ishte zyrtarisht një shtet me statusin e vendit aleat, të cilit i njihej një kontribut i veçantë në fitoren kundër nazi-fashizmit. Ajo ishte anëtare e konferencave dhe organizatave të rëndësishme ndërkombëtare, duke filluar qysh nga Karta e Atlantikut deri tek statusi si anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe pjesëtare e Konferencës së Paqes në Paris. Kjo pozitë e konsoliduar ndërkombëtare e bënte të vështirë e thujse të pamundur çdo lloj cenimi territorial të saj jashtë vullnetit të vet shtetëror. Në këtë këndvështrim ajo kishte mundësi të mëdha dhe të patjetërsueshme ta mbronte rianeksimin e Kosovës dhe viseve shqiptare në shtetin jugosllav.

Përveç kësaj, Jugosllavia po ecte në rrugën e aleancës me BS-në dhe kishte përkrahjen e tij në të gjitha drejtimet e politikës së saj

⁷ L.S. Stavrianos, *The Balkan since 1453*, USA, 1958, f. 833.

të jashtme. Ndonëse, marrëdhëniet me Fuqitë Perëndimore në këtë fazë ishin të ftohta dhe armiqësore, Uashingtoni dhe Londra nuk kishin përpunuar ndonjë politikë reagimi, e cila do të planifikonte cenimin e territoreve të saj, dhe në këtë kontekst as shkëputjen prej saj të territoreve shqiptare. Përndimi u mjaftua vetëm me kufizimin relativ të pretendimeve jugosllave në drejtim të Italisë dhe Greqisë.

Pozita ndërkombëtare e shtetit shqiptar dhe politika e tij e jashtme

Vetizolimi dhe politika konfrontuese ekstremiste, që filloi të ndiqte në këtë kohë udhëheqja shqiptare ndaj Fuqive Perëndimore çoi në armiqësinë e fortë me to. Kjo politikë ndikoi që Shqipëria të humbiste edhe atë kapital politik dhe avantazhet që vinin nga pozita e saj si një vend që kishte luftuar kundër Boshtit, ndonëse asaj asnjëherë nuk iu dha statusi i vendit aleat. Në këtë mënyrë ajo nuk kishte shanset e duhura për të mbrojtur me efektivitet interesat kombëtare në arenën ndërkombëtare, midis tyre edhe sigurimin e një pozite më të mirë të shqiptarëve në Jugosllavi.

Në anën tjetër, SHBA-ja dhe Britania e Madhe u shqetësuan seriozisht nga përpjekjet që bëheshin dhe mundësia e përfshirjes së Shqipërisë në Federatën Jugosllave, pasi kjo do të kishte implikime të rrezikshme në Ballkan dhe më gjerë. Kjo ndikoi që vëmendja e tyre të shpërqendrohej më tej nga situata që zhvillohej në Kosovë. Duke u shqetësuar se bashkimi i shteteve komuniste shqiptare dhe jugosllave do të përkeqësonte pozitat e Fuqive Perëndimore në Ballkan dhe në mënyrë të veçantë do të izolonte dhe kërcënonte më tej Greqinë, të cilën Përndimi e kishte përcaktuar si një bastion që duhej mbrojtur me forcë. Britania e Madhe dha shenja se, nëse ndodhte kjo, do të përkrahte më me forcë kërkesat greke për aneksimin e Shqipërisë së Jugut.

Në këtë klimë tensioni midis Fuqive Perëndimore dhe Shqipërisë, i cili pas vitit 1946 do të rritej edhe më tej me përfshirjen e regjimit komunist të Shqipërisë në luftën civile greke, asnjëra nga Fuqitë Perëndimore nuk do ta kthente sadopak vëmendjen nga

Kosova. Jo vetëm që s'mund të bëhej fjalë për t'ia kthyer atë Shqipërisë, por prej Perëndimit nuk pati qoftë dhe një shenjë serioze interesimi për përcaktimin e një statusi më të drejtë të shqiptarëve brenda Jugosllavisë së re dhe asnjë ndjeshmëri kundrejt viktimave të shumta të dhunës së komunistëve jugosllavë ndaj popullsisë shqiptare.

Jo vetëm kundërshtarët, por as edhe aleati kryesor i regjimit komunist të Shqipërisë, pra BS-së, i cili, siç e pohuam më lart, vijonte të ndiqte objektivat tradicionale rusomëdha në Ballkan, në rrethanat e reja të favorshme pas Luftës së Dytë Botërore nuk demonstroi asnjë mbështetje sado të moderuar dhe të vakët për çështjen e Kosovës. Vetëm në një rast gjatë një takimi në vitin 1946 Stalini i kërkoi Titos “të zgjidhte çështjen e Kosovës dhe Metohisë gjatë takimit të pritshëm me Enver Hoxhën në Beograd”⁸. Në të vërtetë, nuk ka të dhëna nëse Stalini kishte rekomanduar ndonjë zgjidhje konkrete, por me sa duket ai kishte udhëzuar vetëm të arrihej një dakortësi midis palëve për këtë çështje, të cilën Tito, sigurisht, që ishte i lirë ta zgjidhte sipas interesave jugosllave dhe ai nuk pati asnjë kundërshti nga Kremli që ta bënte këtë. Ky interesim i Stalinit shërbeu vetëm për ta inkurajuar Enver Hoxhën që ta parashtronte çështjen në takimin me Titon gjatë vizitës në Beograd, pasi ai u informua nga ambasadori i tij në Moskë, Koço Tashko, për udhëzimin e lartpërmendur të Stalinit.

Në këndvështrimin e interesave kombëtare, qoftë nga pikëpamja historike, ashtu edhe nga situata momentale dhe e perspektivës, aleanca me BS-në ishte krejtësisht jonatyrale e inproduktive, por edhe e rrezikshme. Përveç objektivave të vjetra ruse, në qëndrimin negativ të Moskës ndaj çështjes së Kosovës ndikuan edhe rëndësia më e madhe dhe potencia politiko-ushtarake e pakrahasueshme e Jugosllavisë në raport me Shqipërinë. Pikërisht, për këtë arsye, në vitet e para Kremli, qëllimisht kishte vendosur që ndihmat për Shqipërinë t'i lëvronte përmes Jugosllavisë, duke

⁸ Hamit Kaba, Ethem Çeku, *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse, 1946-1962*, Prishtinë, 2011, f. 31.

njohur, jo vetëm dobësinë e Shqipërisë, por edhe duke miratuar e përcaktuar varësinë e saj nga Jugosllavia. Kjo pozitë tejet e dobët kundrejt BS-së që ishte aleati kryesor i qeverisë komuniste shqiptare, pati pasoja tepër të rënda edhe për Kosovën; dobësia dhe paaftësia e Qeverisë Komuniste Shqiptare për të përpunuar një politikë realiste dhe të përshtatshme për rrethanat e asaj kohe, e cila duhej t'i paraqitej me seriozitet dhe argumente BS-ës, i cili ishte fuqia udhëheqëse e shteteve të vogla komuniste.

Ndikimi i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave

Ndikim thelbësor negativ në ripushtimin e Kosovës kanë pasur marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, në thelbin e të cilave ishin marrëdhëniet ndërmjet partive komuniste të Jugosllavisë e të Shqipërisë.

Ndikimi gati urdhërues jugosllav, i cili ishte faktor determinues për prishjen e Marrëveshjes së Mukjes, ishte me rëndësi të madhe për parandalimin e çdo lloj politike kombëtare të Partisë Komuniste Shqiptare (PKSH) dhe më vonë pas përfundimit të luftës të qeverisë që ajo drejtonte. Kjo ndihmoi edhe për të thyer aspiratën nacionaliste shqiptare të përkrahësve të shumtë të bashkimit me Kosovën, të cilët ekzistonin edhe ndërmjet komunistëve shqiptarë. Presioni i grupit projugosllav dhe direkt i Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ) detyroi Enver Hoxhën që të bënte autokritikë dhe të përndiqte si deviatorë të gjithë shokët e tij që ishin shprehur për një Shqipëri Etnike⁹.

Gjithashtu dhe akoma me ndikim më negativ ishte kundërvënia e Partisë Komuniste e Shqipërisë (PKSH) ndaj aspiratës nacionaliste të grupeve të tjera të shqiptarëve për bashkimin me Kosovën. Ndërsa, shpërthimi i luftës civile prej saj dhe ndjekja me forcë e luftës së klasave brenda Shqipërisë pas përfundimit të Luftës Botërore shkaktoi një çarje të thellë kombëtare, duke e minimizuar potencën dhe influencën e kombit shqiptar në limite asgjësuese. Këto

⁹ Jens Reuter, *Shqiptarët në Jugosllavi*, Botimpex, Tiranë, 2003, f. 42.

zhvillime brenda botës shqiptare dhe kursi politik që ndoqi udhëheqja e PKSH-së në marrëdhëniet ndërkombëtare patën një ndikim jashtëzakonisht fatkeq për të ardhmen e Kosovës dhe të gjithë trojeve shqiptare nën sundimin serb dhe grek.

Braktisja e Kosovës mori karakter ndërkombëtar në janar të vitit 1945. Qeveritë jugosllave e shqiptare përfunduan një marrëveshje e cila përcaktonte rikuadrimin e Kosovës e Metohisë në Federatën Jugosllave¹⁰. Në këto momente të para të pasluftës, Shqipëria ishte plotësisht një shtet satelit jugosllav dhe ky fakt ka pasur ndikim të gjithanshëm në pushtimin e Kosovës. Shqipëria ishte projektuar të integrohej në Federatën Jugosllave me ose pa Bullgarinë.

Objektivisht, vendosja e regjimeve komuniste në Jugosllavi e Shqipëri, premtimet e mëparshme të krerëve të PKJ-së se do të ndihmonin në zgjidhjen e drejtë të çështjes së Kosovës, marrëdhëniet e ngushta të krijuara midis udhëheqjeve politike jugosllave e shqiptare gjatë dhe veçanërisht pas Luftës duhej të krijonin, të paktën teorikisht, mundësi për trajtimin pozitiv të problemit të Kosovës. Por, këto mundësi teorike pozitive, të cilat së paku duhej të çonin në realizimin e një pozite më të mirë të Kosovës dhe përgjithësisht të shqiptarëve në Jugosllavi, u shoqëruan nga rrethana të tjera tepër të pafavorshme.

Duke përfutur nga pozita e dobët e shtetit shqiptar, Qeveria jugosllave përpunoi planet që jo vetëm të mos lejonte bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, por edhe të punonte për përfshirjen e Shqipërisë si republikë e 7-të e Federatës Jugosllave. Projektet jugosllave nuk parashikonin bashkimin e Kosovës me Shqipërinë në një republikë të vetme të Jugosllavisë, por Kosova edhe paskëtaj do të vijonte të ishte pjesë e Republikës së Serbisë¹¹.

Qysh në fundin e vitit 1944, midis Qeverisë shqiptare e Qeverisë jugosllave u nënshkrua një Traktat mbi Aleancën dhe Ndihmën Reciproke, i cili nuk u ratifikua dhe nuk u bë i njohur

¹⁰ *Po aty*, f. 43

¹¹ Ethem Çeku, *Kosova...*, f. 60

publikisht. Midis të tjerash, në të flitej për trajtimin e mirë të minoriteteve respektive. Binte në sy trajtimi i shqiptarëve nën Jugosllavi si minoritet i barasvlefshëm me minoritetin sllav në Shqipëri¹². Kjo do të thoshte se udhëheqja komuniste shqiptare nuk dëshmonte asnjë interes dhe vizion për të përcaktuar një status pozitiv për shqiptarët në Jugosllavi, të cilët në asnjë aspekt nuk mund të barazoheshin me pakicën e papërfillshme sllave në Shqipëri. Ose më e pakta që mund të thuhet është se ajo i ishte nënshtruar plotësisht dhe pa asnjë rezervë konceptit sllav për popullsinë shqiptare dhe statusin e saj.

Por, do të ndodhte edhe më keq me Traktatin e Miqësisë dhe Ndhimës Reciproke midis dy vendeve të 9 korrikut 1946, në të cilin shqiptarët në Jugosllavi as që ziheshin në gojë. Enver Hoxha në këtë kohë pohonte se për të dyja qeveritë tani nuk ishte e volitshme të shtrohej çështja e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë¹³. Ai gjatë vizitë së tij në Beograd, në verën e vitit 1946, e shtroi me ndrojtje problemin e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Ai i kërkoi Titos që Qeveria jugosllave të pohonte publikisht në një farë forme perspektivën e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë¹⁴, por u tërhoq shpejt dhe pa bërë asnjë objeksion përballë argumenteve kundërshtuese dhe vendosmërisë së Titos. Edhe pse u tërhoq, shtrimi i këtij problemi duket se shkaktoi pakënaqësi të madhe në udhëheqjen jugosllave, çka dëshmon se sa e vështirë ishte zgjidhja e drejtë e kësaj çështje. Josip Gjergja i deklaroi ambasadorit sovjetik në Tiranë, D. S. Çuvahin, se Enver Hoxha e shtroi në mënyrë të papërshtatshme çështjen e Kosovës dhe të Metohisë. Në vend që të fliste hapur, siç i takon komunistit me komunistin, Enver Hoxha nga

¹² Hamit Kaba, *Relacione të qeverisë komuniste me Demokracitë e Mëdha Perëndimore*, në: Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shekullit XX, Tiranë, 2007, f. 343.

¹³ Islam Lauka, Eshref Ymeri, *Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse*, Toena, Tiranë, 2006, f. 127.

¹⁴ Ethem Çeku, *Kosova*, f. 75.

larg, bëri vërejtje të mëdha dhe në përgjithësi gjatë diskutimit të kësaj çështje ndjehej në siklet dhe jo krejtësisht i bindur”¹⁵.

Enver Hoxha dhe Qeveria shqiptare nuk ishin përgatitur për ta trajtuar me seriozitet dhe në thellësinë e duhur çështjen e Kosovës dhe më gjerë të shqiptarëve në Jugosllavi. Deri më sot debati midis historianëve është zhvilluar më së shumti rreth çështjes nëse ai kishte apo nuk kishte mundësi që të ndikonte apo impononte bashkimin e Kosovës me Shqipërinë.

Duke pasur parasysh rrethanat ndërkombëtare të kohës, pozitën gjeopolitike të Jugosllavisë së pasluftës, si dhe disbalancën e theksuar të forcave midis shtetit jugosllav dhe atij shqiptar, sigurisht që ishte e pamundur që bashkimi kombëtar i shqiptarëve të realizohej në këtë kohë tepër të vështirë. Por, kjo pamundësi nuk mund të shërbejë, siç ka shërbyer deri më sot, për të mbuluar angazhimin, vizionin dhe vullnetin e Qeverisë Komuniste Shqiptare për të luftuar me të gjitha mjetet politike e diplomatike që Kosovës t’i sigurohej një status më i mirë dhe më i drejtë në kuadrin e Jugosllavisë federative dhe që të ndalohej dhuna dhe shtypja e egër ndaj shqiptarëve, e cila në vitet 1945-1946 mori trajtat më të egra. Ishin të gjitha mundësitë që të diskutohej dhe të gjendej mirëkuptim midis dy qeverive për njohjen dhe akordimin e një statusi politik-kushtetues më të avancuar të shqiptarëve në Jugosllavi dhe ndalimin e dhunës së egër që po ushtrohej kundër tyre.

Udhëheqja komuniste shqiptare, pa asnjë formim dhe ndjeshmëri kombëtare, nuk i shtroi kurrë këto çështje madje, edhe më keq akoma, ajo toleroi pa bërë asnjë vërejtje publike, diplomatike ose konfidenciale ricopëtimin e trojeve shqiptare nën Jugosllavi dhe u bë palë që mbështeti forcat komuniste serbo-sllave në goditjen e ashpër të nacionalistëve shqiptarë. Kështu për shembull gjatë diskutimeve me Titon Enver Hoxha e priti ftohtë edhe një propozim të Titos për të marrë masa që lehtësonin lidhjet e shqiptarëve të Kosovës me Shqipërinë gjer në hapjen e kufirit. Tito veproi kështu

¹⁵ Hamit Kaba; E Çeku, *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse 1946-1962*, Prishtinë, 2011, f. 31

për të justifikuar refuzimin që i pati bërë propozimit të lartpërmendur të Enver Hoxhës për Kosovën në bisedimet e verës së vitit 1946 gjatë vizitës së tij në Beograd.

Ibrahim GASHI

**SHABAN POLLUZHA, DREJTUES I LUFTËS SË DRENICËS
NË DIMRIN E VITEVE 1944-1945**

Shaban Polluzha luftëtar i paepur e vizionar

Në historiografinë bashkëkohore hartimi i biografive të personaliteteve të shquara konsiderohet si puna më sfiduese për profesionin e historianit. Sot kur si historishkrues po përkujtojmë 70-vjetorin e Luftës së Drenicës dhe rënien e heroit të kombit, Shaban Polluzha, njërit që ishte sinonim i kësaj lufte, s'kemi se si të mos e themi një fakt evident se historiografia bashkëkohore shqiptare ende nuk ka arritur ta nxjerr në dritë të plotë përmasën dhe veprën e këtij patriotit të madh të kombit tonë. Anatemimi dhe stigmatizimi i qëllimshëm për më shumë se 40 vite i figurës së Shaban Polluzhës dhe luftës së tij nga historiografia komuniste si duket ka ndikuar që edhe pas demokratizimit dhe heqjes së censurës, historiografia jonë nuk ka arritur të përgatis një studim monografik shterues që do ta sillte këtë figurë në tërësinë e dimensionit të saj.

Shaban Polluzha, në gjithë trajektoren e tij jetësore spikat me qëndrimin, vizionin, guximin dhe veprimin e tij. Që në rininë e tij të hershme, duke qenë se jetoi në epokën e zhvillimeve shumë dinamike dhe të kthesës së madhe në historinë e popujve të Evropës, ai dëshmoi një qëndrueshmëri, por edhe largpamësi, duke arritur të

dallos qartë planet pushtuese, sidomos të shteteve fqinje, ndaj hapësirës sonë kombëtare.¹

Menjëherë pas luftërave ballkanike dhe fillimit të Luftës së Parë Botërore, Shaban Polluzha, ishte njëri nga kundërshtarët e regjimeve okupuese. Si burrë i guximshëm, ai fitoi autoritet kur reagoi hapur në takimet me autoritetet bullgare ndaj plaçkitjeve dhe maltretimeve që bënin ushtarët bullgarë në fshatrat e Drenicës. Për këtë ai u arrestua, madje edhe me familjen e tij dhe u mbajt për disa muaj në burgun e Prishtinës.²

Fati i parisë shqiptare në këto vite ishte shumë i vështirë, por edhe i lavdishëm. Pas krijimit të Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene, Shabani ishte emëruar kryetar i Komunës së Verbofcit. Duket shumë vështirë e realizueshme, por Shaban Polluzha ia doli që nga besimi që i kishte dhënë populli dhe autoritetet shtetërore të jetë vetëm në shërbim të popullit. Ai, madje, në mënyrë të vazhdueshme mbante lidhje dhe e ndihmonte Lëvizjen Kaçake. Ai pati disa takime kinse të “rastësishme” me Azem Bejtën. Se ekzistonte një besim dhe respekt i ndërsjellë midis këtyre dy burrave të mëdhenj të kombit, flet dëshmia që kishte lenë një nga bashkëluftëtarët e Azemit. Ky bashkëluftëtar e kishte pyetur Azemin, sepse i besonte Shabanit kur ky është kryetar komune, Azemi ia kishte kthyer më një ton bindës se “edhe po të behej ve” në duart e Shabanit ai nuk do a thyente”³. Kjo u vërtetua shpejt. Pas rënies heroike të Azem Bejtës, Shaban Polluzha u ndje seriozisht i rrezikuar, ndaj dhe u largua për një kohë në Shqipëri bashkë me shumë pjesëmarrës të Lëvizjes së armatosur kaçake. Atje ai pati rast të takohet me Ahmet Zogun të rikthyer në fronin

¹Zahir Kastrati, *Shaban Polluzha sipas burimeve gojore*, punim i masterit në dorëshkrim; Intervistë me Ramadan Kastratin, djalë i Shaban Polluzhës, (Polluzhë, ora 11:35, më 18.05.2013).

²Intervistë me Hajdin Kastratin, kushëri dhe dëshmitar i luftës së Shaban Polluzhës, (Polluzhë, ora 15:33, më 18.5.2013).

³Bedri Tahiri, *Azem Bejtë Galica*, Prishtinë, *Shkëndija*, 2005, f. 167. Intervistë me Ramadan Kastratin, djalë i Shaban Polluzhës, (Polluzhë, ora 11:35, më 18.05.2013).

qeverisës. Në këtë takim Shabani e kishte njoftuar Zogun për gjendjen e rëndë të shqiptarëve në Jugosllavi.⁴

Fillimi i Luftës së Dytë Botërore Shabanin do ta gjejë në Kosovë. Ai u ndodh në mesin e popullit të tij kur Gjermania naziste e sulmoi Jugosllavinë monarkiste dhe e detyroi të kapitullonte pa kusht. Por, nënshtrimi i një monarkie shtypëse për shqiptarët nuk nënkuptoi çlirimin e tyre. Shumë shpejt Kosova u kërcënua nga njësitet çetnike të Drazha Mihajloviqit, të cilat në emër të bashkëpunimit me gjermanët po mësytin Kosovën dhe Sanxhakun. Fronti kundër forcave paraushtarake serbe ishte gjithë vija e kufirit me Serbinë, ndaj dhe secila krahinë e Kosovës po vetëmbrohej me gjithë çfarë kishte nga barbaritë dhe masakrat çetnike. Në këto përballje të drejtpërdrejta me forcat armike ranë heroikisht shumë burra të Drenicës, të Shalës, të Llapit, të Dukagjinit, të cilët ishin bajraktarë apo kryepleq katundesh që ju prinin forcave vullnetare në mbrojtje të atdheut. Shaban Polluzha në këto momente vendimtare ishte në krye të forcave të Drenicës, në mbrojtje të fshatrave të Artakollit e të Çiçavicës. Paraprakisht, në rrethanat e reja që u krijuan, me nismën e disa krerëve të Drenicës u mbajt Kuvendi i Polluzhës, ku u morr vendim për krijimin e Shtabit të Përgjithshmi të Lëvizës për Çlirim dhe Bashkim Kombëtar, në krye të cilit u zgjodh Shaban Polluzha. Ngritja e këtij shtabi dhe formimi i njësitit “Shqiponja” me pesë batalionet e tij i dha impuls dhe organizim të mirëfilltë luftës së shqiptarëve kundër ndërhyrjeve të bandave çetnike.⁵

Duke e vlerësuar si një personalitet me vlera të larta kombëtare Qeveria shqiptare, përkatësisht Këshilli i Naltë, i udhëhequr nga Mehdi Frashëri me dekret e emëroi Shaban Polluzhën kryetar të Komunës së Skenderajt.⁶

⁴ Intervistë me Hajriz Demakun, bashkëluftëtar i Shaban Polluzhës, (Prishtinë, ora 15:08, më 02. 06. 2013).

⁵ Azem Hajdin-Xani, vep. e cit., f. 116-117.

⁶ Kopja e dekretit ruhet në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, Fletorja Zyrtare, 13 prill 1943 -XXI, nr. 40

Kur epilogu i Luftës së Dytë Botërore po dukej në horizont, veçmas pas kapitullimit të Italisë më 1943 dhe hapjes së Frontit Perëndimor në Normandi, qershor 1944, popujt e Ballkanit ishin bashkërrështuar në një front të përbashkët të rezistencës antinaziste dhe se kush po jepte kontributin e tyre në mbështetje të luftës së aleatëve antinazistë. Edhe shqiptarët në Shqipëri dhe jashtë saj në masë të konsiderueshme, sidomos në vitet 1943- 1944, i gjejmë të rreshtuar në këtë front, natyrisht të bindur në vendimet e aleatëve në Konferencën e Jaltës se e ardhmja e popujve të Evropës, por edhe të botës, do të jetë çlirimi dhe vetëvendosja e tyre.

Në këto momente vendimtare të fundit të Luftës dhe vendosjes së fatit të shqiptarëve të Kosovës, Shaban Polluzha, duke besuar vetëm kauzën kombëtare, filloi të dyshonte kauzën ideologjike të komunistëve kosovarë se do të jenë të gatshëm të shkonin deri në fund në mbrojtje të vendimeve të Konferencës së Bujanit. Më 20 nëntor 1944 me iniciativë të Shabanit u mbajt Kuvendi i Drenicës, në lokalet e Komunës së Polacit, me pjesëmarrje të rreth 200 delegatëve nga vise të ndryshme të Kosovës, ku pas diskutimeve të pjesëmarrësve njëzëri aprovuan këto vendime:

1. Formohet Brigada e Drenicës, si Lëvizje politike dhe ushtarake për çlirim dhe bashkim kombëtar;
2. Mobilizohen të gjithë qytetarët prej moshës 16 deri në 65 vjet;
3. Informimi i aleatëve perëndimorë, sidomos ata anglo-amerikanë, për formimin e Brigadës së Drenicës dhe për qëllimin e saj;
4. Formimi i Shtabit Suprem të Lëvizjes Kombëtare për Çlirim dhe Bashkim Kombëtar, më këtë përbërje: Shaban Polluzha-komandant, e Miftar Bajraktari-zëvendëskomandant.⁷

Krijimi i Brigadës së Drenicës u pa me shumë dyshim nga autoritetet komuniste që udhëhiqnin Shtabin Operativ të LNÇ-së për Kosovë e Metohi. Menjëherë iu bë thirrje Shaban Polluzhës për një takim në Mitrovicë, takim ky i cili dështoi pasi Shaban Polluzha,

⁷ Azem Hajdin-Xani, vep. e cit., f. 68-69.

duke dyshuar në qëllimet e mira të këtij takimi, shkoi atje bashkë me gjithë brigadën e tij. Kur filloi takimi, komunistët u përpoqën të shpërndanin luftëtarët e tij, gjoja duke i caktuar në brigada tjera partizane. Sapo e mori vesh këtë, Shabani ndërpreu takimin dhe doli para luftëtarëve të vet dhe të bashkuar u kthyen në Drenicë.⁸

Në ndërkohë partizanët serbë, me apo pa urdhra nga lartë, kishin filluar të kryenin krime dhe masakra në Drenicë. Kjo i acaroi shumë raportet e Brigadës së Drenicës me Shtabin Operativ. Më iniciativën e Fadil Hoxhës u organizua takimi i dytë në Skenderaj.⁹ Edhe takimi në Skenderaj shkoi keq. Shaban Polluzha kishte nxjerrë trupat e shqiptarëve të masakruar dhe për këtë po kërkonte sqarime nga krerët komunistë të Shtabit Operativ.¹⁰ Më në fund u duk se u arrit një marrëveshje sipas së cilës Fadil Hoxha do të garantonte se s'do të kishte më vrasje të tilla, ndërsa Shabani me brigadën e tij do të nisej për në frontin e Sremit.¹¹

Kjo marrëveshje, edhe pse në letër, përmbante pothuaj të gjitha ato që kërkoi Shaban Polluzha, megjithatë ishte vetëm një karrem për të tërhequr Shabanin së bashku me brigadën e tij nga Drenica dhe nga Kosova, në drejtim të Frontit të Sremit në Serbi. Por, edhe Shabani bëri lojën e tij me këtë rast. Ai pranoi në parim nisjen për në frontin e Sremit, por veprimet që mori treguan se ai nuk e kishte ndërmend një gjë të tillë. Shumë shpejt ai thirri një kuvend të dytë të Lëvizjes për Çlirim dhe Bashkim Kombëtar në Polluzhë për të konsoliduar radhët e veta. Ndër vendimet më të rëndësishme të këtij takimi ishte plotësimi i Shtabit Suprem të Lëvizjes për Çlirim dhe Bashkim Kombëtar me anëtarë të rinj, si: profesor Ymer Berisha nga Gjurgjeviku, Marie Shllaku nga Shkodra, Adem Voca nga Shala e

⁸ Kujtime nga Hajriz Demaku - Është marrë nga Bekim Kastrati, gazeta, "Bota So", *Përpjekjet e komunistëve për të ndarë Brigadën e Drenicës*, Prishtinë, nr. 1834, më 13.2001, f. 20.

⁹ Azem Hajdin-Xani, vep. e cit., f. 142.

¹⁰ Kujtime nga Sylë Bilalli dhe Ajet Qirezi - Është marrë nga Azem Hajdin-Xani, *Shaban Polluzha*, Dëshmi dhe kujtime të kronistit të luftë, I, f. 145-147.

¹¹ Kujtime nga Hamzë Istogu, Aruç Istogu dhe Avdyl Kastrati - Është marrë nga Azem Hajdin-Xani, vep. e cit., f. 155-158.

Bajgorës, Rifat Maloku nga Samadrexha, Ndue Përlleshi nga Jagoda, Ukshin Kovaçica nga Kovaçica, Hashim Gjaka nga Oshlani dhe Feriz Boja nga Kërnica.¹²

Për të përmbushur marrëveshjen Shabani lëvizi së bashku me brigadën e tij në drejtim të Podujevës, por vetëm si hap taktik për të vënë në provë zotimin që kishte marrë para komunistëve në takimin e Skenderajt.

Marshimi i Brigadës së Drenicës në drejtim të Podujevës¹³ dhe ndalimi i saj atje për t'u kthyer shpejt në Drenicë, pasi komunistët po shkelnin marrëveshjen e Skenderajt, është fillimi i epokës së lavdishme në historinë e popullit të Kosovës, që fatkeqësisht për shkak të konstelacioneve ndërkombëtare dhe marrëveshjeve midis Aleatëve të Mëdhenj të luftës nuk arriti të kurorëzohet me sukses.

Lufta që filloi në janar 1945 ishte e përmasave të mëdha. Brigada e Drenicës nisi luftimet në një vijë të gjerë të frontit, që shtrihej nga fshatrat e Qyqavicës e që vazhdonte në gjithë hapësirën e

¹² Kujtime nga Murat Nika, Murat Kamberi dhe Halil Xani, marrë nga Azem Hajdin-Xani, *Shaban Polluzha*, Dëshmi dhe kujtime të kronistit të luftës, I, f. 173-174.

¹³ Shaban Polluzha, së bashku me luftëtarët e tij, niset për në Podujevë. Mirëpo, para se të nisej në këtë rrugë Shtabi i Përgjithshëm në krye me Shaban Polluzhën cakton mbajtjen e një mbledhjeje konsultative në vendin e quajtur Kërshi i Beçiqit. Në këtë takim merr pjesë edhe Mehmet Gradica dhe Marie Shllaku. Mbledhja është mbajtur më 19.01.1945, gjatë natës. Mehmet Gradica raportoi pranë komandantit Shaban Polluzha për organizimin e luftëtarëve në Shalë të Bajgorës, në bashkëpunim me Ahmet Selacin. Më 21 janar 1945, forcat ushtarake të Lëvizjes ishin përqendruar në fshatrat: Novosellë, Lum i Madh, Samadrexhë, Dumnicë, Sfaracak e fshatra përreth, gjithnjë duke u përcjellë, në çdo hap nga forcat e armatosura të Divizionit 46 të Serbisë, të Brigadës V dhe I dhe të asaj të Mbrojtjes Popullore të Kosovës. Derisa forcat e Lëvizjes ishin duke qëndruar në fshatin Novosellë e Maxhunit, Shtabi i Përgjithshëm ishte vendosur në shtëpinë e Raif Maxhunit. Derisa Shaban Polluzha ishte duke qëndruar në Novosellë arrijnë lajme nga Prishtina, Mitrovica dhe Vushtrria, se po nxirren njerëzit nga burgjet dhe po pushkatohen. Shih: *Kujtime* nga Murat Nika, Murat Kamberi dhe Halil Xani, marrë nga Azem Hajdin-Xani, *Shaban Polluzha*, Dëshmi dhe kujtime të kronistit të luftës, I, f. 173-174; Azem Hajdin -Xani dhe Behxhet Thaçi, *Ismajl Thaçi, një jetë kushtuar atdheut*, f. 110-111.

Drenicës, duke përfshirë edhe perëndimin e kësaj treve, që shtrihej deri në afërsi të Klinës.¹⁴ Lufta bashkoi shumë luftëtarë të lirisë, të cilët po e shihnin si të vetmen kauzë të drejtë për ta shpëtuar Kosovën nga kthetrat e jugosllavëve. Ajo tërhoqi vëmendjen edhe të aleatëve ndërkombëtarë. Por, komunistët të cilët kishin mbështetje të drejtpërdrejtë të Bashkimi Sovjetik, i cili e konsideronte Ballkanin si zonë të influencës së tij, arritën ta mbanin të izoluar këtë luftë nga ndihmat e mundshme të aleatëve anglo-amerikanë, duke e etiketuar si kundërrevolucion. Për më shumë komunistët jugosllavë, me

¹⁴ Pasi që numri i forcave të Lëvizjes Kombëtare ishte i madh, ata u vendosën në disa fshatra të Artakollit dhe kështu forcat okupuese jugosllave-komuniste bënë çdo përpjekje që ta pengonin depërtimin dhe koncentrimin e forcave të Lëvizjes në rajonin e Drenicës. Për ta penguar këtë, forcat okupuese kishin zënë pikat shumë strategjike rrëzë Qyqavicës dhe ato prej fshatit; Taraxhë, Zhilivodë e deri në Grabofc. Më 25 janar 1945 forcat jugosllave-komuniste kishin rrethuar forcat e Lëvizjes, një pjesë e të cilave ndodhej në Kullën e Ilaz Kollës. Së pari afër kullës shkojnë dy partizanë shqiptarë, të cilët takohen me rojën e luftëtarëve të Lëvizjes dhe prezantohen si luftëtarë të Shaban Polluzhës. Qëllimi i tyre ishte që t'i mësojnë pozicionet e luftëtarëve të Lëvizjes Kombëtare. Pasi kishin arritur qëllimin e tyre ata largohen nga kulla e Ilazit dhe luftëtari Man Perçuku, në shenjë respekti i përcjellë edhe pak më poshtë se sa ku ishte roja e luftëtarëve të Lëvizjes. Dhe partizanët pasi që e largojnë Manin nga roja e sulmojnë dhe e vrasin. Pasi që dëgjohen krismat, luftëtarët bëjnë thirrje që të përgatiten për luftë. Qëllimi i këtij sulmi nga forcat e armikut ishte, likuidimi i Shtabit të Përgjithshëm dhe asgjësimi i Lëvizjes për Çlirim dhe Bashkim Kombëtar. Në këtë betejë, sipas dëshmitarëve, forcat e armikut patën një humbje të madhe, duke lënë të vrarë në fushën e betejës më se 253 ushtarë dhe shumë të tjerë mbesin të plagosur, pa pasur mundësi tërheqjen e tyre nga fushëbeteja. Ndërkaq, u zunë robër lufte 45 ushtarë të armikut, si dhe një sasi e konsiderueshme e armatimit dhe municionit. Nga ana e forcave të Lëvizjes Kombëtare, në fushëbetejë ranë dëshmorë: Man Peruçku, Isuf Veseli, Milazim Veseli dhe Imer Kosumi,¹⁴ ndërsa u plagosën rëndë: Qazim Morina (vdes më vonë në fshatin Likofc. Ka qenë i varrosur deri në vitin 2006), Ferat Koliçi (vdes më vonë nga plagët e marra), si dhe Fata Mustafa. Shih: Kujtime nga Ilaz Kolla, Mehmet Kolla dhe Bislim Kolla - Është marrë nga Azem Hajdin-Xani, vep. e cit., f. 278; Intervistë me Aziz Morinën, bashkëluftëtar i Shaban Polluzhës, si dhe djalë i Qazim Morinës, bashkëluftëtar i Shaban Polluzhës, i cili plagohet në Betejën e Kollës dhe vdes më vonë nga plagët e marra, (Akrashticë, ora 13:18, më 01.07.2013).

bekimin edhe të komunistëve kosovarë dhe të atyre të Shqipërisë arritën të krijonin një front të tërë kundër Luftës së Drenicës.¹⁵

Rënia heroike e Shaban Polluzhës dhe plagosja për vdekje e bashkëluftëtarit të tij të paepur Mehmet Gradica shënon fundin e rezistencës së lavdishme e vetmja e këtij lloji, kundër ripushtimit të Kosovës nga Jugosllavia komuniste.

Konkluzion:

Ne si historianë do të duhej të nxirrnim disa konkluzione të qëndrueshme dhe të drejta lidhur me Luftën e Drenicës (janar-shkurt 1945):

1. Lufta e Drenicës nuk ishte luftë spontane për vetëmbrojtje, por luftë e drejtuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Lëvizjes për Çlirim dhe Bashkim Kombëtar, e udhëhequr nga Shaban Polluzha dhe patriotë dhe intelektualë më nacionalistë të kohës.
2. Lufta e Drenicës ishte qartësisht çlirimtare dhe kombëtare. Ajo kishte bashkuar në një front të gjithë patriotët dhe luftëtarët e lirisë, të cilët dyshuan në qëllimet e komunistëve jugosllavë, që ende pa përfunduar lufta filluan të shtypnin shqiptarët.
3. Lufta e Drenicës ishte përpjekje më serioze e armatosur më kërkesë jetësimin e vendimeve të Konferencës së Bujanit, të cilat kishin qartësuar dëshirën absolute të shqiptarëve të Kosovës për bashkim më Shqipërinë.

¹⁵ Më 8 shkurt 1945 komandanti i përgjithshëm i forcave jugosllave-komuniste, Tito, në Kosovë, vendosi Pushtetin Ushtarak, që mori kompetencat ekzekutive dhe gjyqësore. Në emër të këtij pushteti Kosovën e mbushi me forca ushtarake për ta zhdukur Lëvizjen Kombëtare, në krye me Shaban Polluzhën, si dhe forcat e tjera aktive shqiptare që vepronin në Kosovë. Për ta realizuar qëllimin e cekur më lartë, pushtuesi jugosllav-komunist, në Kosovë i futi këto forca ushtarake: Divizioni, 21, 24 dhe 46 serbë, Divizioni, 52 I Kosovës, Grupi i brigadave, 1, 3, 4, 5 të Kosovës, Brigada e Bokelit dhe Brigada e Malit të Zi, me çka Kosova duhej t'i kishte tri divizione me më se 30 000 ushtarë me teknikën moderne ushtarake, Divizioni i 50-të dhe i 51-të i Maqedonisë, Divizioni i 5-të dhe i 6-të shqiptarë, Korpusi i MP-së i Kosovës dhe shumë njësi të tjera ushtarake me karakter lokal. Shih: Azem Hajdin-Xani, vep. e cit., f. 288-289.

4. Lufta e Drenicës në planin strategjik dhe ushtarak nuk duhet cilësuar si luftë guerile, por si luftë frontale midis dy ushtrive të organizuara dhe të udhëhequra nga shtabet e tyre të përgjithshme.
5. Lufta e Drenicës mbetet përpjekja më serioze e armatosur në hapësirën mbarë kombëtare, që pati synim shkëputjen e shqiptarëve nga ideologjia komuniste ruso-jugosllave dhe lidhjen e tyre me aleatët anglo-amerikanë dhe vendet e demokracive perëndimore dhe Shaban Polluzha në historinë e re të Kosovës mbetet personazhi më i rëndësishëm i cilësuar për vizionin, guximin dhe veprimin e tij. Ai ishte njeriu më vlera të larta kombëtare, një nacionalist dhe luftëtar i paepur i çlirimit dhe bashkimit kombëtar. Ndaj, duke lartësuar veprën e Shaban Polluzhës në përmasën reale të saj, historianët nuk duhet të frikohen se kështu do të minimizojnë figura tjera të lëvizjes nacional-çlirimtare. Detyra e historianit mbetet të shpalos të plotë veprën e secilit, më të mirat dhe të ligat e tij, dhe pastaj i mbetet opinionit lexues të jap vlerësimet e veta, duke analizuar edhe rrethanat e kohës.

Marenglen VERLI

**DISA KONSIDERATA PËR NGJARJET KULMORE
POLITIKO-USHTARAKE NË KOSOVË NË MUAJT E
FUNDIT TË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE**

Shkaqet e armiqësisë shqiptaro-serbe

Raportet armiqësore midis iliro-arbërve dhe serbëve (më pas shqiptarëve), historikisht, zënë fill nga shek. VII e në vijim, kur trevat e të parëve u sulmuan, u grabitën u pushtuan, robëruan dhe u sunduan prej të dytëve për shumë shekuj. I rëndë qe veçanërisht sundimi gati 150-vjeçar në shek. XII-XIII, që kulmoi me Carin e Madh Stefan Dushanin, në mesin e shek. XIII. Armiqësia do të rigjallërohej pas rënies së Ballkanit nën sundimin e Perandorisë Osmane, veçanërisht kur ndodhi konvertimi i shqiptarëve në islam, masivisht pas shek. XVII dhe kur u forcuan nacionalizmat ndërballkanikë në shek. XIX. Ndërkohë, projektet e konfrontimit etnik dhe fetar, shkëputja dhe aneksimi nga Serbia i viseve shqiptare, posaçërisht nga viti 1878, si dhe spastrimi etnik i Sanxhakut të Nishit në vitet 1877-1878 (100-200 mijë shqiptarë), i acaruan më tej marrëdhëniet shqiptaro-serbe. Konfrontimi me serbët i muhaxhirëve shqiptarë në Kosovë e më gjerë, por edhe i çerkezëve etj., të dëbuar pas Luftës së Krimesë më 1855-1856, ishin pasoja të acarimit më tej të raportit serbo-shqiptar. Gjithsesi, kulmi i përplasjes midis të dy

palëve do të vinte në rrjedhën e Luftës Ballkanike e më pas (vjeshtë 1912-deri në vitin 1915).

Për motive etnike, politike, fetare, ekonomike, sociale etj., Serbia në mënyrë institucionale dha goditje të forta mbi shqiptarët, veçanërisht mbi ata të besimit islam, që në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare veriore e lindore, përbënin masën dërrmuese të popullsisë shqiptare (mbi 90%). Ka vend për të hedhur më tej dritë mbi humbjet e gjithanshme që pësuan shqiptarët aso kohe. Gjysma e popullsisë shqiptare e pranishme më 1912 në trevat në fjalë (që me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër në vitet 1912-1913 mbetën jashtë shtetit shqiptar) nuk ekzistonte më në vitin 1918. Nga rreth 850-950 mijë shqiptarë që llogariteshin në prag të Luftës së Parë Ballkanike në këto vise, më 1921 kishin mbetur (sipas regjistrimit zyrtar të shtetit serbo-kroato-sllloven) rreth 700 000 myslimanë (351 010 në territorin e Kosovës së sotme prej 10 908 km² kur gjithë popullsia e saj kishte 439 010 banorë) dhe vetëm 441 000 shqipfolës. Të tjerët ishin vrarë, shpërngulur, ose kishin vdekur rrugëve, pa arritur në asnjë destinacion. Llogaritet se vetëm 2 në tre të ikur mbetën gjallë gjatë këtij tmerri arratisjeje.

Shteti me aparatin e tij të dhunës dhe të administrimit, por jo vetëm ai, edhe popullsia sllave, serbe, malazeze e maqedone, veçanërisht kolonët e ardhur nga vise të tjera, për pesë motivet e sipërthëna kishin ushtruar gjenocid të shfrenuar në viset shqiptare. Përveç ushtrisë e xhandarmërisë, dhjetëra banda çetnike prej mijëra paramilitarësh (rreth 35 banda vetëm në trevat shqiptare lindore) zbatonin politikën e tokës së djegur.

Ajo që vijoi të ndodhte në vitet 1918-1941 është mjaft e njohur. Shqiptarët qëndruan sa mundën, madje luftuan edhe me armë në vitet 1918-1928, por nuk e ndalën dot spastrimin etnik, të nxitur, programuar e institucionalizuar nga shteti, që ata i konsideronte armiq dhe elementë antishtetërorë. Në regjistrimet e vitit 1948, shqiptarët në Jugosllavi ishin më pak se 700 mijë (498 244 në Kosovë) duke mos rikuperuar për 35 vjet as numrin që kishin pasur në vitin 1912. (Atë numër ata mundën ta arrinin vetëm në mesin e

viteve '60-të). Kishin humbur pra popullsia, prona, ishin lënë jashtë zhvillimit arsimor, kulturor, politik, shoqëror etj.

Sllavët, përgjithësisht serbë e malazezë, që në Kosovë (bashkë me kolonët e ardhur në vitet 1918-1941) arritën në 30-35% të popullsisë, u kthyen në popullsi shtypëse, bashkëpunëtore në masë të konsiderueshme e qeverisë në politikën e spastrimit etnik të viseve shqiptare. Është e panevojshme të theksohen më tej argumente për shkaqet e armiqësisë shqiptaro-serbe që ekzistonte në mesin e shek. XX.

Shkaqet e pozicionimit të shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore

Thënë shkurt e thjeshtë, në vitet e Luftës së Dytë Botërore (LDB) shqiptarët u pozicionuan jo shumë me lëvizjen antifashiste, por ishin joaktivë edhe në krahun italo-gjerman.

Në rrethanat e gjendjes në të cilën u ndodhën gjatë viteve 1912-1915 dhe 1918-1941, shqiptarët në vitet e Luftës së Dytë Botërore përjetuan dilema strategjike.

Politika shtetërore, e mbështetur nga një pjesë e konsiderueshme e komuniteteve sllave (vendas ose kolonë të ardhur), në viset shqiptare, goditjet e pësura gati nga çdo familje shqiptare (dhuna, grabitja, shpronësimi, varfërimi me çdo mjet, fyerja nacionale e fetare, denigrimi kulturor, arsimor, social etj.), thelluan distancën dhe larguan bazat e mirëkuptimit e të bashkëpunimit midis popullsisë shqiptare dhe popullsisë sllave. Bashkëpunimi i një pjese të elitës shqiptare me qarqet drejtuese dhe autoritetet vendore serbe ishin koniunkturore, pragmatiste dhe jo mbi baza besimi e respektimi reciprok. Parashtrimi i problemit shqiptar dhe mbështetja në kërkesat e tij sociale dhe ekonomike (por përgjithësisht, me ndonjë përjashtim, jo politike-kombëtare) nga përfaqësues të social-demokracisë serbe e më pas prej Partisë Komuniste Jugosllave (PKJ), ishin të pamjaftueshme për të sanuar hendekun e krijuar midis shqiptarëve dhe serbëve etj., veçanërisht kur është fjala për masat e gjera të popullsisë. Ato patën efekt të pakët vetëm në një numër fare

të kufizuar të rinisë shqiptare, veçanërisht në radhët e disa të shkolluarve, që kishin iluzionin se mund të ndërtoheshin ura bashkëpunimi mbi baza të sinqerta, mbështetur në vlerat më të mira të demokracisë dhe respektimit të të drejtave të kombeve për vetëvendosje, në drejtim të zhvillimit politik-kombëtar dhe përcaktimit shtetëror.

Rreth 40 të dërguarit nga Shqipëria prej Partisë Komuniste Shqiptare në ndihmë të Partisë Komuniste Jugosllave, për organizimin e rezistencës antifashiste në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare, në bashkëpunim me shqiptarët antifashistë vendas atje, që aderonin në PKJ, bënë sa mundën, por ishte e vështirë të thyhej barriera e krijuar pas dhjetëra e dhjetëra vjetëve të konfrontimit të gjithanshëm, në periudhën e fundit të së cilës të dëmtuarit deri në gjenocid kishin qenë shqiptarët. Këta nuk mund të harronin momente të tilla si spastrimi etnik i Sanxhakut të Nishit (1877-1878) dhe përleshjet e përgjakshme për mbrojtjen e Plavës e Gucisë, në vitet 1879-1880, apo të viseve të ndryshme në rrjedhat e Luftës së Parë Ballkanike, si edhe terrorin që shoqëroi pushtimin e vitit 1912, i cili nuk u ndal gjatë gjithë viteve 1913-1915. Veçanërisht, nuk mund të harronin politikën sistematike antishqiptare në periudhën më të fundit 22-vjeçare (1918-1941) të ushtruar nga Mbretëria Jugosllave, autoritetet zyrtare të së cilës, kishin gjetur terren mbështetës në popullsinë dhe kolonët sllavë të indoktrinuara masivisht me ide shovene.

Në një frymë të tillë, ku frontet kishin qenë qartësisht të ndara, ishte e vështirë të identifikojë brenda komunitetit sllav elementet mendjekthjellët e pa ngarkesa nacional-shoviniste dhe aq më pak të gjejë mbështetjen e tyre.

Kështu lëvizja antifashiste në Kosovë e më gjerë gjeti te shqiptarët e të gjitha shtresave shoqërore një komunitet skeptik, hezitues e për rrjedhim, joaktiv në mënyrë masive.

Por, shqiptarët nuk u bënë aktivë as në krahun italo-gjerman dhe as në atë bullgar. Janë të njohur faktet e angazhimit të dobët të shqiptarëve në formacionet, ose në mbështetje të formacioneve nazifashiste, gjatë gjithë periudhës 1941-1944. Në vitin 1943 Italia,

në zonën e saj të pushtimit në Kosovë e në Trevat Lindore, me popullsi rreth 600 000 banorë, kishte në strukturat e përhershme ushtarake të ngritura vetëm 5 mijë vendas të armatosur, me të cilët më pas gjermanët formuan 5 batalione. Në zonën gjermane të pushtimit me kryeqendër Mitrovicën (1941-1943) në xhandarmërinë shqiptare në periudhën prill 1941-verë 1942, figuronin 796 vetë si efektivë. Më pas këta u shkrinë në Rojën Shtetërore Serbe, të porsaformuar nga qeveria e Nediçit me miratimin e gjermanëve. Po në këtë kohë në fshatra kishte rreth 1 000 forca vullnetare (sipas ndonjë të dhëne tjetër 2 500 vetë). Pra, bëhet fjalë për formacione numerikisht të vogla në një territor me një popullsi prej mbi 100 000 banorësh shqiptarë, ndërkohë që çetnikët M. Gjuroviçit të K. Peçancit, si dhe trupat e qeverisë së Nediçit, ishin 4-6 herë më të mëdha.

Në nëntor 1943, Regjimenti Kosova, i krijuar në territorin e Kosovës me ish-forcat e xhandarmërisë, të ABVER-it, etj., me angazhimin e veçantë të Xhafer Devës, numëronte vetëm 1 500 vetë. Ndërkohë, projektet për të krijuar Milicinë Vullnetare Myslimane me 4 000 burra dhe Policinë Ndihmëse, apo forcat ndihmëse, të Ali Bej Dragës, përfunduan si projekte shterpe. Fryti i kësaj përpjekjeje ishte i papërfillshëm.

Në mes të dhjetorit 1943 gjermanët arritën të mobilizonin afërsisht 13 000 shqiptarë. Kjo ishte shifra më e lartë e arritur gjatë viteve të Luftës, por në maj 1944, të mobilizuarit qenë reduktuar në 10 650 vetë dhe veprimtaria e tyre konsiderohej e pasuksesshme. Në muajin shtator të vitit 1944 ky numër do të reduktohet më tej, do të mbeten vetëm 4 600 vetë. Ndërkohë, në viset e okupuara nga Bullgaria, aleatja e Boshtit Fashist, ku jetonin rreth 160 000 shqiptarë, autoritetet bullgare nuk arritën të aktivizonin më tepër se disa qindra vetë.

Historia e Divizionit SS “Skënderbeg” është shumë domethënëse. Sipas raportit të komandantit të këtij divizioni, Schmidt Huberit, nga 6 491 efektivë të tij, vetëm gjysma ishin shqiptarë, kurse veprimet që kreu divizioni qenë të kufizuara dhe aspak të kënaqshme. Ai veproi vetëm në Kosovë dhe i njihej si sukses

arrestimi i 281 hebrenjve dhe asgjësimi i një organizate komuniste prej 210 aktivistësh. Në tetor 1944 ky divizioni kishte mbetur me një efektiv prej 3 425 vetash dhe ndër ta vetëm 533 ishin shqiptarë.

Qëndrimi i sipërpërmendur i shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore, tashmë është i argumentuar nga studiuesit. Simpatia tradicionale për italo-gjermanët, e krijuar herët për mbështetjen e dhënë nga Italia e Austro-Hungaria në planin diplomatik, por jo vetëm në të, veçanërisht në Konferencën e Londrës 1912-1913, kur u njoh krijimi i shtetit të pavarur shqiptar është e njohur dhe nuk ishte pa efekt edhe më 1941/1944. Por, Boshti Fashist, që do të rezultonte humbës i Luftës, për fatin e shqiptarëve, nuk investoi në planin ushtarak e më gjerë në mënyrë të tillë që të tërhiqte ata pas vetes. Ai në fazën e parë të Luftës Botërore nuk e shihte me përparësi Ballkanin si zonë luftimesh dhe ishte i interesuar për prapavija të qeta. Në këtë kuadër llogariste jo vetëm shqiptarët, por edhe serbët dhe popujt të tjerë të ish-Jugosllavisë. Në fazën e dytë të rënies, pas vitit 1942, nuk kishte as potencialet e nevojshme për të ngritur struktura të mëdha e të fuqishme ushtarake me shqiptarë. Duhet theksuar se në këtë kohë elita politike, apo paria shqiptare e Kosovës dhe më gjerë, i ndiqte me vëmendje zhvillimet ndërkombëtare dhe analizonte me saktësi rrjedhën e Luftës dhe rënien e fuqisë së koalicionit fashist.

Por, shqiptarët ishin skeptik edhe ndaj aleancës antifashiste. Ndaj ata me mjaft hezitim, me pjesëmarrje të pakët, veçanërisht në fillim kur vullnetarizmi ekzistonte, u përfshinë në formacionet antifashiste të rezistencës, ose në strukturat partiake të PKJ-së, që drejtonte këtë rezistencë.

Për shqiptarët aleanca antifashiste kishte dy mungesa të mëdha dhe i vinte ata në një situatë tragjike. Asnjë premtim konkret për realizimin e aspiratave kombëtare të shqiptarëve nuk bëhej, kurse u kërkohej bashkëpunim me komunitetin sllav, që përgjithësisht në dekadat e fundit kishte lënë gjurmë negative me qëndrimin e mëparshëm zyrtar e jozyrtar ndaj popullsisë shqiptare. Vetë Partia Komuniste Jugosllave në politikën e saj për forcimin e lëvizjes antifashiste në ish-Jugosllavi ishte e interesuar më tepër të bënte për

vete Serbinë e serbët dhe maqedonët, se shqiptarët e Kosovës dhe të trevave të tjera. Edhe vetëm një llogaritje fare e thjeshtë matematikore, sillte dy alternativa zgjedhjeje, të fitohej simpatia e 5-6 milionë serbëve e maqedonasve, apo e 700 mijë shqiptarëve.

Shkaqet e qëndrimit të PKJ-së dhe LANÇL ndaj shqiptarëve

Problemin shqiptar drejtuesit e PKJ-së jo vetëm nuk e trajtuan sipas parimeve të deklaruar, por, që gjatë luftës, dëshmuan tendencën që ta zgjidhnin nga pozitat e forcës dhe kundër interesave të shqiptarëve. Jo thjesht llogaria e sipërpërmendur dhe llogaritje të politikës perspektive, por edhe sentimente të vjetra të natyrave nacionale, fetare, kulturore etj., përcaktuan orientimin e PKJ-së. Vendimet e njohura të Konferencës së Bujanit të 31 dhjetorit 1943-2 janarit 1944, u hodhën poshtë nga drejtuesit e PKJ-së, kurse në dimrin e vitit 1944 e më pas, nën justifikimin e luftës kundër “reaksionit” dhe “bashkëpunëtorëve” të fashizmit, ata urdhëruan rifillimin e terrorit masiv mbi popullsinë shqiptare.

Shqiptarët kuptuan se jo vetëm nuk kishin gjasa të vetëvendosnin për të ardhmen e tyre, por nuk do të trajtoheshin as njësoj si popujt e tjerë në Jugosllavinë e pasluftës, madje do të konsideroheshin një pakicë nacionale e padëshiruar, trojet e të cilës duhej të inkuadroheshin të copëtuara nën njësi politike të administruara nga kombet sllave.

Duke përvetësuar idetë shovene të regjimit të mëparshëm, Partia Komuniste Jugosllave dhe drejtuesit e Lëvizjes Anitfashiste Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë (LANÇJ), zbatuan veprime pragmatiste që do të restauronin shtetin e paraluftës, madje edhe më të zgjeruar e me këtë u forcuan edhe qëndrimet e veprimet antishqiptare, të cilat do të merrnin format më të shëmtuara të terrorit e të gjenocidit.

Synimi për të mos lëshuar asnjë pëllëmbë toke nga territoret e Jugosllavisë së paraluftës dhe në këtë kuadër përkëdhelja e synimeve të elitave të popujve sllavë fqinje të afërt të shqiptarëve, serbëve, maqedonëve e malazezëve, për të qeverisur territoret shqiptare si

koloni, përcaktuan qëndrimin e njohur të PKJ-së dhe drejtuesve të LANÇLJ-së ndaj shqiptarëve në tërësi. Në rrethin e afërt të kryekomunistit dhe kryepartizanit, kroatit Tito, ndoshta llogarisnin edhe se nuk kishte për të zgjedhur midis përkrahjes së disa qindra mijërave shqiptarëve, që gjithnjë do të kishin sytë nga Shqipëria dhe disa milionë serbëve, që do të donin të ishin gjithnjë pjesë e Jugosllavisë, ndaj duhej të mos liheshin fort të pakënaqur kur në shtetin e ringritur jugosllav nuk do ta shihnin veten aq të privilegjuar sa në Jugosllavinë e Karagjeorgjeviçëve. Në qëndrimin jugosllav ndaj shqiptarëve ndikoi, gjithashtu, edhe terreni i përshtatshëm antishqiptar e antimysliman, që ekzistonte në popullsitë sllave të Jugosllavisë, si edhe tendenca dhe qëndrimi konsensual i faktorit ndërkombëtar të kohës, për të rikrijuar shtetin jugosllav pas LDB-së.

Konceptet e qëndrimit shovene dhe demagogjia e PKJ-së ndaj shqiptarëve, të cilat konvergjuan në terror të egër, si dikur, nën etiketën: “luftë kundër reaksionit shqiptaromadh”, kishin kështu synimin që Kosova dhe trevat e tjera shqiptare të mbeteshin patjetër në Jugosllavi dhe popullsia shqiptare të paaftësohej edhe për të ardhmen, për të ndërmarrë veprime që mund të sillnin shkëputjen nga ky shtet për t’u bashkuar me Shqipërinë. Në të vërtetë, synimet dhe veprimet e qarqeve drejtuese të LANÇJ-së i favorizonte kontrolli i situatës në Jugosllavi, qëndrimi strategjik i aleancës antifashiste dhe paaftësia e plotë e Partisë Komuniste Shqiptare (PKSH) dhe drejtuesve të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare në Shqipëri (LANÇSH), në pozicion plotësisht të varur e servil në këtë kohë, për të kundërvepruar në mbrojtje të bashkëkombësve shqiptarë në Kosovë e në viset e tjera shqiptare.

Shkaqet e revoltës së Drenicës

Shqiptarët u ngritën masivisht në revoltë në dimrin e vitit 1944-1945. Po pse pikërisht në këtë kohë?

Argument është përcaktimi arbitrar i PKJ-së për të ardhmen e tyre dhe terrori që u ushtrua mbi popullsinë shqiptare. Unë mendoj se në krye si faktor, duhet vënë, pikërisht terrori.

Ata që dinin se çdo të bëhej, ose më mirë që e parashikonin këtë, ishin të pakët dhe, ose ishin pjesë e LANÇJ-së, e ndaj e kishin të vështirë të reagonin, ose ishin pjesë e elitës së vjetër, pjesërisht të larguar nga Kosova, pjesërisht pa autoritetin e dikurshëm, meqenëse nuk bënë pjesë në taborin e fitimtarëve. Por terrorin, të cilin dëshmitarët e kohës, na e kanë përshkruar me skena ngjethëse, e ndjenin të gjithë. Kjo i bëri bashkë shqiptarët, kjo i ngriti me armë në dorë banorët e trevave tradicionale të qëndresës, si: Drenica, Ferizaj, Shala e Bajgorës, kjo i ktheu nga rruga e i rreshtoi përkrah kryengritësve drenicas edhe disa reparte partizane kosovare, si brigada e Shaban Polluzhës.

Shtypja e përgjakshme e revoltës u pasua nga vendosja e Administratës Ushtarake në Kosovë më 8 shkurt 1945, për të vijuar në mënyrë të organizuar shtypjen e çdo shfaqjeje të pakënaqësisë së popullsisë shqiptare e për ta detyruar atë të pranonte çdo vendim për copëtimin e trevave shqiptare në Jugosllavi dhe për aneksimin e Kosovës si “oblast” (qark) në Republikën e Serbisë, sikurse u veprua në mbledhjen e manipuluar, apo në të ashtuquajturin “Kuvendin e Prizrenit”, të 8-10 korrikut 1945.

Për revoltën apo Luftën e Drenicës, historiografia dhe qarqet politike të “Jugosllavisë së re” të Titos kanë përdorur etiketimin “rebelim”, ose “revoltë kundërrevolucionare” e “shqiptarëve që mbajtën qëndrim armiqësor kundër LANÇ”, për shkak se nuk dilnin dot nga primitivizmi dhe synonin të ruanin “privilegjet” e siguruara në kohën e fashizmit.

Tezave të sipërpërmendura mund t’u jepet përgjigje, ndër të tjera, përmes këtyre pyetjeve: E para, si shpjegohet shpërthimi i “revoltave” pas largimit të trupave gjermane, dhe e dyta a mund të quhet luftë kundër reaksionit shqiptar terrori deri në gjenocid mbi popullsinë civile pa dallim moshe e gjinie.

Nuk ka dyshim se shqiptarët u revoltuan kur panë jo vetëm humbjen e çdo perspektive për realizimin e aspiratave të tyre, por kur një terror i pashembullt filloi të ushtrohej ndaj tyre nga “çlirimtarët”. Forcës së re politike që po merrte pushtetin në “Jugosllavinë e re” i interesonte ngritja e shqiptarëve, për t’i goditur e gjuhëzuar

plotësisht ata. Sa më “reaksionare” të dukej Kosova aq më lehtë do të argumentohej mbajtja e saj në Jugosllavi, duke përdorur edhe dhunën. Tito kishte *miratimin* e koalicionit antifashist të *të mëdhenjve* për të restauruar Jugosllavinë Federative jo vetëm në kufijtë e vitit 1941, por edhe në kufij më të gjerë.

Shkaqet e qëndrimit të Partisë Komuniste Shqiptare

E dobët, servile, që prej themelimit, me një lob në mos agjenturë të fuqishme në elitën drejtuese, por edhe për shkak të qëndrimit të faktorit ndërkombëtar që nuk e kishte në konsideratë, Partia Komuniste Shqiptare dhe regjimi i ri në Shqipërinë e pasluftës, i krijuar nën drejtimin e saj, nuk mund të luanin ndonjë rol të rëndësishëm për të ndalur dhunën kundër shqiptarëve në Kosovë e në viset e tjera shqiptare në Jugosllavi, kurse për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë as që mund të mendohej. Dhuna do të pakësohej vetëm pasi u shtyp me gjak qëndresa e shqiptarëve në Jugosllavi dhe filluan të hidhen hapa për përfshirjen e Shqipërisë në Federatën Jugosllave si një republikë e shtatë e saj. Ajo do të rifitonte më 1948 në koniunkturat e njohura të krijuara rishtas, pas acarimit të raporteve midis Moskës dhe Beogradit dhe pozicionimit të Tiranës përkrah të parës.

Roli i brigadave nga Shqipëria

Ky rol duhet vlerësuar kompleks me aspekte pozitive dhe negative. Repartet partizane të UNÇSH-së zhvilluan disa luftime me forcat nacionaliste shqiptare. Gjithsesi rezistenca ndaj tyre është e pakët krahasuar me rezistencën që ndeshën formacionet e UNÇJ-së, ose ato bullgare, të cilat depërtuan në Kosovë dhe në vise të tjera shqiptare. Për partizanët nga Shqipëria nationalistët kosovarë që iu kundërviheshin konsideroheshin “reaksionarë” dhe “bashkëpunëtorë të fashizmit”. Në brigadat shqiptare gjetën strehë shumë të rinj kosovarë, por pati prej tyre që dhe u dorëzuan për shkak të akuzave të ngritura nga jugosllavët. Gjithsesi, për partizanët shqiptarë,

kosovarët ishin bashkëkombës, që nuk duhej të masakroheshin. Por, ata nuk ndiheshin të aftë të pengonin serbët, malazezët ose maqedonët që ta bënë këtë.

Gjithsesi, drejtuesit e partizanëve shqiptarë u bënë evidentues të krimeve të serbëve, por pa shfaqur fuqi ndaluese. Raporte të individëve që drejtonin repartet e UNÇSH-së dhanë një pasqyrë reale të situatës atje dhe të gjendjes së popullsisë shqiptare, por ato përgjithësisht për momentin vetëm u protokolluan.

Prania e reparteve partizane të UNÇSH-së në Kosovë mund të konkludohet se pati realisht një impakt të trefishtë. Së pari, lehtësoi riokupimin e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nga formacionet partizane të UNÇJ-se; së dyti, reduktoi disi, qoftë edhe përkohësisht, terrorin e këtyre në zonat e dislokimit; dhe, së treti, formacionet e UNÇSH-së, u bënë strehë e shumë të rinjve shqiptarë që, duke u përfshirë në to, i shpëtuan terrorit.

Shkaqet e Masakrës së Tivarit

Ngjarja është e njohur. Janë diskutuar kryesisht shifrat për numrin e të të masakruarve, por debat ka pasur edhe për shkaqet. Cilat, pra, ishin shkaqet që ndodhi masakrimi në Tivar, njëherësh e brenda pak minutash, i qindra djemve shqiptarë, që ishin rekrutuar për t'u çuar në front kundër forcave gjermane në Srem e në viset e tjera veriore të Jugosllavisë?

Natyrisht, bëhet fjalë për një kompleks faktorësh me ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikuan në masakrimin e pashembullt të shqiptarëve në Tivar dhe jo vetëm aty, në fund të Luftës së Dytë Botërore. Në rastin konkret armët u shkrehën nga efektivit i një batalioni të Brigadës së 10-të Partizane Malazeze (të Divizionit të 46-të), që shoqëronte në rrugën Shkodër-Tivar grupin prej 2 382 rekrutësh shqiptarë të nisur nga Prizreni më 26 mars 1945, por edhe nga “këshilltarë e infermierë”, dhe pjesëtarë të “gati të gjitha institucioneve civile dhe ushtarake që ndodheshin në Tivarin e Ri”, me një fjalë nga “të gjithë ata që ishin në atë moment aty dhe

kishin armë”.¹ Masakra, sikurse pranohet në dokumentacionin jugosllav të cituar, ndodhi në sy të komandantit dhe komisarit të Brigadës së 10-të Malazeze.

Së pari, efektivat e batalionit malazez ishin bijë të një popullsie të indoktrinuara prej disa brezash me ide të theksuara antishqiptare. Për ta shqiptarët ishin armiq tradicionalë, ishin ish-sunduesit dhe njëherësh përfaqësuesit e fesë armiqësore myslimane.

Së dyti, efektivat e batalionit ishin përgatitur nga propaganda që eprorët e tyre t’i shihnin shqiptarët si “reaksionarë” e “bashkëpunëtorë të fashizmit”.

Së treti, në luftimet për shtypjen e *Revoltës së Drenicës*, brigada malazeze, ku bënte pjesë batalioni që kreu Masakrën e Tivarit, kishte pësuar humbje të rënda, rreth gjysmën e efektivave. Shumëkush me këtë rast kishte mllef ndaj shqiptarëve për shokët e vrarë.

Së katërti, në përbërje të batalionit, sikurse dhe në shumë formacione të tjera partizane të UNÇJ-së, ishin infiltruar shumë fanatikë nacionalistë të ish-formacioneve çetnike malazeze, serbe, maqedonase etj. Këta nacionalistë shovenë të konvertuar në muajt e fundit të luftës, kishin pasur në programet e organizatës ku kishin bërë pjesë dhe në ideologjinë me të cilën ishin formuar, *alergjinë patologjike për gjithçka ishte shqiptare*. Ata kishin luftuar konkretisht për spastrimin etnik të viseve shqiptare dhe e konsideronin detyrë “patriotike” likuidimin fizik të shqiptarëve.

Së pesti, duhet theksuar se edhe faktori ndërkombëtar, përkatësisht fuqitë e koalicionit antifashist, fituese të Luftës së Dytë Botërore, kishin krijuar në elitën drejtuese, por edhe gjerësisht në shtresat e ndryshme të popullsisë, një opinion negativ për vendet dhe popujt që në një mënyrë apo në një tjetër kishin qenë terrene të konsideruara “profashiste”. Mbi këtë bazë ato në Ballkan u lanë dorë të lirë grupimeve aleate, në rastin konkret partizanëve të Titos, të shpartallonin kudo popullsitë e përfshira masivisht në aksionet e

¹ Arkivi i Luftës Nacinalçlirimtare, MMP të RFJ, Dokumenti, nr. rendor 41-1/5, I. 1411, dt. 08.04.1945, f.1-2.

Boshtit (si në rastin e qindra mijërave gjermanëve të Vojvodinës dhe të italianëve të Bregdetit Dalmat) madje edhe popullsive disi të paangazhuara, ose të papërfshira mjaftueshëm në luftën antifashiste. Në dokumentet jugosllave shënohet se në kohën që ndodhi masakra e Tivarit “në momentin e qitjes, një “xhip” me amerikanë u afrua shumë afër vendit të ngjarjes. Fatmirësisht, shkruhet në dokument, disa nga udhëheqësit tanë i kthyen dhe i larguan drejt Ulqinit”.²

Së gjashti, ndër fuqitë drejtuese të koalicionit antifashist, për sa u përket aleatëve jugosllavë, përkatësisht partizanëve të Titos, me kontribut të veçantë luftën antifashiste të popujve të Ballkanit, ekzistonte një vlerësim i lartë dhe njëkohësisht mendimi se u duhej dhënë satisfaksioni për të vepruar si të mundnin për ringritjen e shtetit jugosllav dhe të rolit të tij në rajon, rol ky i përcaktuar në takimet e Trojkës, përkatësisht të F. Rusveltit, J. Stalinit, U. Çerçillit në Jaltë, Potsdam etj.

Gjatë shumë dekadave pas Luftës së Dytë Botërore, rreth masakrës së Tivarit ka pasur paqartësi, manipulime, lidhur me vetë ngjarjen, shkaqet, shifrat e publikuara etj. Përmes kësaj kumtese u hodhën disa mendime e vlerësime për çka ndodhi, si ndodhi e pse ndodhi. Për të ndodhur një krim duhet të ekzistojë arsyeja ose dëshira për ta kryer, kushtet për ta kryer dhe mundësisht garancia ose shpresa që ai të mos ndëshkohet. Besoj se në këtë kumtesë u dhanë argumente se ekzistonte një situatë kur synimi dhe gatishmëria për të terrorizuar shqiptarët ekzistonte nga të dy krahët e orientimeve politike jugosllave. Çetnikët e kishin në program shfarosjen e shqiptarëve, kurse komunistët likuidimin e kundërshtarëve politikë. Fakti se para dhe pas momentit të masakrës së Tivarit, ka përgjithësisht një vijë të qartë të politikës antishqiptare nga drejtuesit e LANÇ-së jugosllave, është domethënëse. Kur ndodhi Masakra e Tivarit porsa ishte shtypur kryengritja e Drenicës (janar-shkurt 1945) dhe po ideohej farsa e Prizrenit, që në korrik 1945 do ta përcaktonte Kosovën një “oblast” (qark) të Republikës së Serbisë. (Më 8. II.- 5.

² Po aty; shih edhe Fatos Beja, *Krim lufte në Tivar* (Raport për komisionin Parlamentar), Tiranë: Klean, 2013, f. 56-60.

VII. 1945 u vendos administrata ushtarake, më 7-8 prill u zhvillua mbledhja e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Serbisë, më 8-10 korrik 1945 zhvilloi punimet Kuvendi i Këshillit Popullor për Kosovën e Rrafshin e Dukagjinit i cili me 137 pjesëmarrës, nga të cilët vetëm 32 shqiptarë mori vendimin pa votim që Kosova të jetë qark i Serbisë dhe më 3 shtator kjo gjë u ligjërue nga kryesia e Kuvendit Popullor të Serbisë). Në këto rrethana është e qartë se për masakrën e Tivarit mban përgjegjësi direkte elita politike jugosllave e kohës, pra PKJ-së, por, për qëndrim servil e paaftësi për të reaguar, edhe elita politike shqiptare komuniste në Shqipëri dhe në Kosovë (faktet vetëm evidentoheshin dhe raportoheshin në kupolën e PKSH-së, por asnjë reagim me efekt frenues, madje as denoncues, nuk pati). Kjo elitë përgjegjësi mban edhe për propagandimin te repartet e saj partizane se viset veriore e verilindore shqiptare ishin zona “reaksionare”, siç ndodh edhe me Fuqitë e Mëdha, që përcaktuan të ardhmen e vendeve të rajonit, duke neglizhuar trajtimin me realizëm aspiratave të kombit shqiptar, të lëvizjes së tij antifashiste dhe të shtetit shqiptar.

Masakra e Tivarit i kushtoi shqiptarëve disa qindra të vrarë e të plagosur. Por, nuk ishte ky i vetmi rast kur shqiptarët u masakruan. Masakra masive pati edhe në Drenicë, në Gjilan, në Ferizaj, në Vuçitërnë, në Gostivar, në Tetovë. Një bilanc i saktë deri sot ka munguar, por shifra e pranuar gjithsesi është mjaft e lartë dhe sillet në rreth 40 mijë shqiptarë.

Pavarësisht, kohës që ka kaluar, historia nuk duhet të heshtë. Pasqyrimi i realitetit është domosdoshmëri për ta njohur të kaluarën pa deformime me të mirat e të këqijat e saj. Vetëm kështu ngrehina e bashkëpunimit dhe integritetit rajonal e më gjerë mund të ndërtohet mbi themele të shëndosha.

Izber HOTI

LUFTA E DRENICËS DHE SHABAN POLLUZHA NË RRJEDHAT POLITIKE E USHTARAKE

Vështirësitë dhe çështjet teorike

E vërteta e kamufluar dhe e propaganduar rrejshëm për rrethanat, qëndrimet, orientimet dhe zhvillimet në ish-Jugosllavi filluan të përhapeshin që nga Plenumi i Splitit të Komitetit Qendror të Parisë Komuniste, të mbajtur në Split më 1935, që deri atëherë ishte e vetmja parti që në njëfarë mënyre përpiquej të angazhohej për një lloj drejtësie sociale dhe kombëtare. Pas këtij plenumi Partia Komuniste e Jugosllavisë u përcaktua në dëm të popujve dhe etnikumeve, madje edhe sllave, për ruajtjen artificiale të kësaj kreatore artificiale dhe të hegjemonisë. Ky përcaktim do të mbetet në fuqi në Jugosllavi gjatë gjithë kohës së Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj deri në shpartallimin e këtij shteti. Thënë ndryshe, ruajtja e Jugosllavisë dhe shpartallimi i saj në të vërtetë ishte çlirimi i disa etnikumeve, kombeve dhe popujve apo robërimi i mëtejshëm i tyre. Në këtë mënyrë filloi, dashur dhe padashur, ndarja e shapit prej sheqerit dhe këto orientime, qëndrime dhe përcaktime u pasuan edhe nga organizimet e forcave të ndryshme politike dhe ushtarake. Si pasojë do të paraqiten e riparaqiten çetnikët, lotiqasit, ballistët dhe

shumë forca të tjera nacionaliste me orientime e qëndrime të drejta dhe të padrejta, por që si veçori kishin angazhimin për interesat e tyre nacionaliste shumica prej tyre në dëm të të tjerëve.¹ Në këto rrethana dhe rrjedha, siç dihet, ende mbijetonte orientimi ideologjik komunist, i cili mbështetej dhe ushqejej kryekëput kinse në luftën kundër nazifashizmit, duke iu bashkëngjitur kështu bllokut antifashist botëror, që ishte një postulat i fortë dhe kundërvënja ndaj tij nuk ishte e lehtë, ani pse çdo ditë e më shumë shihej se kjo ideologji anonte kah interesat nacionaliste dhe hegjemoniste.² Nga këto veçori do të shoqërohen edhe rrethanat e fillimit të Luftës së Dytë Botërore në Kosovë dhe në viset shqiptare të Jugosllavisë së kohës.

Ndikim të madh në këto rrethana në Kosovë do të ketë edhe qëndrimi i *Shqipërisë Londineze*, por edhe përcaktimi dhe ndikimi i komunistëve shqiptarë me besimin e sinqeritetin e tepruar në internacionalizmin, madje edhe deri në nënshtrim. (Mos të harrojmë se gjatë tërë kësaj lufte komunistët e Shqipërisë lidheshin me qendrën evropiane të komunistëve, Kominternën, derisa ajo ekzistonte, nëpërmjet komunistëve jugosllavë, por kjo lidhje komuniste shqiptaro-jugosllave vazhdoi edhe pas shuarjes de fakto të saj). Po në këtë kohë dhe po në këtë vorbull ngjarjesh do të sendërtohet një pjesë e dëshirës së kahershme shqiptare për bashkimin kombëtar, natyrisht në kuadër të Liktorit italian dhe kryqit të thyer (svastikës) gjerman.³

Lufta për territore dhe pushtet në mes sllavëve të jugut fqinj dhe shqiptarëve në prag, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore ishte e pandërprerë, por me intensitet të ndryshëm, siç ndodhte edhe me përpjekjet për ndikim në masa, veçanërisht të ideologjisë komuniste dhe orientimeve kombëtare. Në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare

¹ Janko Pleterski, *Komunistička partija Jugoslavije i nacionalno pitanje 1919-1941*, Beograd, 1971.

² Izber Hoti, *Qëndrimet, orientimet dhe veprimet e Shaban Polluzhës*, Dardania sacra nr. 1, 1999.

³ Jacomoni, Francesco, *Politika e Italisë ne Shqipëri*, Tiranë: 55, 2005, f. 170; Xhelal Gjeçovi, *Kleri mysliman dhe çështja kombëtare në vitet e Luftës së Dytë Botërore*, www.orientalizmi.shqiptar.

të pushtuara nga fqinjët kështu do të ndodhë deri në fund të vitit 1944 dhe fillim të vitit 1945. Takimet, mbledhjet dhe marrëveshjet e llojllojshme mbanin vulën e këtyre veçorive pothuajse të gjitha forcat, ndërsa është për t'u shquar Konferenca e Bujanit (31. XII. 1943-1 dhe 2 I. 1944), e cila u përpoq të bëjë diçka dhe të zhdaraviste këto orientime e qëndrime, por Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë do t'i kundërvihet rreptë me letrën e tij dërguar Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste për Kosovë e Dukagjin (Metohi) më 28. III. 1944.⁴ Nga kjo kohë u sheshuan dhe u thelluan edhe më shumë dallimet e komunistëve shqiptarë dhe fqinjëve të tyre sllavë për të ardhmen e këtyre anëve dhe atyre që jetonin këtu. Po kështu, në mënyrë të heshtur, jo rrallë dhe haptazi, dolën dallimet edhe në mesin e vetë komunistëve e veprimtarëve politikë e ushtarakë shqiptarë sa përfunduan në qasjet dhe veprimet e ndryshme ndaj politikës dhe rrjedhave të Luftës.⁵

Sa më shumë që afrohej përfundimi i Luftës së Dytë Botërore aq më shumë zhvisheshin synimet e komunistëve jugosllavë, të cilët deri atëherë propagandonin çlirimin nacional, ndërsa në këtë kohë çdo kush që përhapte këtë qëndrim shpallej nationalist dhe antijugosllav, ndërsa për të tillët nuk mungonte as plumbi. Komunistët e Shqipërisë vazhdonin avazin e vjetër dhe nuk besonin në ndryshimin rrënjësor të aleatëve ideologjikë në përmasa të gllabërimit edhe vetë Shqipërisë në Federatën Ballkanike, ku mbizotëruese do të ishte Jugosllavia apo edhe të ashtuquajturës republikë të shtatë në kuadër të federatës së shteteve të sllavëve të jugut. S'do mend, në këtë frymë me ndikim të madh ishte edhe amnistia e çetnikëve, në të cilën shovinistët serbë në vend të

⁴ Izber Hoti, *Nuk janë përherë fajtorë rrethanat ndërkombëtare* (Kumtesë e aktualizuar politikisht e studimit shkencor *Administrimi Ushtarak akt i dhunës së armatosur kundër mëvetësisë dhe të pavarësisë së Kosovës*) lexuar Kumtesë e lexuar në Tiranë me rastin e 50-vjetorit të Konferencës së Bujanit në ndërtesën e Muzeut Kombëtar, 1993.

⁵ Sabile Keçmezi-Basha, *Organizatrat dhe grupet ilegale në Kosovë 1981-1989 (sipas aktgjykimeve të gjykatave ish-jugosllave)*, Prishtinë 2003, f. 19.

kokardës vunë yllin pesëcepësh dhe bënë kërdi mbi popullsinë e pafajshme shqiptare.⁶

Në rrethanat e krijuara në fund të vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945 ishte plotësisht i natyrshëm ndryshimi dhe thellimi i orientimit, qëndrimit dhe përcaktimit të shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare të pushtuara sa edhe individët dhe forcat e tjera të organizuara (p. sh. ato të Shaban Polluzhës) të deridjeshme antifashiste e madje edhe komuniste të braktisnin orientimet dhe qëndrimet e kaluara e të kalonin dhe përkrahnin e pastaj edhe të vepronin nga pozitrat nacionaliste e mbrojtëse kundër të të ashtuquajturit çlirim që në të vërtetë ishte ripushtim i Kosovës dhe i viseve të tjera shqiptare. Për orientimet e mëparshme nacionaliste as që ka nevojë të thuhet. Qëndrimi i tyre dëshmohej gjithnjë e më shumë. Këtë qëndrim e forconin edhe sjelljet e “çlirimtarëve jugosllavë” si dhe shumë përkrahësve të tyre shqiptarë, ani pse tashmë ishte vërtetuar e kishte marrë dhenë degradimi i Komitetit Krahinor dhe Shtabit Kryesor të Kosovës dhe Dukagjinit (Metohisë), si dhe të çdo çështjeje që edhe tërthorazi shpinte në barazimin e shqiptarëve me jugosllavët.⁷

Në përcaktimin nacionalist dhe mbrojtës nga depërtimi i sllavëve të jugut partizan apo çetnik në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare ndikuan, po kështu, krimet partizane-çetnike, përfshirë këtu edhe Masakrën e Tivarit, kërcënimet që i bëheshin drejtpërdrejt apo tërthorazi shqiptarëve etj. Si pasojë në Nacional Demokratikun e riformuar dhe riorganizuar do të gjenden së bashku edhe nazifashisti e komunisti i deridjeshëm që shpresonte se Lëvizja Nacionalçlirimtare do t’ua plotësonte ëndrrat e kahershme sociale dhe kombëtare. Të kësaj natyre dhe këtë mbështetje e kishin edhe forcat politike e ushtarake kombëtare të lidhura pas personaliteteve të shquara të kohës. Këta njerëz dhe këto forca nuk ngurrenin që të

⁶ Hakif Bajrami, *Dokumenti NOB-a i Socijalističke revolucije, borbe na Kosovu januar - februar 1945.* god.; Vjetar i Arkivit të Kosovës XI-XII, Prishtinë, 1978, f. 259.

⁷ Josip Broz Tito, *Vepra*, XII, Rilindja, Prishtinë, 1984, f. 86 e tutje

sakrifikonin edhe jetën për kauzën e tyre, ndërsa kur nuk gjetën zgjidhje tjetër ta lënë Kosovën nën pushtimin sllavo-komunist dhe merrnin botën në sy me shpresë se në një të ardhshme do të bëheshin ndryshime të rrjedhave politike ndërkombëtare ashtu siç dëshironin dhe ëndërronin.⁸

Jeta dhe veprimtaria e Shaban Polluzhës

Të dhëna të pakta për jetën

Mbështetur në të dhënat e deritashme historiografike e publicistike (kryesisht kujtime), Shaban Polluzha u lind më 1871 (sipas disave më 1873) në Polluzhë të Drenicës.⁹ Fëmijërinë dhe rininë e kaloi duke ndihmuar prindërit në punët e bujqësisë dhe të blegtorisë. Shabani ishte i biri i Mustafë Rexhep Kastratit dhe kishte vetëm një vëlla (Dervishin), por ai vdes në moshë të re. Familja e Mustafë Rexhep Kastratit kishte një pasuri mesatare,¹⁰ që i ndihmoi atij që qysh në rini, anipse i paarsimuar, të merrej edhe me politikë dhe me vëzhgimin e njohjen e rrjedhave shoqërore. Ky interesim ndikoi që banorët e Polluzhës dhe të rrethit në kohën e pushtimit bullgar të vendosin që Shaban Polluzhën ta zgjedhin përfaqësues të tyre, përkatësisht polic bashkie (çaušh). Pasi në Vërbofc vret Jeft Bullgarin, të njohur si zullumqar, Shabani me familje (në këtë kohë kishte tre fëmijë) burgoset dhe dërgohet në Prishtinë. Mirëpo, pushtimi bullgar nuk zgjati shumë dhe Kosova u ballafaqua me ripushtimin serb, të cilit Shaban Polluzha iu kundërvu pa u hamendur, prandaj ai burgoset sërish në Skenderaj dhe në Mitrovicë,

⁸ Si shënim 5.

⁹ Sipas Islam Dobrës Shaban Polluzha u lind më 1873 (*Lufta e Drenicës 1941-1945*, Prishtinë, 1995, f. 112), ndërsa sipas Muhamet Mjekut ai u lind më 1871 (*Lufta e Drenicës dhe Shaban Polluzha*, Prishtinë, 1991, f. 117).

¹⁰ Edhe rreth bazës ekonomike nuk pajtohen dr. Islam Dobra dhe Muhamet Mjeku. Sipas të parit, vepra e përmendur f. 112, familja e Shaban Polluzhës ishte mesatarisht e pasur, ndërsa sipas të dytit, vepra e përmendur faqe 114, familja e Shabanit ishte e varfër.

por nuk vonoi shumë dhe u lirua, ndërsa nga populli u zgjodh kryetar komune, por kreu edhe detyra të tjera me përgjegjësi politike. Këto detyra dhe përgjegjësi nuk e penguan Shabanin që të mbante lidhje me Azem Bejtën dhe me patriotët e tjerë të kohës.¹¹

Shaban Polluzha u burgos edhe nga ana e pushtuesve italianë dhe si kundëritalian një kohë kaloi në burgun famëkeq të Kullës së Sheremetit. As ky burgim dhe as kjo ndjekje e pushtuesve italianë nuk ndërprejnë veprimtarinë patriotike të Shaban Polluzhës. Ai ishte njëri ndër organizatorët e ruajtjes së kufirit në Rozhajë, por edhe i mobilizimit të shqiptarëve në ndihmë të popullit të rrezikuar në Sanxhak dhe Peshter. Po në këtë kohë me sukses kreu edhe besimin që iu dha si anëtar i *Islihatit të Drenicës*.¹² Pra, Shaban Polluzha ishte njëri ndër ata patriotë që nuk mund të qëndronte duarkryq përderisa vëllezërit në Sanxhak e Peshter dhe në vise të tjera digjeshin dhe masakroheshin nga hordhitë çetnike dhe partizane.

Ndikimi i rrethanave

Kryerja e këtyre detyrave ndikoi shumë në përcaktimin e Shaban Polluzhës për rrjedhat shoqëro-politike. Si përgjegjës i këtyre detyrave Shabani njohu për së afërmi padrejtësitë e Mbretërisë së Jugosllavisë që i bëheshin shqiptarëve dhe ai u bind se kundër këtij pushtuesi dhe kundër masave të cilat i ndërmernte ai duhej angazhuar deri në fund. Duke parë se për arritjen e qëllimeve të tyre ata nuk zgjidhnin as mjete as forma, ndërsa preferonin shfrytëzimin e armëve, Shaban Polluzha u bind se atyre duhet kundërvënë vetëm me armë. Shaban Polluzha me kohë do të bindet se arma ishte dhe mbeti i vetmi mjet i çlirimit kombëtar e social, mu ashtu si ishte edukuar nga të të parët e tij. Këtu gjenden edhe arsytet pse ai në fillim u bë përkrahës i Lëvizjes Nacionalçlirimtare, ndërsa më vonë edhe

¹¹ Muhamet Mjeku, *Lufta e Drenicës dhe Shaban Polluzha*, Prishtinë, 1991, f. 114; Lefter Nasi, *Ripushtimi i Kosovës (shtator 1944-korrik 1935)*, Tiranë, 1994, f. 152.

¹² Islam Dobra, *Lufta e Drenicës 1941-1945*, Prishtinë, 1995, f. 112.

bashkëpunoi me të.¹³ Natyrisht, në përcaktimin e tij për luftën e armatosur ndikuan edhe rrethanat e tjera të kohës, siç ndikuan edhe te bartësit e Luftës Nacionalçlirimtare në Kosovë, në Jugosllavi dhe në Shqipëri, të cilët Shaban Polluzhës, si autoritet, ia besuan organizimin dhe formimin e njësitit të armatosur të quajtur *Brigada e Drenicës*, komandant i së cilës u zgjodh dhe e cila u planifikua t'i bashkëngjitej Brigadës VII të Ushtrisë Nacionalçlirimtare e të Aradheve Partizane (UNÇ e AP) për Kosovë e Metohi.¹⁴ Për këtë

¹³ Për kundërnazifashizmin e Shaban Polluzhës dhe bashkëpunimin e tij me Lëvizjen Nacionalçlirimtare në Kosovë dhe në Shqipëri, për atë në Jugosllavi as që mund të flitet, ka mendime të ndryshme. Nga të arriturat historiografike, por edhe nga të dhënat arkivale të fushës së Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe të asaj të Jugosllavisë, orientimi dhe përcaktimi i Shaban Polluzhës mbetet pezull dhe kryesisht në mes të ithtarit, bashkëpunëtorit dhe të pjesëtarit të LNÇ-së. Mbështetur në arritjet historiografike, por edhe në dokumentet e kohës, kujtoj se Shaban Polluzha ishte vetëm një ithtar i luftës së armatosur kundërnazifashiste. (Më gjerësisht shiko: Muhamet Shatri, *Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Prishtinë, 1997, f. 252 /mbrohen tezën e bashkëpunimit/; Nexhmedin Spahiu *Ekulibret shqiptare*, Marin Barleti, Tiranë (pa vit botimi) f. 296 /mbrohen tezën se Shaban Polluzha ishte partizan i rebeluar/; Muhamet Pirraku, *Historiani ka për detyrë të paraqet e jo të krijojë histori*, Fjala Jonë, shtator 1994 /sipas tij Shabani ishte me orientime kundërnazifashiste, i ndikuar nga mësuesit e ardhur nga Shqipëria të cilët propagandonin bashkimin kombëtar/; Lefter Nasi, *Ripushtimi i Kosovës (shtator 1944-korrik 1945)*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë 1994, f. 236 /mendon se Shabani ishte i lidhur dhe ndihmoi lëvizjen antifashiste çlirimtare, mirëpo konteston formimin Brigadës së Shaban Polluzhës me leje të SHO-së të UNÇ-së e AP-së për Kosovë e Metohi/; Spasoje Djaković, *Sukobi na Kosovu*, Narodna knjiga, Beograd, 1984, f. 250 /mbrohen tezën se Shaban Polluzha nuk ishte fare kundërnazifashist, por bëri mobilizimin krye më vete e SHO i UNÇ-së e AP-së për Kosovë e Metohi u vu para një akti të kryer, prandaj u detyrua ta pranonte me kusht që të mobilizuarit t'i bashkëngjiteshin njësiteve partizane/; Sinan Hasani *Kosova, të vërtetat dhe mashtrimet*, Prishtinë, 1986, 135-136 /sipas tij Shaban Polluzha ishte "bashkëpunëtor i fshehtë i okupatorit në këtë anë dhe sapo u bind për drejtëshmërinë e politikës së pushtetit të ri popullor dhe u nis me një batalion në drejtim të Frontit të Sremit, para se të largohej nga Kosova u pendua"/.

¹⁴ Muhamet Shatri, *Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Prishtinë 1997, f. 252; Muhamet Pirraku, *Ripushtimi i Kosovës 1945*, Prishtinë, 1992, f. 62. Sipas këtij shkencëtari, Shaban Polluzha ishte komandant i Brigadës së Drenicës vetëm

arsye marrëdhëniet në mes tyre ishin përherë të tendosura, madje mund të thuhet edhe armiqësore. Që ishte kështu shihet edhe nga rrjedha e bisedimeve të Shaban Polluzhës dhe të përfaqësuesve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare (LNÇ) në Skenderaj në fund të vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945, kur ai në një mosmarrëveshje rreth veprimeve çnjerëzore të njësiteve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë (UNÇJ-së) me Vllado Kërstiqin nuk u përmbajt dhe deshi madje atë edhe ta vras. Mirëpo, edhe Vllado Kërstiqi informoi për këtë mosmarrëveshje autoritetet në Mitrovicë dhe ata organizuan atentat kundër Shaban Polluzhës, por ky atentat nuk u krye me sukses, e Shaban Polluzha shpëtoi.¹⁵

Nuk vonoi shumë dhe sërish më 22. XII. 1945 në Skenderaj, Shaban Polluzha pati edhe një mosmarrëveshje të ndjeshme edhe me kreun e SHO-së të UNÇ-së dhe AP-së për Kosovë dhe Metohi dhe me përgjegjësit e Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste të Jugosllavisë (KK të PKJ-së) për Kosovë dhe Metohi, Miladin Popoviqin, Fadil Hoxhën, Kërsto Filipoviqin dhe Ali Shukrinë.¹⁶ Si njeri që nuk respektonte gjysmat dhe i shtytur nga krimet që bënë njësitet e UNÇJ-së më parë në Sanxhak e Peshter e më vonë edhe në Kosovë, Shaban Polluzha ia tërhoqi vërejtjen rreptë këtyre udhëheqësve dhe bartësve të LNÇ-së për këto veprime sa ata u detyruan të mbroheshin duke premtuar se kështu më nuk do të ndodhte dhe se për zgjidhjen e këtyre çështjeve shqiptarët duhej të kishin pak më shumë “durim”. Mirëpo, premtimet mbetën vetëm premtime, ndërsa krimet e UNÇ-së ndaj shqiptarëve vazhdonin. Për këtë arsye Shaban Polluzha në ditët e përgatitjes për nisje në Srem, pasi u zbulua në Skenderaj një varrezë masive e shqiptarëve,

nominalisht, “sepse njësia e revoltuar nuk ishte aq monolite dhe me grupet e revoltuara udhëhiqnin shumë krerë popullorë, pa ndonjë komandë shumë rigorozë të përbashkët. Madje, *e vetmja platformë luftarake që i bashkonte këta krerë dhe masat e revoltuara ishte: ‘Dy duar për një krye dhe koka për nderin e varreve tona’*”(po aty.).

¹⁵ Muhamet Mjeku, *Lufta e Drenicës dhe Shaban Polluzha*, Dielli, Prishtinë, 1991, f. 21.

¹⁶ Muhamet Shatri, *Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Prishtinë 1997, f. 253.

urdhëroi që të liroheshin të gjithë të burgosurit nga ana e UNÇ-së në këtë qytezë. Të paaftë që t'i kundërviheshin këtij urdhri udhëheqësit dhe bartësit e LNÇ-së e zbatuan këtë kërkesë të tij ¹⁷, mirëpo krimet dhe torturat kundër popullit shqiptar nuk u ndalën se nuk u ndalën.

Thellimi i mosmarrëveshjeve dhe riorientimi

Shaban Polluzha me brigadën e tij, për shkak të rrethanave mbizotëruese, u detyrua t'i besojë premtimeve të udhëheqësve të LNÇ-së në Kosovë dhe vendosën të niseshin në veri. Mirëpo, krimet e Nacionalçlirimtares nuk pushuan dhe për to Shabani me shokë njoftojë pothuajse gjatë tërë rrugës për në Podujevë, ndërsa aty u mbush kupa. Veç kësaj, në rrugë e sipër njësitet e UNÇJ-së i bënë shantazhe dhe e rrethuan këtë brigadë, ndërsa në Podujevë filloi edhe trysnia më e madhe kundër saj, gjithherë duke zbatuar planin e saj të kahershëm të nxitjes së një kryengritjeje e cila pastaj do të bënte të mundshëm pastrimin etnik të Kosovës dhe luftën e suksesshme kundër çdo kundërvënijeje shqiptare. Këto plane i dinin forcat nacionaliste, të cilat nuk mund të pranonin ripushtimin serb të Kosovës. Ato, të shoqëruara nga kundërshtarët e kahershëm të LNÇ-së në Shqipëri dhe në Jugosllavi, qysh nga dhjetori i vitit 1944 u lidhën me forcat patriotike me synim të organizimit të një rezistence të ndjeshme. Pothuajse në të gjitha këto tubime e kuvendime, në të cilat u vendos disa herë që të mos shkohej në veri, Shaban Polluzha mori pjesë dhe dha kontributin e tij,¹⁸ prandaj ato nuk mund të harroheshin lehtë dhe ndikuan shumë edhe në vendimet e tij më 23. I. 1945 në Podujevë. Në vendimet e tij me këtë rast, ndikuan edhe shokët që e shoqëronin Shabanin. Në këto rrethana vështirë ishte të priteshin rezultate të tjera dhe si pasojë që nga kjo kohë filloi *Lufta e Drenicës*, udhëheqës i së cilës u bë Shaban Polluzha.

¹⁷ Si shënimi (më tej shën.) 15, f. 29.

¹⁸ Ramiz Kelmendi, Viktor Gashi, *Shqipëria e Marie Shllakut, katër martirë shkodranë (Marie Shllaku, at Bernard Llupi, Kolë Parubi, Gjergj Martini)*, Pejë 1995, f. 17; si shën. 8, f. 255; si shën. 7, f. 34.

Vendimi historik i Shaban Polluzhës dhe JO-ja e madhe e tij drejtuar SHO-së të UNÇ-së e AP-së për Kosovë e Metohi për shumë historianë ishte kthesë e rrallë.¹⁹ As fjala e Feriz Bojës dhe e Miftar Llaushës, si dhe e shokëve të tjerë të Shaban Polluzhës në Podujevë nuk mund të merret jashtë këtyre kornizave dhe pa pëlqimin e Shabanit, sado që Shaban Polluzha para Fadil Hoxhës arsyetohej se “nuk po më dëgjojnë shokët”.²⁰

Vendimet që mori Shtabi i Shaban Polluzhës në Podujevë paraqesin një kthesë të madhe jo vetëm për Shabanin si personalitet dhe për njësitin e tij, por pothuajse edhe për të gjithë shqiptarët në trevat e ripushtuara më 1945. Vërtet, ky vendim nuk u bë *ad hoc*, por ai kishte mbështetjen e tij të hershme, mirëpo kjo JO-ja e madhe sa ishte me pasoja aq kishte edhe domethënie historike.

Shaban Polluzha dhe përkrahësit e tij në këtë mënyrë kundërshtuan haptazi synimet dhe vendimet e SHO-së të UNÇ-së e AP-së për Kosovë e Metohi e në këtë mënyrë edhe të UNÇJ-së dhe të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë (UNÇSH-së), duke shprehur kështu qëndrimin e shumicës dërrmuese të popullit shqiptar, por që, pa dyshim, ishte në kundërshti me rrjedhat shoqëro-politike të kohës, veçanërisht me orientimet, me synimet dhe me qëndrimet e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë (LNÇJ-së) dhe të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare të Shqipërisë (LANÇSH-së). Orientimet dhe qëndrimet demokratike perëndimore në këtë kohë ishin larg nga Kosova, ndërsa bartësit e tyre as që kishin investuar mjaft që ato të përhapeshin në këtë anë. Në këtë mënyrë Shaban Polluzha dhe përkrahësit e ithtarët e tij, dashur e padashur, mbetën të vetmuar e madje në s’përputhje me rrjedhat e kohës. Kjo doemos do t’u hakmerret atyre, por jo vetëm atyre. Se ndodhi kështu shihet nga rrjedhat e *Luftës së Drenicës* dhe pasojat e saj.

¹⁹ Muhamet Pirraku, *Ripushtimi i Kosovës 1945*, Prishtinë, 1992, f. 62.

²⁰ Hakif Bajrami, *Tragjedia e Tivarit*, Prishtinë, 1993, f. 180.

Veprimtaria luftarake

Veprimtaria politike dhe ushtarake e Shaban Polluzhës gjatë Luftës së Dytë Botërore u kurorëzua me udhëheqjen dhe komandimin e Luftës së Drenicës.

Në kohën e Luftës së Drenicës Shaban Polluzha kishte më tepër se 70 vjet. Mirëpo, mbështetur në kujtimet nga terreni, por edhe në arritjet historiografike, ai ishte plotësisht i vetëdijshëm për përgjegjësinë që kishte marrë apo më mirë të thuhet para së cilës ishte venë në këto rrethana të pavolitshme, prandaj nuk vepronte pothuajse kurrë me vetënjohje dhe pa u këshilluar me shtabin e tij, si dhe me shokët dhe miqtë në të cilët kishte besim. Megjithatë, vetëm në prag të vdekjes së tij arriti që komandën e Brigadës t'ia besojë atij që e meritonte mbështetur në përgatitjen e tij profesionale - togerit Mehmet Gradica.²¹

Ekzistonin disa arsye që Mehmet Gradica nuk u emërua me kohë komandant i Brigadës së Drenicës. Së pari Mehmet Gradica e Shaban Polluzha që herët nuk kishin marrëdhënie të mira, që, pa dyshim, ndikoi në emërimin e Mehmetit për komandant. Për përmbarrimin e Mehmetit dhe të Shabanit u bënë disa përpjekje dhe vetëm pas kurorëzimit të tyre Mehmet Gradica u zgjodh në Shtabin e Brigadës së Drenicës. Veç kësaj, në këtë kohë nga shqiptarët nuk respektohej shumë përgatitja profesionale, por autoriteti, me të cilin Mehmeti as që mund të krahasohej me Shaban Polluzhën, sikurse që ndodhi edhe me Shaban Polluzhën dhe Miftar Bajraktarin, i cili nuk u emërua komandant i Brigadës ngase dihej se menjëherë do të refuzohej nga SHO-ja e UNÇ-së e AP-së për Kosovë e Metohi si person që u kishte shërbye “qeverive kuislingë”.²² Natyrisht, këto vështirësi dhe dobësi ndikuan mjaft në veprimtarinë luftarake të njësitit të armatosur të Shaban Polluzhës, edhe pse ai dhe shtabi i tij përpiqeshin t'i zbusnin dhe kapërcenin ato disi. Në këtë frymë nuk

²¹ Muhamet Pirraku, *Historiani ka për detyrë të paraqet e jo të krijojë histori*, Fjala Jonë, shtator 1994.

²² *Po aty*; si shën. 15, f. 74.

ndihmonin shumë as tubimet dhe kuvendimet në çdo mbrëmje që Shaban Polluzha i bënte me shtabin dhe luftëtarët e tij, ku trajtohej lufta e zhvilluar brenda ditës dhe bëheshin plane për ditën e nesërme, as edhe morali i fortë dhe optimizmi i papërshtatshëm i këtij plaku të etshëm për liri, i cili pothuajse çdo ditë me kalë shëtiste në frontet e luftës dhe kurajonte luftëtarët e vetë. Nuk ndihmonin as përpjekjet e Shaban Polluzhës të mos bëhej individualist dhe episodist, pasi ai kishte ndjenjën e organizimit kolektiv kombëtar dhe ishte palë e denjë ndërluftuese, ndërsa ushtria e tij mbante shenja dalluese dhe kishte një lloj qeverisjeje me qendër në Rezallë.²³

Taktika luftarake e Shaban Polluzhës dhe e shtabit të tij, që nuk mbështetej në arritjet shkencore, por në traditë dhe në rrethanat mbizotëruese, megjithatë nuk ishte për nënçmim.²⁴

Shaban Polluzha shquhej edhe me veçori të tjera që ndihmonin luftën e tij kundër ripushtuesve serbë e malazez, mirëpo si i papërvojë në fushën e shkathtësive ushtarake njësitë e tij nuk arriti të formojë p.sh. itendanturën dhe shërbimin sanitar,²⁵ por as shërbime të tjera pa të cilët nuk pritej suksesi i Luftës së Drenicës. Ushqimi në popull ishte me rrezik, sepse njësitet e UNÇJ-së shumë nga bukëdhënësit i shkatërronin me plëng e me shtëpi,²⁶ ndërsa shërimi me barëra popullore shpeshherë ishte vdekjeprurës për luftëtarët e plagosur.

Përpjekjet që i bëri shumë vonë Mehmet Gradica për riorganizimin e ushtrisë së Shaban Polluzhës (sigurimi i përhershëm i ushqimit, aktivizimi i fshatarëve të armatosur dhe i materialit e potencialit tjetër ushtarak),²⁷ që u bë shumë vonë me pëlqimin e komandantit të Brigadës së Drenicës,²⁸ mbetën të kota. Lufta e Drenicës, e udhëhequr nga humanisti dhe demokrati,²⁹ siç ishte

²³ Si shën. 15, f. 77-79.

²⁴ Si shën. 16, f. 252.

²⁵ Islam Dobra, *Lufta e Drenicës 1941-1945*, Prishtinë, 1995, f. 114, 165.

²⁶ Si shën. 15, f. 42.

²⁷ Si shën. 21, f. 166.

²⁸ *Po aty*, 144.

²⁹ Si shën 21.

Shaban Polluzha, por siç ishin edhe vetë luftëtarët e tij, sepse *radikalistit militant*, Mehmet Gradica, iu bashkëngjitën vetëm disa dhjetëra shqiptarë.³⁰ Ishte shumë vështirë t'i kundërvijej një ushtrie të specializuar për krime dhe shtypje të vullnetit të popullit, që ishte me dhjetëra herë më e madhe dhe me disa herë më e armatosur. Këto ishin arsytet pse populli shqiptar, në mesin e tyre edhe drenicasit, mëdysheshin në përcaktimin e tyre për luftë apo qetësi, që shihet edhe nga përcaktimi i tyre për Luftën e Shaban Polluzhës. Në fillim të kësaj lufte Shaban Polluzha pati me mijëra ithtarë, përkrahës dhe pjesëtarë,³¹ ndërsa në kohët e fundit me Shaban Polluzhën mbetën vetëm pak veta,³² që nuk mund të arsyetohet nëse duam ta mbrojmë qëndrimin se populli shqiptar ishte përcaktuar për luftë ashtu si kërkonte p. sh. Miftar Bajraktari, i cili në luftë për çlirim kombëtar nuk zgjidhte mjete dhe nuk shikonte viktimat,³³ të cilin shpeshherë e këshillonte Shaban Polluzha, por nuk mund të vepronte si ai pasi Shabani kishte besim të madh në popull.

Mbështetur në besimin e tepruar që kishte për shqiptarët Shaban Polluzha bëri edhe disa gabime që ndikuan mjaft në luftën dhe në qëndrimin e shqiptarëve ndaj ripushtuesve serbo-malazez. Ndryshe nuk mund të shpjegohen dy përpjekjet që Shaban Polluzha i bëri duke i propozuar SHO-së të UNÇ-së e AP-së për Kosovë e Metohi që të ndërroi disa autoritete me disa të tjerë me shpresë se ata nga njësitet e këtij shtabi do të liroheshin e do të shpëtonin (Bedri Gjinajn me mulla Ibrahim Polacin dhe Abdyl Zhubin me Halil Haxhiun e Tërnavcit).³⁴ Veprimet e tilla të Shaban Polluzhës zbehin

³⁰ Si shën. 21; si shën. 7, f. 114.

³¹ Izber Hoti, *Forcat e armatosura në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Prishtinë, 1998, f. 184.

³² “Më 13-17. II. 1945 me Shaban Polluzhën mbetën vetëm pak veta dhe pikërisht vetëm disa persona të cilët ishin të shquar gjatë rezistencës si dhe personalitete udhëheqëse, të rëndësishme, të cilët në rast dezertimi do të vriteshin pa gjyq ose me ceremoni plot poshtërsi të gjyqeve ushtarake komuniste-çetnike me fyerje, tortura dhe vrasje publike”. (Si shën. 11, 102 dhe 106).

³³ Si shën. 16, f. 106.

³⁴ Si shën. 19, f. 94.

shumë pohimet se ai me shtabin e tij ishin dinakë dhe falë kësaj dinakërie shpërthyen bllokadën në Llap dhe hutuan organet e LNÇ-së se do po i drejtoheshin Prishtinës në vend Drenicës, që mund të dëgjohet shpesh në terren dhe mund të lexohet edhe në shumë studime të historianëve.³⁵ Këto vlerësime mbështeten edhe me faktet se në Brigadën e Shaban Polluzhës, madje në organet udhëheqëse, pati mjaft spiunë të UNÇ-së, që pengonin mjaft mobilizimin dhe veprimet e tyre luftarake, në mesin e të cilëve përmendet edhe Ali Bojiqi,³⁶ por edhe në faktin se pjesëtarët dhe bartësit e UNÇ-së patën guxim që të kërkonin nga ai të bënte atentat kundër Mehmet Gradicës në rrugë e sipër për në veri, të cilin, kuptohet, e hodhi poshtë kategorikisht Shaban Polluzha.³⁷

Besimi i tepruar i Shaban Polluzhës mbështetur në humanizmin e tij të lindur, sikurse edhe të shqiptarëve në përgjithësi, janë edhe shkaqet që shqiptarët nuk dinin se si duhej vepruar me armiqtë e zënë rob, pa marrë parasysh a ishin ata shqiptarë apo jo. Të zënit rob në të shumtën e rasteve liroheshin pa një therë në këmbë, ndërsa rrallëherë ndodhte që ata të pushkatoheshin.³⁸ Kështu nuk vepronin kundërshtarët e tyre. Në luftë kundër njësitit të Shaban Polluzhës, si dhe njësiteve të tjera si ky, ata përdornin edhe mjetet më të palejueshme të luftës.

Që të pengonin sendërtimin e synimeve të njësitit të Shaban Polluzhës organet e UNÇJ-së për fillim propozuan që ai të ndahej në njësite më të vogla e në këtë mënyrë t'i bashkëngjiteshin brigadave të tjera të UNÇ-së së Kosovës, mirëpo këtë kurth e hetoi Shaban Polluzha me shokë dhe e hodhën poshtë.³⁹

Organet e UNÇ-së nuk planifikonin të shkatërronin vetëm njësitin e Shabanit, por edhe të gjithë Brigadën VII të Kosovës e Metohisë, si dhe gjithë kundërvënien shqiptare. Që t'ia arrinin këtyre qëllimeve këto organe me anë tensioni dëshironin të krijonin

³⁵ Si shën. 16, f. 35; si shën. 8, f. 257.

³⁶ Si shën. 12, f. 179.

³⁷ *Po aty*, f. 180.

³⁸ Si shën. 17, f. 142 dhe 165.

³⁹ Si shën. 16, f. 254.

pasiguri.⁴⁰ Në këtë mënyrë ata përpiqeshin të sendërtonin qëllimet e tyre të kahershme - pastrimin etnik të Kosovës. Përpjekjet e tyre nuk mbetën të kota, prandaj edhe në “zonën e lirë të Drenicës” mbizotëronte gjendje ankthi ndërmjet shpresës për jetë dhe të frikës për likuidimin masiv.⁴¹

Këtë gjendje e ngarkonin edhe më shumë shqiptarët e verbër e spiunë që ishin angazhuar në veprimtarinë kundërshtqiptare siç ishte Kadri Mehmeti nga Klina, i cili mori guximin që të godas me top kullën e Dvoranëve në Tërstenik, në të cilën gjendej Shaban Polluzha me shtabin e tij.⁴² Kjo ishte goditja përfundimtare kundër Shaban Polluzhës dhe brigadës së tij dhe fundi i Luftës së Drenicës, që u bë natën e 21. II. 1945.⁴³ Në këtë mënyrë mori fund edhe njëra nga golgotat shqiptare,⁴⁴ në të cilën u goditën me mijëra shqiptarë, si dhe u vranë dhe u plagosën me qindra, ndërsa u zunë rob dhe dorëzuan, po kështu, me qindra.⁴⁵ Kjo ishte një goditje e rëndë për kundërvënien shqiptare, si atë të armatosur ashtu edhe atë të paarmatosur.

Fundi i jetës së Shaban Polluzhës dhe i luftës së tij nuk mund të pritej ndryshe ngase u injorua dhe u nënçmua si faktori i jashtëm, ashtu edhe faktori i brendshëm, ndërsa Lufta e Drenicës nuk u përhap në të gjitha territoret e ripushtuara shqiptare dhe mbeti e parcializuar, si shumë kundërvënie të tjera shqiptare në fund të vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945, por edhe më vonë. Veç kësaj, forcat ripushtuese ishin disa herë më të armatosura, ndërsa edhe në njerëz ishin dhjetëra herë më shumë. Dëshira dhe përcaktimi i shqiptarëve për liri në këto rrethana ishte dhe mbeti vetëm një vullnet i pasendërtuar. Megjithatë, veprimtaria e Shaban Polluzhës dhe lufta e tij i tregoi haptazi ripushtuesve se shqiptarët nuk e pranojnë robërimin dhe se herdo-kurdo ata do të ballafaqoheshin edhe me luftë të armatosur çlirimtare.

⁴⁰ Si shën. 19, f. 101.

⁴¹ Si shën. 15, f. 82.

⁴² Si shën. 19, f. 106-107.

⁴³ *Po aty*.

⁴⁴ Si shën. 21.

⁴⁵ Si shën. 16, f. 166.

Hakif BAJRAMI

SI U OKUPUA KOSOVA NGA JUGOSLLAVIA DHE ME KËRKESE TË KUJT, MË 1945?

Në Kosovë gjatë fundit të nëntorit dhe dhjetorit 1944 do të ndodhë një fushatë e egër antishqiptare nga njësitet, të cilat i komandonte *de jure*, Shtabi i degraduar Operativ i Kosovës. *De fakto*, ato njësi ishin të dirigjuara nga komunisto-çetnikët e sojit të Pavle Joviqieviqit dhe Petar Brajeviqit me Spasoje Gjakoviqin. Në këtë grup hynin edhe shumë kolonistë sllavë me përkatësi komunisto-çetnike, sidomos pas amnistisë së çetnikëve nga Kryesia e AVNOJ-it, më 21 nëntor 1944. (1. Luan Gashi, Historia e krimeve në Kosovë 1943-1946, dorëshkrim i deponuar në A. të Gjermanisë, pa datë).

Fushata e mobilizimit në Kosovë kishte filluar më 30 nëntor 1944, pas Mbledhjes së Byrosë KK për Kosovë dhe Rrafshit të Dukagjinit. Në Këshillim do të analizohet situata politike dhe ushtarake dhe do të zgjidhet Byroja e KK të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit. Sekretar politik i PKJ-së për Kosovë do të zgjidhet, Milladin Popoviqi. Sekretar organizativ do të zgjidhet, Dushan Mugosha, ndërsa anëtarë të Byrosë do të zgjidhen: Pavle Joviqeviq, Fadil Hoxha, Boshko Qakiq, Xhavit Nimani, Kërsta Filipoviq, Spasoje Xhakoviq, Ismet Shaqiri, Mita Milkoviq. Në Byro zgjidhen ose vërtetohen këto kuadro: Mehmet Hoxha, kryetar i KNÇ-së për Kosovë dhe Rrafsh të Dukagjinit, komandant i Shtabit Operativ;

Fadil Hoxha, komisar politik i shtabit; Kërsta Filipoviq, komandant për çështje personale; Pavle Joviqeviq, zëvendës i komandantit Petar Brajeviq. Nga mbledhja do të nxirret një dokument që do t'u drejtohet anëtarëve të partisë, komandantëve dhe komisarëve të brigadave. Në dokumentin direktivë të nënshkruar nga Milladin Pooviqi thuhet:

1. “Kundër grupeve të armatosura që luftojnë kundër LNÇ-së sonë duhet të veprojmë energjikisht dhe pa mëshirë. Pasurinë e atyre që rezistojnë duhet shpallë PRONË shtetërore, ndërsa pas afatit të dorëzimit të atyre që janë kundër nesh shtabet e brigadave duhet ta pastrojnë terrenin.

2. Fshatrat që kanë rezistuar ndaj luftës sonë, duhet t'i gjejnë organizatorët e rezistencës dhe ata do të dorëzohen gjyqeve ushtarake të cilat duhet të gjykojnë menjëherë. Pasuria t'u sekuestrohet. Fshatrat e tilla të çarmatosen...

4. Gjatë operacioneve ushtarake në tren duhet pas kujdes që mos të ngjajnë ndërmarrje të pakëndshme (vrasje, plaçkitje e të tjera)... Luftëtarët tanë duhet t'i respektojnë adetet e shqiptarëve.

5. Luftën duhet shpjeguar nëpër konferenca me popull dhe në atë mënyrë ta mobilizojmë popullin për veprime të mëtejme deri në shkatërrimin e okupatorit fashist dhe ta vejme pushtetin popullor...

6. Të gjithë ata që i përgjigjen mobilizimit të sistemohen nëpër njësi. Kjo punë duhet zhvillohet nga zëvendëskomisarët politikë. (2. A. Kosovës, Fondi. KK. I LKK. Letra direktive e M. Popoviqit më 30 XI 1944). Lidhur me këtë, pas kësaj mbledhje të gjithë komunisto-çetnikët në Kosovë do ta marrin leje blanko që të sillen si kolonialistë të rinjë.

Lufta në Ferizaj dhe rrethinë, 1-2 dhjetor 1944

Shtabi i Brigadës së Dytë të Kosovës gjendej në këtë kohë në Ferizaj. Më 1 dhjetor nga Shtabi Operativ do të merret vendimi që dy batalione të kësaj brigade të drejtohen prej Prizrenit për në Gjakovë. Ndërsa, dy batalione tjera të drejtohen prej Ferizajt për në Prizren, për të shënuar një rrotacion të lëvizjes së forcave ushtarake, si është

rregulli i manovrimit. Por, më 2 dhjetor në Ferizaj dhe rrethinë do të zhvillohet luftë e vërtetë në mes forcave patriotike shqiptare që luftonin për Kosovën e bashkuar me Shqipërinë dhe forcave komunisto-çetnike që luftonin për t'iu aneksuar Kosova Serbisë, ashtu siç kishte vepruar Tito me Shtabin Kryesor, më 2 shtator 1944, duke e degraduar në Shtab Operativ, në vartësinë e Shtabit Kryesor të Serbisë. Sulmi kishte ndodhur kundër popullsisë shqiptare duarthatë nëpër fshatrat: Gadime, Budakovë, Zhegojc, Verbicë, Jezerc dhe në qytezën e Ferizajt. Në sajë të epërsisë së armatimit forcat shqiptare do të tërhiqen nga fronti, për ta vazhduar luftën guerile. (3. A. Kosovës, Shënime stenografike për sulmin në Ferizaj të komunisto-çetnikëve të konvertuar-detajisht; Dr. Shaban Hashani, Ferizaj dhe rrethina 1941-1945, gjerësisht).

Lufta në Gjilan dhe rrethinë, më 23 dhjetor 1944

Në Gjilan dhe rrethinë, populli do të mobilizohet nën drejtimin e Idriz Gjilanit me qëllim që t'i mbrojë trojet etnike shqiptare nga okupimi komunisto-çetnik. Në këtë trevë me detyrë speciale për ta venë popullin para aktit të kryer ishte transferuar Divizioni 46 i Serbisë, i armatosur edhe me armë të rënda. Në këtë trevë do të instalohet edhe Brigada XVII e Maqedonisë. Në kuadër të tyre ishte vënë edhe Brigada V e Kosovës. Të gjitha këto do të bëjnë mizori mbi popull sa që do ta detyrojnë komandantin e Shtabit Operativ të Kosovës Fadil Hoxhën, të reagojë duke thënë: “Njësitët partizane me rastin e hyrjes nëpër fshatrat shqiptare po bëjnë mizori dhe kështu po e përlyejnë orientimin tonë për luftë të drejtë. Në këtë reagim tinëzisht do të reagojnë Pavle Joviqeviqi dhe Petar Brajeviqi më 26 dhjetor, duke kërkuar nga Shtabi Suprem që në Kosovë të vihet diktatura ushtarake. (3. Letra e Fadil Hoxhës drejtuar Shtabit Suprem, për Titon; Kërkesa e Pavle Joviqeviqit dhe Petar Brajeviqit, për diktaturë ushtarake në Kosovë, në AVII B. K. 1411).

Si u vendos Divizioni 46 i Serbisë në Kosovë?

Më 20 dhjetor 1945 Shtabi Operativ i AP-së së UNÇ-së të Kosovës do ta lejojë në bazë të imponimit që Divizioni 46 i Serbisë, i stërmëbushur me çetnikë dhe “komunistë” të konvertuar që ta pastrojë pjesën veriore të Kosovës nga elementët kundërshtarë. Divizioni në fillim e kishte për detyrë “pastrimin e sektorit Kushumli-Prishtinë”. Ky divizion përbëhej nga brigadat 25, 26 dhe 27 që do të bëjnë mizori mbi shqiptarë. Në të gjitha dokumentet (janë botuar në seri në origjinal më 1985, ‘86 dhe ‘87, por që nuk i ka lexuar gati askush në “VJETAR” të Arkivit Kosovës - HB, vërehet një shovinizëm ekstrem antishqiptar, vërehet përdorimi i emrit “shiftari”.

Ky divizion ishte në aksion nga 6 janari 1945. Kjo do të thotë dhjetë ditë pasi që Pavle Joviqeviq dhe Petra Brajeviq më 26 dhjetor 1944 kishin kërkuar nga Shtabi Suprem i Jugosllavisë që në Kosovë të vendoset diktatura ushtarake. Me që e dinin me siguri se diktatura do të vendoset, repartet e Divizionit 46 të Serbisë do ta bëjnë shkrumb e hi sidomos krahinën e Llapit, me ç’rast popullsia e 83 fshatrave do të arratiset në sektorin e Prishtinës dhe Malësi të Gallapit. Brigadat e Divizionit famëkeq do të djegin sidomos fshatrat Podujevë-Pollatë dhe Pollat-Zhiti-Çuka e Vugnarashit, Oshtor-Kopi-Bajgorë-Bare-Mitashiq-Mazhiq-Rashan-Pasomë-Tarllabuç. Aksioni i krimeve pastaj drejtohej në vijat: Tarllabuq-Mirçë-Gojbulë-Studime-Ceceli-Kumovik dhe kthehej në kotën Llapshticë e Llapit, për t’u mbyllë prapë në Podujevë.

Krimet kishin ngjarë në lokalitetet Obrancë-Bradash-Pollatë-Dobratin-Pakashticë-Bajqinë dhe në Llapashticë të Epërme. Krimet i drejtonte komandanti i Brigadës 26, e cila ishte themeluar pas 21 nëntorit 1944, kur u amnistuan të gjithë çetnikët nga Tito dhe Ivan Ribari. Mizoritë do të vazhdoen nga Brigada 27 e Divizionit 46 të Serbisë në sektorin, Pollatë-Parduz-Revuçë-Kaçanuell-Shkëmbi i Bardhë deri në Bunishtë. Brigada e 25 e Divizionit 46 të Serbisë do të operojë në sektorin, Terstenë-Gumnishtë-Kovaçicë në një kolonë vrastare. Kolona tjetër do të bëjë mizori në Bare-Bajgorë-Kaçanuell deri te Kodra e Naltë. Operacioni i mizorive ndaj popullit duarthatë

kishte filluar me komandë me urdhër të Tomë Popoviqit, komandant i Divizionit 46, më 9 janar 1945. Mizoritë ishin paraparë të zgjasin deri më 14 janar 1945. (4.AVIIB. K. 1941, nr. Regjistrat 1-4/1; K.1341, nr. Regj.11/1). Në raportet e mëtejme jepen fakte se Divizioni 46 i Serbisë kishte hyrë në Kosovë më urdhër të Shtabit Kryesor të Serbisë në operacione në Kosovë, qysh më 25 dhjetor 1944, dhe Brigada 25 në sektorin Mitrovicë-Zveçan-Trepçë ku kishte për detyrë të operojë ushtarakisht dhe politikisht. Kjo do të thotë se, *de fakto* Serbia e kishte vënë pushtetin ushtarak pa u vendosur ai *de jure*, më 8 shkurt 1945. Brigada 26, kishte vepruar ushtarakisht dhe politikisht në sektorin e Prishtinës sidomos në fshatrat Siçevë, Sharban, Rimanishtë dhe disa lokalitete tjera duke vrarë aty këtu njerëz të njohur për të shkaktuar panik dhe duke ua konfiskuar tërë ushqimin. Merreni me mend në këtë operacion gjendet vetëm një pushkë dhe ajo pa municion. Për t'i numëruar 23 burra të pushkatuar pa gjyq dhe pa asnjë reagim, Brigada 27 e këtij divizioni famëkeq do të veprojë në sektorin Vushtrri-Gojbulë-Podujevë duke vrarë e maltretuar popullsinë me qëllim që ajo të zgjasë operacionet e luftës, ashtu si i kishte porositë Vasa Qubrilloviqi dhe komunistët tjerë kriminelë, populli shqiptarë të arratiset kah Shkupi dhe në pronat e tij të instalohen menjëherë kolonistët e rinj nga Serbia. (5.AVIIB. K. 181. 5-2/2).

Si reagoi Fadil Hoxha ndaj këtyre mizorive?

Ja teksti integral i reagimit me titull URDHËRI nr. 3: Ka ngjarë në shumë raste që ushtarët dhe rojet partizane me rastin e kontrollimit të fshatrave si dhe në disa konteste me popull i kanë rrahë disa persona, kështu që kanë shkaktuar reagimin e të gjitha fshatrave. Sjelljet e këtilla e komprometojnë luftën tonë dhe ushtrinë tonë në përgjithësi. Si po veprohet kështu, po barazohet ushtria jonë dhe lufta jonë me ushtrinë dhe xhandarmërinë e ish-Jugosllavisë. Në këtë mënyrë u tërheqim vërejtjen shtabeve dhe komandave të sektorëve, si dhe rojeve partizane që ndaj secilit veprim kriminal do të merren masat më të rrepta ushtarake. Urdhëresa t'u lexohet

ushtarëve dhe rojeve partizane kudo që veprojnë”. Komandanti i Shtabit Operativ të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit, Fadil Hoxha. (6.AVIIB. NOB. Kutija - Naredbe). Pas këtij urdhri pason Raporti i Shtabit të Divizionit 46 të Serbisë, dërguar Shtabit Kryesor të Serbisë me këtë përmbajtje: Raporti e zbulon hapur qëllimin e Divizionit 46 të Serbisë që po ushtronte mizori mbi popullin shqiptar. Në raport pika 1 theksohet tekstualisht: “Qëllimi i parë dhe i vetëm nga 20 dhjetori 1944 e deri më 14 janar 1945 është që ta çarmatosim popullsinë shqiptare duke e disiplinuar atë.

Në këtë aksion të çarmatimit po kontrollohen shtëpitë, malet dhe fshatrat me qëllim që kinse po kërkohen armë, por në esencë duhet ndjekur çdo njeri që është shqiptar e që nuk pajtohet me forcën tonë ushtarake. Për këtë qëllim, për ta frikësuar popullin janë vrarë, si raste të izoluara, 19 shqiptarë. Ka pas raste që njerëzit janë vrarë pa asnjë rezistencë. Prandaj, lidhur me këtë konstatojmë: Janë grumbulluar nja 200 pushkë, disa revole, dy pushkomirtaloze, një pushkë antitankist dhe material tjetër ushtarak.

Në fakt, ky armatim nuk ka të bëjë fare me shqiptarë, por me mbajtje të armatimit gjerman që është larguar prej këtyre trevave në drejtim të Sarajevës. Gjatë kësaj kohe ka pas maltretime, por edhe vrasje të fshatarëve. Për gjatë kësaj kohe 20. XII. 1944-9. I. 1945 disa drejtues të njësiteve tona, por edhe disa ushtarë janë sjellë me dhunë ndaj shqiptarëve dhe popullsisë në përgjithësi. Ka pas raste kur janë burgosur fshatarët shqiptarë duke iu nënshtruar njëkohësisht torturave. Me një rast ka pas rrahje masive të fshatarëve sa që ka ardhur deri te një vrasje makabër nga ana e togerit Stoshiq në cilësinë e shefit të Brigadës 26. Ky oficerë i ka vrarë në prani të anëtarëve të familjeve në oborr dy fshatarë, vetëm pse nuk kanë pas armë për t'i dorëzuar. Lidhur me këtë, duhet theksuar se ka pas edhe vjedhje të parave, të orendive dhe gjësendeve të arta që kanë bartë gratë. Por, ka pas edhe shantazhime duke u kërcënuar se duhet të gjeni këtë dhe atë sasi prash dhe ari, ose do të vriteni në masë. Si duket ekziston URREJTJA në mes shqiptarëve dhe serbëve, sepse, këto mizori po iniciojnë disa vendas serbë duke i shtyrë ushtarët tanë në krime monstruoze. Prandaj, nën vellon se po kërkojmë armët e fshehura,

popullsia po torturohet pa masë. Ne kemi marrë masa kundër këtyre keqbërësve në shkallë të lartë disiplinore dhe shpresojmë se ma nuk do të ndodhin”. (7. AVII B> K. 1341-3-1/1). Pas mbarimit të këtij aksioni barbar do të fillojë më 15 janar 1945 mobilizimi.

Çka thuhet për të mobilizuarit më 18 janar 1945?

Në tërë Kosovën parashihej që për dhjetë ditë të mobilizohen 10 000 regrutë për nevoja plotësuese të brigadave të Kosovës: VI, VII dhe VIII. Si rezultat ishin mobilizuar 7 500 shqiptarë, krejt me qëllim që t’i largojnë nga Kosova duke u drejtuar kah Fronti i Sremit. Shumica dërmuese e këtyre të mobilizuarve ishte nga Drenica kryengritëse. Siç dihet ishin formuar tri eshalone. Për ato eshalone thuhet tekstualisht më 17 janar 1945: “Gjatë ditëve 20, 21, 22, 23 dhe 24 janar 1945, nga territori i Kosovës do të niset për Veri Brigada VII që numëron mbi 7 000 luftëtarë, e cila është e përbërë gati në tërësi prej KRIMINELËVE. Kjo brigadë do të udhëtojë për Frontin e Sremit, prandaj duhet të organizohet që asnjë shqiptarë mos të dezertojë derisa të jetë në territorin e Kosovës.

Urdhri të lexohet si material TEJET SEKRET vetëm në radhët e shtabit të brigadave. Lidhur me këtë, me urdhër pasues do të jepet vija e marshit. Ajo ishte, Brigada VII, ose si quhej ndryshe Brigada e Shaban Polluzhës do të sigurohet në vijën Prishtinë-Podujevë-Përpellac-Kushumli-Prekupe, nga ana e *djathhtë* prej Brigadës V të Kosovës prej 20 e deri më 23 janar 1945. Në anën e *majtë* sigurimin do ta kryej Divizioni 46 i Serbisë me brigadat 25, 26, 27 gjatë ditëve 20-23 janar. Të mobilizuarit do të jenë të rrethuar nga çdo anë. Ushtarët tanë që do të gjinden për së afërmi në duar do të bartin SHENJËN “N. O.”, që do të thotë (Narodna Odbrana - Mbrojtjeje Popullore). Kjo do të thotë, se urdhërdhënësit qysh më parë e dini se çka do të ndodhë. E bënë këtë sepse në prapavijë kishin organizuar mizori, sidomos në Drenicë. Të mobilizuarit më 19-20 janar, gjendeshin në fshatrat, Llapshticë-Gllmnikë-Dumosh-Buricë-Konushefc-Penuhë e Epërme-Sibofc-Llugë e Lluzhanit.

Shtrirja jugore ishte në vijën Sallabajë, ndërsa shtrirja veriore ishte në Podujevë. Ndërsa, shtrirja lindore ishte në fshatin Dumosh, kurse shtrirja perëndimore ishte në Llapashticë. Të gjithë të mobilizuarit duhej të ishin të bllokuar. (8. AVIIB. NOB. K. 1341-4-2/1, tejet sekret nr. 7. 17 janar 1945; K. 1341-4-1/1; K. 1341-6-1/1; K. 1411-4-1/1).

Më 23-24 shkurt 1945, Shtabi i Divizioneve Jugosllave kishte marrë urdhër për rrethimin e përgjithshëm të efektivave që i komandonte Shaban Polluzha. (9.AVIIB. K. 1341-6-1/1). Këto forca komunisto-çetnike kishin marrë urdhër që së pari t'i privojnë nga liria duke i izoluar, çarmatosë dhe pastaj burgosë drejtuesit e Shtabit të Shaban Polluzhës. (10.AVIIB. K. 1411-4-1/1). Më 28 janar 1945 ishte paraparë të sulmohen nga efektivat e Divizionit 46 të Serbisë edhe tërë treva e Shalës së Bajgorës. (11.AVIIB. K. 1342-3-1/6). Këto fakte flasin për një ofensivë antishqiptare të divizioneve të sjellura nga Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia. Këto njësi kishin urdhër sekret që nga 3 tetori 1944 për të ndërmarrë sulm frontal kundër shqiptarëve në Kosovë dhe më gjerë me qëllim të riokupimit.

Në lidhje me këtë, Shtabi Operativ i Kosovës nuk ishte njoftuar fare. (12.AVIIB. K. 185-12-1/2). Urdhri i Shtabit Suprem të Jugosllavisë mbante shenjë tejet sekret nr. 10 nga 3 tetori 1944, me detyrë që t'i pastrojë territoret e banuara me shqiptarë. Kjo dëshmon qartë se Tito ishte përgatitë që t'ua plotësojë të gjitha kërkesat serbo-çetnikëve për ta riokupaur Kosovën. Prandaj, çdo bisedë për këtë çështje ishte vetëm një maskë e tejdukshme politike. Lidhur me këtë, më 26 janar 1945 për të mbjellë mjegull, ishin organizuar demonstrata kundër kthimit të Kral Petrit në fronin e Beogradit. Organizimin me qëllim kamuflimi se “nuk do të kthehet regjimi i vjetër”, e kishte organizuar Shtabi i Brigadës 26 nga Divizioni 46 i Serbisë, që po mbillte vrasje masive në Kosovë, pa asnjë shkas në shumë raste. Në të njëjtën ditë nxirren nga burgjet e shumta në Prishtinë 52 shqiptarë dhe pushkatohen në vendin e quajtur Strelishte, kah Gërmia. Ishte organizuar kjo masakër, sepse më 23/4 pastaj me inskenim të OZN-së kishte filluar dezertimi nga Brigada e Shaban Polluzhës në Podujevë në vijën drejt Lluzhanit. Kundër

efektivave të Shaban Polluzhës do të ngriten, Divizioni 46 i Serbisë, Brigadat e Kosovës 1, 2, 3, 4, 5, nga 25-31 janar 1945 në të gjitha frontet. Shkurt, e tërë Drenica dhe Shala e Bajgorës ishte rrethuar me ushtri e pajisur me armë të rënda me qëllim që të bombardohen lokalitetet dhe të shkaktohet frikë në tërë popullsinë. Për këtë skenar kishin punuar OZN-ja dhe shërbimet e Divizionit 46 nga Serbia. (13.AVIIB. 1341 dhe K. 1411-7-1/3;-6-1/1).

Siç shihet, ende nuk kemi diktaturë ushtarake të emëruar *de jure*, por *de facto* ajo ka qenë e vendosur prej që njësitet nga Serbia kanë hyrë në Kosovë në fillim të nëntorit 1944 nga Sektori i Përpellacit dhe Merdarit.

Më 5 shkurt 1945 Shaban Polluzha çmohej se në Divizionin e tij i kishte afro 7 000 luftëtarë. Këto efektiva që do të mobilizohen me ndihmën e Shtabit Operativ të Kosovës, të komanduar nga komandant gjeneral Fadil Hoxha, dhe major Kërsta Filipoviq, komisar politik i shtabit. Deri më tash askush nuk e ka theksuar se përderisa Shaban Polluzha dhe Mehmet Gradica dhe eminenca kryesore e të mobilizuarve Miftar Llausha ishin nisë me vetëdije të shkojnë në Frontin e Sremit, por në prapavijë Sasoje Gjakoviqi, njëfarë shqipfolësi N. Bojiq dhe A. Shukriu do të organizojnë plojën e njohur duke i futë kufomat e të pushkatuarve nën akullin e Lumit Drenica. Lidhur me këtë një konfident shqiptar, pa emër të shënuar në dokumente, që ishte mik i luftës me Bedri Gjninin dhe 12 patriotë të tjerë që Shabani i kishte dorëzuar në OZN do të nxitojnë dhe do t'i tregojnë Miftar Llaushës në Podujevë këtë lajm: “Ju po shkoni në luftë për t'i çliruar trojet e shkieve nga nazistët gjermanë, ndërsa në trojet tona kanë ardhë nazistët dhe çetniko-komunistët e Titos dhe po na masakrojnë. Kthehuni në afërsi të Drenasit në Lumin Drenica dhe shikoni sa kufoma janë nën akull”. Ky lajm do ta ndezë “fitilin” e mosdëgjueshmërisë. (14.AVIIB. Gjerësisht, K. 1341-11-1/1).

Më 7 shkurt 1945 komandën ushtarake e merr Sava Derleviqi, pasi që ishte autorizuar nga Tito për ta vendosë diktaturën ushtarake në Kosovë, krejt me qëllim që sa ma lehtë ta aneksojë. Komandanti i diktaturës ushtarake në Kosovë, Sava Derleviq do të raportojë për 393 shqiptarë të vrarë, 313 të plagosur, 490 të zënë rob, 264 të zënë

pa armë, të dorëzuar 1 078 si dhe 750 të privuar nga liria për sabotazh. Humbjet e Sava Derleviqit ishin: 82 të vrarë, 117 të plagosur dhe 730 të nxënë nëpër shtëpia. Sava Derleviqi raporton se 22 shqiptarë ishin pushkatuar me procedurë të shkurtë. (15.AVIIB. K. 1341-11-1/1).

Ndarja e Kosovës në sektorë mobilizimi, më 12 janar 1945

Pushteti ushtarak, më 12 shkurt 1945, e ndan Kosovën në disa sektorë, duke iu dhënë divizioneve sllave detyra operationale për shkatërrime masive. Sektorët ishin: 1. Sektori i Shalës së Bajgorës, ku rezistonin Ahmet, Mehmet dhe Riza Selaci në bashkëpunim me Adem Vocën; 2. Sektori i Luginës së Ibrit me Kolashin, ku ndiqeshin shqiptarët ndërsa çetnikët mobilizoheshin dhe nxiteshin për vrasje masive në Kosovë; 3. Sektori i Qyqavicës, ku vepronte Shaban Poilluzha me 7 batalione që në realitet përbënin një divizion; 4. Sektori i Drenicës, ku pushtetin e kundërshtonin: Sadik Rama, Zeçë Rama, Hysen Sadiku; 5. Sektori i Prizrenit, ku pushtetin e kundërshtonte Xhemë Gostivari deri në jugperëndim të Maqedonisë; 6. Sektori i Kaçanikut, ku pushtetin e kundërshtonte Hajdin Matoshi; 7. Sektori i Zhegofcit, ku pushtetin e kundërshtonte Adem Gllavica; 8. Sektori i Keqekollës, ku pushtetin e kundërshtonte efektiva e Hasan Hoxhës, Hakif Rimanishtës dhe Bahtir Dumnicës; 9. Sektori i Karadakut, ku pushtetin e luftonte Ali dhe Liman Stanofci, Xheladin Miftari, Asan Kabashi, Fazli Ranatofci, Ajet Burinca etj. (16. AVIIB. K. 1411-14-1/7).

Më 23 shkurt 1945, me shifër nr. 25, Shtabi i Divizionit 52 të UNJ-së së Kosovës, lajmëronte se më 20 shkurt efektivat e Shaban Polluzhës dhe Mhemet Gardicës janë përqendruar në Qyqavicë. Këto forca në efektivë prej 80 luftëtarësh kanë kaluar nëpër Shtuticë dhe Bezhani. Urdhri për sulm nga batalionet 1-2 të Brigadës IV duhet t'i shpartallojë. Si duket nga efektivat kompakte Shaban Pollzha kishte urdhëruar që të themelohet çeta më të vogla me aftësi operative lëvizëse, sepse në dimër nuk kishin ku të strehohen në rend të parë. Prandaj, më 20-21 shkurt efektiva e Shaban Polluzhës do të

përqendrohet në Terstenik. Në vijim, ishin sulmuar dhe pastaj kontrolluar edhe lokalitetet Kraimirofc, Beçuk etj. Në këtë aksion ishte nxënë rob një luftëtar i plagosur. Ai i kishte informuar, me detyrim pas dhunës kriminale se Shaban Polluzha dhe Mehmet Gradica ishin të plagosur për vdekje nga granatat e topit. Thuhet në raport se Shaban Pollzha ka vdekur, ndërsa Mehmet Gadica i plagosur rëndë nuk mundet të flasë. Patrullat kishin hasë në shenja gjaku në trevat ku ishin zhvilluar luftimet. Në fund theksohet se të dy prijësit legjendarë ishin varrosë në vende të panjohura për okupatorët e rinj. (18.AVIIB. K.1412-4-1/2). Në raportin vijues Shtabi i Divizionit 52 për Shtabin Operativ të Kosovës thuhet se deri më 25 shkurt ishin vrarë 358 ushtarë të Divizionit të Shaban Polluzhës. Numri i kufomave është më i madh, thuhet në dokumente, sepse për shkak të borës nuk kemi mundur t'i gjejmë kufomat e mbetura nën borë. Në këtë kohë ishin zënë rob edhe 98 ushtarë, prej të cilëve 14 ishin pushkatuar. Të tjerët ishin dorëzuar organeve të OZN-së në Skenderaj. Gjithsej ishin dorëzuar 459 ushtarë dezertorë. (19.AVIIB. K. 1411-9-1/5).

Më 26 shkurt, Shtabi Operativ i Kosovës i drejtuar nga kriminelin Sava Derleviq kishte bërë emërime të reja për të ushtruar në popull mizori. Ishin ata Steva Dragojeviq, deri në këtë kohë shef i Shtabit të Brigadës VI i malazezëve ishte i ngarkuar me detyrë që ta kontrollojë tërë prapavijën e fronteve në tërë Kosovës. Kjo vërteton se tërë Kosova ishte kthyer në front të luftës pa asnjë përjashtim. Në këtë drejtim edhe Milutin Nikoliqi nga Brigada VI malazeze ishte emëruar shef i Informimit, duke i vënë në disponim disa çeta lëvizëse, në stilin e “leteçi vodëve” të Nikolla Pashiqit gjatë viteve 1919-1925. Historia e krimeve mbi shqiptarët po përsëritej në të njëjtat forma, me qëllim që populli të arratiset dhe pastaj të sulmohet si “dezertor”. (20.AVIIB. K.1411-5-9). Në lidhje me këtë duhet theksuar edhe këtë informatë se më 27 shkurt 1945 Divizioni 46 i Serbisë e njoftonte Sava Derleviqin se forcat e Shaban Polluzhës janë “likuiduar në tërësi në tërë trenin e Drenicës”. Pas kësaj kohe efektivat e Sava Derleviqit do t'i përqendrojnë aksionet kriminale në trevat e Prizrenit, Rahovecit dhe Gjakovës duke ndërmarrë aksione të

burgimeve dhe vrasjeve në vende publike, me qëllim që populli të frikësohet. Kishte raste kur gjuhej me topa në drejtime të maleve vetëm për të shkaktuar panik. (21. AVIIB. K. 1341-7-3/2).

Mobilizimi i popullsisë në Drenicë nga Shaban Polluzha

Të kthehemi edhe njëherë në një përshkrim të shkurtër të mobilizimit të efektivave të Shaban Polluzhës. Në fund të dhjetorit 1944 dhe fillim të janarit 1945, Shaban Polluzha do ta mobilizojë popullin në Drenicë për t'i mbrojtur trojet shqiptare nga agresioni komunisto-çetnik serb. E vërteta, ashtu si e kualifikonin fuqitë evropiane dhe aleanca ballkanike më 1912 luftën shqiptare për t'i mbrojtur trojet kombëtare, se kinse shqiptarët “po luftojnë për t'i mbrojtur regjimet gjakatare të Stambollit”. Në të njëjtën mënyrë, më 1945, luftën shqiptare prapë për mbrojtjen e trojeve etnike duke i luftuar divizionet jugosllave komunisto-çetnike nga Serbia, nga Maqedonia dhe Mali i Zi, luftë kjo që ishte e drejtë, por pikërisht komunisto-çetnikët do ta zbulojnë kartën e vjetër për akuza ndaj shqiptarëve se kinse po luftonin për mbrojtjen e nazizmit gjerman. E vërteta është se nga 23 nëntori 1944, gjermanë në Kosovë nuk kishte. Fronti kundër nazizmit në janar 1945 kur komunisto-çetnikët po thurnin këso gënjeshtërash, gjermanët ishin në vijën e frontit: Sarajevë-Srem. (23.AVIIB. Fondi LNÇ .K. 1411-gjerësisht).

Luftës së Shaban Polluzhës do t'i bashkëngjitet popullsia e Llapit, Shalës së Bajgorës, Dukagjinit e e tërë Kosovës. Në ballë të reparteve luftarake shqiptare ishte, pra, Shaban Polluzha, ishin edhe Mehmet Gradica, Adem Voca, Ahmet, Mehmet, Rizah Selaci, Ibrahim Lutfiu, Hakif Rimanishta, Mehmet Xhakja, Ukë Toverlani, Musli Dumoshi, Bahtir Dumica e shumë të tjerë. (24. AVIIB. Fondi LNÇ. K. 1411). Me fjalë të tjera në frontet e luftës në janar-shkurt 1945 në tërë Kosovën ishin 8 500 kryengritës. (25. AVIIB. F. LNÇ. K. 1411-Locimi i vullnetarëve shqiptarë, janar-shkurt 1945).

Numri i brigadave komunisto-çetnike në Kosovë, janar-shkurt 1945

Më 21 janar 1945, Fadil Hoxha do ta organizojë një mbledhje të Shtabit Operativ të Kosovës. Në këtë mbledhje, pas kthimit të Shaban Polluzhës me tërë brigadën prej Podujevës për t'u pozicionuar në Drenicë, Shtabi Operativ i Kosovës vendos që ta rrethojë, dhe në rast mosbindje ta sulmojë tërë brigadën si quhej të Shaban Polluzhës. Për rrethimin e brigadës ishin urdhëruar: Brigada e Pestë e Kosovës, dy batalione nga Divizioni 46 i Serbisë (të gjithë ish-çetnikë e HB) si dhe Brigada e KNOJ-it, e njohur për mizori ndaj shqiptarëve, sepse komandohej prej Spasojë Gjakoviqit dhe kriminelëve ordinerë të njohur si dhunues edhe para Luftës së Dytë Botërore në Kosovë. Në këtë rrethanë, do të mbahen disa takime të Shabanit me komunisto-çetnikët, por ato kishin mbaruar pa sukses. E vërteta, sipas Fadil Hoxhës, komandant Shaban Polluzha do të deklarojë: “Llapjanët ma prishën brigadën me propagandë duke thënë se ne po shkojmë në Serbi, por serbët po vijnë në Kosovë për të na i çnjerëzuar familjet dhe për ta okupuar Kosovën, sepse Kosova po shprazet me sherr prej Serbisë”. (26. Shënimet e Fadil Hoxhës më 1986 për një libër që pretendohej të botohet në 420 faqe). Në këtë kohë (janar 1945) brigadat e Kosovës kishin këtë numër luftëtarësh: Brigada e Parë, 1 500 luftëtarë, Brigada e Dytë i kishte 3 200 luftëtarë, Brigada e Tretë i kishte 1 300 luftëtarë, Brigada e Katërt i kishte 1 550 luftëtarë, Brigada e Pestë i kishte 1 350 luftëtarë, Brigada e Gjashtë i kishte 1 400 luftëtarë, Brigada e Shtatë i kishte afro 5 500 luftëtarë. Komandant urdhërdhënës i këtyre brigadave, *de jure* ishte Fadil Hoxha. Komisar politik ishte Kërsta Filipoviqi, i njohur për vrasjet monstruoze të Qamil Hoxhës me shokë në Skenderaj. (27. Fadil Hoxha, Këto shifra ishin nga 3 XII 1944 e deri më 6 janar 1945).

Kur filloi mobilizimi i përgjithshëm në tërë Kosovën?

Sipas dokumenteve të Shtabit Operativ të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës ishte shtruar nevoja e kohës që të fillojë mobilizimi i përgjithshëm më 15 janar 1945 me moton: “Çdo gjë për front, çdo gjë për liri”. Me këtë devizë do të fillojë mobilizimi i përgjithshëm me emrin për “krijimin e brigadave plotësuese”. Me këtë platformë politike dhe ushtarake në Kosovë do të mobilizohen mbi 20 000 regrutë-luftëtarë. Në operacionin e parë të mobilizimit shqiptarët kishin vajtur në Frontin e Sremi pa asnjë problem.

Në këtë kontingjent ishin rekrutuar, në Brigadën e Parë, prej 2 500 luftëtarësh, të drejtuar nga Qamil Brovina, një patriot i dëshmuar, më 19 janar 1945. (28. Qamil Brovina, Kujtime 1972). Komisar i kësaj brigade ishte Vuko Turkoviq, i njohur si njeri shumë i qetë dhe i paanshëm.

Në Brigadën e Dytë që drejtohej për Srem më 20 janar 1945, e që drejtohej nga Shaban Haxha i kishte 2 500 luftëtarë. Komisar i kësaj brigade ishte Pavle Brajeviq që njihej si antiçetnik i përbetuar.

Në Brigadën e Tretë, më 21 janar 1945, që i kishte 2 600 luftëtarë komandonte Miça Mijushkoviq, i njohur si njeri shumë i afërt me shqiptarë, madje komandonte në gjuhen shqipe! Komisar politik i kësaj brigade (grupe si quhej me tendencë - HB) ishte Vojin Vukeliq, i njohur si komunist shumë i sinqertë, por që ishte me temperament të tepruar prej ushtaraku. Itinerari i këtyre forcave ishte, Prishtinë-Podujevë-Kushumli-Nish-Beograd-Srem. (29. AVIIB. LNç, K. 1411; Shënimet e Qamil Brovinës, *Si shkuam në Srem më 1963*, dorëshkrim). Derisa arritën në Vershac, brigadat e lartshënuara nëpër Serbi do të kalojnë pa probleme të vogla rrugëtimi. Përrjashtim bënë një tentim të komunisto-çetnikëve për ta shkëputë lokomotivën nga vagonët në relacionin Kushumli-Nish, por falë vigjilencës së Musa Efendisë nga Gjakova, që ishte një patriot i vërtetë, katastrofa do të evitohet dhe çetnikët (3 persona) do të pushkatoen me procedurë të shkurtë afër Nishit. (30. Deklaratë e Qamil Brovinës dhe Musa Efendisë, më 1973).

Në Vershac më 19 shkurt 1945 në ora 21:00 regrutët do ta kurdisin arratisjen nga andej dhe do të mësyhen për Beograd. Duke mos e ditur rrugën, oficerët rusë dhe serbë të gjithë 472 regrutë, do t'i arrestojnë në vendin e quajtur Shid. Të gjithë, me përjashtim të dy regrutëve që ishin mbytë në ujërat e Danubit, do të gjinden para Gjykatës Ushtarake, me organizim të OZN-së, që do të themelohet enkas për këtë dezertim. Shtabi i brigadës i drejtuar si i fuzionuar (të gjitha brigadat në një) do ta themelojnë gjykatën dhe në krye të saj do ta emërojë Qamil Brovinën. Pas një hetimi jo të dhunshëm, do të rezultojë se 11 regrutë ishin organizatorë. Të gjithë do të ekzekutohen me ligje të luftës. Nga kjo kohë kjo brigadë do të quhet “Brigada e Shaban Haxhisë”, pasi që lufta kishte marrë dimensione përfundimtare. (31. AVIIB. fasc.1/IV. K. 222).

Mosdëgjushmëria ushtarake e Shaban Polluzhës

Sipas dokumenteve komandant i Brigadës së Drenicës (që kishte edhe nga anët tjera) ishte Mehmet Gradica, ndërsa zv. komandant ishte Shaban Polluzha, por autoriteti i plakut e kishte bërë të vetën dhe brigada quhej e Shaban Polluzhës.

Sipas raporteve të nënshkruar nga komandanti i diktaturës ushtarake S. Derleviq dhe zëvendësit të tij Gjura Medenica më 10 shkurt 1945, ishin mobilizuar 6 300 regrutë shqiptarë. Mbetej për t'u rekrutuar edhe 5 000 të tjerë, të cilët duhej të ishin të gjithë shqiptarë. Pse komandanti e kishte këtë synim, del sheshazi se ishte fjala për shprazje të Kosovës, për ta institucionalizuar okupimin klasik. Lidhur me këtë, për ta kryer detyrën e besuar nga Shtabi Suprem i Jugosllavisë, S. Derleviq kishte kërkuar koordinim të partisë, zonës dhe frontit nëpër komanda të vendeve. Mobilizimin e kishin marrë për detyrë ta kryenin brigadat e Kosovës: 1, 2, 3, 4, 5 dhe divizionet e Serbisë: 24 dhe 46. Në këtë detyrë ishte autorizuar të veprojë edhe një pjesë e Divizionit 41 të Maqedonisë. Në këtë rrethana pushteti ushtarak kishte bërë riorganizime, kuptohet të lejuara nga Shtabi Suprem. Pra, nuk kishte këtu “punë” njëherë për Shtabin Kryesor të Serbisë, deri sa të shprazej Kosova. Prandaj, brigadat e Kosovës: 1, 2

, 4 e përbënin Divizionin e Kosovës me nr. 52. Më 12 shkurt 1945, Brigada 3 dhe 5 të Kosovës, Brigada 6 dhe Brigada 1 e Bokelit (malazeze) e kishin themeluar një shtab komandues dhe ai quhej Grupi i Brigadave. Derisa të parët mobilizonin dhe bënë krime në Kosovë (Divizioni 52) të dytët (Grupi i Brigadave) bënë krime monstruoze në Dukagjin, Drenicë dhe Shalë të Bajgorës. (32. AVIIB. F. LNÇ. K. 1411). Poenta kryesore e këtyre brigadave që silleshin e “pështilleshin” nëpër viset e banuar me shqiptarë, pa e mobilizuar asnjë serbë, sidomos asnjë kolonistë, fliste që popullit shqiptar po i përgatitej thika pas shpine. Mu për këtë arsye Shabn Polluzha nuk kishte pranuar nga fillimi që të rekrutojë ushtarë për LNÇ-në, pa u armatosë. Ky element i kishte shërbyer mjaftë me rastin e shndërrimit të pajtimit njëherë e pastaj të refuzimit që të shkojë në frontin e Sremit.

Si u organizua Brigada e Shaban Polluzhës gjatë janarit 1945?

Në Brigadën e Shaban Polluzhës kishte edhe oficerë shqiptarë që kishin përvojë të duhur ushtarake, por ishin të ngritur edhe politikisht. Ata nuk do të pranojnë të nisen në Frontin e Sremit pa qenë të armatosur. Pra, kësaj brigade nuk do t'i ndodhë sikurse që u ndodhi regrutëve të mobilizuar për Armatën e Katër të vijës së Adriatikut që shkuan në front të paarmatosur, të përcjellur nga ushtarët serbo-maqedonë, të armatosur deri në dhëmbë. Edhe një fakt, ushtarët e rekrutuar për Armatën Jugosllave të Adriatikut nuk i kishin zgjedhë drejtuesit e tyre. Ata sikur po deportoheshin, sikur të ishin rob lufte!

Ja si ishte e organizuar Brigada e Shaban Polluzhës në anën tjetër. Pas mobilizimit Brigada e Shaban Polluzhës mori këtë strukturë. Komandant Brigade Shaban Polluzha (1871-1945), zëvendëskomandant Mehmet Gradica (1915-1945), zëvendës i dytë Rexhep Qena nga Likoshani, këshilltar i parë i Brigadës Azem Aruçi, këshilltar i dytë i Brigadës Sadik Lutani, komandant i Batalionit të Parë Isa Zymberi, komandant i Batalionit të Dytë Sadik Zeka nga Vushtrria, komandant i Batalionit të Tretë Miftar Llausha-Bajraktari,

komandant i Batalionit të Katërt Aziz Xheku nga Oshlani, komandant i Batalionit të Llapit Rifat Maloku, komandant i kompanisë së Çetës Iliaz Muli, komandant i kompanisë Hakif Rimanishta, komandant i Çetës së Llapit Abdullah Mihaliqi (prej të gjithë regrutëve 25% ishin pa armë), komandant i kompanisë Islam Vatofci nga Qyqavica, komandant i kompanisë përcjellëse të Shaban Polluzhës Ajet Qezi. Pasi që kjo Brigadë do të kthehet nga rruga në Podujevë për në Drenicë, duke mos iu bind urdhrave të Shtabit Operativ, me të drejtë sepse në prapavijë, sidomos në Drenicë OZNA-ja kishte bërë mizori, do të zhvillohen sulme ndaj saj nga ana e Divizionit 52 që e drejtonte krimineli Petar Brajeviq nga 10-23 shkurti 1945. (33. AVIIB. Fondi: LNÇ. K. 1411).

Luftimet, thuhet në dokumente janë zhvilluar për çdo ditë. Luftimet më të rrepta sipas këtyre dokumenteve janë zhvilluar më 12 shkurt 1945 në Qyqavicë dhe Kolashin të Vjetër. Në dokumente theksohet për humbjet e mëdha në të dy anët. Pushteti ushtarak, vlerësonte se në anën e Shaban Polluzhës janë vrarë 258 luftëtarë, ndërsa 56 janë nxënë rob. Prej tyre me procedurë të shkurt nga gjyqi ushtarak 12 ishin pushkatuar, ndërsa të tjerët ishin dorëzuar në OZN-në për trajtim. Lidhur me këtë, një dokument i sajuar nga kreshnikët e Ajet Gergurit, dëshmon se të gjithë (44) të mbeturit janë pushkatuar nga Petar Brajeviqi përmes çetës vrasëse që ishte themeluar pranë Divizionit 52 me detyrë speciale. (34. AVIIB.F. LNÇ. K.1411)

Në shënimet e tij Fadil Hoxha, më 1985, thekson se vënia e diktaturës ushtarake, Miladin Popoviqin e ka tronditë. Prandaj, ai kishte vendosë të shkojë në Beograd për të kërkuar sqarime, sepse më 8 shkurt lufta e Shaban Polluzhës dhe luftimet tjera në Kosovë ishin dobësuar deri në masën e fundit. Shkurt, çetat që rezistonin nuk kishin as armatim, as fuqi njerëzore të na rezistojnë. Ata, madje nuk kishin as sanitet, as ushqim të duhur, prandaj koha punonte për Shtabin Operativ dhe strategjinë e tij”. (35. Fadil Hoxha, Dorëshkrim për LNÇ-në 1941-1945, pjesa “Vojna uprava bez razloga”).

“Në Beograd - do të shkruajë Fadil Hoxha - synonim të bisedojmë me J. B. Titon, por aty për aty na u kundërvu Millovan Gjillasi. Më duhet të them se në dhomën përcjellëse ishin edhe A.

Rankoviqi, S. Zhujoviqi, B. Neshkoviqi të cilët nuk i njihja, por e njihja S. V. Tempon. Ai nuk na u afrua fare. Kjo do të thotë se ata ishin marrë vesh që ta ndajnë Kosovën sikurse më 1913, si kërkoi Gjillasi. Por, Milladini reagoi shumë ashpër dhe biseda u ndërpre me largim të Gjillasit nga zyra. Ajo bisedë ka zgjatë jo më shumë se dhjetë (10) minuta. Çdo gjë tjetër si epilog dihet dhe nuk dihet, por Milladini u vra, më 13 mars 1945, nën mbikëqyrjen e pushtetit ushtarak. Zyrën e tij e ruanin tri (3) roje dhe nuk kishte shans që ndonjë njeri t'i hyjë në zyrë pa u shënuar dhe pa u pyetur se për çka kërkon takim. Shënimet për këtë regjim kanë munguar gjithmonë dhe ato nuk i kemi kërkuar sepse ishin çështje ushtarake?!". (36. Fadil Hoxha, Dorëshkrim për LNÇ-në 1941-1945).

Pasojat e diktaturës ushtarake për shqiptarë

Defaktorizimin e Kosovës në të gjitha aspektet Shtabi Suprem i Jugosllavisë do ta sigurojë në kontinuitet, hap pas hapi. Ja faktet. Josip Broz Tito, më 2 shtator 1944, në emër të Shtabit Suprem të Jugosllavisë, Shtabin Kryesor të Kosovës e kishte degraduar në Shtab Operativ, nën komandën e Shtabit Kryesor të Serbisë. (AVIIB. K.1411). J. B. Tito më 26 dhjetor 1944, kishte marrë një kërkesë të nënshkruar nga Pavle Joviqeviqi, Petar Brajeviqi dhe Spasoje Gjakoviqi, pa dijen e M. Popoviqit dhe Fadil Hoxhës, që në Kosovë të vendoset diktatura ushtarake, me qëllim që populli i kësaj treve shqiptare mos të ketë mundësi që me referendum ta kërkojë bashkimin me Shqipërinë. Lidhur me këtë, pushteti çetnik-komunist (çetnikët, kryesia e AVOJ-it i kishte amnistuar, më 21 nëntor 1944) do të inskenojë konflikte në vise të ndryshme të Kosovës me qëllim që të justifikohen masat represive ushtarake në kushte të luftës. Lidhur me këtë, me kërkesë të Millovan Gjillasit dhe A. Rankoviqit, Vasa Qubrilloviqi kishte përpiluar program për likuidimin e shqiptarëve dhe atë ua kishte dorëzuar çarqeve ushtarake, më 3 nëntor 1944, në Beograd. Për atë program ishte dakorduar edhe J. B. Tito. Po atë, do ta pranojë edhe E. Kardeli, më 1974 në Kranj të Sllovenisë.

Çka thotë Fadil Hoxha për vendosjen e diktaturës ushtarake?

Fadil Hoxha shkruan se forcat balliste në Kosovë ishin shumë të fuqishme më 1945. (Fadil Hoxha nuk e dinte se ballistë, në Kosovë, në kuptimin ushtarak si formacione ushtarake nuk kishte, por kishte rezistencë të armatosur kundër ardhjes së efektivave ushtarake komunisto-çetnike nga Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia, të dirigjuara nga PKJ-HB). Forcat balliste, vijon Fadili i udhëhiqnin oficerët dhe personat tjerë të ushtruar nga Gestapoja. Fon Ler, komandant i Armatës “E” ishte oficerë fanatik që planifikonte t’i tërhiqte 350 000 ushtarë nga Greqia, Shqipëria dhe Maqedonia nëpër Kosovë. Prandaj, më 14 tetor 1944, Fon Ler e vendos shtabin në Mitrovicë, për ta hapur rrugën pastaj të vendoset në Sarajevë, deri në kapitullim, më 15 maj 1945.

Për këtë arsye ai formon shtab dhe i armatosë disa efektiva shqiptarë, në mënyrë që “anglezët mos të vijnë në Kosovë”, si çlirimtarë. Sulmi ndaj efektivave të Shaban Polluzhës, do të shkruaj Fadil Hoxha, para një komisioni shtetëror, që e kishte shti nën HETIME, do të fillojë më 24 janar 1945, në vendin e quajtur Kulinë (ngushticë strategjike në mes Prishtinës dhe Llapit). Forcat partizane do e sulmojnë Divizionin e Shaban Polluzhës me të gjitha mjetet ushtarake mu aty, në atë ngushticë, por pa sukses, sepse ata kishin vendos mos të shkojnë në Frontin e Sremit. Fadil Hoxha pastaj e sjell përbërjen complete të Shtabit Operativ të Kosovës që e kishte formuar Tito me urdhër sekret nr. 30, më 8 shkurt 1945.

Fadil Hoxha thekson se në ora 08:00 në zyrën e tij do të hyjnë pa paralajmërim disa oficerë. Me këtë Fadili dëshmon se sa ata që erdhën ishin të kujdesshëm dhe sa e çmonin Luftën Antifashiste në Kosovë. Ndodhte ky fenomen sepse po ta çmonin Kosova, duhej të konsiderohej njësi federative e barabartë me njësitet tjera. Por, Tito si demagog politik dhe antishqiptar kishte treguar qysh më 2 shtator 1944 se kush ishte, kur e kishte degraduar Shtabin Kryesor të Kosovës nën Shtabin Kryesor të Serbisë. Ky ishte paralajmërimi evident se çka do të ngjajë me Kosovën - me shqiptarët në Jugosllavi. Në bisedë me ta, Fadili i fton anëtarët e Shtabit Operativ dhe

sekretarin e PKJ-së për Kosovë, Milladin Popoviqin. I njofton se kemi mysafir nga Shtabi Suprem i Jugosllavisë. Në ato rrethana fillon mbledhja ku janë prezent të gjithë anëtarët e duhur për atë moment. Sava Derleviq i prezanton oficerët që vinin nga Beogradi. Ndërsa, Fadil Hoxha i prezanton oficerët e Shtabit Operativ.

Milladini i prezanton anëtarët e Byrosë Politike të Komitetit Krahinor. Pas kësaj “ceremonive” Sava Derleviq e nxjerrë një letër dhe e lexon se në Kosovë vendosë diktatura ushtarake. Pas leximit, disa minuat në sallë mbretëron një atmosferë varri. Ne ishim të befusuar. Milladini zverdhet dhe më shikon - thekson Fadili, se si do të reagojë. Pas leximit, Fadil Hoxha e merr fjalën duke e thënë këtë: “Me siguri se Shtabi Suprem e ka analizuar situatën dhe në bazë të saj ka sjellë vendim. Kjo sipas mendimit tim është dashtë të vendoset më herët, kur kundërshtarët kanë qenë shumë të fortë, por tash kur i kemi mund prapë me ardhjen tuaj ne jemi këtu që t’ju ndihmojmë. Ju keni përvojë në luftë kundër fashistëve dhe çetnikëve. Unë jam në dispozicionin tuaj. Aty ku thotë Shtabi Suprem dhe KQ-ja e PKJ-së, unë jam aty. Jam i sigurt se kështu do të veprojnë edhe shokët tjerë të Shtabit Operativ. Ne do t’ju ndihmojmë me informata”. Kjo bisedë e lehtësoi atmosferën. Fadil Hoxha nuk e dinte se prapa shpinës së tij, Pavle Joviqeviqi, Petar Brajeviqi, Tomë Popoviqi, Spasoje Gjakoviqi dhe Dushan Mugosha kishin komunikuar me Rankoviqin dhe Gjillasin dhe e kishin bind Titon se “nëse nuk vendos diktaturë ushtarake, Kosova do të luftojë deri në pikën e fundit për t’iu bashkuar Shqipërisë”. (37. Fadil Hoxha, Për “Vojna upravën”-pushtetin ushtarak”).

Miladin Popoviqi pastaj e merr fjalën dhe e përshëndet vendimin me ton befasues dhe me një skepticizem se do të angazhohet me të gjitha forcat progresive për stabilitet dhe demokraci në Kosovë. E pra, demokracia që e theksoi dhe diktatura nuk përkonin me pajtimin definitiv politik me këtë akt të tillë militarist dhe do të thoja neofashist. Miladini e shton pyetjen, do të jetë shumë vështirë t’ia shpjegojmë popullit dhe ashtu duke shpjeguar ta arsyetojmë këtë vendim, pasi që ne ishim në fund të

likuidimit të forcave regresive. Sikurse Miladini, për mos me u zbuluar, flet përciptazi edhe Pavle Joviqeviqi. (38. Fadil Hoxha, Pushteti ushtarak, si u vendos).

Pse reagoi Miladini dhe në çka bazohej?

Miladin Popoviqi e mbante qëndrimin e vitit (tetor) 1940 të KQ-së së PKJ-së së Kosova duhet të jetë njësi e posaçme federative, republikë sovjetike e lidhur politikisht drejtpërdrejt me KQ-në e PKJ-së. Kosova pra, ishte sikurse njësitë tjera federative në hierarkinë politike nga viti 1940, por, ishte në të njëjtën pozitë me njësitet tjera kur e kishte themeluar Shtabin Kryesor, më 20 tetot 1942, të cilin S. v. Tempo si delegat i Shtabit Suprem e vërteton se është legjitim, më 15 mars 1943, në Shar. Kosova në aspektin legjislativ me Kuvendin e Bujanit e kishte organin e vet të pushtetit (një AVNOJ) sikurse njësitet tjera. Prandaj, ky degradim nuk ishte i falshëm për Milladinin i cili e dëshironte pozitën më të lartë politike në Kosovë dhe për këtë nuk kishte konkurrencë. Do të reagojë, por do të pësojë, do ta paguaj me jetë. Fadili do të pajtohet dhe do të notojë në ujërat e titizmit duke faktorizuar Kosovën dhe shqiptarët nëpër etapa të vështira që impononte shovinizmi serbomadhi i ndihmuar nga tërë politika jugosllave, pa dallim. (39. Ismet Shaqiri, *Kujtime* 1972).

Sërish e merr fjalën Sava Derleviq, duke sqaruar se Fadil Hoxha dhe Pavle Joviqeviqi mbesin në Shtab. Se Fadil Hoxha do të jetë zëvendëskomandant i Shtabit, ndërsa Pavle Joviqeviqi anëtar përgjegjës për politikë kadrovike. Ndërsa, Petar Brajeviq do të emërohet komandant i Divizionit 52 që do të themelohet. Sava Derleviq do të konstatoj më tej se nga Mali i Zi do të vijnë në Kosovë dy brigada, të cilave do t'iu bashkëngjitet në operacione edhe Brigada e KNOJ-it. Në tërësi në Kosovë do të operojnë 9 brigada kundër armikut për të vënë rend dhe qetësi. Sava Derleviq do të konstatojë se pas pesë ditësh në Kosovë do të vijë nënkoloneli Ratko Vujaqiq-Shpanac i cili do të jetë shef i Shtabit Operativ të Kosovës. Lidhur me këtë, më 9 shkurt 1945, Shtabi Operativ i diktaturës ushtarake do ta analizojë situatën politike dhe ushtarake dhe pastaj

me një proklamatë do t'i drejtohet popullit. Në proklamatë shpjegohet pse është vendosë diktatura ushtarake. Do të kërkohet që për një afat të caktuar të dorëzohen të gjithë dezertorët dhe pas dorëzimit do të ndodhë amnistia. Do të shpjegohen kushtet e dorëzimit. Nëse dezertorët do t'i dorëzohen gjyqit ushtarak, për ta thuhet se do të ketë lehtësira. Ky konstatim dëshmon se pushteti ushtarak do t'i drejtojë tri niveleve të pushtetit: atë legjislativ, gjyqësor dhe ekzekutiv. E vërteta është se, Partia Komuniste si parti e vetme (pa konkurrencë) vihej jashtë ligjit. *De fakto* Sava Derleviqi kishte ardhur në Kosovë me një mision të valive të dikurshëm të vilajeteve të Turqisë. Madje nëse analizohet proklamata, ajo i përngjan “ERRFISE” së Dergut Pashës në shtator të vitit 1910. Si duket shprehja dhe përmbajtja ishin kopjuar prej saj. Lexuesit i mbetet t'i krahasojë. (40. AVIIB. K. 22-30/1).

Edhe Komiteti Krahinor i PKJ-së do ta lëshojë një proklamatë drejtuar popullit. Ndër të tjera, në të thuhet: “Historia e rezistencës në Kosovë fillon me Ferizajn, Gjilanin, Llapin, Drenicën dhe Shalën e Bajgorës. Rezistencës - shkruan në proklamatë - i bashkëngjitet edhe reaksioni çetnik”. Nuk duhet harruar se ka pas keqsjellje edhe nga ana e pushtetit të rinj ndaj shqiptarëve në disa lokalitete e që i kanë dekurajuar qytetarët që ta mirëpresin pushtetin e ri demokratik. Milladini e thekson se në këtë rezistencë kanë gishtë ish-oficerët gjermanë, pohim ky që është sajësë politike dhe nuk mund të vërtetohet me asnjë argument. E vërteta është krejt diku tjetër. Shqiptarët në masë nuk donin që të mbesin sërish nën zgjedhën koloniale të Serbisë apo Jugosllavisë së konvertuar. Prandaj vendosja e pushtetit ushtarak duhet kuptuar si reagim që Kosova mos t'i bashkohet Shqipërisë, ashtu si kishte qenë një pjesë e saj gjatë okupimit nazifashist 1941-1944. Milladin Popoviqi kërkon në proklamatë “likuidim të bandave, pastrim të terrenit dhe forcim të pushtetit popullor, kërkon flakje të shovinizmit dhe mosbesimit në mes popujve të Kosovës. Prandaj, vijon ai, duhet njoftohen organizatat e PKJ-së pse është vendosë pushteti ushtarak. Këtë detyrë ua mveshë sekretarëve të partisë nëpër rrethe dhe lokalitete të

Kosovës. Anëtarët e partisë duhet më tej t'ua shpjegojnë masave të gjëra se pushteti ushtarak është në dobi të tyre, të sigurisë së tyre, për ta krijuar pastaj pushtetin demokratik në rrethana tjera. Pasi që në Kosovë veprojnë shumë divizione dhe brigada nga viset tjera të vendin - shkruan Milladini - ne duhet t'i udhëzojmë që të kanë kujdes në sjellje lidhur me specifikat që mbretërojnë në Kosovë në rrafshin nacional. Individët duhet të kenë kujdes, sepse në rast se keqpërdorin rrethanat dhe pozitën do të përgjigjen në instancat ushtarake dhe partiake në formën ma të ashpër. Duhet - shkruan ai - të punohet që populli të afrohet me pushtetin dhe ngadalë të mësohet me gjendjen e re, por ajo atmosferë krijohet vetëm me mirësjellje partizane ushtarake dhe korrektësi politike dhe njerëzore. (41. A. KQ. PKJ. D. 1580).

Diktatura ushtarake - shkruan në një studim Fadil Hoxha - më 1962, shfuqizohet në fillim të qershorit 1945. Atëbotë, transformohet Shtabi Operativ i Kosovës. Kompetencat e tij kalojnë në Armatën e Tretë me seli në Shkup. (Fadil Hoxha, Aspekte të LNÇ-së, dorëshkrim i pabotuar). Pas këtyre konkluzave politike shtrohet pyetja, pse Fadil Hoxha dhe Milladin Popoviqi shkuan për t'u ankuar në Beograd pikërisht te Josip B. Tito, i cili nuk i pranoi fare, por vetëm M. Gjillasi, i cili me çdo çmim luftonte që Kosovën ta aneksojë Mali i Zi, ose ta ndaj me Serbinë sikurse më 1913. Shtrohet tash pyetja, pse shkoi Milladini kur ai nuk ishte, e këtë e vërtetojnë dokumentet sekrete (Letra e 2 janarit 1945, dërguar KQ-së së PKJ-së nr. 1581), që Kosova t'i takojë Shqipërisë. Jo, Milladini shpresonte se Kosova do të jetë një njësi e barabartë me republikat tjera, ashtu si ishte vendosur në Zagreb, më 1940. Në këtë filozofi politike, Milladini shpresonte se në Republikën e Kosovës “deri në vdekje do të jetë violina e parë”, do të konkludojë Fadil Hoxha më 1985 në një bisedë në Prishtinë. E pra, vrasja e Milladinit e ka pikënisjen këtu, që OZN-ja do ta likuidojë për të bërë Tito, Gjillasi dhe Rankoviqi me Kosovën çka të duan dhe si të duan. Pra, për çdo krim e krime monstruoze ka pas për “eksport”, fajtorë janë këta tre varmihës në pretendim të shqiptarizmit në shekullin XX. (42. Konstatim i një analize të Shtabit USTASH, më 1974 në Mynhen të Gjermanisë).

Vendosja e diktaturës ushtarake në Kosovë, më 8 shkurt 1945

Tejet sekret nr. 30, më 8 shkurt 1945, sipas nevojës së duhur emërojnë:

1. Në Shtabin Operativ të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit: për komandant kolonelin Sava Derleviq, deri tash kryeshef i Shtabit të Armatës së Parë të UÇJ, për zëvendës të komandantit kolonel Fadil Hoxhën, për komisar politik kolonelin Gjuro Medenica, për kryeshef të Shtabit kolonel Duklan Vukotiqin, deri tash zëvendës i komandantit të Divizionit 46 të UPÇJ; 2. Shtabi i Divizionit Kosovës: për komandant kolonel Petar Brajeviqin, për komisar politik Aca Vukotiqin, për ndihmës të komisarit politik nënkolonel Bllazha Markoviqin, për shef të Shtabit për Kosovë dhe Rrafsh të Dukagjinit majorin Stanko Mrxhenoviq; 3. Shtabi Operativ për Kosovë dhe Rrafsh të Dukagjinit do të jetë nën komandën e drejtpërdrejtë të Shtabit Suprem. Këtë emërim duhet zbatuar menjëherë. Komandanti Suprem i UPNÇJ-së, mareshal Tito.

Shtabi Suprem i UPNÇJ-së, tejet sekret nr. 31, sipas nevojës së duhur urdhëroi: 1. Që në Kosovë dhe Dukagjin të instalohet dhe funksionojë pushteti ushtarak, i cili do të jetë organ i pushteti shtetëror ushtarak në regjionin e përmendur; 2. Për komandant të pushtetit ushtarak në Kosovë dhe Dukagjin emëroi kolonelin Sava Derleviq, komandant të Shtabit Operativ për Kosovë dhe Dukagjin. Për komisar politik emëroi, nënkolonelin Gjuro Medenica, që do të jetë komisar politik i Shtabit Operativ të Kosovës dhe Dukagjinit. Kolonel Sava Derleviq dhe nënkolonel Gjuro Medenica do ta kryejnë këtë detyrë sipas punës së rregullt në Shtabin Operativ; 3. Për komandant të Regjionit Ushtarak të Kosovës dhe Dukagjinit emëroi, kolonelin Nikolla Bozhoviq. Komanda e regjionit ushtarak është nën komandën e drejtpërdrejtë të pushtetit ushtarak, përkatësisht të Shtabit Operativ për Kosovë dhe Dukagjin; 4. U ndalohej shqiptarëve komunikimi në gjuhën shqipe në vendet publike në

Kosovë dhe Maqedoni; 5. Të dërgohen nëpër kampe të përqendrimit të gjithë shqiptarët që kanë bashkëpunuar me okupatorin dhe pushtetin kuisling si dhe ata që e kundërshtojnë pushtetin tonë popullor dhe demokratik”. (Nga Ditari i Luftës i Josip Gjergjës, viti 1945, i pabotuar; 6. Mbi 90% e shqiptarëve ka bashkëpunuar me fashizmin). Për Shtabin Suprem të Jugosllavisë Tito d. v. (43.AVIIB. Vojna uprava na Kosmetu 1945).

Nga versioni i parë Mosha Piade i evitoi pikën 4, 5 dhe 6, pas një diskutimi problematik në mes Gjillasit, Rankoviqit, Kardelit, Blagoje Neshkoviqit dhe Sreten Zujoviqit. Tito provoi të arbitrojë në favor të personave të theksuar, por Mosha Piade si hebre, duke e njohur kontributin e shqiptarëve doli hapur: “Ky formulim nuk kalon. Është i pandërgjegjshëm dhe i pastudiuar mirë. Sot në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë (shkurt 1945) janë mbi 60 000 shqiptarë. Ata po luftojnë heroikisht në të gjitha frontet kundër fashizmit. Nuk mund të barazohen shqiptarët me Xhafer Devën dhe Muharrem Bajraktarit që kanë lidhë marrëveshje me çetnikët e Drazha Mihajloviqit. Lexoni informatat nga terreni”. (44. Shënim i Josip Gjergjës në ditarin e luftës 1945).

Tejet sekret nr. 32. Shtabi Suprem, sipas nevojës së krijuar urdhëroi: 1. Nën komandën e drejtpërdrejtë të Shtabit Operativ në Kosovë dhe Rrafsh të Dukagjinit janë si njësi organike të shtabit: Divizioni i Kosovës, Grupi i brigadave operative të Malit të Zi me dy brigada, Divizioni 46 serb; 2. Shtabi Operativ për K. dhe D. do ta forcojë Grupin Operativ Malazez me një brigadë nga Kosova dhe do t'i ketë tri divizione të cilat duhet t'i kenë 30 000 luftëtarë; 3. Në divizione duhet zbatuar formacionet e organizuara dhe udhëzimet e fundit. Komandanti suprem i UPNÇJ-së, Tito.

Shtabi Suprem i UPNÇJ-së, tejet sekret nr. 33, sipas nevojës së krijuar urdhëroi: 1. Për komandant të Divizionit 44 të UPNÇJ-së emëroi, kolonelin Velko Zhizhiq, deri tani në Shtabin e Korpusit të Dytë të UNPÇJ-së; 2. Për komisar politik të Divizionit 44 emëroi, Vukalica Millutinoviqin; 3. Për zëvendës të komisarit, Dushan Vukotiq. Këtë orar duhet zbatuar menjëherë.

Komandanti suprem, Tito

Tejet sekret nr. 33, sipas nevojës së krijuar zyrtare emëroi: 1. Për komandant të Grupit të Brigadave të UPNÇJ-së kolonelin, Velko Zhizhiq, deri tani në shërbim të Shtabit të Korpusit sulmues të Dytë të UNPÇJ-së; 2. Për ndihmës komisar Dushan Vukotiqin. Këtë urdhër duhet zbatuar menjëherë, Tito. Siç shihet, J. B. Tito, i ndikuar nga klani shovinist serb dhe për ta siguruar pozitën në pushtetin e Jugosllavisë do ta shlyej çdo veçanti të Kosovës. Këtë e bënte edhe për interesa të Malit të Zi, që synonte për ta ndarë Kosovën sikurse më 1913. (45. Dokumente gjinden në: AVIIB. Fondi LNÇ. K.1411). Krijimi i forcës ushtarake që do ta zbatojë pushtetin ushtarak në Kosovë dhe Dukagjin sipas kërkesës së imponuar urdhëroi: Nën komandën e drejtpërdrejtë të Shtabit Operativ për Kosovë dhe Dukagjin tash e tutje janë këto njësite: Divizioni i Kosovës (i përberë prej 9 brigadave ku 85% të ushtarëve ishin shqiptarë. Këta luftëtarë antifashist e faktorizuan Kosovën dhe popullin shqiptar, për ndryshe do të pësonim sikurse folksdojçerët në Vojvodinë dhe italianët në Istër.

Faktorizimin shqiptar në Jugosllavi e siguruan edhe dy divizionet e Shqipërisë - HB). Grupi operativ malazez i përberë nga dy brigade (Brigada e Bokelit e njohur për krime në Kosovë dhe...HB). Divizioni 46 i Serbisë, Shtabi Operativ i Kosovës dhe Dukagjinit do ta forcojë Grupin e Brigadave Malazeze prej të cilave do të formohet divizioni i veçantë. Në këtë mënyrë Shtabi Operativ i Kosovës dhe Dukagjinit do t'i ketë tri divizione të cilat numërojnë 30 000 luftëtarë. Pse ndodhi ky riorganizim në këtë kohë. Sipas dokumenteve sekrete të kohës rezultoi se Mali i Zi - Gjillasi dhe Serbia - Rankoviqi synonin ta ndajnë Kosovën sikurse e ndanë Sanxhakun, ose sikurse e kishin ndarë dikur më 1913. Pse shkuan në Beograd Milladin Popoviqi dhe Fadil Hoxha? (19 shkurt 1945). Pas vendosjes së diktaturës ushtarake në Kosovë, më 8 shkurt 1945, Milladin Popoviqi dhe Fadil Hoxha do të befasohen sepse në kohën kur u vendos diktatura nuk kishte asnjë rrezik për fatin e pushtetit të ri okupues jugosllav në Kosovë. Mbetet enigmatike çështja se si u trajtuan në Beograd Milladini dhe Fadili. Atyre rojet e derës ku ishte

Gjillasi dhe Rankoviqi do t'ua kërkojnë pasaportat e jo lejet identifikuese që i posedonin të dy udhëheqësit e lartë të Kosovës. Me të hyrë në zyrën e Millovan Gjillasit pas një përhëndetje të ftohtë Gjillasi do t'i drejtohet Milladinit në serbishte: “Eja Milladin ta ndajmë Kosovën sikurse Sanxhakun”. Milladini i befasuar pse nuk u pyet pse kanë ardhur në Beograd do të reagojë me një shpejtësi nervoze: “Jo, shoku Gjido, Kosova nuk është Sanxhak dhe nuk do të ndahet prej askujt. Kosova dhe Dukagjini janë një tërësi e moçme administrative dhe ne nuk njihemi atje si pushtet imperialist, por si çlirimtar”. Me këtë bisedë takimi do të merë fund. (46. Fadil Hoxha, Kujtime për shkuarjen në Beograd, më 19 shkurt 1945).

Si reagoi Enver Hoxha ndaj diktaturës ushtarke në Kosovë?

Tash e shtrojmë një pyetje, që nuk është ndier kurrë? A reagoi Enver Hoxha (Shqipëria) ndaj Diktaturës ushtrike të vëndosur në Kosovë nga: Tito-Rankoviq-Stojniq-Gjillas më 8 II 1945. Të dhënat arkivore që nuk janë botuar kurrë e që ruhen në Koleksionet e Sava Zllatiqit dhe Vlladimir Dedierit, gjindet ky shënim zyrtar i Enver Hoxhës më 9 II 1945: “Titos për njoftim. Ne jemi shumë të brengosur për militarizmin e Kosovës. Jemi në dijeni se vllazërit shqiptarë i janë përgjigjë masovikisht thirrjes për mobilizim, shumë më tepër se në viset tjera të vendit tuej. Muskujt nuk i tregohen popullit me ushtri, por i ndihmojnë me demokratizim të jetës, sepse shqiptarët mjaftë kanë vuajtë nga ish Mbretëria Jugosllave kolonizatore.. Divizionet tona që janë jashtë ish kufirit Shqipërisë, që luftojnë përkrah vllazërve të vet kundër nazifashizmit nuk mund të keqpërdorën për t'i zbatuar urdhërat diktatoriale”. Enver. (Tekstin nga shqipja në serbishte e kanë përkthyer Vehap Shita dhe M. Berisha më 1945). Lidhur me këtë jugosllavët do të inskenojnë “dezertime” në Brigadën e VI të Shqipërisë (420 luftarë të “dezertuar”!!!). Si duket, sipas dokumenteve sekrete jugosllave, komuinisto-çetnike, Enver Hoxha do të reagojë edhe te Misioni anglez në Tiranë. Ndërsa anglezët do t` i reagojnë Titos përmes

legatës tyre në Beograd. (47. A. CK. SKJ. Koleksioeti e Sava Zllatiqit dhe Vladimir Dedierit, “Arhivalie” - të ndryshme).

Si reaguan heshtazi anglezët?

Kundër diktaturës ushtrake reagon edhe Forein Ofissi britanik, përmes përfaqësuesit në Tiranë: “Jugosllavia Demokratike Federative, po i tregon muskujtë në Kosovë. Atje nuk është prek fare agjentura e Antikos dhe dr Qirillit (agjent italian që e drejtonin SIM-in-HB). Ajo agjunkturë shqiptare është katapultuar e tëra në OZN-a, përmes oficerëve të saj, për t`u shërbyer në punën e tyre ideologjike. Edhe agjentët shqiptarë që ishin eminecë e Gestaposë, nuk janë burgosë. Ata, OZN-a po i shfrytëzon për ta konstruktuar rrietin e ri të informatorëve nga shqiptarët që janë të gatshëm të shiten pas çdo steme dhe për pak para, por edhe për shkak se u është premtuar se nuk do të denohen”.

Për këtë reagim serioz dhe problematik, jugosllavët do të inskenojnë kinse në fshatrat e Llapit (në mes të Bradashit dhe Velika Rekës) kanë zbritë 13 diverzantë çetnikë nga ajri e që janë regrruar në Gjermani. Diverzantët ishin zënë “robë” dhe ishin intervistuar duke montuar se kemi “të bëjmë me çetnik të “ZBORIT” fashist serb. Por pas këtij “lëshimi nga ajri”, do të pasojë diverzioni tjetër në Kopaonik i përbërë prej 16 çetnikëve. Të dy palët ishin “deshmi” para anglo-amerikanëve se territori i Kosovës është i rrezikur nga çetnikët, të cilët “kanë miqësi afariste me shqiptarë, sidomos me grupet terroriste”. Prandaj, për ta evituar këtë rrezik në Kosovë është instaluar Diktatura ushtrake.

Me këtë katapultim të rrenave, jugosllavët do ta mbyllin çështjen e Diktaturës, e cila në vijim do të “maskohet” dhe më tutje e tërë pesha e krimeve do të ngushtohet për të oragnizuar një kuvend, ku do të mirret vendimi për “bashkim të Kosovës me Serbinë”. Këtë farsë së pari serbët do ta organizojnë në Beograd, duke e detyruar Mehmet Hoxhën që të deklarojë se: “Shqiptarët kanë dëshirë t`i bashkohen Serbisë Federale”. Pas këtij teatri kriminal, nuk ishte

vështirë të oragnizohet Procesi i Prizrenit më 10 VII 1945. (48. A. CK. SKJ. Koleksioni i Josip Gjergjës; Koleksioni i Velimir Stojniqit).

Hamit KABA

VËSHTRIM I BRITANIKËVE DHE AMERIKANËVE PËR RIPUSHTIMIN E KOSOVËS

E ardhmja e shqiptarëve në projektet e aleatëve perëndimorë gjatë Luftës së Dytë Botërore

Ripushtimi i territoreve shqiptare nga Jugosllavia e Titos në mbarim të Luftës së Dytë Botërore nuk kaloi pa u vënë re nga politikanët, diplomatët e ushtarakët aleatë perëndimorë anglezë e amerikanë, të cilët kishin misionë ushtarake e diplomatike në Shqipëri e në Jugosllavi. Tërheqja e gjermanëve krijoi mundësinë për futjen e ushtrisë jugosllave në territoret shqiptare në Kosovë e në Maqedoni, ndërsa rezistenca e popullsisë shqiptarëve ndaj saj ishte një fenomen i pritshëm. “Që shqiptarët e Kosovës, të mirëpresin përfshirjen në një shtet jugosllav pa rezistencë, shkruante nga Beogradi ambasadori britanik, Stivenson më 27 prill 1945, sidomos pas shumë vitesh keqtrajtimi në duart e qeverisë jugosllave e veçanërisht pas lojës së zgjuar të gjermanëve për qëllimet e tyre irredentiste, është si të presësh më shumë se ç’duhet”¹.

Bërthamës së vjetër të forcave të rezistencës iu shtuan edhe mijëra shqiptarë të tjerë, të cilët nuk kishin bashkëpunuar me

¹ *The National Archives (London)*, (më tej: TNA) FO 371/48090, Relacion i ambasadorit britanik në Beograd, zotit Stevenson për Sekretarin e Shtetit, zotin Eden, *Albanian population in Yugoslav-Macedonia*, Beograd, më 27 prill 1945.

gjermanët, por e kundërshtonin me forcë ribashkimin me Jugosllavinë. E pritshme ishte edhe sjellja e ashpër e ushtrisë jugosllave të Titos ndaj popullsisë shqiptare, jo vetëm për shkak të marrëdhënieve të këqija të së shkuarës dhe ndarjes së saj pas shpërbërjes së Jugosllavisë, por sidomos për konceptin e forcave të reja “çlirimtare”, të cilat i cilësonin shqiptarët si “bashkëpunëtorë të nazifashistëve dhe të dyshuar si armiq të rendit të ri socialist”².

Pavarësisht nga përpjekjet e fuqive aleate për të tërhequr popullsinë shqiptare të Jugosllavisë së shpërbërë, mosbesimi i saj për një të ardhme me Shqipërinë pas mbarimit të luftës ishte i madh. Karta e Atlantikut nuk i njohu ndryshimet territoriale të bëra me forcë nga Fuqitë e Boshtit, e rrjedhimisht as bashkimin e pjesës më të madhe të territoreve shqiptare në një shtet të vetëm. Parimi i vetëvendosjes i shpallur në gusht 1941 nga Çurçilli e Rusvelti nuk zuri vend sa duhet tek shqiptarët e këtyre viseve, të cilët e shihnin me dyshim zbatimin e këtij parimi pas mbarimit të luftës, duke pasur në kujtesë historinë e shkuar dhe interesat e të Mëdhenjve në Ballkan. Shqiptarët dhe Shqipëria ishin në periferi të interesave të Aleatëve të Mëdhenj, krahasuar me fqinjët grek e jugosllavë.

Bashkimi në një shtet në vitet 1941-1944 u mirëprit nga shumica e shqiptarëve, pavarësisht se ai u realizua nga Italia fashiste dhe Gjermania naziste. Në mënyrë të veçantë ai gjeti mbështetjen e popullsisë shqiptare në Kosovë e në Maqedoni, të ndarë nga trangu amtar që në vitin 1913. Sidoqoftë, ajo ishte një zgjidhje afatshkurtër, sepse fuqitë e Boshtit po e kumbisnin luftën.

Do të ishin fuqitë fituese aleate ato që do të vendosnin mbi të ardhmen dhe fatin e territoreve shqiptare në Kosovë e në Maqedoninë Perëndimore, nëse ato do t'i mbeteshin Shqipërisë, apo do t'i riktheheshin Jugosllavisë. “Nuk ka dyshim se nëse zbatohej Karta e Atlantikut, shkruan një ushtarak britanik, njerëzit e zonave të aneksuara më shumë do të qëndronin me Shqipërinë, se sa do t'i ktheheshin Jugosllavisë... Të njohurit e këtij fakti nga shqiptarët e

Paul Mojzes, *Balkan Genocides, Holocaust and Ethnic Cleansing in the Twentieth Century*, Mayrlend: Rowman & Littlefield Publishers, 2011, f. 96.

shoqëruar me qetësinë tonë, vazhdohej më tej, kishte qenë një ferrë për propagandën aleate dhe një turp i përhershëm për singëritetin e tyre”³.

Mungesa e një prononcimi të hapur apo të nënkuptuar të Aleatëve të Mëdhenj, për të ardhmen e territoreve shqiptare kishte shkaktuar shqetësim dhe pasiguri në popullsinë shqiptare, veçanërisht tek shqiptarët e Kosovës e viseve të tjera. Ideja e Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Shqipëri dhe në Kosovë, për zgjidhjen e problemit sipas formulës së Kartës së Atlantikut, (përmes mbajtjes pas lufte të një plebishiti), ishte pozitive, por as Fuqitë e Mëdha aleate dhe as Partia Komuniste e Jugosllavisë nuk u prononcuan qartësisht për të ardhmen e Kosovës me Shqipërinë, pas mbarimit të luftës. Disa referenca nga dokumentet britanike⁴, të cilat përmendin një komunikatë të Titos të datës 4 dhjetor 1942, në të cilën thuhet se “e ardhmja e Kosovës do të vendoset nga një plebishit, dhe nëse është e nevojshme kufiri do të rregullohet në favor të Shqipërisë”, janë vënë në dyshim nga studiuesja Ana Lalaj e cila i referohet një përgjigjes mohuese të bërë nga Titoja në një periudhë të mëvonshme⁵.

Faktori shqiptar ishte i përçarë. Qeveria e Tiranës e konsideronte të mirëqenë bashkimin ekzistues të shqiptarëve në një shtet me qendër Tiranën. Nacionalistët aktivë kërkonin nga fuqitë aleate prononcim të qartë për të ardhmen e territoreve shqiptare, ndërsa lëvizjet e majta të rezistencës në Shqipëri e në Kosovë i përmbaheshin zgjidhjes, që do të vinte nga mbajtja e një plebishiti pas mbarimit të luftës. Aleatët kërkonin angazhim më të madh të shqiptarëve në luftë, por nuk jepnin sinjale për zgjidhjen e problemit shqiptar. Indiferenca ndaj të ardhmes kombëtare të shqiptarëve e shtoi më tej dozën e dyshimit tradicional të popullsisë së saj, ndaj qëllimeve të Evropës dhe politikës së saj në favor të fqinjëve. Kjo

³ TNA, WO 204/9558 (War Office), *Shqipëria 1944*, Studim i H. Hodgkinson, Office of NLO, BAF, korrik 1944.

⁴ TNA, HS 7/70, “Marrëdhëniet me vendet fqinje. Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave”, studim i vitit 1946

⁵ Ana Lalaj, *Dosjet e Luftës*, Tiranë: Botimet Toena, 2014, f. 158-159.

politikë e fuqive aleate, por edhe filozofia e pritjes, mospërzierjes dhe e mosangazhimit të një pjese të popullsisë shqiptare në “punët e Evropës” e shtoi pasivitetin dhe mosbesimin e saj për kauzën aleate. Një pjesë e forcave politike e ushtarake në Shqipëri e në Kosovë nuk arritën që ta “lexonin” si duhet politikën e Aleatëve të Mëdhenj, e cila kërkonte angazhimin e shqiptarëve në luftë, ndërsa këta të fundit nuk ditën të përfitonin sa duhet nga energjitë e shqiptarëve dhe cilësitë e tyre të njohura luftarake.

Ndër dy Fuqitë e Mëdha aleate perëndimore, Britania e Madhe ishte shteti më i interesuar dhe më i angazhuar në Ballkan e në Shqipëri. Në arkivat britanike e amerikane gjenden jo pak dokumente për planet e shteteve të tyre për të ardhmen e shqiptarëve në rajonin tonë. Institucione të specializuara pranë Ministrisë së Jashtme Britanike (Foreign Office) dhe Departamentit të Shtetit (Department of State) ende pa mbaruar lufta hartuan studime të posaçme për të ardhmen e Shqipërisë e të shqiptarëve në Ballkan dhe për kufijtë e tyre. Por, tek ato mbizotëron ideja e ruajtjes së kufijve të vitit 1913, ndërsa alternativa e bashkimit të territoreve shqiptare mbeti një opsion fare i dobët⁶.

Deklarata britanike e dhjetorit të vitit 1942, njohu të drejtën e ekzistencës së një shteti të pavarur shqiptar pas mbarimit të luftës, por ajo e la të hapur problemin e cedimit të kufijve jugorë të Shqipërisë në favor të Greqisë. Britanikët në mbarim të luftës e kishin braktisur fare idenë e bashkimit të territoreve shqiptare në një shtet të vetëm, duke ia lënë zgjidhjen e saj “vullnetit të mirë” të komunistëve të Titos, të cilët po vinin në pushtet. Edhe deklarata amerikane e vitit 1942, për ringritjen e shtetit të pavarur shqiptar, ndonëse ishte më pozitive se ajo e Britanisë së Madhe, nuk nënkuptonte ndonjë zgjidhje pozitive në favor të shqiptarëve. SHBA-të, nuk e përmendën në deklaratën e tyre çështjen e pretendimeve greke për Shqipërinë e Jugut, por as e mohuan “të drejtën” e Greqisë, për t’i paraqitur pretendimet e saj në Konferencën e ardhshme të

⁶ Hamit Kaba, *Shqipëria dhe të Mëdhenjtë, nga Lufta e Dytë Botërore në Luftën e Ftohtë*, Tiranë: Botimet KLEAN, 2015, f. 55.

Paqes, që do të thirrej pas mbarimit të luftës. Megjithëkëtë, SHBA-të ishin shprehur disa herë jozyrtarisht për ruajtjen e kufijve shqiptarë të vitit 1913.

Problemi i të ardhmes së shtetit shqiptar dhe territoreve që i ishin bashkuar atij në vitin 1941, u bë objekt diskutimi në rrethet e larta ushtarake e politike britanike në pranverë e në verën e vitit 1943, kur britanikët hartuan plane për zbarkimin e trupave të tyre ushtarake në Ballkan⁷. Në Ministrinë e Luftës ekzistonin mendime të ndryshme për mënyrën e zbarkimit në Shqipëri dhe për statusin e territoreve të Kosovës e Maqedonisë Perëndimore dhe për administratën që do të ngrinin në këtë rast. Për qeverinë angleze kishte dy probleme që duheshin zgjidhur para zbarkimit në territorin shqiptar. I pari kishte të bënte me opsionin se si do ta konsideronin Shqipërinë një territor mik apo armik, dhe së dyti, a do vazhdonin që ta ruanin shtetin shqiptar ashtu siç ishte, apo do t'i bashkonin sërish me Jugosllavinë territoret shqiptare të shkëputura prej saj në vitin 1941. Për zgjidhjen e këtyre problemeve ekzistonin opsione të ndryshme.

Në Ministrinë e Luftës (War Office) gjykonin se Shqipëria duhej të trajtohej si “një territor armik”, koncept ky që do të kushtëzonte edhe sjelljen e trupave ushtarake britanike në vend, si dhe qëndrimin ndaj administratës ekzistuese. Por, në Ministrinë e Jashtme (Foreign Office) gjykonin ndryshe. Sekretari Eden, në kundërshtim me opsionin e shfaqur nga Ministria e Luftës, në shtator të 1943 do të deklaronte, se në rast zbarkimi Shqipëria do të konsiderohej si “vend mik”⁸ dhe jo një territor armik. Në këtë rast administrata do të kontrollohej prej tyre, ndërsa në përbërjen e saj nuk do të lejoheshin shtetas të huaj italianë, grekë dhe jugosllavë, por vetëm shqiptarë. Ky përcaktim e radhiste Shqipërinë ndër vendet

⁷ Planet britanike për zbarkim në Ballkan nuk u mbështetën nga SHBA dhe si rrjedhojë ato nuk u zbatuan. Sidoqoftë në arkivat britanike ka jo pak dokumente për zbarkimin e tyre, duke përfshirë edhe Shqipërinë, statusin e saj, qëndrimin ndaj administratës ekzistuese, planet e ndihmave për shqiptarët etj.

⁸ TNA, FO 204/9540, “Administrimi i territoreve në Ballkan”. Trajtimi i Shqipërisë, shumë sekret, 28 qershor 1943, f. 10.

aleate, pavarësisht se vendit tonë nuk iu njoh zyrtarisht ky status gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Politika britanike, nuk ishte e qartë në qëndrimet e veta në rast zbarkimi në Ballkan, nëse do ta ruante shtetin shqiptar ashtu siç ishte, apo do ta rikthente atë në kufijtë e vitit 1913. Ekzistonte një prirje e fortë që territoret shqiptare që i ishin bashkëngjitur shtetit shqiptar t'i riktheheshin Jugosllavisë që gjatë luftës, duke iu bashkëngjitur zonës jugosllave të kontrolluar nga britanikët. Por, ekzistonte edhe alternativa tjetër, që territoret e bashkuara shqiptare do të vazhdonin të mbeteshin nën administrimin ushtarak të tyre, deri në një zgjidhje përfundimtare që do të merrej në Konferencën e ardhshme të Paqes. Pavendosmëria e tyre u reflektua edhe në planet e ndihmave ushtarake, që do t'i jepnin Shqipërisë, të cilët ndryshonin nga koha në kohë për sa i përket sasisë dhe kohës. Me planet e ndihmave u ngarkua Military Liaison / Ndërlidhja Ushtarake⁹. Në planet e para të kësaj organizate për Shqipërinë përfshihej edhe Kosova, por më pas ajo u nda prej saj.

Në dokumentacionin britanik e amerikan ka jo pak studime për kufijtë e ardhshëm të Shqipërisë. Sipas tyre, nëse zbatohej Karta e Atlantikut, brenda kufijve të saj do të përfshiheshin edhe territoret shqiptare të shkëputura padrejtësisht prej saj në vitin 1913. Argumentet e karakterit historik, etnik, ekonomik e gjeografik ishin në favor të një zgjidhjeje të tillë. Disa studime të pakta e mbështetnin këtë opsion. Në rast se Kosova do të mbetej me Shqipërinë, kolonëve serbë të zhvendosur gjatë luftës do t'u ndalohej rikthimi dhe po kështu dëmshpërblimi për tokat dhe pasuritë e lëna prej tyre në Kosovë.

Britanikët dhe amerikanët e parashikonin situatën e rëndë që do të krijohet për popullsinë shqiptare, kur trupat jugosllave do të futeshin në territoret shqiptare dhe hakmarrjen e tyre ndaj saj. Për të shmangur apo zbutur pasojat e saj, britanikët propozuan që në

⁹ Military Liaison u krijua në vitin 1943 nga aleatët anglo-amerikanë dhe u ngarkua të ndihmonte Shqipërinë, Greqinë dhe Jugosllavinë para fillimit të operacioneve të UNRRR-së.

Kosovë të dërgoheshin rreth 5 000 trupa amerikanë, që do të shërbenin si amortizatorë për zbutjen e situatës, por pa dobi, sepse ky version nuk u realizua ndonjëherë. Qeveria britanike e quajti budallallëk ndërhyrjen e saj në situatën e koklavitur që u krijua në Kosovë pas futjes së trupave jugosllave, por qëndroi në pritje të vendimit që do të merrej në Konferencën e ardhshme të Paqes. Trupat jugosllave u futën në Kosovë vetëm një ditë pasi Konferenca e Jaltës vendosi që të restauronte Jugosllavinë e para luftës. Më 8 shkurt 1945, në Kosovë u vendos regjimi i gjendjes së jashtëzakonshme. Duke adoptuar politikën e mosndërhjryes aleatët perëndimorë në fakt i hapën rrugën ripushtimit të Kosovës, popullsia e së cilës u bë preh e kasaphanës dhe hakmarrjes së forcave jugosllave të Titos.

Ripushtimi i territoreve shqiptare dhe rezistenca e tyre

Dokumentet britanike e amerikane për ripushtimin e Kosovës janë pak të njohura. Më të rëndësishmin (që ne njohim) do të konsideronim një raport të ambasadorit britanik në Beograd, Ralph Skrine Stevenson (Ralf Skrin Stivenson), që i drejtohet sekretarit të Shtetit, Eden (Iden) më 27 prill 1945¹⁰. Ai i kushtohet situatës së krijuar në territoret shqiptare gjatë futjes së trupave jugosllavë dhe rezistencës serioze të popullsisë shqiptare në Kosovë e Metohi, dhe në pjesën veriperëndimore të Maqedonisë. Stivenson ka shfrytëzuar kryesisht burime britanike, amerikane e jugosllave.

Vështrimi i tij për shqiptarët e këtyre trevave nuk del jashtë kuadrit të politikës britanike. Por, duke qenë relativisht më afër ngjarjeve, ai përpiket të japë shpjegime për arsyet, se pse shqiptarët nuk u përfshinë masivisht në lëvizjen çlirimtare, dhe pse ata e kundërshtuan me forcë ribashkimin me Jugosllavinë. Autori jep të dhëna dhe gjykime për politikën e Titos ndaj shqiptarëve në mbarim të luftës; për shkallën e pjesëmarrjes së tyre në luftë përkrah aleatëve; për politikën e aleatëve perëndimorë dhe rezervat e shqiptareve ndaj

¹⁰ TNA, HS 7/70, dok. i cituar.

saj. Në mënyrë të veçantë ai trajton rezistencën e popullsisë vendase ndaj pushtimit të Kosovës, term që ambasadori britanik e përdor pa ekuivoqe.

Stivenson gjykon se shqiptarët e këtyre viseve, në përgjithësi, kanë qenë armiqësorë me ushtrinë jugosllave dhe se lëvizja partizane nuk ka gjetur simpati dhe mirëkuptim. Arsyet e këtij fenomeni ai i shpjegon me shtypjen e gjatë të popullsisë shqiptare nga Jugosllavia monarkiste, nga politika e ndjekur nga pushtuesit italianë e sidomos gjermanë, tek mosbesimi ndaj alternativës aleate dhe tek akti i fundit: bashkimi me forcë i territoreve shqiptare me Jugosllavinë. Shqiptarët e këtyre zonave, sipas ambasadorit britanik, u munduan më shumë të mbronin atë që kishin arritur në periudhën e pushtimit italian e gjerman, se sa të luftonin kundër tyre. Përpyekjet e Ushtrisë Çlirimtare Jugosllave për të hyrë në Kosovë para tërheqjes së gjermanëve kishin qenë të pasuksesshme, sepse sipas tij, rezistenca e rojeve kufitare kosovare, kishte qenë fanatike. Më 2 maj (1944) shqiptarët i kishin kthyer mbrapsht trupat jugosllave, që u përpoqën të qojnë nga Mali i Zi, ndërsa në korrik ata u rezistuan forcave serbe të gjeneral-leitnant Popoviç, të cilat u përpoqën të avanconin nga veriu i Gjilanit.

Sidoqoftë, ambasadori britanik nuk e mohon pjesëmarrjen e shqiptarëve në luftë përkrah aleatëve. Ai përmend një numër njësisish e brigadash me shqiptarë, të krijuara herët, të cilat luftuan më shumë jashtë Kosovës se sa brenda saj. Rezistencën e forcave antifashiste në Kosovë, Stivenson e sheh të lidhur ngushtë me atë të Frontit Nacionalçlirimtar në Shqipëri, i cili shërbeu sipas tij, si katalizator, pavarësisht se Enver Hoxha, përmend ai, e kishte njohur Kosmetin si pjesë të sferës së influencës së Titos.

Stivenson, duke iu referuar një raporti amerikan sjell të dhëna për luftën e Drenicës, të udhëhequr nga Shaban Polluzha. “Ne shkurt, shkruan ai, në Kosovë pati një revoltë të organizuar nga Balli Kombëtar, në të cilën u përshinë rreth 7 000 burra, e cila u shtyp nga 6 divizione të Ushtrisë Kombëtare çlirimtare Jugosllave”. Duket se autori nuk u ka shpëtuar influencave dhe raportimeve të ushtrisë jugosllave, të cilat e ndryshonin me qëllim thelbin e kryengritjes së

Drenicës dhe figurën e saj kryesore atë të Shaban Polluzhës. Në këtë vazhdë, historiografia e mëpasme jugosllave do ta shtrembëronte me tej qëllimin dhe karakterin çlirimtar të kësaj kryengritjeje, e cila pati si mision që të luftonte e rezistonte e të mos lejonte ribashkimin e tokave shqiptare me Jugosllavinë. Por, në Jugosllavinë e Titos, sikurse edhe në Shqipërinë e Enver Hoxhës u përzjenë qëllimisht kolaboracionistët me kundërshtarët politikë të regjimit komunist, me qëllim që t'i eliminonin ata më lehtë.

Autori, përmend disa prej lëvizjeve të rezistencës në Kosovë dhe sjell një pamje më të qartë e të plotë të qëndresës së shqiptarëve në Maqedoninë Perëndimore. Stivenson përmend mijëra të vrarë, të burgosur e të keqtrajtuar në këtë krahinë shqiptare. Ai shkruan për luftimet e zhvilluara më 28 shkurt 1945 afër Kërçovës, si rezultat i së cilës u vranë edhe 50 forca greke të EAM-it, që kishin kërkuar strehim në zonën Gostivar-Kërçovë, nga një bandë irredentistësh shqiptarë të Ballit Kombëtar. Por, vazhdon Stivenson, si rezultat i kundërmasave të ushtrisë maqedone u kapën dhe u sollën në Shkup 200 shqiptarë të burgosur nga Gostivari. Ai nënvizon edhe masat e ashpra, të ndërmarra nga Komanda e Lartë Jugosllave për mobilizimin e detyruar të shqiptarëve. Në zonën Strugë-Gostivar, sipas tij u mobilizuan të gjithë burrat e moshës 17-45 vjeç, ndërsa në një fshat shqiptar të zonës së Raduzës me 125 shtëpi, i shpëtuan mobilizimit të detyruar vetëm 8 burra.

Stivenson i raporton Londrës edhe për dezertimet e shqiptarëve të mobilizuar me forcë nga ushtria jugosllave dhe për bashkimin e një pjese të tyre me bandat e drejtuara nga Xhem Gostivari e Mifail Zajazi. Sipas tij, bandat e shqiptarëve në zonën Tetovë-Gostivar bastisën tre fshatra përreth Gostivarit dhe vranë të gjithë partizanët e Komiteteve Nacionalçlirimtare, ndërsa njësitë maqedone iu kundërpërgjigjën duke djegur fshatra dhe duke burgosur mijëra shqiptarë në burgjet e Shkupit.

Luftimet e shqiptarëve me forcat maqedone vazhduan sipas raportit edhe në muajt mars e prill të vitit 1945. Pas kërkesës së qeverisë federale maqedonase në Shkup erdhën dy brigada të OZNA-së. Më 16 prill 1945, raportohet se, kryengritja e shqiptarëve në

zonën e maleve të Sharrit, Shkupit, maleve të Karabizicës, në Brod, Kerçovë, duke përfshirë edhe Tetovën, Gostivarin e Dibrën kishte marrë përmasa alarmante. Për shtypjen e saj u përdorën forcat e Brigadës së Parë të kalorësisë së Shkupit, brigadat e 8,9,16 dhe trupa të tjera të paidentifikuara nga Manastiri. Por, në luftime u përfshinë edhe njësi të ELAS-it (Ushtria Nacionalçlirimtare Greke), në zonën e Gostivarit. Në Tetovë, sipas raportit u burgosën 7 000 shqiptarë, ndërsa një numër tjetër i madh nga Shkupi u ishin qepur pyjeve. Rreth 1 200 shqiptarë nga Kumanova, Gjilani e Vranja u çuan me forcë në Banat.

Raporte amerikane bënë fjalë për qindra shqiptarë të mobilizuar me forcë nga Kosova që shkonin në drejtim të Splitit. Mobilizimi kishte si qëllim, si thekson ambasadori britanik, që të spastroheshin zonat kryengritëse, pas trazirave që kishin ndodhur në zonën e Prishtinës. Në raportin e Stivenson gjenden të dhëna edhe për bashkëpunimin e çetnikëve serbë me nacionalistët shqiptarë në Skopska Cerna Gora dhe në zonën e Preshevës. Stivenson bën me faj qeverinë federale maqedone për kundërveprimin e çetnikëve serbë në zonën e Maqedonisë, sepse ajo “ka shkaktuar ndjesi të keqe tek popullsia serbe në Maqedoni”.

Autori është në dijeni të faktit, se politika e egër që po ndiqej ndaj popullsisë shqiptare në Jugosllavi ishte e iniciuar nga Titoja. Ai përmend një seancë të Parlamentit serb ¹¹, të organizuar nga Marshalli Tito, ku morën pjesë edhe 25 delegatë nga Kosova e Metohia. Delegatët e fundit ishin të kryesuar nga Mehmet Hoxha, i cili kryente funksionin e Kryetarit të Këshillit Kombëtar Çlirimtar të Kosovës. Tito, sipas Stivenson, ishte sjellë ashpër në këtë takim me shqiptarët e Kosovës, por edhe me ata të Shqipërisë, duke i quajtur “reaksonarë” e “obskurantistë”, ndërsa shumicën e pronarëve shqiptarë të tokave, si “bashkëpunëtorë të armikut”. Për t’u hequr

¹¹ Duket se këtu flitet për Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Kuvendit Antifashist Nacionalçlirimtar të Serbisë, që u mbajt në Beograd më 7-9 prill 1945. Në këtë mbledhje përveç delegatëve nga Serbia, merrnin pjesë edhe 22 përfaqësues nga Vojvodina dhe 2 nga Kosova: Mehmet Hoxha si kryetar i Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar të Kosovës dhe sekretari i këtij Këshilli, Dushan Mugosha.

“njollën” dhe reputacionin e keq, Titoja u kërkoi organeve kompetente, që shqiptarët të rekrutoheshin e të mobilizoheshin me forcë në ushtrinë jugosllave dhe ndaj tyre të përdroreshin metoda të forta për t’u ndryshuar qëndrimin.

Në prill 1945, duket se rezistenca e armatosur e shqiptarëve kishte rënë. Vendosija e Administratës Ushtarake në Kosovë; mobilizimi dhe largimi masiv i luftëtarëve shqiptarë jashtë territoreve të tyre; vrasjet dhe arrestimet, duke përfshirë edhe Gani Kryeziun, kishin dhënë efektet e veta negative. Rezistenca kishte rënë edhe në Maqedoninë Veriperëndimore, por ajo nuk ishte shuar. Sipas raportit të Stivenson, bandat çetnike serbe kishin bashkëpunuar me rebelët kosovarë në afërsi të kufirit me Shqipërinë, por bastioni kryesor i tyre vazhdonte të mbetej Skopsa Crna Gora. Në zonën e Kopaonikut, thuhej se ishin hedhur parashutistë gjermanë, të cilët ishin kapur nga trupat jugosllave. Por, Stivenson nuk besonte se rezistenca e shqiptarëve do të shuhej. Ai vinte në dukje se, shpallja e bashkimit të ardhshëm të Kosovës me Serbinë, si njësi federale e saj mund ta ringjallte sërish rezistencën e shqiptarëve.

Proletar HASANI

**NDIHMESSA DHE NDIKIMI I BRIGADAVE TË USHTRISË
NACIONALÇLIRIMTARE NGA SHQIPËRIA NË ÇLIRIMIN
E KOSOVËS, NË PËRFUNDIM TË LUFTËS SË DYTË
BOTËRORE**

Në muajt shtator-tetor të vitit 1944 Lufta e Dytë Botërore kishte arritur kulmin e saj. Forcat pushtuese gjermane dhe bashkëpunëtorët e tyre në gjithë frontet evropiane të Luftës së Dytë Botërore, të gjendura nën trysinë dhe goditjet e forcave aleate të Koalicionit Antifashist ndërkombëtar, po tërhiqeshin pa kthim. Në verë-vjeshtë të këtij viti ishin goditjet e fuqishme dhe fitoret e vazhdueshme të shpejta të ushtrisë sovjetike, që i detyruan forcat e ushtrisë gjermane naziste të tërhiqeshin me humbje të mëdha. Ndërkohë, ushtritë aleate anglo-amerikane, përmes bombardimeve masive, i shkaktuan ushtrisë gjermane në të gjithë frontet e Perëndimit humbje të rënda njerëzore dhe dëme të mëdha në armatime, pajisje dhe material e teknike luftarake. Pas kësaj, aleatët mësynë mbi Francë me gjithë fuqitë, duke çelur kështu, atë që në historinë e Luftës së Dytë Botërore njihet si Fronti i Dytë. Hapja e këtij fronti përshpejtoi dukshëm veprimet luftarake për çlirimin e gjithë Evropës nga pushtimi i egër nazist gjerman. Në këtë rrjedhë,

në fundin e vjeshtës së vitit 1944, ushtritë e aleatëve gjendeshin mu në portat e vetë Gjermanisë¹.

Rrjedhat e luftës në Evropë morën kahje tejet të shpejtë edhe në rajonin e Ballkanit. Tanimë forcat ushtarake naziste gjermane në Bullgari, Greqi, Jugosllavi dhe Shqipëri ishin pothuajse të rrethuara dhe bllokuara nga njësitet të mëdha të ushtrisë sovjetike, si dhe nga forcat luftarake të ushtrive antifashiste nacionalçlirimtare të vendeve ballkanike. Këto të fundit, përfshi dhe ato të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare (UNÇSH), vijonin të goditnin paprerë forcat e ushtrisë gjermane, të cilat e shihnin dhe e ndjenin fare pranë fundin e tyre.

Në Shqipëri, në muajt shtator-tetor 1944, Lufta Antifashiste Çlirimtare Shqiptare kishte hyrë tashmë në fazën e saj përfundimtare. Ndërkohë, Kosova dhe krahinat përreth saj, kishin marrë një rëndësi të veçantë në pikëpamje ushtarake, sidomos për forcat e ushtrisë pushtuese gjermane. Kjo ndodhte për arsyen e thjeshtë se sukseset e forcave antifashiste nacionalçlirimtare të rajonit të Ballkanit dhe ato të ushtrisë sovjetike, nga pjesa veriore e Ballkanit, kërcënonin seriozisht vënien në rrethim dhe asgjësim të plotë të afro 300 mijë trupave gjermane, të cilat gjendeshin në unazën e rrethimit. Shtegu i vetëm për tërheqjen e tyre nga Greqia dhe Shqipëria mbetej, padyshim, drejtimi operativo-strategjik Kosovë-Sanxhak-Bosnje e Hercegovinë.

Për këtë arsye këtë vijë strategjike forcat gjermane duhej mbajtur të hapur me çdo kusht dhe çmim, prandaj Kosova kishte marrë një rëndësi të veçantë. Nëpërmjet saj Serbia lidhej me Maqedoninë, Malin e Zi, përgjatë rrugës Mitrovicë-Pejë-Podgoricë. Ndër to, nyja më e rëndësishme ishte padyshim Mitrovica, prej nga shpërndahen rrugët automobilistike për në Veri, gjatë rrjedhës së lumit Ibër nëpër Serbi; drejt Sanxhakut për në Bosnje e Mal të Zi; drejt Perëndimit dhe Jugperëndimit për në Mal të Zi dhe Shqipëri

¹ *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar*, Vëll. IV. Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1988, f. 874.

dhe, drejt Jugut, nëpër Fushën e Kosovë, duke dalë në Maqedoni dhe Shqipëri.

Është kjo arsyeja pse komanda gjermane e forcave në Ballkan mori masa të veçanta dhe shtesë për të mbajtur nën kontroll dhe të lira rrugët më të mundshme për tërheqjen e forcave të veta. Të tilla ishin rrugëkalimet Shkodër-Mali i Zi-Vishegrad dhe tjetri Kosovë-Sanxhak-Vishegrad, të cilat kjo komandë duhej t'i ruante me fanatizëm për të siguruar daljen nga kurthi i madh i rrethimit antifashist. Për këto arsye komanda e forcave gjermane shfrytëzoi në të gjitha pikëpamjet cilësitë mbrojtëse natyrore të terrenit përgjatë gjithë rrugëve të lëvizjes, të gërshetuara këto me punimet fortifikuese dhe me përdorimin e forcave naziste dhe të reaksionarëve vendas. Vetëm në Kosovë gjatë kësaj periudhe u krye përqendrimi i forcave kryesore të Gruparmatës gjermane "E". Në këtë mënyrë armiku e kishte kryer përqendrimin e forcave të veta kryesisht në qendrat më të rëndësishme, si: Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Junik etj.

Por, ndërkohë, çfarë po ndodhte tjetër në pjesën tjetër të territorit shqiptar, në Kosovë, të ndarë padrejtësisht nga trugu mëmë i Shqipërisë që në vitin 1913, duke mbetur kësisoj brenda territorit të shtetit të ish-Jugosllavisë të asaj kohe?!

Më 31 dhjetor të vitit 1943 deri më 2 janar të vitit 1944, kishte mbajtur punimet Konferenca e Bujanit, e cila kishte ndërmarrë disa vendime në interes të fatit dhe të ardhmes së shqiptarëve të Kosovës. Këto vendime kishin të bënin me orientimin, organizimin dhe drejtimin e Luftës Antifashiste në Kosovë, duke i vulosur ato me një Rezolutë. Këto vendime u pritën me entuziazëm dhe shpresë nga populli i Kosovës.² Njëkohësisht që ato patën jehonë dhe ndikime të dukshme në organizimin e njëjësive luftarake antifashiste në luftën e

2 *Fjalori Enciklopedik Shqiptar (FESH)*, Vëll. 1. "Kristalina K-H", Tiranë, 2008, f. 300.

3 *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. IV. Botimet TOENA, Tiranë, 2008, f. 144.

4 *Po aty*, f. 144-145.

5 *Po aty*, f. 145; Shih edhe *Historia e Luftës Antifashiste NÇ e popullit shqiptar*, Vëll. IV, f. 874.

armatosur kundër pushtuesit të huaj.³ Kjo jehonë arriti deri në Shqipëri, ku u përshëndet nga Lëvizja Antifashiste Çlirimtare Shqiptare, që e propagandoi dhe e mbështeti atë. Por, udhëheqja jugosllave reagoi krejt ndryshe. Ata i vlerësuan të gabuara vendimet e Bujanit, prandaj nisën sulmet ndaj Konferencës së Bujanit, vendimeve të saj dhe organizmave drejtuese të Luftës Çlirimtare të Kosovës, duke mos i njohur ato.⁴

Ky qëndrim kokëfortë dhe i njëanshëm i udhëheqjes së Luftës Antifashiste jugosllave dhe, sidomos vendimet e tyre ndaj Konferencës dhe instrumenteve organizatore dhe drejtuese të Luftës Antifashiste dhe të Pushtetit Krahinor për Kosovën, zgjoi dhe shtoi natyrshëm zhgënjimin dhe zemërimin e shqiptarëve të Kosovës. Njëkohësisht, kjo situatë krijoi rrezikun që të shkonte në dobi dhe interes të pushtuesve të huaj dhe reaksionit ekstremist sllav. Për këtë arsye udhëheqja jugosllave dhe ajo kosovare, duke nuhatur rrezikun e këtij reagimi dhe zemërimi që mund të ngrihej në krahinën shqiptare, gjykuan t'i drejtoheshin për ndihmë udhëheqjes së Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare Shqiptare në Shqipëri (LANÇSH). Kjo ndihmë nënkuptonte dërgimin e njësisve të mëdha luftarake të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë në trevat e Kosovës, por dhe në trevat e tjera shqiptare në Jugosllavi.

Në pikëpamje historike, nëse i referohemi burimeve nga *Historia e Popullit Shqiptar* dhe asaj të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Shqipëri kjo kërkesë në të vërtetë i ka fillimet dy-tre muaj më parë, që në qershor të vitit 1944. Atëherë, nga ana e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave, si dhe nga Shtabi Kryesor i Ushtrisë Nacionalçlirimtare (UNÇ) të Kosovës, më datën 26 qershor 1944, ishte bërë një kërkesë drejtuar Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë⁵. Në të, midis të tjerave, shkruhej se: “*ardhja e*

brigadave shqiptare në këtë trevë kishte me i shkatërrue planet e okupatorit dhe të reaksionarëve, duke e kthyer këtë trevë nga baza e reaksionit në bazë liridashëse".⁶ Ndërsa, pak më poshtë, duke dashur ta bënte sa më të qartë përfitimin nga ardhja e brigadave nga Shqipëria amë, në ata kërkesë vijonte të shkruhej se: "...shkaktarët që Kosova është bërë bazë e reaksionit janë hegjemonët serbë", duke e përmbyllur me fjalët, "...shumica e popullit të Kosovës nuk kishte besim tek PKJ dhe tek shtabi jugosllav".⁷

Lidhur me këtë argument nismëtar dhe bazal historiani gjermano-amerikan Bernd J. Fischer, njohës dhe lëvruer i njohur i historisë së Shqipërisë, sjell një trajtim paksa ndryshe nga ajo e historiografisë shqiptare. Fischeri e sheh me dyshim kërkesën e udhëheqësit të Lëvizjes Antifashiste të Jugosllavisë, Josip Broz Tito, drejtuar udhëheqjes dhe Komandës së Përgjithshme të UNÇ-së të Shqipërisë për dërgimin e brigadave shqiptare për spastrimin e Kosovës, mbetet ende e diskutueshme.⁸

Këtë argument autori përpiqet ta bazojë në faktin se lëvizja e tij (e Titos), "... ishte shumë më e fuqishme se LNÇ", prandaj është e diskutueshme kjo kërkesë, e cila arsyeton më tej autori, "është vështirë të mos arrihet në përfundimin se arsyet e tij ishin cinike".⁹ Megjithatë, më poshtë, B. Fisheri pohon po atë argumentim që njohim prej kohësh nga historiografia shqiptare se, "Titua ishte i vetëdijshëm rreth mungesës së popullaritetit të partizanëve të tij në Kosovë dhe, me të drejtë ndiqte mendimin se partizanët shqiptarë do të ndeshnin aty me një kundërshtim më të vogël nga popullsia vendase".¹⁰ Ky argumentim është pothuajse i përafërt me atë të dhënë nga historianët shqiptarë të periudhës socialiste, lidhur me nevojën e dërgimit të brigadave sulmuese të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare (UNÇSH) për të ndihmuar në çlirimin e Kosovës.

⁶ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. IV, ..., f. 144.

⁷ *Po aty*, f. 144-145.

⁸ Bernd J. Fischer, *Shqipëria në Luftë 1939-1945*, Çabëj, Tiranë, 2000, f. 311.

⁹ *Po aty*.

¹⁰ *Po aty*.

Kërkesa e muajit qershor u përsërit edhe në muajt pasues, korrik dhe gusht 1944. Përtej kësaj kërkesë synimi ishte i qartë si drita e dielli se vetëm njësitë e UNÇSH-së, e vëllezërve nga Shqipëria, mund të hynin dhe të vepronin në Kosovë, sepse kosovarët, për asnjë arsye, nuk mund të kundërvepronin ndaj luftëtarëve vëllezër nga Shqipëria.

Në këtë rrjedhë, më 1 shtator 1944, Shtabi Suprem i Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave (UNÇJ), i propozonte Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së që, “... të dërgojë një pjesë të forcave të veta në veri të Drinit për të bashkëpunuar me njësitë e UNÇJ-së dhe...për çlirimin e Kosovës, për pranimin e luftëtarëve të rinj, për formimin e njërive të reja dhe shpartallimin e reaksionit”.¹¹ Parë në vetvete kjo letër ishte program i mirë dhe i vërtetë për veprimtarinë e forcave të dërguara nga UNÇSH-ja.

Ndërkohë, në rrjedhën e këtyre ngjarjeve, udhëheqja jugosllave në një urdhër të saj, të datuar më 2 shtator 1944, kishte vendosur shndërrimin e Shtabit Kryesor të Kosovës në Shtab Operativ nën vartësinë e Shtabit Kryesor të UNÇ-së të Serbisë. Megjithëkëtë manovër, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Shqiptare dhe Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së e miratuan kërkesën e jugosllavëve dhe të udhëheqjes shqiptare të UNÇ-së së Kosovës. Për rrjedhojë ndodhi që më 12 shtator të vitit 1944, Komanda e Përgjithshme e UNÇSH-së i dha urdhër Komandës së Korparmatës së Parë të saj që të dërgonte dy brigada për në Kosovë. Ja si shkruhej në atë urdhër: “(Shumë konspirative). Të përgatiten dhe të nisen menjëherë për në Kosovë Brigada I dhe III”.¹² Por, vetëm dy ditë më pas, më 14 shtator, ky urdhër do të pasohej nga një tjetër, që bënte një ndryshim në përbërjen e brigadave sulmuese të UNÇSH-së, që do të kalonin në Kosovë. Në urdhrin e dytë, që dërgohej nga Komandanti i Përgjithshëm i UNÇSH-së, për Shtabin e Korparmatës së Parë,

¹¹ Ali Hadri, *Lëvizja Nacional Çlirimtare në Kosovë, 1944-1945*, ”Rilindja”, Prishtinë, 1971, f. 410.

¹² *Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm dhe të Komandës së Përgjithshme të UNÇSH*, Vëll. II. Sh. Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1976, f. 160.

shkruhej: *“Brigada V* dhe III** me personelin që keni caktuar mund të shkojnë për Kosovë”*.¹³ Zëvendësimi i Brigadës së Parë Sulmuese me Brigadën e Pestë ndodhte sepse, në kohën kur u dha urdhri i kalimit për në Kosovë, kjo brigadë gjendej fare pranë saj, në krahinën e Kukësit.

Gjithnjë sipas urdhrit dhe udhëzimeve të Komandës së Përgjithshme dhe të Komandës së Korparmatës së Parë, të dy brigadat shqiptare duhej të bashkërendoheshin gjatë veprimeve luftarake në trevën e Kosovës, me forcat partizane të Kosovës dhe ato jugosllave në përgjithësi. Kjo me qëllim që të plotësonin objektivin e tyre kryesor për të goditur dhe *“...larguar forcat pushtuese gjermane dhe të ndihmonin në çlirimin e këtyre territoreve”*.¹⁴ Po ashtu, në udhëzimet e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së dhe atij të Korparmatës së Parë të kësaj ushtrie, për brigadat në fjalë, bëheshin të njohura *qëllimi, misioni dhe detyrat*, që ato duhej të përmbushnin në territorin e Kosovës. Në misionin e dy brigadave shqiptare që, pak kohë më pas, së bashku me Brigadën e Njëzetepestë Sulmuese, po të UNÇSH-së, do të krijonin Divizionin e Pestë të kësaj ushtrie, përveç veprimeve luftarake kundër nazistëve pushtues dhe bashkëpunëtorëve të tyre, si spastrimi i krahinës nga mbeturinat e reaksionit ekstremist sllav etj., natyrisht ishin përfshirë edhe synime të tjera. Ndër to më të rëndësishëm ishin pranimi i luftëtarëve të rinj kosovarë dhe shtimi i radhëve të brigadave shqiptare me ta, por edhe formimi i njësive të reja me luftëtarë vendas etj.

* Brigada e Pestë Sulmuese ishte ndër më të vjetrat, më luftaraket dhe më të njohurat e UNÇSH-së. Ajo u përrua më 28 nëntor 1943, në Tragjaz të Vlorës dhe luftoi deri në Kosovë dhe Serbi. Gjatë veprimeve në Kosovë, radhët e saj gati u dyfishuan me shumë luftëtarë nga kjo krahinë shqiptare. Nga radhët e saj ranë 363 dëshmorë.

**Brigada e Tretë Sulmuese, ndër të parat në UNÇSH, u përrua më 9 tetor 1943, në Arbanë të Tiranës. Luftoi deri në Kosovë dhe Serbi. Ajo i dha Luftës Antifashiste NÇ, 256 dëshmorë.

¹³ Po aty, f. 172.

¹⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. IV, e cituar, f. 145.

Në anën tjetër në Shqipëri forcat e Korparmatës së Parë të UNÇ-së, si Brigada e Tretë dhe ajo e Pestë, pas afro dy muajve luftime të vazhdueshme në zonat e Shqipërisë së Veriut, i kishin plotësuar objektivat e tyre kryesore luftarake. Në fundin e muajit shtator 1944 këto njësi luftarake kishin dalë, përkatësisht, Brigada e Pestë në rrugën Kukës-Prizren dhe Brigada e Tretë Sulmuese në Tropojë.¹⁵

Në këtë situatë, Brigada e Tretë Sulmuese mori për detyrë që, pasi të çlironte qendrën e nënprefekturës së Tropojës, të mësynte në drejtimin Tropojë-Junik, të godiste kolonat gjermane në rrugën Gjakovë- Pejë dhe më tej, në bashkëveprim me Brigadën e Parë të UNÇ-së të Kosovës, të ndante dhe veçonte nga njeri-tjetri garnizonet e armikut në qendrat e banuara. Vetëm pas kësaj, kjo brigadë duhej të hidhej në mësymje vendimtare për të çliruar Junikun, Deçanin dhe Pejën.¹⁶ Ndërkaq, Brigada e Pestë Sulmuese, kishte marrë detyrë të çlironte anën e Dragashit, më pas të kalonte lumin Drini i Bardhë dhe, pasi të kapte bregun lindor të këtij lumi, të bashkëvepronte me Brigadën e Katërt UNÇ-së të Kosovës dhe, së bashku, të vijonin mësymjen për çlirimin e qyteteve Gjakovë dhe Prizren.

Në fazën pasuese të dy brigadat e UNÇSH-së duhej të depërtonin dhe të shtriheshin në brendësi të krahinës për të plotësuar detyrën për çlirimin e plotë të qyteteve dhe të krejt krahinës së Kosovës. Sipas urdhrit të Komandës së Përgjithshme të UNÇSH-së, për të përmbushur këtë detyrë, brigadat do të duhej të bashkëvepronin me forcat e Korparmatës së Dytë të UNÇ-së Jugosllave, në drejtimin Plavë-Andrejevicë.

Disa ditë para kalimit të dy brigadave të UNÇSH-së në Kosovë, komandanti i përgjithshëm i kësaj ushtrie lëshoi disa udhëzime, të cilat vlerësoheshin të rëndësishme për kohën. Në to

¹⁵ FESH, Vëll. I, “Kristalina K-H”, Tiranë, 2008, f. 18.

¹⁶ Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm dhe të Komandës së Përgjithshme të UNÇSH,(DSHPKP), Vëll. II. Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1976, f. 86.

shkruhej: *“Në Kosovë sjellja duhet të jetë shembullore, disiplina e fortë. Të bëhet mobilizimi i kosovarëve në radhët e ushtrisë pa diferencë. Të formohen njësitë nën komandën tonë ose të jugosllavëve”*.¹⁷

Duke marrë për bazë këto udhëzime Shtabi i Korparmatës së Parë të UNÇSH-së përpiloi një Urdhër Operacioni që ua dërgoi komandave të të dy brigadave të veta, ku shkruhej: *“Kalimi i forcave tona në Kosovë ka për qëllim t’i shkatërrojë dhe hedhë poshtë të gjitha parullat e tyre të okupatorit, të mobilizojë popullin në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe Jugosllave, ta hedhë në luftë kundër armikut të përbashkët, okupatorit dhe tradhtarëve... ”*.¹⁸

Sipas planit të operacionit grupimi i forcave pjesëmarrëse në operacion përbëhej nga katër brigada sulmuese, të cilat arrinin deri në “rreth 3 200 luftëtarë”, të brigadave të Tretë dhe Pestë të UNÇSH-së, si dhe nga dy brigada të Kosovës, e Para dhe e Katërta. Brigada e Parë Kosovare kishte një efektiv prej 700-800 luftëtarësh, të cilët erdhën nga Maqedonia, më 28 shtator 1944, ndërsa Brigada e Katërt Kosovare u formua në Krumë të Kukësit, më 12 tetor 1944, me afro 400 luftëtarë.

Nisur nga planet ushtarake operacioni në Kosovë do të kryhej në dy faza kryesore. Në të parën brigadat e UNÇSH-së do të kalonin kufirin shtetëror me qëllim që të mësynin për çlirimin e Rrafshit të Dukagjinit dhe të qyteteve kryesore që gjendeshin në të. Më së pari do të duhej të spastroheshin nga pushtuesit zonat Dragash, Zym, Damjan, Junik dhe të tjera përreth Gjakovës, Pejës dhe Prizrenit. Më tej, të gjitha brigadat duhej që përmes veprimeve të shpejta të realizonin bllokimin e garnizoneve të armikut, duke i goditur ata përgjatë rrugëve të lëvizjes dhe duke shkatërruar urat që gjendeshin në to. Ndërsa, në fazën e dytë mund të kalohej në goditjen dhe çlirimin e qyteteve kryesore të Kosovës. Brigada e Tretë e UNÇSH-

¹⁷ AQP (Arkivi Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë), Fondi 210, Urdhër Operacioni, 18 shtator 1944.

¹⁸ *Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm dhe..., Vëll. II*, vep. e përmendur, f. 160; AQP. Fondi 202, Dosja 13, Radiogram drejtuar shtabit të Korparmatës I, datë 16 shtator 1944.

së, në bashkëveprim me Brigadën e Parë të Kosovës, duhej të vepronin në zonën Deçan-Istog-Pejë, ndërsa Brigada e Pestë e UNÇSH-së, së bashku me Brigadën e Katërt Kosovare, do të duhej të vepronin në zonën midis Gjakovës dhe Prizrenit.

Me hyrjen në territorin e Kosovës të dy brigadat nga Shqipëria duhej të vepronin sipas udhëzimeve të lëshuara nga Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së dhe planit të veprimeve që kishte hartuar Shtabi Operativ i Kosovës. Sipas tyre brigadat sulmuese nga Shqipëria dhe Kosova do të duhej të bashkërendoheshin në veprimet e tyre luftarake kundër forcave pushtuese gjermane dhe atyre reaksionare. Në këto rrethana, sipas urdhrit, Brigada e Pestë Sulmuese kaloi në Kosovë natën e 4-5 tetorit 1944¹⁹, duke lëvizur nga Shishtavec i dhe Novoseja në drejtim të Dragashit. Në të gjendeshin një numër prej 700-800 ushtarësh gjermanë dhe disa forca reaksionare shqiptare. Por, disa forca armike ndodheshin edhe në fshatin Gllaboçicë, në jug të Dragashit. Pikërisht Brigada e Pestë e UNÇSH-së bëri provën e parë të zjarrit kundër këtij grupimi armik në bashkëveprim me një batalion të Brigadës së Parë Kosovare dhe të Batalionit “Kosova”. Luftimet qenë mjaft të rrepta dhe zgjatën disa orë. Në përfundim armiq të u thyen dhe një pjesë u tërhoqën për në Prizren. Veprimet luftarake u shtrinë në një front prej afro 40 kilometrash gjerësi, i cili përfshinte edhe rajonet e Zymit, Rugovës, Dumjanit, Smaçit etj.

Brigada e Tretë Sulmuese e UNÇSH-së kaloi në Kosovë më 20 tetor 1944. Me të kaluar në ato territore edhe kjo brigadë sulmuese shqiptare u përfshi në veprime luftarake.

Në Krumë të Kukësit ishte përruruar Brigada e Katërt Kosovare mbi bazën e Batalionit “Kosova” dhe luftëtarë të rinj, brigadë kjo që u përfshi menjëherë në luftimet.

¹⁹ *Historia e LANÇSH*, Vëll. IV,..., f. 815. Sipas komandantit të kësaj brigade, “...në agimin e datës 4 tetor 1944, Batalioni III dhe IV u urdhëruan të sulmojnë nga drejtime të ndryshme forcat armike dhe tradhtarë, të cilat, më 4 tetor 1944 sulmuan forcat e Batalionit IV në afërsi të Bicajt”. (Shefqet Peçi, *Fragmente nga epopeja e lavdishme*. Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1984, f. 353).

Dragashi ishte çliruar, por ndërkaq Brigada e Pestë Sulmuese, nga Dragashi iu drejtua Veriut, pasi kaloi lumin Drini i Bardhë, marshoi drejt qytetit-garnizon të Gjakovës ku, më 11 tetor 1944, së bashku me Brigadën e Parë të Kosovës, me të kapur postën e Zymit dhe të Damjanit, më 15 tetor, sulmuan qytetin e përforcuar dhe të përgatitur për mbrojtje të Gjakovës. Ky qytet vlerësohej nga pushtuesit si një nyje e rëndësisë së veçantë që duhej mbrojtur me çdo kusht sepse shërbente si një rrugëdalje për të siguruar tërheqjen e forcave gjermane nga rajoni i Ballkanit. Në këto rrethana, Brigada e Pestë e UNÇSH-së me Brigadën e Parë të Kosovës, pasi spastruan më parë rrethinat e qytetit dhe rrugët që e lidhnin atë me Prizrenin dhe Pejën, zhvilluan luftime veçanërisht të rrepta, sidomos në rajonin e kazermave dhe tek Ura e Terezive. Megjithatë, nuk qe e mundur që qyteti të merrej në këtë sulm, sepse pushtuesit i erdhën në ndihmë trupa të shumtë gjermane nga ana e Pejës dhe Prizrenit.

Pasi thyen kundërveprimin e forcave gjermane, më 14 tetor, kundër forcave të Brigadës së Parë sulmuese të UNÇSH-së, në Smaç, Damjan dhe Zym, ku ata nuk ia dolën të zmbrojnë forcat shqiptare asnjë kilometër më tej nga vija e zënë. Mësymja tjetër e forcave çlirimtare nga Shqipëria dhe Kosova u dha në javën e parë të muajit nëntor 1944 nga ana e forcave të Brigadës së Pestë të UNÇSH-së dhe Brigadës së Katërt të Kosovës, të mbështetura këto nga forcat luftarake të Brigadës së Tretë të UNÇSH-së dhe të Brigadës së Parë Kosovare. Qyteti u çlirua më 10 nëntor 1944.

Me çlirimin e Gjakovës u krijuan të gjitha kushtet për çlirimin e Pejës dhe të Prizrenit. Kësisoj, qyteti i Pejës u çlirua më 17 nëntor 1944 nga forcat e Brigadës së Tretë të UNÇSH-së dhe Brigada e Parë e Kosovës. Pas këtyre zhvillimeve luftarake qyteti i Prizrenit konsiderohej si një nyje me rëndësi të posaçme në tërë skemën e tërheqjes së trupave gjermane nga drejtimi i Greqisë dhe i Maqedonisë. Ky qytet mbrohej një garnizon i fuqishëm gjerman dhe nga mjaft forca reaksionare, të cilat luftonin të pozicionuara në një mbrojtje të përgatitur në pikëpamje fortifikimi, duke nisur nga rrethinat, brenda në qytet, si në kodrat dhe në kalanë e qytetit. Kështu, kalaja e qytetit ishte shndërruar në pikëmbështetjen më të

fuqishme, kurse kodra në jug dhe vetë ndërtesat, në një zinxhir me qendra zjarri të dendura.

Njësitë partizane të Brigadës së Tretë të UNÇSH-së dhe forcat e Brigadës së Parë Kosovare, së bashku sulmuan Junikun, qendër kryesore e krahinës së Kosovës të asaj kohe dhe, njëherësh nyje me rëndësi në rrugën Pejë-Gjakovë. Mirëpo, edhe pse forcat mësymëse shqiptare nga Shqipëria dhe Kosova mundën të depërtonin në Junik, pas luftimeve shumë të rrepta, nuk e morën dot atë më 20 tetor 1944. Këtë e arritën tri ditë më pas, më 23 tetor, kurse më datën 26 po të këtij muaji mundën të kapnin edhe Batushën e Deçanin.

Pasi ia dolën të çlironin qytetin e Gjakovës, njësitë e ardhura nga Shqipëria dhe ato kosovare, iu drejtuan Pejës dhe Prizrenin, të cilat, në mënyrë të veçantë Prizrenin, pushtuesit gjermanë donin t'i mbanin me çdo kusht, sepse ato vlerësoheshin si nyje përgjatë korridorit të tërheqjes së forcave të tyre nga Maqedonia dhe Kosova. Madje, në Prizren ishin mbledhur edhe forca kolaboracioniste të tërhequra nga Shqipëria. Ndonëse në Prizren ishte shpallur gjendja e jashtëzakonshme, forcat ushtarake gjermane nuk mundën kurrësi të pengonin mësymjen e njërive nga Shqipëria dhe atyre kosovare që, më 17 nëntor, arritën të futen në Prizren, Pejë dhe Istog. Vetëm pas dy ditëve, më datën 19 nëntor, po këto forca hynë pa luftë në Suharekë.

Gjithashtu, më 19 nëntor, forca luftarake të njërive bullgare, serbe dhe kosovare mundën të hynin në qytetin e Prishtinës, kurse më 20 nëntor u çlirua Vushtrria, pak më pas edhe Trepça dhe Zveçani. Në fillimin e muajit dhjetor, me kërkesën e Shtabit Operativ të Kosovës dy njësitë e ardhura nga Shqipëria morën kërkesën për të hyrë në zonën e Drenicës, që sipas atyre, gjendja në Drenicë ishte *“shumë e vështirë”*, sepse *“reaksioni aty kishte baza shumë të forta”*. Por, përtej situatës, brigadat e UNÇSH-së, brenda pak ditëve e qetësuan gjendjen dhe rikthyen *normalitetin* në zonë.

Më 20 nëntor, Brigada e Pestë e UNÇSH-së u përqendrua në Lipjan, ndërsa ato të Brigadës së Tretë po të kësaj ushtrie, nisën marshimin në drejtimin Drenicë-Istog-Mitrovicë. Më 20 nëntor 1944 këto brigada mësuan lajmin për krijimin e Divizionit të Pestë të

UNÇSH-së, në të cilin krahas tyre, ishte përfshirë edhe Brigada e Njëzetepestë e kësaj ushtrie. Mbrëmjen e 25 nëntorit 1944, forcat e Brigadës së Tretë Sulmuese të UNÇSH-së, kishin arritur në rrethinat e Mitrovicës, kurse më 27 dhe 28 nëntor forcat e kësaj brigade, së bashku me Brigadën e Pestë dhe formacionet luftarake të Kosovës, goditën dhe e detyruan armikun të lëshojë qytetin, ku u futën dhe më datën 29 nëntor parakaluan forcat e njësitë çlirimtare nga Shqipëria dhe Kosova.

Sapo kaluan në territorin e Kosovës njësitet e më sipërme luftarake, u përfshinë në luftime mësymëse për çlirimin e qyteteve dhe fshatrave të Kosovës, si dhe spastrimin e tyre nga bandat çetnike që terrorizonin popullsinë shqiptare të tyre. Gjatë veprimeve luftarake, që zgjatën për më se tre muaj, forcat e brigadave të UNÇSH-së, në bashkëveprim me formacionet luftarake të Kosovës dhe në disa raste dhe me ato jugosllave, e plotësuan misionin e tyre në treguesit kryesorë.

Ardhja dhe veprimtaria e brigadave sulmuese të Divizionit të Pestë Sulmues të UNÇSH-së në Kosovë nuk ishte me vlera dhe përfitime vetëm për vëllezërit shqiptarë të Kosovës, por edhe për vise të tjera të Jugosllavisë, të banuara nga shqiptarët. Ato patën ndikime dhe qenë një ndihmesë e dukshme për çlirimin e popullit të Kosovës dhe trevave të tjera në Jugosllavi. Njëkohësisht, njësitë luftarake nga Shqipëria, me veprimet luftarake që kryen në Kosovë, sollën disa përfitime politike dhe shoqërore për popullsinë e krahinës shqiptare të Kosovës, por dhe më gjerë. Ndërkaq, ato zbuluan, më së shumti, edhe mjaft aspekte dhe dukuri që lidhen me historinë dhe artin ushtarak të zbatuar prej tyre gjatë këtij operacioni luftarak. Meqenëse aspektet e tjera u trajtuan dhe, ndoshta, mund të trajtohen në të ardhmen nga kolegë të nderuar, historianë të fushave përkatëse, më lejoni të ndalem dhe të sjellë, në vijim të kësaj kumtese, disa dukuri që lidhen pikërisht me aspekte të historisë dhe artit ushtarak, e cila është, tek e fundit, fusha jonë e studimit dhe shpresojmë të paraqesin interes për veçoritë e tyre.

Së pari dhe më së shumti, është qartësisht e kuptueshme që brigadat e UNÇSH-së, që siç dihet ishin formacione luftarake dhe merreshin atëkohë me veprimtari luftarake, do të sillnin, padyshim, një produkt dhe përfitime që vinin nga zhvillimi i veprimeve në fushën e luftës. Për këtë arsye mund të nxjerrim dhe disa përfundime që lidhen pikërisht me këto aspekte.

Kështu, që në krye mund të thuhet me siguri se, ardhja e forcave e dy brigadave sulmuese të UNÇSH-së, në ndihmë të forcave luftarake të Jugosllavisë dhe Kosovës, për çlirimin e krahinës shqiptare të Kosovës ishte padyshim një ndërmarrje e suksesshme në disa pikëvështrime. Kjo sepse ardhja dhe lufta e tyre çoi në çlirimin e plotë të Kosovës nga pushtuesit e huaj gjermanë dhe në spastrimin e krahinës nga reaksioni i egër ekstremist serbo-sllav, të cilin nuk kishte guxuar dhe mundur ta godiste askush, asnjë forcë vendase deri atëherë. Tipik ishte rasti i krahinës së Drenicës, për të cilin, në fillimin e muajit dhjetor 1944, me kërkesën e Shtabit Operativ të Kosovës, u kërkuar që forcat luftarake nga Shqipëria të rihynin në këtë krahinë të trazuar. Por, sipas të dhënave të Shtabit Operativ të Kosovës, të cilat *“nuk përputheshin me realitetin”*, gjendja në këtë krahinë paraqitej *“shumë e vështirë”*.

Kjo gjendje vinte sepse *“reaksioni kishte aty baza shumë të forta”*.²⁰ Prandaj, ndërhyrja ishte e domosdoshme. Por, në realitet, gjendja që gjetën në Drenicë forcat luftarake nga Shqipëria ishte krejtësisht ndryshe nga sa ua kishin përshkruar më parë drejtuesit e Shtabit Operativ të Kosovës. Ajo situatë që gjetën në Drenicë ishte dramatike, për shkak se popullsia e vendit ishte tejet e shqetësuar nga sulmet dhe shpifjet e propagandës jugosllave, që i paraqisnin shqiptarët e këtushëm si përkrahës të reaksionit dhe vetë krahinën si bazë e tij. Ndërkohë, lajmi lidhur me terrorin dhe spastrimet që kishin ndërmarrë repartet e armatosura jugosllave dhe bandat e armatosura çetnike, kishin ngjallur frikën e natyrshme në radhët e popullsisë shqiptare të krahinës. Për këto arsye, drenicasit që, në

përgjithësi, mbanin armë, kishin qenë të shtrënguar të fshiheshin për t'u mbrojtur në pyjet përreth.

Pavarësisht nga tabloja e errët dhe rrethanat e ndërlikuara në krahinë, forcave luftarake të UNCSH-së i u deshën vetëm pak ditë për të normalizuar situatën dhe për të qetësuar popullsinë e Drenicës. Brigada e Pestë e UNÇSH-së ndërhyri duke u dhënë një goditje të shpejtë dhe të fuqishme forcave reaksionare çetnike të përqendruara në krahinën e Drenicës. Më pas batalionet e kësaj brigade hynë thellë nëpër fshatrat e krahinës, duke ndihmuar në shpëtimin e popullsisë vendase nga terrori i egër dhe i dyfishtë gjermano-nazist dhe ai i bandave shoviniste sllave. Për rrjedhojë njerëzit nisën të ktheheshin nëpër shtëpitë, që i kishin braktisur ditë më parë për të shpëtuar nga terrori. Ata, kur mësuan për ardhjen e luftëtarëve vëllezër nga Shqipëria, u drejtoheshin me mirënjohje dhe besim atyre me fjalët: *"Ju na sollët lirinë dhe besimin se fati ynë ka me u zgjidh drejt. Ju po silleni me ne tamam siç kemi dëgjuar për ushtrinë e popullit. Ju na shpëtuat tue u ndal dorën atyre që duan me na shfarosë"*.²¹ Por, ky nuk ishte rasti i vetëm, gjatë veprimtarisë luftarake të brigadave partizane nga Shqipëria në Kosovë, ku forcat e brigadave të UNÇSH-së, duke bashkëvepruar përherë ngushtësisht me formacionet luftarake kosovare, që e njihnin mirë terrenin dhe njerëzit, ashtu si dhe kundërshtarin përballë, kryen me sukses dhe brenda një kohe relativisht të shkurtër spastrimin nga reaksioni i egër edhe të atyre zonave që deri atëherë ishin konsideruar nga shumëkush si tabu, ku nuk mund t'i prekte askush, pa le më të hynte në brendësi të tyre! Pikërisht me ardhjen e tyre në Kosovë, forcat luftarake të brigadave të Ushtrisë NÇ të Shqipërisë, mundën të ndikonin dhe, duke bashkëvepruar ngushtësisht në pikëpamje ushtarake me formacionet luftarake antifashiste kosovare, mundën ta thyenin këtë tabu brenda pak muajve!

Nga kryerja e luftimeve, shpeshherë të rrepta dhe të zgjatura për ditë të tëra, nga dy brigadat shqiptare, në bashkëveprim të

²¹ *Historiku i Brigadës së Pestë Sulmuese i UNÇSH*. Shtëpia Botuese: "8 Nëntori", Tiranë, 1989, f. 184.

vazhdueshëm me formacionet luftarake antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës, u bë e mundur që brenda vetëm dy muajve të arrihej çlirimi i një territori me përmasa më se 20 mijë kilometra katrorë, territori ku jetonte një popullsi prej më shumë se një milionë banorë.²²

Kalimi dhe ardhja e brigadave të Ushtrisë Nacionalçlirimtare nga Shqipëria në Kosovë, u krye në muajt e vjeshtës dhe vijoi edhe në fillimin e dimrit të viteve 1944-1945, gjë që nënkupton kryerjen e veprimeve të shumta luftarake në një mot me kohë të ftohtë dhe të një terreni të panjohur. Luftëtarëve nga Shqipëria u duhej të përdornin taktikën e luftimit ditën dhe natën, në një mot me temperaturë të ulët, që shpeshherë shkonin nga -20 deri -25 gradë celsius.²³ Po ashtu, luftëtarëve nga Shqipëria i u desh që të kryenin veprime luftarake duke depërtuar në zona apo krahina të thella, ku mungonin fare ose ishin tejet të kufizuara rrugët për lëvizjen dhe manovrimin e forcave.

Megjithatë, ata, duke shfrytëzuar përvojën si luftëtarë të vjetër dhe të mësuar me luftime dhe vështirësi, i përballuan kushtet e jashtëzakonshme, duke qëndruar pranë njëri-tjetrit dhe duke ruajtur kështu, kurdoherë kompaktësinë dhe bashkëveprimin. Nga ana tjetër, për të zbutur ndikimin e faktorëve negativë dhe përballimin e vështirësive të shumta, të cilat pengonin përmbushjen me sukses të detyrave luftarake, ata u ndihmuan përherë nga luftëtarët dhe popullsia vendase e zonave ku luftohej. Vendasit i udhëhiqnin partizanët shqiptarë përmes terrenit të panjohur për ta dhe duke kryer veprime të përbashkëta, që çoi në përfundimin me sukses të luftimeve.

Bashkëveprimi midis forcave të brigadave sulmuese të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe atyre të formacioneve luftarake të Kosovës, ishte i përhershëm dhe një ndër faktorët kryesorë që çuan në realizimin me sukses të operacionit për çlirimin e Kosovës, por dhe në disa vise të tjera në Jugosllavi. Madje, ky element tejet i

²² *Material Studimi*, Akademia e Mbrojtjes, Tiranë, 1984, f. 19.

²³ *Po aty*, f. 38.

rëndësishëm i artit të luftës, ishte dhe një ndër porosinë dhe pikat më të cilësuar në udhëzimet e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së, si dhe të Korparmatës së Parë të kësaj ushtrie, jo vetëm me brigadat, por me të gjitha formacionet luftarake të vëllezërve shqiptarë të Kosovës dhe ato jugosllave në përgjithësi. Dhe vërtet, gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake, u pa një bashkëveprim i pandërprerë, sidomos midis formacioneve luftarake të brigadave të UNÇSH-së me ato të Kosovës. Kështu ndodhi që në ndeshjen e parë midis forcave të Brigadës së Pestë Sulmuese, e cila kaloi kufirin dhe, në bashkëveprim me një batalion të Brigadës së Parë të Kosovës, si dhe me Batalionin partizan “Kosova”, sulmuan trupat e përziera gjermane dhe mercenare në Dragash, që u thyen dhe u tërhoqën drejt Prizrenit. Po kështu ndodhi edhe me forcat e tjera të UNÇSH-së, në të gjitha betejat dhe luftimet e zhvilluara në qytetet apo qendrat e banuara në Kosovë, si në: Gjakovë, Prizren, Junik etj.

Gjatë kohës së qëndrimit në territorin e Kosovës njësitë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare nga Shqipëria ndikuan dhe ndihmuan ndjeshëm në zgjerimin e luftës dhe shtimit të radhëve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës me luftëtarë dhe formacione luftarake të reja. Në këtë rrjedhë, në harkun kohor vetëm tremujor u ngritën dhe përruan dy brigada luftarake me djem dhe burra kosovarë.²⁴ Ndërsa, deri në përfundim të luftës ky numër arriti në tetë brigada luftarake kosovare. Ndërkaq, shumë të tjerë mbushën radhët e brigadave ekzistuese dhe formacioneve të tjera luftarake të Kosovës.²⁵

Në këtë hark të shkurtër kohor, edhe radhët në brigadave të UNÇSH-së, u dyfishua numri i efektivave të tyre me luftëtarë nga shqiptarët e zonave të ndryshme të Kosovës, ku kishin vepruar gjatë kësaj kohe. Kështu, sipas të dhënave, që vinë kryesisht nga burime historiografike të Shqipërisë, numri i luftëtarëve të Brigadës së Tretë Sulmuese të kësaj ushtrie arriti në 2 000 luftëtarë,²⁶ gjithashtu edhe

²⁴ *Historia e Luftës Antifashiste NÇ të popullit shqiptar*, Vëll. IV, f. 831.

²³ *Material studimi...*, f. 18.

²⁶ Proletar Hasani, *Histori e pashkruar*, FLLAD, Tiranë, 1999, “Pasqyra” nr. 6.

numri i luftëtarëve të Brigadës së Pestë Sulmuese u ngjit në 2 000 luftëtarë,²⁷ kurse efektiv i Brigadës së Njëzetepestë Sulmuese, e cila erdhi më vonë në Kosovë, u shtua me 200 luftëtarë²⁸ të tjerë.

Natyrisht, brigadat ishin formacione luftarake dhe, si të tilla, gjatë kryerjes së veprimeve luftarake përshfaqën edhe një numër treguesish të veçantë në fushën e luftimit. Të tillë ishin treguesit që lidheshin me përmasat e ndërtimit të formacionit apo të rendimit të luftimit të brigadave dhe batalioneve në front dhe thellësi; ato për tempin e lëvizjeve dhe marshimeve në një terren pak ose aspak të njohur për brigadat luftarake shqiptare; ose treguesit që kishin lidhje me shfrytëzimin e terrenit karakteristik të vendit, etj.

Gjithashtu, tërheqin vëmendjen luftimet kundër qyteteve dhe qendrave të banuara, të fortifikuara, kundër të cilave u aplikuan skema taktike, ku u gërshetuan mirë luftimet rrethuese me ato sulmuese, me forca të përqendruara; mënyrat dhe format e organizimit të bashkëveprimit midis forcave të ndryshme luftarake dhe mjaft dukuri e veçori të tjera, të cilat është vështirë të trajtohen në një kumtesë si kjo. Ndoshta është vendi i duhur për të hedhur idenë e studimeve të përbashkëta, të munguara për më se shtatëdhjetë vjet midis institucioneve të Shqipërisë me ato të Kosovës. Në këtë rast një prej projekteve mund të ishte edhe kjo temë, fare pak e prekur, në pak botime, si në *Historinë e Popullit Shqiptar*, apo *Historinë e Artit ushtarak të LANÇ-së të popullit shqiptar*, botim i vitit 1989, ku mungojnë burimet dokumentare apo botimit nga Kosova, Serbia etj.

Në pikëpamje politiko-administrative njësitet luftarake të UNÇSH-së dhanë një ndihmë të madhe në ngritjen dhe organizimin e pushtetit vendor të këshillave nacionalçlirimtare dhe rikthimin e qetësisë e të normalitetit në të gjitha trevat e Kosovës. Njësitet e Divizionit të Pestë të UNÇSH-së e kishin përmbushur misionin dhe detyrat e ngarkuara nga Komanda e Përgjithshme dhe, pas afro 400 kilometrash marshim, u rikthyen në Shqipëri. Operacioni për çlirimin

²⁷ Po aty.

²⁸ *Historia e Luftës Antifashiste të popullit shqiptar*, Vëll. IV, f. 831.

e trevave të Kosovës dhe viseve të tjera në Jugosllavi ishte vulosur me gjakun e afro 400 dëshmorëve²⁹, që ranë për çlirimin dhe lirinë e vëllezërve shqiptarë të Kosovës, si dhe të viseve të tjera të Jugosllavisë. Historiografia sllave është përpjekur ta minimizojë luftën e formacioneve luftarake shqiptare në Kosovë dhe treva të tjera të Jugosllavisë, por treguesit e kësaj lufte janë të dukshëm.

Pasi forcat e brigadave sulmuese të UNÇSH-së, në bashkëveprim të ngushtë me ato të Kosovës, i çliruan dhe kthyen qetësinë në territoret e Kosovës, këto forca morën urdhër për të vazhduar operacionin në zona të tjera të Jugosllavisë. Pikërisht në këtë kohë, sipas raporteve të asaj kohe, që vinin nga Kosova për në Shqipëri, bëhej me dije se: *“...menjëherë pas largimit të Brigadës së Tretë Sulmuese nga Drenica, kuadrot serbë filluan nga arrestimet dhe vrasjet e njerëzve të ndryshëm me kombësi shqiptare pa i kaluar fare në gjyq”*,³⁰ ndërsa në një raport të vitit 1944, që komandanti i Shtabit Operativ i dërgonte Komandës së Korparmatës së Parë të UNÇSH-së, ndërmjet të tjerave raportonte se: *“...Ushtarakisht shkohet përpara, por fatkeqësisht punët nuk shkojnë kështu edhe politikisht... Në ushtri (jugosllave) mungon një vijë politike për vëllazërimin e popujve... Gjendja këtu është bërë kaotike... Arrestohen e burgosen të pafajshëm. Kontrolltet dhe arrestimet bëhen pa asnjë autorizim. Dhe të gjitha këto ndodhin në familjet muhamedane. Pjesa më e madhe e malazezëve janë prepotentë. Ndër vendet ku janë partizanët tanë, punët nuk shkojnë keq sepse çdo veprim bëhet prej të dy palëve. Po të mos merren masa ... punët do shkojnë keq e më keq”*.³¹ Po kështu ndodhte edhe në zonën e Drenicës. Në muajin dhjetor të vitit 1944, ku u kthyen me një operacion spastrimi forcat e Brigadës së Pestë Sulmuese të UNÇSH-

²⁹ Sipas Bernd J. Fischerit, në luftimet në Kosovë ranë 300 dëshmorë nga brigadat sulmuese të UNÇSH-së. (*Shqipëria në Luftë*, f. 311).

³⁰ *Historia e Luftës Antifashiste NÇ e popullit shqiptar*, Vëll. IV, f. 829.

³¹ AQP, Fondi 210, dosja 9, Korparmata e Parë, 27. 11. 1944.

së, të cilat rikthyen, brenda një kohe të shkurtër, qetësinë dhe normalitetin në krahinë. Pothuajse kështu ndodhte dhe në zona të tjera të Kosovës. Rikthimi i terrorit, pasigurisë dhe ankthit në krahinën shqiptare ishte një paralajmërim për atë që do të ndodhte më pas, me popullsinë shqiptare, me largimin e forcave të njësiteve të UNÇSH-së.

A ishte kjo fushatë fillimi i ripushtimit të Kosovës të pasluftës?! Natyrisht që po dhe që, për fat të keq, do të vijonte gjatë, deri në Luftën e Kosovës të vitit 1999. Kjo luftë, e cila bazohej në heroizmin e luftëtarëve të UÇK-së dhe kishte mbështetjen e fuqishme të NATO-së, do të përmbyllej më në fund me fitore dhe do çonte, pas më se nëntëdhjetë vjetësh, në Pavarësinë e Kosovës dhe ngritjen e shtetit të saj të pavarur.

Me kalimin e tyre në drejtim të territorit të Kosovës, forcat luftarake të Divizionit të Pestë të UNÇSH-së, e përmbushën misionin dhe detyrat e tyre kryesore, që kishin të bënin kryesisht me luftën për çlirimin e trojeve shqiptare të Kosovës, por edhe ato jashtë saj, të banuara gjithashtu nga shqiptarët. Natyrisht, ata ndikuan dhe ndihmuan konkretisht nëpërmjet përkushtimit, trimërisë dhe vetëmohimit, duke plotësuar detyrën atdhetare në çlirimin e vëllezërve kosovarë, nga pushtuesi i huaj dhe bandat e shovinistëve sllavë. Gjatë këtyre luftimeve, këto brigada, në bashkëveprim të ngushtë dhe efektiv me formacionet dhe njësitet luftarake antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës, shpërfaqën edhe disa dukuri që kanë lidhje me zbatimin me krijimtari dhe në mënyrë racionale të artit të luftës në fushën e luftës. Të gjitha këto, kanë përbërë deri më sot një objekt të veçantë studimi për studiuesit e historisë dhe të artit ushtarak shqiptar, jo vetëm për t'i njohur ato, por edhe jo vetëm si përvojë. Ndoshta kjo mund dhe duhet të shërbejë edhe si një nismë për një projekt të përbashkët studimi të plotë në këtë fushë dhe tematikë, nga institucionet përkatëse të Shqipërisë dhe Kosovës.

Halim PURELLKU

**PUSHTIMI I TREVAVE LINDORE SHQIPTARE NGA
FUQITË JUGOSLLAVE/PARTIZANE NË GJYSMËN E DYTË
TË VITIT 1944**

Fuqitë ndërluftuese

Gjatë Luftës së Dytë Botërore rrethi i Dibrës, i Radastushës (Rekës së Dibrës), i Strugës, i Kërçovës, i Gostivarit dhe ai i Tetovës, si dhe pesë fshatra të rrethit të Prespës, me sipërfaqe rreth 4 100 km², nga shtatori i vitit 1943 e deri në nëntor të vitit 1944, ishin nën pushtimin ushtarak gjerman dhe me administratë shqiptare, kurse pjesa tjetër e Trevave Lindore shqiptare ishin nën pushtimin bullgar.¹ Asokohe, në Trevat Lindore shqiptare, krahas ushtrive dhe pushteteve gjermane dhe bullgare, vepronin edhe struktura të tjera legale e ilegale politike dhe si ushtarake. Nga organizmat politike shquheshin: “Lidhja e Dytë e Prizrenit”, me komitetet e saja edhe në Tetovë dhe në Gostivar², Partia Komuniste e Jugosllavisë (PKJ), si dhe Organizata çetnike etj.³ Secila nga këto organizata kishin ngritur

¹ Masar Kodra, Shqiptarët e Maqedonisë gjatë Luftës së Dytë Botërore (1939-1944), Kumanovë, 1996, (në vazhdim: Masar Kodra, vep. e përmendur...), f. 76-78, 106-107.

² Masar Kodra, vep. e përmendur..., f. 110 dhe 111 dhe 227.

³ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна

edhe fuqitë e tyre të armatosura. Të gjithë këta faktorë ushtarakë, madje si faktorët ushtarakë edhe ata politikë vepronin në këto treva mbi bazën e interesave dhe ideologjive të veta.

Fuqitë shqiptare/balliste: Në Trevat Lindore shqiptare, “fuqitë shqiptare” ashtu siç i cilësonte edhe Mihajllo Apostollski, në një raport të tij në tetor të vitit 1944,⁴ njihen dhe me sinonime të tjera, si: “fuqitë kreshnike”, “fuqitë kufitare vullnetare”,⁵ por dhe hera-herës në dokumente dhe literaturë i hasim me emrin fuqitë e “shqiptarëve progjerman”, por termi “fuqi balliste” mbeti emërtimi më i përdorur për ta pas përfundimit të luftës, ndaj dhe ne në këtë punim do të përdorim termin: fuqitë shqiptare/balliste. Organizimi i këtyre formacioneve të armatosura në trevat e Gostivarit, Kërçovës, Tetovës etj, filloi që nga fillimi i majit 1944, me dekret të Xhemail (Xhemë) Hasanit (Xhemë Gostivarit), i cili edhe ishte komandant i tyre, kurse zëvendës komandant ishte Mefail Shehu (Mefail Kërçova).⁶ Në gusht 1944, numri i ballistëve në këto treva përgjithësisht ishte i kufizuar dhe ishin dobët të armatosur, kryesisht me armë të lehta, posedonin vetëm disa armë automatike.⁷ “Ballistët

Македонија, Избор и редакција д-р Тодор Чепреганов, д-р Ѓорѓи Чакарјаневски, д-р Васил Јотевски, д-р Миле Михајлов, д-р Лилјана Пановска, ботон: Институт за национална историја, Скопје, 2005 (нë vazhdim: Ослободување на федерална Македонија, Западна Македонија...), dok. nr. 30, f. 53.

⁴ Државен архив на Република Македонија (нë vazhdim: ДАРМ), Скопје, Фонд (нë vazhdim: Ф.) Бр. 254- Главен штаб на Македонија 1942-1945 (нë vazhdim: ГШМ), Кутија (нë vazhdim: К.) Бр. 54-а (i pa rregulluar), Nr. 32, 31.X.1944, Raport i Mihajllo Apostollskit, komandant i Shtabit Kryesor për Maqedoni, Shtabit Suprem të UNÇAP të Jugosllavisë.

⁵ *Arkivi Qendror i Shtetit* (нë vazhdim: AQSH), Tiranë, Fondi (нë vazhdim: F.) 152, Viti (нë vazhdim: V.). 1944, Dosja (нë vazhdim: D.) 179, fl. 21-26, Projekt, kryeministri Rexhep Mitrovica, Ministrisë së PB, Tiranë, 7 dhjetor 1943.

⁶ Masar Kodra, ver. e përmendur..., fq. 111

⁷ Велика Британија и Македонија, Документи 1942-1945, Избор, превод и редакција Д-р Тодор Чепреганов, ботон: Државен архив на Македонија dhe Матица македонска, Скопје, 2000, (нë vazhdim: Велика Британија и Македонија, Документи 1942-1945...), dok. 352, f. 421; Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 3,

e trevave të Kërçovës-Gostivarit ishin drejtpërdrejt të lidhur me ballistët e Kosovës dhe ishin nën komandën e përbashkët me qendër në Prizren nga ku furnizoheshin me armë e municione” - thuhet në dokumentet partizane të kohës.⁸

Fuqitë jugosllave/partizane: Numri i anëtarëve të Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ) në Trevat Lindore shqiptare asokohe ishte shumë i vogël apo minimal. Nga mesi i vitit 1944, në rrethet e Tetovës, të Gostivarit, të Dibrës dhe të Strugës PKJ-ja, kishte gjithsej rreth tetëdhjetë (80) anëtarë.⁹ Ndërkaq, në korrik të vitit 1944, në gjithë “Maqedoninë” njësitë partizane numëronin gjithsej rreth 3 000 luftëtarë.¹⁰ “Brigada kosovare është (ishte-^{H.P.}) boshti i lëvizjes partizane maqedonase. Kjo pranohet edhe nga liderët maqedonas”, - vlerësonte kapiten britanik MekDonalld (Donalld), në një raport të tij për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Britanisë (Foreign Office).¹¹ Ndërkaq, në qarqet e larta komuniste, Svetozar Vukmanoviq Tempo cilësohej si “organizuesi dhe frymëzuesi” i brigadave partizane jugosllave në “Maqedoni”,¹² një konstatim i këtillë gjen mbështetje edhe në vetë raportin e Tempos, dërguar KQ-së të PKJ-së, 8 gusht 1943.¹³ Sa i përkiste karakterit të lëvizjes komuniste partizane në “Maqedoni” MekDonalld vlerësonte se ajo: “në themelet e saj para së gjithash është (ishte-^{H.P.}) nacionaliste, e pastaj lëvizje komuniste”.

f. 31.

⁸ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 45 f. 80.

⁹ Masar Kodra, ver. e përmendur..., f. 209-210, 212, 219 dhe 221.

¹⁰ ДАРМ, Скопје, Ф. Бр. 254- ГШМ 1942-1945, К. Бр. 54-а , Nr. 32, 31. X. 1944, Raport i Mihajllo Apostollskit...

¹¹ Велика Британија и Македонија, Документи 1942-1945... dok. 352, f. 418, Raport i kapitenit MekDonalld, shef i Misionit britanik pranë Shtabit Kryesor për Maqedoni, 4 dhjetor 1944 vj.

¹² AQSH, Tiranë, F. 41/AN, V. 1944, D. 134, fl. 1, Letër e Video Smilevski-Bata, Shtabit Kryesor të LNÇ dhe AP, 1, Komanda e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, Shokut Tempo, më 24 Mars 1944.

¹³ ДАРМ, Скопје, Ф. Бр.- 1.426-Централен Комитет на КПМ, К. 2, ае. 422, л. 1-11.

Fuqitë partizane “maqedonase” kishin një nivel disipline. Ata, deri në tetor të vitit 1944, nuk kishin ndërmarrë ndonjë aksion të madh luftarak dhe gjithmonë iu shmangeshin atyre;¹⁴ “thuaje asnjëherë partizanët nuk i shqetësonin trupat gjermane...” në “Maqedoni”, vlerësonte dhe konsulli italian në Manastir, në një raport të tij (30 janar 1945).¹⁵

Tërheqja e trupave gjermane nga Trevat Lindore shqiptare¹⁶ dhe operacionet ndërluftuese midis palëve (shtator-tetor 1944)

Fillimi, zhvillimi dhe përfundimi i operacioneve ndërluftuese midis faktorëve ndërluftues në Trevat Lindore shqiptare; trupave gjermane, fuqive shqiptare/balliste dhe fuqive partizane ishin ngushtë të ndërthurura me situatat momentale ndërkombëtare dhe rajonale, nga të cilët ishin: përfundimi i përgatitjeve të Aleatëve për ofensivë të fuqishme kundër Gjermanisë, si nga lindja ashtu edhe nga perëndimi; hyrja e trupave sovjetike në Serbi dhe Bullgari; zbarkimi i trupave britanike në jug të Shqipërisë; kapitullimi i Bullgarisë (9 shtator 1944); operacionet aleate “Ratweek” dhe “Helium” mbi trupat gjermane; vendimet e Konferencës së Jaltës etj.¹⁷

¹⁴ Велика Британија и Македонија, Документи 1942-1945..., dok. 352, f. 417-418, 424; Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 3, f. 32.

¹⁵ Велика Британија и Македонија, Документи 1942-1945..., dok. 394, f. 463.

¹⁶ Me termin/nocionin “Trevat Lindore shqiptare” nënkuptojmë: trevat shqiptare në lindje të maleve Sharr-Korab-Deshat-Jablanica dhe në jug të maleve Sharr dhe Mali i Zi i Shkupit (Karadak).

¹⁷ ДАРМ, Скопје, Ф. -Бр. 254-ГШМ, К. Бр. 54-а, Р. Бр. 134, Прилог 32, Nr. 32, 31.X.1944, Raport i Mihajllo Apostollskit; Велика Британија и Македонија, Документи 1942-1945..., dok. nr. 337, f. 369, nr. 352, f. 415-417, nr. 394, f. 464 dhe shënimi nr. 720; Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 3, f. 30, nr. 31, f. 56 dhe 58, nr. 32, f. 59, nr. 36, f. 66, nr. 70, f. 179; Историја на Македонскиот народ, Том пети, boton: Институт за национална историја,(në vazhdim: Историја на Македонскиот народ, Том пети...), Скопје, 2003, f. 305.

Komanda Madhore (e Lartë) gjermane, më 2 shtator 1944 e miratoi tërheqjen e Armatës (Korparmatës) “E” nga Greqia. Komanda e grupit të armatave “E”, në krye me gjeneralkolonelin Ler, kishte vendosur që efektivat kryesore të tërhiqen në drejtim të veriut nëpërmjet luginës Moravë-Vardar, kurse efektivat e “Korpusit njëzetënjë (21) të armatës”, i cili ndodhej në Shqipëri, të tërhiqen në drejtimin: Lezhë-Shkodër-Podgoricë-Nikshiq.¹⁸

Me qëllim që nëpërmjet dëmtimit maksimal të linjave hekurudhore të zvarritej për dy muaj tërheqja e trupave gjermane nga Greqia, aviacioni ushtarak britanik më 1 shtator të vitit 1944 ndërmoi operacionin e koduar si “Retvik” (“Ratwek”), kurse pas 7 shtatorit 1944 operacioni vazhdoi me emrin e ri “Helium”. Ndërkaq, në Trevat Lindore shqiptare operacioni filloi më 26 gusht 1944, me sulmin mbi linjën hekurudhore (d’covil) Gostivar-Kërçovë-Strugë ose Ohër. Brenda një jave, sipas planit u ndërpre në plotësisht të gjitha linjat e komunikacionit në drejtimet: Kërçovë-Strugë, Strugë-Dibër, Dibër-Kërçovë dhe Dibër-Gostivar.¹⁹ Kështu, gjatë 28-30 gusht dhe 1 shtator 1944, fuqitë partizane, në bashkëveprim me sulmet e aviacionit aleat i cili natën bombardonte qendrat e rëndësishme, kurse gjatë ditës sulmonte kolonat dhe mjetet transportuese të armikut, rrënuan pjesë të hekurudhës Gostivar-Kërçovë dhe Kërçovë-Strugë, përkatësisht pjesën e hekurudhës Izvor-Botun dhe stacionet hekurudhore: Slivovë, Presekë, Pesoçan

¹⁸ Oslobođilački rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Druga knjiga (Od Drugog zasedanja AVNOJ-a do konačne pobeđe), Drugo prepravljeno i dopunjeno izdanje, boton: V o j n o istorijski institut, B e o g r a d, 1 9 6 5 (në vazhdim: Oslobođilački rat naroda Jugoslavije 1941-1945, knj. 2,...), f. 250-351; Marenglen Kasmî, Aspekte të luftës së Tiranës dhe largimi i Wehrmacht-it nga Shqipëria, Studime historike, Nr. 1-2/2015, Tiranë, 2015, f. 187; Дaнe Пeткoвски, Влaдo Стрeзoски, Бoрбeнa дeјствa y Зaпaднoј Mакeдoнији 1941-1944, Бeoгpaд, 1983 (në vazhd.: Дaнe Пeткoвски, Влaдo Стрeзoски, вep. e пeрмeндyр...), f. 229.

¹⁹ Вeликa Бритaнијa и Mакeдoнијa, Дoкyмeнтe 1942-1945..., dok. 352, f. 415; Oслoбoдyвaњe нa фeдeрaлнa Mакeдoнијa, Дoкyмeнтe, Тoм III, Зaпaднa Mакeдoнијa..., dok. nr. 3, f. 30; Истoријa нa Mакeдoнскиoт нaрoд, Тoм пeти,..., f. 304-305.

dhe Botun.²⁰ Pas evakuimit/tërheqjes së gjermanëve nga Kërçova dhe pas një qëndrese të vogël të fuqive balliste, më 1 shtator 1944, Brigada I Kosovare e pushtoi Kërçovën, me ç'rast partizanët terrorizuan popullatën e fshatit shqiptar Dërgovë të Kërçovës. Por, përpara kundërgoditjes së fuqishme të “fuqive balliste” nga drejtimi: Dërgovë-Kërçovë, në fshatrat Klenoec e Izvor, në jug dhe në malin Bukovik, në veri, në të njëjtën ditë partizanët u thyen dhe ishin të detyruar të largohen nga Kërçova me rrethinë. Ndërkaq, më 3 shtator Brigada I kosovare u tërhoq në trekëndëshin Dibër-Kërçovë-Gostivar.²¹

Ndërkohë, më 4 shtator 1944, trupat gjermane u evakuuan/tërhoqën edhe nga qyteti i Dibrës, i cili pastaj ra në dorë të partizanëve shqiptarë të Ushtrisë Nacional Çlirimtare (UNÇ) dhe Aradheve Partizane (AP) të Shqipërisë, si dhe të Aradhes Partizane të Dibrës-Kërçovës, e cila aradhe më 10 shtator 1944 hyri në kuadër të Brigadës IV Shqiptare të Ushtrisë Nacional Çlirimtare (UNÇ) dhe Aradheve Partizane (AP) të Jugosllavisë.²² Dibra vazhdon të ishte në dorë të partizanëve shqiptarë deri në fund të operacioneve luftarake (19 nëntor 1945). Kurse, Trevat Lindore tjera vazhdonin dhe më tej të jenë në dorë të trupave gjermane dhe të fuqive shqiptare/balliste. Kështu, rreth 10 shtatorit 1944, Struga, Ohri, Kërçova, Gostivari, Tetova vazhdonin të ishin në dorë të gjermanëve, ku dhe qenë përqendruar një numër i vogël i trupave gjermane, si dhe një numër më i madh fuqish shqiptare/balliste. Treva e Tetovës, e Shkupit dhe e Kumanovës dhe linjat e komunikacionit: Shkup-

²⁰ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 14, f. 41-42.

²¹ AQSH, Tiranë, F. 41/AP. v. 1944, D. 135, fl. 17-19, Komunikatë Nr.1 e Shtabit Kryesor të UNÇ dhe APM; Ослободување на федерална Македонија, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 14, f. 41-42, nr. 18, f. 44, nr. 21, f. 46; Ослободилачки rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Knjiga 2...,f. 346; Дане Петковски, Владо Стрезоски, vep. e përmendur..., f. 236.

²² Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 21, f. 46; Prof. dr. Masar Kodra, vep. e përmendur..., f. 229-230.

Kaçanik dhe Shkup-Tetovë vazhdonin të ishin në dorë të trupave gjermane edhe më 15 shtator 1944.

Ndërkaq, nga mesi i shtatorit 1944, fuqitë partizane ishin të grupuara në male midis Dibrës-Kërçovës-Gostivarit dhe në zonat e Brodit (Poreçes) e të Krushevës, ku dhe po përgatiteshin për një sulm të ri.²³ Gjithashtu, dhe fuqitë shqiptare/balliste të prira nga Xhemë Hasani (Gostivari), sipas vlerësimeve të zyrtarëve komunistë jugosllavë, nga fundi i shtatorit 1944 vazhdimisht po forcoheshin për të mbrapsur sulmet partizane: “I gjithë populli shqiptar, me përjashtim të një pakice, me armë në dorë merr pjesë në anën e Xhemës”, ndaj dhe për një kohë shumë të shkurtër ai ishte në gjendje të mobilizonte 3-4 000 veta nën armë. Në gjysmën e dytë të shtatorit, fuqitë shqiptare/balliste iu dhanë disa goditje të rënda fuqive partizane duke iu shkaktuar dhe humbje të mëdha në njerëz.

Kështu, p.sh. më 19 shtator, fuqitë e Xhemës shpartalluan fuqitë partizane në fshatin Kiçinicë të Rekës së Dibrës. Ndërkohë, një grup fshatarësh të trevës së Tetovës në një përpjekje të armatosur me një “aradhe partizane” jugosllave, ia dolën t’i rrethojnë dhe t’i likuidojnë njëzet e gjashtë (26) partizanë dhe udhëheqësin e tyre Todor Ciposki-Merxhan. Kjo shënonte një goditje të rëndë për partizanët në zonën e Tetovës.²⁴ Gjithashtu, kur fuqitë jugosllave/partizane, me to dhe Brigada IV Shqiptare, më 26 apo 28 shtator 1944 sulmuan dhe i pushtuan fshatrat Serbicë, Novoselë dhe Harangjell në veri të Kërçovës, përpara kundërpërgjigjes së fshatarëve shqiptarë, partizanët u thyen dhe në mënyrë të paorganizuar ikën që aty, duke lënë pas 9 të vdekur dhe 21 të plagosur.²⁵

²³ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 23, f. 47-48, nr. 25, f. 49, nr. 26, f. 50.

²⁴ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 30, f. 53.

²⁵ ДАРМ, Скопје, Ф. Бр. 254- ГШМ, К. Бр. 54-а, Nr. 32, 31.X.1944, Raport i Mihajlo Apostollskit...; Oslobodilački rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Knjiga 2..., f. 348; Историја на Македонскиот народ, Том пети..., f. 305.

Ndërkaq, sipas burimeve jugosllave, në fund të shtatorit, përkatësisht në fillim të tetorit 1944, rreth 1 000 trupa gjermane vazhdonin të qëndronin në Strugë, në Ohër dhe në dy fshatra të fushës së Strugës, si p.sh. në Mesheishtë, të cilët mbanin nën kontroll rrugën Ohër-Tiranë. Por, edhe rreth 100 ballistë të armatosur vepronin në trevën e Strugës.²⁶ Më 3 tetor 1944 qe lëshuar urdhri për tërheqjen e trupave gjermane nga Shqipëria dhe Greqia.²⁷ Burimet partizane jugosllave bëjnë të ditur se në ditët e para të tetorit 1944, gjermanët po tërhiqeshin nga Vlora për në Strugë e Ohër. Disa kolona gjermane kaluan nga Ohri në Resnjë, por përsëri u rikthyen në Ohër. Ndërkaq, fuqitë e Brigadës VII partizane me veprime luftarake në qafëmalin “Gjvatë” u përpoqën të pengonin lëvizjen e trupave gjermane në këtë relacion, por, më 4 tetor 1944 fuqitë jugosllave/partizane u thyen dhe trupat gjermane vazhdonin lirshëm lëvizjet e tyre.²⁸ Andaj, Grupi i armatave “E”, vazhdonte t’i dominojë linjat kryesore të komunikacionit, si dhe të sigurojë tërheqjen e disa divizioneve gjermane drejt veriut. Po ashtu, edhe fuqitë shqiptare/balliste gjatë tetorit të vitit 1944 zhvillonin thujtë luftë të përditshme me fuqitë partizane të UNÇAPJ-së në Trevat Lindore shqiptare, që nga Ohri e Struga në jug e deri në zonat e Kaçanikut, Malit të Zi të Shkupit, dhe Kumanovës-Preshevës në veri.²⁹

Në këto rrethana, nga strukturat drejtuese jugosllave partizane ishte hartuar një Plan operativ për pushtimin përfundimtar të Trevave Lindore shqiptare. Për realizimin e këtij plani parashihej që të angazhohen dy korpuse: “Korpusi i Shkupit” dhe “Korpusi i

²⁶ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 30, f. 54, nr. 34, f. 62; Ослободилачки rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Knjiga 2..., f. 355.

²⁷ Marenglen Kasmi, pun. i përmendur..., f. 187.

²⁸ ДАРМ, Ф. -Бр. 254- ГШМ (1942-1945), К. 54-а, Р. Бр. 134, Прилог 32, Relacion i “Shtabit Kryesor të Maqedonisë” për luftimet e fuqive partizane nga 20 gusht e deri më 23 tetor 1944 (nr. arkival 3997), f. 2 dhe 9 (në vazhdim: Relacion... 20 gusht-23 tetor 1944); Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 31, f. 57; dok. nr. 36, f. 66.

²⁹ Ослободилачки rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Knjiga 2..., f. 356-357.

Manastirit” (XV). Sipas planit, detyrat e njësive partizane të “Korpusit të Shkupit”, të ndihmuara dhe nga njësitë e ushtrisë bullgare të konvertuara në partizan, ishin: të ndërpresin linjat e komunikacionit në drejtimet: Shkup-Gryka e Kaçanikut; Shkup-Tetovë dhe Shkup-Kumanovë. Njëkohësit këto fuqi partizane gjatë këtyre operacioneve ishin ngarkuar dhe me detyrën: të veçonin (ndanin) fuqitë shqiptare/balliste nga gjermanët dhe t’i detyronin ata të tërhiqen në Tetovë. Ndërkaq, njësive të Divizionit 48 të “Korpusit të Manastirit” (XV), iu dha për detyrë që pasi të pushtonin Ohrin dhe Strugën të sulmon Kërçovën dhe, pas pushtimit të saj të vazhdon marshin drejt Gostivarit për të kontribuar në suksesin e operacioneve për Shkupin.

Mësymja ndaj trevës së Kërçovës planifikohej të fillonte më 8 tetor 1944. Operacionet e fuqive jugosllave/partizane për realizimin i këtij plani do të vazhdojnë gjatë tetorit të vitit 1944.³⁰ Më 6 tetor 1944, katër brigada jugosllave/partizane të Divizionit 48, ndër ato dhe Brigada IV Shqiptare i kishin zënë pozitat luftarake përreth Kërçovës.³¹ Fuqitë jugosllave/partizane ishin të pajisura dhe me artileri të rëndë; disa topa, të cilët dhe i vunë në veprim.³² Ata më 8 tetor filluan mësymjen mbi Kërçovën³³ nga disa drejtime, kryesisht me zonë veprimi përreth vetë qytetit të Kërçovës dhe në pjesën

³⁰ ДАРМ, Скопје, Ф. Бр. 254- ГШМ, К. Бр. 54-а, Nr. 32, 31.X.1944, Raport i Mihajlo Apostollskit...; Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. 31, f. 56-58, nr. 32, f. 59, nr. 33, f. 61 dhe fusnota/referenca nr. 8; Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том II, Централна Македонија, Избор и редакција: д-р Васил Јотевски, д-р Ѓорѓи Чакарјаневски, д-р Тодор Чепреганов, д-р Миле Михајлов, д-р Лилјана Пановска, ботоп: Институт за национална историја, Скопје, 2005 (нë vazhdim: Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том II, Централна Македонија...), dok. nr. 93, f. 110.

³¹ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 30, f. 55, nr. 33, f. 61.

³² Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 31, f. 57,

³³ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 33, f. 61, nr. 34, f. 61-62.

veriore të kësaj zone. Brigada e Katërt (IV) Shqiptare vepronte në veri të trevës së Kërçovës dhe, përkohësisht pushtoi fshatin Tuhin, pastaj efektivat e saj u hodhën në malin Bukojç (Bukvik). Kurse, Brigada I Maqedonase në mëngjesin e 9 tetorit 1944 nga jugu sulmoi qytetin e Kërçovës, por nuk arriti ta pushtojë. Po më 9 tetor 1944, luftime të ashpra zhvilloheshin edhe në vijën e luftës Kërçovë-fshati Qafë (në veri). Mirëpo, fuqitë shqiptare, të ndihmuara nga popullata vendase dhe nga gjermanët, e thyen mësymjen disaditëshe të fuqive partizane mbi Kërçovën dhe iu shkaktuan atyre humbje të mëdha në njerëz dhe materiale, ndaj dhe kjo trevë vazhdonte të ishte në dorë të shqiptarëve.³⁴

Kështu, Divizioni 48 i UNÇJ-së, në kuadër të së cilit vepronte dhe Brigada IV Shqiptare, pas luftës dëshpëruese me “fuqitë balliste” në vijën Kërçovë-fshati Qafë, më 8 e 9 tetor 1944, u hodh nga sektori i Kërçovës në sektorin e Strugës, me qëllim të pushtimit të trevës së Strugës dhe me këtë të ndërpret linjën e komunikacionit Tiranë-Ohër. Ndërkohë, garnizoni gjerman në Strugë qe përforcuar me efektiva të reja nga Ohri dhe Shqipëria e vjetër, e pastaj qe drejtuar për veprim përgjatë linjës së komunikacionit Resnjë-Ohër. Pas luftimeve treditëshe, fuqitë e Divizionit 48 nuk arritën të pushtonin as Strugën dhe, më 19 tetor 1944 e ndërprejnë sulmin ndaj saj. Struga vazhdonte të mbetej në dorë të gjermanëve, si dhe të fuqive/balliste me rreth 100 veta të armatosur nën komandën e Murat Labnishti.³⁵

Gjithashtu, edhe në hapësirën midis Gostivarit dhe Shkupit, gjatë tetorit 1944, qenë zhvilluar luftime të rrepta të herëpashershme midis fuqive jugosllave/partizane me fuqitë shqiptare/balliste dhe

³⁴ Masar Kodra, vep. e përmendur..., f. 231; Велика Британија и Македонија, Документи 1942-1945..., dok. nr. 337, f. 372-373; Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 70, f. 179-180.

³⁵ ДАРМ, Скопје, Ф. Бр. 254-ГШМ, К. 54-а, Р. Бр. 134 прилог 32, Relacion...20 gusht-23 tetor 1944, f. 18, 22; Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 30, f. 54-55, nr. 39, f. 71-72; Masar Kodra, vep. e përmendur..., f. 231; Oslobodilački rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Knjiga 2..., f. 355-356.

trupat gjermane. Qëllimi i partizanëve ishte të pushtonin Shkupin dhe territorin në jug dhe perëndim të këtij qyteti.³⁶ Në mbrojtje të trevës së Shkupit që vënë edhe Xhemë Hasani (Gostivari), komandanti i fuqive shqiptare/balliste, me fuqitë e tij. Në fillim të tetorit të vitit 1944, ai me një numër të fuqive balliste, me Shtabin e vendosur në Harijevë (sot: lagja “Gjorçe Petrov”-Shkup) ndodheshin të përqendruara në mbrojtje të rrugës Shkup-Tetovë.³⁷

Qëllimi i këtyre fuqive shqiptare/balliste ishte t’i përzënë nga ky rajon fuqitë jugosllave/partizane dhe të ndërliiden me trupat gjermane në Shkup.³⁸ Mirëpo, në fillim të tetorit 1944, dy brigada jugosllave/partizane do të marshojnë nga mali “Karlijaka” (Karshijaka), drejt pozicioneve të këtyre fuqive shqiptare/balliste.³⁹ Numri i efektivave partizane ishte i madh, vetëm rreth Shtabit qëndronin 800 veta. Operacioni i këtyre fuqive jugosllave/partizane kishte për objektiv që pasi të thyen fuqitë balliste të kalonin lumin Vardar dhe të vepronin në zonat në perëndim të tij, për të ndihmuar kështu fitoren e fuqive jugosllave në operacionet për pushtimin e Trevave Lindore shqiptare. Në mëngjesin e 7 tetorit 1944 fuqitë jugosllave/partizane sulmuan fuqitë shqiptare/balliste me zonë veprimi përgjatë vijës: Govorlevë-Svetapetkë-Barovë-Çiflik (fshatra të Shkupit). Pasi e thyen vijën e frontit, fuqitë jugosllave/partizane depërtuan deri te lumi Treska. Por, trupa gjermane, rreth mesditës, marshuan në drejtim të fshatrave Nerez dhe Matkë të Shkupit dhe në mbrëmje i thyen e i përzunë që andej fuqitë partizane. Në jug të Shkupit, luftime midis fuqive balliste dhe atyre partizane u zhvilluan edhe gjatë 12 tetorit, që përfunduan me humbje të dyanshme në

³⁶ ДАРМ, Скопје, Ф. Бр. 254- ГШМ,, К. 54-а, Р. Бр. 134 Прилог 32, Relacion ...20 gusht-23 tetor 1944, f. 20.

³⁷ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том II, Централна Македонија..., dok. nr. 93, f. 110; Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 32, f. 59.

³⁸ Oslobodilački rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Knjiga 2..., f. 355.

³⁹ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том II, Централна Македонија..., dok. nr. 93, f. 110; Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 32, f. 59.

njerëz e materiale.⁴⁰ Por, operacionet luftarake në hapësirën midis Shkupit dhe Tetovës vazhdonin. Gjatë 17-19 tetor 1944, Divizioni 42 jugosllav/partizan u ndesh me një pjesë të trupave gjermane të Divizionit XI dhe fuqitë shqiptare/balliste dhe, sipas burimeve jugosllave, këtu u thyen fuqitë balliste dhe, partizanët “ia dolën ta kontrollonin dhe ta mbanin në dorë të tyre rrugën Tetovë-Shkup”, si dhe e rrënuan linjën e komunikacionit Shkup-Kaçanik. Njëkohësisht vazhdonin dhe përgatitjet e fuqive partizane për sulm mbi Shkupin.⁴¹ Mirëpo, pas një jave, më 25 dhe 26 tetor 1944, sërish u zhvillua luftë për Malin e Thatë (“Suva Gora”) dhe vijën e komunikacionit Shkup-Tetovë midis fuqive shqiptare/balliste dhe atyre jugosllave/partizane.⁴²

Kështu, deri më 18-19 tetor 1944 të gjitha operacione luftarake të fuqive jugosllave/partizane në të gjitha Trevat Lindore shqiptare, pos disa “sukseseve taktike”, përfunduan kryesisht “me sukses operativ” të armikut. Kurse trupat gjermane pas përforcimeve me efektiva të reja nga Ohri dhe Shqipëria e vjetër, vazhdonin të vepronin përgjatë linjës së komunikacionit Resnjë-Ohër. Gjë që dhe më tej Grupi i armatave gjermane “E” vazhdonte t’i dominojë linjat kryesore të komunikacioni.⁴³ Mbeturinat e fundit të ushtrisë gjermane nga Trevat Lindore shqiptare do të evakuohen në dhjetëditëshin e parë të nëntorit 1944.⁴⁴

⁴⁰ ДАРМ, Скопје, Ф. Бр. 254-ГШМ, К. 54-а, Р. Бр. 134 прилог 32, Relacion ... 20 gusht-23 tetor 1944, f. 9, 20 dhe 24-25.

⁴¹ ДАРМ, Скопје, Ф. Бр. 254-ГШМ, К. 54-а, Р. Бр. 134 прилог 32, Relacion ... 20 gusht-23 tetor 1944, f. 26 dh 31; Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 37, f. 66, nr. 42, f. 76

⁴² Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 39, f. 71-72, nr. 42, f. 76.

⁴³ ДАРМ, Скопје, Ф. Бр. 254-ГШМ, К. 54-а, Р. Бр. 134 прилог 32, Relacion ... 20 gusht-23 tetor 1944, f. 18, 22; Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 30, f. 54-55, nr. 39, f. 71-72; Prof. dr. Masar Kodra, vep. e përmendur..., f. 231; Oslobodilački rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Knjiga 2..., f. 355-356.

⁴⁴ Велика Британија и Македонија, Документи 1942-1945..., dok. nr. 336, f. 366-377; Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III,

Operacionet luftarake përfundimtare për Trevat Lindore shqiptare (nëntor 1944)

Nga fundi i tetorit 1944, fuqitë jugosllave/partizane po përgatiteshin për operacione të përmasave të mëdha. Qe hartuar dhe plani operativ për pushtimin përfundimtar të Trevave Lindore shqiptare.⁴⁵ Sipas planit, kjo detyrë i qe ngarkuar Korpusi XV të UNÇAPJ-së.⁴⁶ Por, dhe popullata shqiptare në Trevat Lindore shqiptare, që nga fundi i tetorit-fillimi i nëntorit 1944, po organizohej dhe mobilizohej për t'iu kundërpërgjigjur mësymjes së fuqive jugosllave/partizane.⁴⁷ Sipas burimeve jugosllave, asokohe formacionet shqiptare/balliste në këto treva numëronin rreth 15 000 veta, nga të cilët: rreth 6 000 ishin sistemuar në rajonin e Kërçovës; rreth 2 000 në rajonin e Gostivarit dhe 5 000 në rajonin e Tetovës etj.⁴⁸

Pushtimi i Resnjës, Ohrit dhe Strugës: Më 20 tetor 1944 Korpusi XV i UNÇAPJ-së mori urdhër të fillon operacionin për “çlirimin” e Pelagonisë dhe të trevave rreth liqeneve të Ohrit dhe të Prespës.⁴⁹ Më 24 tetor 1944, fuqitë partizane shqiptare dhe jugosllave sulmuan kolonën ushtarake gjermane e cila ishte në lëvizje të përhershme në aksin rrugor Qafë Thanë-Strugë. Por, pasi që nga Elbasani arritën trupa shtesë gjermane, në mbrëmjen e asaj dite forcat partizane u tërhoqën në drejtim të fshatrave: Ladorishtë, Frëngovë dhe Zagorçan të Strugës. Pas dy ditësh, më 26 tetor filloi kundërmësymja e trupave gjermane që përfundoi me përzënie e

Западна Македонија..., dok. nr. 64, f. 110, nr. 67, f. 175; Oslobodilački rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Knjiga 2..., f. 357.

⁴⁵ ДАРМ, Скопје, Ф. Бр. 254- ГШМ, К. Бр. 54-а, Nr. 32, 31.X.1944, Raport i Mihajlo Apostollskit....

⁴⁶ Oslobodilački rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Knjiga 2..., f. 357; Историја на Македонскиот народ, Том пети,., f. 336.

⁴⁷ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 30, f. 54; Oslobodilački rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Knjiga 2..., f. 369.

⁴⁸ Историја на Македонскиот народ, Том пети,.,., f. 336.

⁴⁹ Oslobodilački rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Knjiga 2..., f. 364.

partizanëve nga këto fshatra. Me këtë rast, më rëndë e pësoi fshati shqiptar Ladorishtë, ku gjermanët i dogjën shumë shtëpi të këtij fshati, si dhe pushkatuan rreth 100 shqiptarë.

Ndërkohë, në mbrëmjen e 31 tetorit, një kolonë gjermane nga drejtimi i Elbasanit pasi theu forcat partizane midis Qafë Thanës dhe Strugës arriti në qytetin e Strugës. Gjithashtu edhe trupat gjermane që ndodheshin në Resnjë, më 31 tetor 1944 u nisën për në Ohër. Rugës pati një përleshje me fuqitë partizane në Bukovë (ndërmjet Resnjës dhe Ohrit), pas disa përleshjeve gjermanët rreth orës 12:00 të 2 nëntorit 1944 hynë në qytetin e Ohrit dhe, nga aty vazhduan marshin në drejtim të Strugës.

Në sektorin e Strugës vepronin Brigada IV Shqiptare dhe një batalion i Brigadës XV Jugosllave.⁵⁰ Kurse, në hapësirën midis Ohrit e Strugës në fillim të nëntorit (rreth 6 nëntor 1944) ishin përqendruar trupat gjermane të grupit “Stajerer”, të cilat përgatiteshin për tërheqje nëpër Shqipërinë e vjetër. Më 6 nëntor 1944 filloi operacioni i Divizionit 48 partizan për Ohrin. Gjatë këtij operacioni, Brigada IV Shqiptare, e cila ishte në kuadër të Divizionit 48, kishte për detyrë të vërë nën kontroll linjën e komunikacionit Ohër-Strugë dhe të mos lejonte të arrijë nga drejtimi i Strugës asnjë ndihmë për gjermanët.⁵¹ Më 7 nëntor forcat partizane të Divizionit 48 të UNÇ-së dhe APJ-së sulmuan një kolonë ushtarake gjermane përgjatë aksit rrugor Strugë-Ohër dhe po atë ditë (7 nëntor) pushtuan dhe Ohrin, kurse në qytetin e Strugës hynë më 8 nëntor 1944.⁵² Përkatësisht, më 8 nëntor 1944 Brigada IV Shqiptare hyri pa luftë në Strugë. Gjatë luftimeve në trevën e Strugës nga radhët e kësaj brigade 35 veta u vranë dhe 60 të tjerë u plagosën.⁵³ Kështu, fuqitë partizane më 6 nëntor 1944

⁵⁰ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 41, f. 75-76, nr. 43, f. 77-78, nr. 45, f. 80, nr. 51 f. 89.

⁵¹ Ослободилачки rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Knjiga 2..., fq. 366.

⁵² Prof. dr. Masar Kodra, vep. e përmendur..., f. 333; Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 51-fq. 8; Велика Британија и Македонија, Документи 1942-1945..., dok. 336, f. 366.

⁵³ Masar Kodra, vep. e përmendur..., f. 333-340; Ослободилачки rat naroda

pushtuan Resnjën, në 7 nëntor Ohrin dhe më 8 nëntor Strugën.⁵⁴ Kurse, trupat gjermane po tërhiqeshin nga Struga në drejtim të Qafë Thanës dhe Elbasanit, tërheqja e të cilëve po pengohej nga njësitë partizane shqiptare.⁵⁵

Dokumentet historike të kohës, vërtetojnë se pas pushtimit e në vazhdim të nëntorit, Struga mbahej nga fuqitë partizane nën shtetrrethim dhe qe mbyllur “hermetikisht” kufiri shtetëror i paraluftës me Shqipërinë e vjetër. Ashtu që në dhjetëditëshin e tretë të nëntorit të vitit 1944 brigadat partizane po ndërmerrnin nëpër vendbanimet e Strugës fushata me pretekstin e çarmatosjes, por në të vërtetë ato ishin ekspedita ndëshkuese masive ndaj shqiptarëve, të cilat shoqëroheshin me: “spastrime”/likuidime në “mënyrë më energjike”, arrestime, si që thuhej, të ballistëve të dalluar dhe simpatizuesve, por në të vërtetë ato fushata u shtrinë mbi të gjithë popullatën shqiptare pa dallim gjinie e moshe. E pësuan rëndë fshatrat: Frëngovë, Kalishtë, Zagraçan, Radolishtë, Veleshtë, Oktis, Potgorcë, Lubanishtë etj. Mirëpo, edhe tani përballë terrorit çnjerëzor jugosllav, vazhdonte qëndresa e shqiptarëve të Strugës kundër pushtimit jugosllav/partizan. Një nga drejtuesit e saj ishte Murat Labnishti, nën udhëheqjen e të cilit organizoheshin grupe/njësi të armatosura shqiptare dhe tubime mobilizuese nëpër fshatra të Strugë. Në gjysmën e dytë të muajit nëntor 1944, rreth 280 fuqi shqiptare/balliste operonin me zonë veprimi në fshatrat: Lubanishtë, Tërpejcë, Leshan, Cërvenë etj.⁵⁶

Jugosllavije 1941-1945, Knjiga 2..., f. 367.

⁵⁴ Велика Британија и Македонија, Документи 1942-1945..., dok. nr. 336, f. 366; Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 41, f. 75-76, nr. 43, f. 77-78, nr. 49, f. 87, nr. 51, f. 89, nr. 55, f. 95.

⁵⁵ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 51, f. 89, nr. 55, f. 95; Велика Британија и Македонија, Документи 1942-1945..., dok. nr. 336, f. 366.

⁵⁶ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 92, f. 222-223.

Kështu, deri më 8 nëntor 1944 trevat me qytetet: e Dibrës, Strugës, Ohrit dhe Prespës kishin rënë nën pushtimin e fuqive jugosllave/partizane. Kurse nga 10 nëntori 1944 do të vazhdojnë luftimet midis fuqive shqiptare/balliste dhe atyre jugosllave/partizane në sektorët Shkup-Kaçanik dhe Shkup-Tetovë-Kërçovë”.⁵⁷

Pushtimi i Shkupit dhe Tetovës: Pasi që Armata e Kuqe iu afrua Beogradit dhe Nishit, linja e komunikacionit Shkup-Vrajë-Nish për gjermanët e humbi rëndësinë dhe tani për to më e rëndësishme ishte linja Shkup-Kaçanik.⁵⁸ Ndërkaq, largimi i trupave gjermane të grupit “Stajerer” drejt Shqipërisë, iu mundësoi fuqive partizane të shtinë në dorë linjat e komunikacionit Velez-Shkup.⁵⁹ Deri në 10 nëntor linjat e komunikacionit Kumanovë-Shkup ishin në dorë të gjermanëve, por më 10/11 nëntor 1944 trupat gjermane u evakuuan nga Shkupi dhe, më 11 nëntor 1944 Shkupi dhe Kumanova ranë në dorë të njërive jugosllave/partizane dhe të trupave bullgare të Armatës I të konvertuar në partizan.⁶⁰

Përgjithësisht fuqitë partizane në Shkup, që në fillim të tetorit 1944, ishin të ngarkuara me tri detyra kryesore, dhe atë: të pamundësohet evakuimi i gjermanëve në drejtim të Kaçanikut; të likuidohen trupat gjermane në Shkup dhe në vise tjera përreth; të ndahen/veçohen fuqitë shqiptare/balliste nga gjermanët dhe të detyrohen të tërhiqen në Tetovë.⁶¹ Sipas planit detal ushtarak po bëhej përqendrimi i fuqive jugosllave/partizane në trevën e Shkupit. Efektivat e Brigadës 12 të Divizionit 42, më 11 nëntor ishin pozicionuar në Vodno të Poshtme dhe përreth fshatit Krushapek, me detyrë të mbrapsnin ndonjë intervencion eventual të fuqive

⁵⁷ Велика Британија и Македонија, Документи 1942-1945..., dok. nr. 336, f. 366-377; nr. 337, f. 375-376.

⁵⁸ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 32, f. 59.

⁵⁹ Ослободилачки rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Knjiga 2..., f. 367.

⁶⁰ Ослободилачки rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Knjiga 2..., f. 360.

⁶¹ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 32, f. 59; Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том II, Централна Македонија, dok. nr. 93, f. 110.

shqiptare/balliste dhe të mbrojnë hidrocentralin “Matka”. Ndërkaq, trupat gjermane në natën e 13/14 nëntorit 1944 po evakuoheshin nga treva e Shkupit në drejtim të Kaçanikut.⁶² Ndërkohë, Xhemë Hasani, Mefaili Shehu dhe Shabani në natën e 11/12 nëntorit 1944 kishin arritur në trevën e Shkupit, për të ndihmuar në mobilizimin dhe ngjeshjen e radhëve të fuqive balliste në mbrojtje të trevës së Shkupit, përpara rrezikut partizan jugosllav.⁶³

Lufta midis formacioneve jugosllave/partizane të Korpusit të Shkupit (XVI) me trupat gjermane në sektorët: Shkup-Kaçanik dhe Shkup-Tetovë do të vazhdojë nga 11 e deri në 14 nëntor 1944, por me fuqitë shqiptare/balliste ajo do të vazhdoi deri më 19 nëntor. Kështu, më 13 nëntor 1944, Batalioni IV i Brigadës XII partizane vazhdoi operacionin për pushtimin e fshatrave shqiptare të zonës së Shkupit: Nerez i Sipërm, Gërçec, Krushapek dhe Shishovë që shtrihen përreth lumit Treska, dhe ia doli që formacionet balliste t'i shtyn përtej bregut të majtë të lumit Treska.⁶⁴ Veçanërisht luftime të rrepta u zhvilluan te fshati shqiptar Orman, në drejtim të Kaçanikut dhe në vijën: fshatrat Çiflik, Lubin, Gllumovë-manastiri Shën Mëria dhe më tej në drejtim të Tetovës. Formacionet balliste jo vetëm që nuk u thyen, por gjatë 15 dhe 16 nëntor kaluan në kundërmësymje mbi divizionet 42 dhe 50 jugosllave/partizane. Luftime më intensive u zhvilluan veçanërisht rreth hidrocentralit “Matka” dhe fshatit Gllumovë. Fuqitë jugosllave/partizane përballuan këtë kundërsulm dhe pas përgatitjeve, njësitë e Divizionit 50 me mbështetjen e artilerisë dhe armëve tjera të rënda filluan operacionet për Tetovë nga dy drejtime, dhe atë: nëpër luginën e Dervenit (Shkup-Tetovë) dhe nëpër luginën e Vardarit. Kështu, në mëngjesin e 17 nëntorit forcat jugosllave/partizane kaluan lumin Treska dhe filluan kundërsulmin ndaj “fuqive balliste dhe gjermane”.⁶⁵ Pas luftës së rreptë dhe

⁶² Oslobodilački rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Knjiga 2..., f. 369.

⁶³ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 63, f. 116.

⁶⁴ Историја на Македонскиот народ, Том пети,..., f. 333, 335.

⁶⁵ Oslobodilački rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Knjiga 2..., f. 371; Историја на Македонскиот народ, Том пети,..., f. 338.

humbjeve të shumta nga të dyja palët ndërluftuese, në mbrëmje të asaj dite njësitë e Divizionit 50 ia dolën të depërtojnë përtej vijës mbrojtëse shqiptare: Kopanicë, Arnaqi, Semenishtë, Çajlanë. Pas pushtimit të këtyre pozicioneve, njësitë e këtij divizioni ndërmorën sulm drejt fshatit Rashçe, me synim të depërtojnë në luginën e Vardarit dhe të vazhdojnë nëpër fshatin Radushë në drejtim të Tetovës. Forcat jugosllave/partizane po avanconin dhe, deri në mbrëmje të 17 nëntorit ata u pozicionuan për së gjati në vijën: Gramadë, Grupçin, Kopaçindoll, Llërcë. Më 18 nëntor brigadat partizane të pajisura edhe me artileri, vazhduan sulmin në drejtim të Tetovës. Ndërkaq, formacionet shqiptare/balliste pas luftimeve të ashpra gjatë tërë ditës me partizanët të fshati Grupçin, u detyruan të mbrapsen drejt qytetit të Tetovës. Në mëngjesin e 19 nëntorit tri brigada partizane (e 13-ta, e 14-ta dhe e 15-ta) pa luftë hynë në qytetin e Tetovës ngase që evakuuar më parë nga trupat gjermane, kurse Brigada III e Divizionit 42 zuri pozicione të fshatrat Xhepçishtë dhe Poroj të Tetovës.⁶⁶

Pushtimi i Kërçovës dhe Gostivarit: Rrethet e Kërçovës, Gostivarit dhe Tetovës ende rreth 12-13 nëntorit 1944 ishin në dorë të formacioneve balliste, të cilët dhe i kishin zënë pozitat për mbrojtjen e këtyre trevave.⁶⁷ Konsiderohet se fuqitë balliste të cilat ishin vënë në mbrojtje të Kërçovës, Gostivarit dhe Tetovës arrinin në rreth 12 000 veta. Ndërkaq, për pushtimin e Kërçovës, ishin planifikuar njësitë jugosllave/partizane të Korpusit të Manastirit (XV), dhe atë: Divizioni 41 dhe Div. 48 dhe Brigada e 7-të e Divizionit 49. Ndër këto formacione partizane ndodhej dhe Brigada IV Shqiptare (“shiptarska”) partizane. Detyra e këtyre fuqive jugosllave/partizane ishte thyerja dhe eliminimi i fuqive shqiptare/balliste dhe pushtimi i Kërçovës e pas saj dhe i Gostivarit e Tetovës, si dhe krijimi i kushteve për vendosjen e pushtetit jugosllav

⁶⁶ Историја на Македонскиот народ, Том пети,..., f. 339 dhe 350.

⁶⁷ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 63, f. 122, nr. 65, f. 171, nr. 67, f. 175.

në këto treva.⁶⁸ Në këtë kuadër, “Shtabi partizan i Grupit të Kërçovës”, me në krye shefin Vuko Turkoviq dhe komandantin Kosta V. Jashmak, më 12 nëntor 1944, iu urdhëroi fuqive partizane të angazhuara për pushtimin e Kërçovës, që gjatë operacionit të bëjnë, veç tjerash: spastrimin e zonës dhe të vetë qytetit të Kërçovës nga fuqitë shqiptare/balliste; të grumbullonin të gjitha materialet ushtarake, për çka “nëse ishte e nevojshme të përdoret forca”, si dhe; të bënin grumbullimin në kazermat e Kërçovë të të gjithë meshkujve shqiptarë të aftë për armë, ku do të qëndronin nën roje deri në “vërtetimin e përgjegjësisë”. Por, detyra kryesore e partizanëve jugosllavë në këtë operacion ishte të likuidonin sa më shumë efektiva shqiptarë në njerëz, por dhe të bëheshin “zhdukje sa më të mëdha” të gjithë çka hasej në trojet shqiptare.⁶⁹

Asokohe, edhe fuqitë partizane të UNÇ-së dhe AP të Shqipërisë shprehën gatishmëri të marrin pjesë në mënyrë aktive në mësymjen ndaj Kërçovës dhe Gostivarit. Me këtë detyrë që ngarkuar Divizioni IV i Korpusit I të UNÇAPSH-së.⁷⁰ Mirëpo, gjatë ofensivës së fuqive jugosllave/komuniste mbi Kërçovën 12-15 nëntor 1944, nuk iu lejua të merr pjesë këtij divizioni, por ai që urdhëruar të veprojë në drejtim të Gostivarit. Si duket kjo ndodhi nga arsyeja jo vetëm e pozitës strategjike të Kërçovës, por dhe për atë që forcat e këtij divizioni të mos jenë dëshmitarë të terrorit dhe masakrave të partizanëve jugosllavë mbi shqiptarët e trevës së Kërçovës.⁷¹

Luftimet për Kërçovën, për Gostivarin dhe për Tetovën midis fuqive shqiptare/balliste dhe atyre jugosllave/partizane të Korpusit XV u zhvilluan nga 11 e deri më 20 nëntor 1944. Në këto operacione

⁶⁸ Ослободилачки rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Knjiga 2..., f. 370; Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 67, f. 175.

⁶⁹ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 67, f. 174-177.

⁷⁰ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 46, f. 82-83, nr. 51, f. 90, nr. 68-f. 178,

⁷¹ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 68, f. 178.

ishin angazhuar një numër shumë i madh i efektivave partizane. Kështu, sipas vetë burimeve jugosllave, vetëm njësitë e Divizionit 48 nga 11 nëntori e deri në 15 nëntor 1944 numëronin gjithsej rreth 2 100 efektiva, kurse më 16 nëntor ky numër shkoi në 3 326 efektiva, apo gjatë 19-20 nëntor ai numër arriti në 3 529 efektiva.⁷²

Ndërkaq, sipas një Raporti të Shtabit të Divizionit 48, të 12. 11. 1944, kuptojmë se efektivat shqiptare/balliste të përqendruara në mbrojtje të rrethit të Kërçovës ishin nën komandën e Mefail Shehut (Zajazit,) Shazos dhe Shabanit etj., dhe se numri i tyre nuk ishte dhe aq i madh. Në prapavijat e fuqive kryesore shqiptare/balliste dhe në qytetin e Kërçovës kishte efektiva të pakta balliste. Fuqitë shqiptare/balliste në numër më të madh ishin përqendruar në sektorin e Zajazit dhe, çdo shtëpi në fshatin Zajaz ishte e fortifikuar për mbrojtje.⁷³

Operacionet intensive luftarake midis fuqive shqiptare dhe atyre jugosllave/komuniste për Kërçovën dhe Gostivarin do të zgjasin nga 15 deri më 18 nëntor 1944.⁷⁴ Kurse, Divizioni 48 (pa brigadat 4-të dhe 6-të), i cili divizion përbënte grup të veçantë për veprim nën drejtimin e “Shtabit të përkohshëm” të krijuar rishtas, do të zhvillojë në luftën për thyerjen dhe zhdukjen e formacioneve balliste deri në pushtimin e fshatit Zajaz.⁷⁵ Kështu, pasi që deri në mbrëmje të 14 nëntorit 1944 njësitë e divizioneve 41 dhe 48 të Korpusit XV i pushtuan pozicionet fillestare për sulm, më 15 nëntor 1944 ata u ndanë në tri grupe operative dhe filluan sulmin për pushtimin e Kërçovës, nga tri drejtime:

1. Nga veriu, sulmoi Brigada e 11, në drejtim të fshatrave Qafë dhe Prapadisht;

⁷² Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 64, f. 110, 133, 155, 157.

⁷³ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 66, f. 171.

⁷⁴ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 81, f. 203.

⁷⁵ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 64, f. 164.

2. Nga verilindja, sulmoi Brigada e 2-të në drejtim të fshatrave Tuhin dhe Novoselë. Pasi i theu forcat balliste kjo brigadë pushtoi fshatin Tuhin dhe pastaj vazhdoi sulmin drejt fshatrave Jagoll dhe Sërbicë;

3. Nga lindja, sulmoi Brigada e 6-të në drejtim të fshatrave Shutovë, Premkë, Garanë dhe Strellcë dhe, ia doli t'i thyej forcat balliste, me përjashtim në fshatin Garanë ku zhvillohej luftë për çdo shtëpi, dhe ia doli t'i pushtojë këto fshatra.

Si gjithmonë në kontinuitet detyra edhe e këtyre divizioneve partizane jugosllave të përqendruara në këto treva ishte: spastrimi përfundimtar i terrenit nga fuqitë shqiptare/balliste; çarmatosja dhe ndëshkimi e nënshtimi i shqiptarëve.

Më 15 nëntor formacionet partizane/komuniste e pushtuan qytetin e Kërçovës, kurse fuqitë balliste në tërheqje nga Kërçova në drejtim të veriut (Gostivarit) u pozicionuan në fshatin Kolibar (disa km. në veri të Kërçovës) dhe disa njësi nga radhët e tyre shkuan si përforsim në mbrojtje të fshatit Zajaz. Ndërkaq, Brigada IV Shqiptare, ndërkohë bënte ndjekjen e ballistëve në drejtim të fshatrave Reshtan dhe Llagje (Trapçidoll). Luftimet nga fshati Zajaz deri në pushtimin e Gostivarit i zhvillonte Divizioni 48, por tani pa Brigadën I.⁷⁶

Luftime më të rrepta midis fuqive shqiptare/balliste dhe fuqive jugosllave/partizane të Divizionit 41 u zhvilluan në zonën e fshatit Zajaz të Kërçovës.⁷⁷ Por, deri në ora 14:00 të 15 nëntorit 1944, fuqitë komuniste partizane arritën të pushtonin Zajazin dhe pjesën më të madhe të rrethit të Kërçovës. Fuqitë shqiptare/balliste u tërhoqën nga rrethi i Kërçovës në mënyrë të organizuar drejt veriut në malin Bukojç (Bukovik/Parkovik). Aty me përforsimet e reja që erdhën nga Gostivari ata hapën front të ri lufte me zonë veprimi: fsh. Tajmisht-Staroselë-Kolari-kot. 1 278 dhe, në natën e 15/16 nëntorit ndërmorën

⁷⁶ Ослободилачки рат народа Југославије 1941-1945, Књига 2..., fq. 370-371; Prof. dr. Masar Kodra, vep. e përmendur...,f. 234; Историја на Македонскиот народ, Том пети,..., fq. 337; Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 64, f. 110 dhe 164.

⁷⁷ Историја на Македонскиот народ, Том пети,..., fq. 351.

tri sulme të furishme mbi fuqitë jugosllave/partizane. Në 16 nëntor, në ora 6:00, ata mësyn mbi pozitat e pararojave partizane dhe për pasojë i morën disa pozita luftarake të partizanëve. Luftimet vazhdonin edhe gjatë 16 nëntorit në të dy krahët e vijës së frontit të luftës.⁷⁸ Deri në ora 12:30 të 16 nëntorit forcat shqiptare/balliste ia dolën ta rikthejnë një pjesë të territorit të humbur një ditë më parë.⁷⁹ Por, pas 3-4 ditë luftimesh, më 18 nëntor 1944 Kërçova me rrethinë qe pushtuar nga fuqitë jugosllave/partizane. Po më 18 nëntor, formacionet jugosllave/partizane vazhduan marshin nga Kërçova drejt Gostivarit nga tri drejtime, me qëllim që të pushtonin trevën e Gostivarit, të “çarmatosnin” fuqitë shqiptare/balliste, si dhe të ndërlidheshin me njësi të Korpusit 16 që po marshonte nga Shkupi për Tetovë. Luftimet rezultuan me rrethimin e qytetit të Gostivarit, i cili qe pushtuar më 19 nëntor nga forcat e Divizioni 48.⁸⁰

Kështu, më 19 nëntor 1944, të gjitha efektivat e njësive partizane, pos dy brigadave, të Korpusit XV të UNÇAPJ-së, ndërmorën ofensivë energjike kundër fuqive shqiptare/balliste, në drejtimin: Kërçovë-Gostivar-Tetovë, që rezultoi me pushtimin e Gostivarit rreth orës 16:00 të së njëjtës ditë (19 nëntor 1944). Pas pushtimit, qyteti i Gostivarit vazhdonte të mbahej i bllokuar edhe gjatë natës 19-20 nëntor 1944 dhe, njëkohësisht bëhej “çarmatosja masive e shqiptarëve” nënkuptohet ndëshkimi i atyre të cilët i hasën në qytetin e Gostivarit dhe në fshatrat përreth.

Më 20 nëntor 1944, pjesa operative e Shtabit të Korpusit XV, selinë e kishte në Gostivar. Ndërkaq, divizionet e këtij korpusi ishin të dislokuara si vijon: njësitë e Divizionit 41, me Shtabin në Kërçovë, ishin sistemuar në qytetin e Kërçovës dhe në zonën veriore të rrethit të Kërçovës, kurse njësitë e Divizionit 48, me Shtabin në Gostivar, u sistemuan në Gostivar dhe në fshatrat Balindoll dhe Vrapçishti,

⁷⁸ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 75, f. 189-191.

⁷⁹ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 78, f. 195,197.

⁸⁰ Ослободилачки rat naroda Jugoslavije 1941-1945, Knjiga 2..., f. 371; Историја на Македонскиот народ, Том пети..., f. 338.

Divizioni 49 i Korpusit XV vazhdonte të ishte i përqendruar në “frontin kufitar” me Greqinë dhe Shqipërinë, me përjashtim të Brigadës VII të këtij divizioni, e cila pas operacionit Kërçovë-Gostivar u kthye në divizionin e vet, me seli në Dibër. Por, dy batalione të Brigadës VII të Divizioni 49 të Korpusit XV në kthim e sipër për në divizionin e tyre në Dibër, nga 20 nëntori zhvillonin operacionin e spastrimit të terrenit nga formacionet shqiptare, në zonën jugperëndimore të rrethit të Gostivarit, si dhe në rrethin e Radostushës (Rekës së Dibrës) e deri në qytetin e Dibrës. Gjithashtu, edhe njësitë tjera të Korpusit XV, së paku deri në fund të nëntorit 1944, vazhdonin operacionet e tyre edhe në trevat e Gostivarit, Strugës etj., ku dhe herë pas here zhvilloheshin përpjekje të armatosura me fuqi të armatosura shqiptare.⁸¹

Pas pushtimit të Gostivarit u tërhoqën nga aty edhe Xhemë Hasani (Gostivari) dhe Mefail Shehu (Kërçova), komandantët e fuqive shqiptare/balliste, për t’iu prirë dhe më tej deri në vdekje qëndresës kundër pushtimit jugosllav.⁸² Deri në fund të nëntorit 1944, në Trevat Lindore shqiptare u zhvilluan një numër përpjekjesh të armatosura midis fuqive jugosllave/partizane dhe atyre shqiptare/balliste.⁸³ Luftimet në territorin e Divizionit 48 (Gostivarit) përfunduan më 27-28 nëntor 1944, me thyerjen e qëndresës shqiptare dhe, të shoqëruara me ekspedita ndëshkuese të llojeve të ndryshme, nga të cilat ishin dhe ekspedita të “grumbullimit të armëve”, të eliminimit të “ballistëve”/shqiptarëve, të arrestimeve në masë të shqiptarëve në “llogore për të zënë rob” (“pleniçeski llageri”) të brigadave partizane jugosllave, të likuidimeve fizike në masë etj.⁸⁴

⁸¹ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 64, f. 164-165, nr. 92, f. 220-226.

⁸² Prof. dr. Masar Kodra, ver. e përmendur..., f. 234; Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 92, f. 223, 224.

⁸³ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна Македонија..., dok. nr. 93, f. 227, nr. 94, f. 228, nr. 101, f. 237, . nr. 105, f. 243, Историја на Македонскиот народ, Том пети,..., f. 351.

⁸⁴ Ослободување на федерална Македонија, Документи, Том III, Западна

Sipas të dhënave jugosllave, në luftimet për trevat e Kërçovës, Gostivarit dhe Tetovës humbën jetën ose u zunë rob dhe u arrestuan nga armiku gjithsej rreth 13 000 shqiptarë,⁸⁵ kurse rreth 10 000 shqiptarë të trevave të Gostivarit, të Kërçovës, të Tetovës, të Dibrës, të Strugës, si dhe të trevave të Shkupit e Kumanovës (Karadakut), përpara terrorit u tërhoqën dhe në kushte të dimrit u strehuan ndër male dhe nëpër fshatra malore.⁸⁶

Македонија..., dok. nr. 92, f. 223, nr. 96, f. 230.

⁸⁵ Историја на Македонскиот народ, Том пети,..., f. 340.

⁸⁶ Историја на Македонскиот народ, Том пети,..., f. 350.

Sabit SYLA

QËNDRIMI I PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË NDAJ RIPUSHTIMIT TË KOSOVËS

Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, faktori jugosllav goftë ai nacionalist apo komunist e shihte të ardhmen e Kosovës brenda shtetit jugosllav. Platformat ndryshonin në metodë dhe në praktikën e realizimit, ajo e Mihajloviçit kuptohet ishte më ekstreme. Për këto qëllime të përafërta si çetnikët po ashtu edhe partizanët (1944), harmonizuan planet dhe projektet e tyre, kur me forca të përbashkëta iu vërsulen Kosovës me synim e qëllim të vetëm, pastrimin e Kosovës gjoja nga elementi josllav, e duke pastruar atë etnikë shqiptar përmes hakmarrjes kolektive të tipit racial. Shtabi Kryesor i Serbisë, më 2 dhjetor 1944 kishte dhënë urdhër për spastrimin e vendit nga “bandat shqiptare” dhe nga “njësitet e armatosura prej tradhtarëve shqiptarë”. Si pasojë e masave të ndërmarra, Kosova do të shndërrohej në një poligon të vërtetë të masakrave, ekzekutimeve, dhunimeve, e burgosjeve individuale dhe kolektive.

Situata e tillë e krijuar në Kosovë shkaktoi një indinjatë të thellë të popullsisë, ashtu edhe të krerët e prijësit e Drenicës si: Shaban Palluzha, Mehmet Gradica etj.. Për t’i bërë ballë situatës së rëndë të krijuar në vend, në fund të dhjetorit 1944 u formua Brigada

e Drenicës me komandant Shaban Palluzhën, sa që për 15 ditë arriti të ketë afër 3 000 luftëtarë, duke shkaktuar kështu një reagim të rreptë të qarqet politiko-ushtarake të Jugosllavisë. Në janar dhe shkurt të vitit 1945 kundër Drenicës, forcat jugosllave përdorën artileri të rëndë e korpuse të tëra ushtarake, si: Brigada e Parë e Kosovës dhe Metohisë, me Zufer Musiqin në krye; Brigada e Bokelit, e njohur me emrin famëkeq “Bokelska”; Brigada e 6-të malazeze; Brigada e KNOJ-it; Brigada IV dhe Brigada V e Kosovës; brigadat serbe e maqedone, etj. E tërë kjo forcë ushtarake nga e cila ishin të rrethuar shqiptarët, përbëhej nga afro 36 000 ushtarë serbë, malazezë, maqedonë, bullgarë e fatkeqësisht edhe shqiptarë. Ndërkohë, më 8 shkurt 1945, vetëm një ditë pas vendimit të marrë në Konferencën e Jaltës për njohjen e kufijve të Jugosllavisë së paraluftës, Tito do të shpallte dhe urdhëronte vendosjen e Administrimit Ushtarak në Kosovë.

Në vitin 1945, në Kosovë u intensifikua dhuna e terrori, duke përjetuar populli një dimër dhe pranverë të përgjakshme. Në atë vit mijëra veta u pushkatuan, u burgosen dhe u dërguan në kampe, si dhe familje të tjera u izoluan e shumë shqiptarë u shpërngulen për Turqi, siç ndodhi edhe me mijëra shqiptarë që vriten jashtë kufijve të Kosovës.

Partia Komuniste e Shqipërisë jo vetëm që heshti përballë dhunës e terrorit të ushtruar ndaj shqiptarëve në Kosovë, por në disa raste ajo lejoi që dhuna jugosllave të shtrihej edhe në territorin e shtetit shqiptar. Madje, në këto krime kanë marrë pjesë edhe disa agjentë të qeverisë shqiptare, të cilët në fillim të vitit 1945 lejuan oficerët e OZN-së, jugosllave, që të pushkatonin ilegalisht dhe pa gjyq në territorin e shtetit shqiptar më tepër se 1 000 shqiptarë nga Kosova¹. Ky krim e terror i ushtruar në Shqipëri nga OZN-ja jugosllave, në periudhën e pasluftës dëshmohet nga disa deklarata, të

¹ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (më tej: AMPJ), viti 1949, dos. 191 (B/ V-2), f. 43. Të dhëna rreth terrorit serb ndaj shqiptarëve në Kosovë e Shqipëri.

bëra nga ish-nëpunës të lartë të shtetit shqiptar² e në disa relacione të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të vitit 1950 përgatitur nga Drejtoria e Sigurimit të Shtetit³. PKSH nuk bëri asnjë veprim për të ndaluar terrorin në shtetin shqiptar e lëre më për të protestuar dhe vënë në dijeni organizmat ndërkombëtarë dhe opinionin botëror për krimet makabre dhe politikën e egër antishqiptare të udhëheqjes jugosllave. Duket se logjika ideologjike dhe ajo e ruajtjes së pushtetit ishin faktorët përcaktues të asaj politike.

Në Kosovë siç dihet, kanë qenë edhe disa divizione partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë, të cilat për fat të keq, në emër të luftimit të reaksionit, bashkëpunuan e bashkëvepruan me disa njësi të armatosura të UNÇJ-së. Në tetor të vitit 1946, Koçi Xoxe përmes një telegrami kërkonte nga Seksioni i Sigurimit të Shtetit (Kukës), që të dërgonte një relacion për Kosovën⁴. Në raportin i cili iu dërgua ndër të tjera thuhej se: “Me rastin e hyrjes së Ushtrisë Shqiptare dhe Jugosllave, të gjithë ballistët luftuan kundër nesh, duke vazhduar më tej: “Me çlirimin e Kosovës, reaksioni filloi lëvizjen në Drenicë ku afro 12 000 veta u çuan kundër UNÇJ, kryetar i së cilës ishte Shain Sllausha (Shaban Palluzha-S. S), Bislim Bajgora...” etj.. Është për t’u theksuar se në atë raport Azem Bejta paraqitej si spiunë, ndërsa Shaban Palluzha si kryetar i ushtrisë rebele...”⁵. Kjo nënkuptonte me të vërtetë edhe braktisjen e çështjes së Kosovës nga PKSH-ja, që ajo të zgjidhej në kuadër të atyre

² Shih deklaratën e Nesti Kerenxhi - zëvendësministër i Ministrisë së Brendshme, më 28 mars të vitit 1948. Ndreçi Plasari & L. Maltezi, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948*, Përmbledhje dokumentesh, Tiranë: “Gjergj Fishta”, 1996, f. 578.

³ AMPJ, viti 1950, dos. 247, f. 1. Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit (Dega I). Relacion mbi terrorin dhe persekutimet në Kosovë, Tiranë, 19 tetor 1950. Shih relacionin, “Mbi terrorin shqiptar dhe persekutimet në Kosovë”.

⁴ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme (më tej: AMPB), Drejtoria e Zbulimit Politik, dos. 128, viti 1946, f. 55. Telegram nga Koçi Xoxe dërguar Seksionit të Sigurimit të Shtetit-Kukës (Beqir Ndout), Tiranë, tetor 1946.

⁵ Po aty, f. 57-61. Raport mbi Kosovën, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit-Kukës, Kapiteni I, Beqir Ndou, dërguar Koçi Xoxes, 29 nëntor 1946.

premtimeve të bëra gjatë luftës, se “në rast të kundërt do ta luftonte Jugosllavinë”, por në fakt ai mbeti vetëm një slogan shterp.

Në kohën që ndodhnin vrasjet dhe përndjekjet e shqiptarëve të Kosovës, ndërmjet shtetit shqiptar dhe atij jugosllav ishin vendosur marrëdhënie të ngushta dhe miqësore bashkëpunimi. Bedri Pejani pas përfundimit të luftës u arrestua në Shqipëri dhe u ekstradua për Jugosllavi ku u gjykua dhe u dënua e vdiq në spitalin e burgut, më 1946⁶. Mbështetur në radiogramet shkëmbyer ndërmjet zbulimit dhe të ngarkuarit me punën e Zbuluesit në Jugosllavi mbi veprimtarinë e reaksionit në Kosovë, Beqir Ndou i shkruante Koçi Xoxes më 14 korrik 1946, se: “...fytyra ma e njohur politike e reaksionit shqiptarë në Kosmet asht ish-profesori Imer Berisha, i cili rron ilegalisht në krahinat e Drenicës. Elementi i Oznos ju ka futur brenda në njësitin e tij. Shpresohet që të vritet”. Ndërsa më vonë i shkruante: “Në vazhdim të radiogramit t’onë, profesor Imer Berisha u vra...”. Pra, një ndër çështjet e prekura në atë kohë ishte edhe problemi i ndjekjeve dhe arrestimeve të shqiptarëve nga Kosova, për të cilët si dëshmon edhe letra e Rankoviqit, pala shqiptare tregonte vullnetin e duhur për kapjen e tyre.

Në dimrin e vitit 1945 kur në Kosovë vazhdonte lufta për çlirim kombëtar kundër ushtrisë jugosllave, ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë nënshkruheshin edhe traktate si: “Traktati (në fakt projekt, S. S) mbi Aleancën dhe Ndihmën Reciproke midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë”, ndërmjet qeverive të dy vendeve, i nënshkruar më 20 shkurt 1945, nga këta përfaqësues të delegacionit shqiptar: Myslym Peza, Omer Nishani, Medar Shtylla dhe Bedri Spahiu, ndërsa, nga pala jugosllave: Josip B. Tito dhe Josif Smodllaka. Traktati në fakt mbeti një draft sepse ai nuk u ratifikua nga parlamentet e të dy vendeve. Traktati kishte më shumë formën e një aleance ushtarake ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Vetëm ndonjë nen i tij u kushtojë çështjeve civile dhe ekonomike, por në asnjërin prej tyre nuk flitej për Kosovën si entitet i veçantë brenda

⁶ Marenglen Verli, *Nga Kosova për Kosovën (profile bibliografike)*, Tiranë: “Botimpex”, 2006, f. 153.

Federatës Jugosllave, apo për të ardhmen e saj të përbashkët me Shqipërinë. Kosova trajtohej thjesht si minoritet brenda Jugosllavisë. Në nenin VI të këtij traktati thuhej: “Duke mbajtur përpara syve parimin demokratik, të dy palët kontraktojnë se detyrohen t’u sigurojnë minoriteteve nacionale në vendet e tyre mbrojtje dhe respekt të plotë”⁷. Kjo klauzolë trajton thjesht në parim minoritetet e dy vendeve, duke i barazuar ata, ndërkohë që sllavët e Shqipërisë përbënin një pakicë numerike të papërfillshme. Sipas dokumenteve ruse, traktati i lartpërmendur figuron i nënshkruar nga dy qeveritë së paku që më 9 janar 1945. Ai përmendet në takimin e delegacionit jugosllav të kryesuar nga Hebrangu me Stalinin në Moskë. Koha e publikimit, shkurt 1945, u rekomandua nga Stalini⁸, sepse parashikohej të mbaronte Konferenca e Jaltës.

Partia Komuniste e Shqipërisë, heshti ose bëri fare pak për të kundërshtuar edhe vendimet e Partisë Komuniste Jugosllave për të ardhmen e Kosovës. Fillimisht duhet përmendur faktin se, për Kosovën nuk u diskutua fare në Plenumin e KQ të Helmesit në maj të vitit 1944. Në Plenumin e KQ të PKSH-së, mbajtur në Berat nga 23 deri 27 nëntor 1944, çështja e Kosovës nuk u zu fare në gojë. Po ashtu, Kosovën nuk u diskutua zgjidhje e as nuk u fol për të, as në mbledhjen e Dytë të KANÇ (Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar) e as në ditën e 28 nëntorit, kur Qeveria e Enver Hoxhës, hyri në Tiranë dhe mbajti një fjalim të gjatë para masës⁹. Ndërsa, sa i përket vendimeve të ndërmarra në Mbledhjen e Kuvendit Antifashist Nacionalçlirimtar të Serbisë, (Beograd nga 7 deri më 9 prill të vitit 1945 Serbisë)¹⁰, dhe Kuvendit të Prizrenit (me 8, 9 e 10 korrik 1945),

⁷ AMPJ, viti 1945, dos. B/V-2 (nr. rendor 50), f. 2-4. Traktat mbi Aleancën dhe Ndihmën Reciproke midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, Beograd, 20 shkurt 1945.

⁸ Islam Lauka & Eshref Ymeri, *Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse*, Tiranë: “Toena”, 2006. f. 99-101.

⁹ Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, Instituti i Historisë, Prishtinë: 2012, f. 73.

¹⁰ AMPJ, viti 1963, dos. 909 (B/VII-2dh), f. 2. Të dhëna për Mbledhjen e Kuvendit Antifashist Nacionalçlirimtar të Serbisë në Beograd, prill 1945.

i cili aprovoi Rezolutën për aneksimin serb të Kosovës¹¹, Komiteti Qendror i PKSH-së, me në krye Enver Hoxhën heshti. Deri me sot, nuk kemi të dhëna që dëshmojnë të kundërtën. Me këtë rast vlen të përmendim se përveç heshtjes së PKSH-së, as Aleatët e Mëdhenj te të cilët kishin shpresuar shqiptarët, nuk reagueshin ndaj aneksimit të dhunshëm të Kosovës në kuadër të Jugosllavisë Federative.

Pas Administrimit ushtarak në Kosovë, e vendimeve të ndërmarra nga organet qeveritare jugosllave për statusin dhe të ardhmen e Kosovës, Enver Hoxha në mbledhjen e Plenumit IV, të Komitetit Qendror të PKSH-së, mbajtur më 17 tetor 1945, do të shprehej: “Partia e jonë e ka shfaqur pikëpamjen e saj karshi Kosovës. Për Partinë kjo nuk është kritike, por me qenë se e ngre opozita ka rëndësi. Cili qëndrimi ynë para popullit? Po ai i me parshmi. Perspektiva e largët është që Kosova do të lidhet me ne. Kosova është shqiptare këtë e dimë edhe ne edhe Jugosllavia. Në rast se opozita do ta ngre këtë çështje, ne do të na duhet që të mbajmë një qëndrim edhe me shkrim, por gjithmonë ky do të jetë qëndrimi i ynë¹². Një qëndrim i tillë i shprehur nënkuptonte, edhe tërheqje të alternativës për shtrim të çështjes kombëtare për kohën, e çështja të mbetej e hapur nën kontekstin kohor. Andaj, edhe në raportin e mbajtur në Plenumin V të KQ-së së PPSH-së, më 21 shkurt 1946 Enver Hoxha porosiste: “Duhet të luftojmë me mish e me shpirt tendencat shoviniste të atyre shqiptarëve që kërkojnë të ngjallin mërinë e vjetër kundër popujve të Jugosllavisë”¹³.

Në Plenumin e Jashtëzakonshëm të KQ-së së PKSH-së, mbajtur më 18-20 dhjetor 1946, Enver Hoxha do të deklaronte: “Disa anëtarë partie duan të filozofojnë se mos thotë populli se ç’bëtë me Kosovën. Në qoftë se një anëtar i partisë e ka të qartë vijën, ai e ka të

¹¹ *Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës* (më tej: ASHAK), Fondi: Komiteti Krahinor i L. K. të Kosovës, viti 1945, kutia 23/A, dokumenti nr. 2352, f. 1-2. Rezolucion i Asamblesë Krahinore të Kosovës e Metohisë.

¹² *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: AQSh), Fondi: 14, dos. 2, viti 1945, f. 101. Diskutim i Enver Hoxhës në Plenumin IV, tetor 1945.

¹³ N. Plasari, L. Malltezi, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, Raporti i mbajtur nga Enver Hoxha në Plenumin V të KQ-së së PPSH-së, 21 shkurt 1946, f. 27.

qartë edhe çështjen e Kosovës. Jugosllavia demokratike është me e përparuar se ne. Interesi ynë është që ajo të jetë e fortë, se me një Jugosllavi të fortë do të ketë demokraci në Ballkan. A është në interesin tonë të kërkojmë Kosovën, kjo nuk është progresiste. Pra, në këtë situatë, përkundrazi, duhet të bëjmë ç'është e mundur që kosovarët të vëllazërohen me jugosllavët. Asgjë tjetër nuk është aktuale, e nuk është progresiste të kërkojmë Kosovën. Kur ne të kemi arritur në socializëm, që do të thotë kur atje (në Jugosllavi) dhe këtu (në Shqipëri) mbeturinat e kapitalizmit do të kenë ngrënë dru, atëherë, në një situatë të tillë, Kosova do të bashkohet me Republikën Socialiste të Shqipërisë. Kjo është vija, këtë na e mëson marksizmi-leninizmi. Ne këtë do ta shpjegojmë. Ata që nuk e kuptojnë këtë, ne kemi për detyrë t'i luftojmë. Populli i Kosovës i ka të gjitha liritë. Ai ka marrë tokën, kanë shkolla, me jugosllavët jemi miq të mirë, prandaj forca e argumenteve është e madhe”¹⁴.

Udhëheqja shqiptare vetëm pas prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave (1948) do të ndryshonte qëndrimin karshi zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Ripushtimi jugosllav i Kosovës, terrori dhe masakrat e viteve 1944/45/46, ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë dhe vise tjera shqiptare do të bëhen objekt shqyrtimi në një serë relacionesh të ndryshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Jashtme¹⁵, etj. Përveç, relacioneve edhe shtypi shqiptar, kishte shkruajtur për masakrat në masë, ndaj popullit shqiptar¹⁶.

¹⁴ AQSh, Fondi: 14, viti 1946, dos. 4/1, f. 1. Procesverbal i mbledhjes së KQ-së së PKSH-së, 18-20 dhjetor 1946.

¹⁵ AMPJ, viti 1960, dos. 530/2, f. 10. Relacion, Gjendja dhe probleme të popullsisë shqiptare në Jugosllavi, Rako Naço dhe Petro Papi.

¹⁶ “Politika nacional-shoviniste e revizionistëve jugosllavë kundër shqiptarëve të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi”, *Zëri i Popullit*, 9 shtator 1958, nr. 217 (3118), f. 4.

Muhamet SHATRI

**PËRQENDRIMI DHE VEPRIMTARIA ANTISHQIPTARE E
FORCAVE TË ARMATOSURA JUGOSLLAVE NË KOSOVË
NË FILLIM TË VITIT 1945**

Në fillim të vitit 1945 në Kosovë u koncentruan forca të mëdha ushtarake dhe paramilitare jugosllave. Së pari aty vepronin të 8-të brigadat kosovare, bashkë me brigadat 25, 26 dhe 27 të Divizionit 46 serb. Në zbatimin e politikës antishqiptare u mobilizuan, krahas reparteve të rregullta të ushtrisë edhe organet ushtarake të prapavijës.

Formacionet e lartpërmendura ushtruan dhunë dhe terror të paparë në Kosovë dhe në trevat tjera shqiptare. Kështu në trevën e Gjilanit, më fshatin Çarr, më 5 janar 1945, forcat e OZN-së (Oranizaja za zaštitu naroda), arrestuan dhe likuiduan 23 veta. Në Llashticë qëndruan mbi tokë 3-4 ditë kufomat e 12 fshatarëve shqiptarë të vrarë pa kurrfarë procesi gjyqësor. Po nga ky fshat u mbytën edhe 10 veta të tjerë. Masakra të mëdha u bënë edhe në fshatrat: Shipashnicë, Hogosht, Kopërnice, Vruçec, Livoq i Poshtëm, Tërpezë, Koretin, Livoq i Epërm, Rogoçicë, Sfirçë, Tugjec, Zhyjë, Gjurišec, Lisockë, Shahiq, Dazhdincë, Kërstiq, Tërstenë, Topanicë, Konçul, Rekali, Marevc, Kamenicë, Rubofc, Budrikë e Epërme, Lluçan të Preshevës, Miratofc, Vërban, Sllubicë, Tërrnoc, Breznicë, Dobrosin, Kokaj, Dobërçan, Ranatoc, Pogradjë, Përlepnicë,

Busovatë, Malishevë të Gjilanit, Gosponicë, Gajre, Sllatinë, Makresh, Preshec, Stanec etj¹. Po këtë fat patën edhe fshatrat: Sedllar, Desivojcë, Karaçevë, Kranidell, Koretinë etj. Në Lisovicë u vranë 7 vëllezër, të cilëve më parë ua dogjën në zjarr një djalë 6-vjeçar, kurse në fshatin Velegllavë u masakruan 35 veta, ndër të cilët edhe 7 gra dhe 2 fëmijë. Viktima pati edhe në fshatrat Carravajkë dhe Stanec të Karadakut të Preshevës, në Anamoravën e Epërme e sidomos në Pozharan. Ekzekutuesit kryesorë të këtyre krimeve ishin drejtuesit e formacioneve jugosllave, Sima Mileniq, V. Kovaçeviq, Lubo Shotra, që kishin zënë pozita më rëndësi në pushtetin okupues. Ata me ndihmën e Brigadës XVII maqedonase terrorizuan fqinjët shqiptarë që u kujdesën për ta dhe i strehuan gjatë luftës.²

Më 7 janar 1945, ditën e Krishtlindjes Ortodokse, filloi ploja e madhe në oborrin e Xhamisë së Pozharanit, ku i grumbulluan 200-300 fshatarë të pafajshëm. Nga rrahjet me dajak vdiqën 4 veta, kurse 16 të tjerë u mbytën në burgun e Gjilanit*. Masakra e Pozhoranit do të përsëritej edhe në fshatin Komogllavë, po të mos ndërhynte patrioti Ibrahim Grainca, i cili në momentin kritik me një repart të Rojës Partizane, e "bindi" ekspeditën ndëshkuese të Lluka Vlladushiqit që t'i linte të qetë fshatarët e pafajshëm.³

¹ Rustemi, Sabit, *Shënimet e një vullnetari*, (Jetëshkrim i Sylë Kopërnicsës), "Rilindja", Zofingen, 11. XII. 1993.

² *Po aty*.

* Me këtë rast në burgun e Gjilanit pos Shaban Halil Alidemës, plak 70-vjeçar, Misin Xheladin Alidemës 50-vjeçar, Ajet Fejzë Tërziqit 70-vjeçar dhe Ahmet Mustafë Zukës 20-vjeçar, u likuiduan edhe 16 të tjerë. Në këtë grup ishin vëllezërit Osman e Shefik Alidema, Tefik Osman Alidema, i biri i Osmanit, Azem Shyt Alidema, Abaz Sadik Ramiqi, Rifat Bajram Musa, Zenun Shaban Halimi, Rifat Shefki Tërziqi, Bajram Rexhep Tërziqi, Rexhep Sylejman Sylja, Tahir Adem Dragobuzhda, Isak Rexhep Zuka, Rexhep Mahmut Çerkezi. Rexhep Gërbën-Ostrogllavën e therën me thika në oborrin e burgut të Gjilanit, kurse kolonisti Jovan Kovaçeviq, ka pranuar se Latif Hysen Pirën dhe Ali Tafë Ramiqin i kishin futur dhe djegur gjysmë të gjallë në një furrë në Gjilan. U likuiduan edhe vëllezërit Behxhet dhe Januz Alidema, Myrtë Hasan Misini, Ismajl Hysen Kurtishi, Esat Çerkezi etj (Tahir Berisha, "Trojet që nuk shuhen, Shënime nga Vërbani dhe Anamorava", Prishtinë, 1993, f. 139).

³ *Po aty*.

Me urdhrin e Milladin Popoviqit, për të hedhur dritë mbi këto masakra të përbindshme, u formua një komision i posaçëm. Mirëpo, skenaristët e plogës së Pozharanit i kishin marrë të gjitha masat për të fshehur gjurmët e krimit të tyre dhe për të ngarkuar me përgjegjësi pjesëtarët e Brigadës XVII maqedonase dhe ish-kontraçetnikun bullgar, Tozë Drobeshin. Organizatorët kryesorë të masakrës, Ll. Vlladushiq dhe V. Kovaçeviq jo vetëm që nuk pësuan asgjë, por ata nëpërmjet vendimeve gjyqësore, të vrarët i shpallën si "armiq të popullit" dhe u konfiskuan edhe pasurinë e patundshme. Kjo praktikë u aplikua në shumicën e rasteve dhe ndaj të masakruarve të tjerë në Kosovë dhe në trevat e tjera. Ndërkaq, autorët e këtyre masakrave, me angazhimin e Spasoje Gjakoviqit, u shpërblyen me dekorata, grada e funksionet më të larta.⁴

Terrorit e gjenocidit iu nënshtruan edhe trevat e tjera të Kosovës, si: Skenderaj, Klina e Epërme, Vushtrria, Mitrovica, Podujeva etj. Në Drenicë u likuiduan edhe imami i Istogut, haxhi Jahja Daci, pastaj Tush Selmani, luftëtar i njohur nga fshati Izbicë, Ahmet Nuhi nga fshati Shushicë e Istogut, Alush Xani nxënës 16-vjeçar, Rexhep Vojvoda, Sadik Zeneli, ish-deputeti Halil Haxhija, Qamil Hoxha i deleguar i Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste të Jugosllavisë për organizimin e Lëvizjes Antifashiste në këto anë si dhe shumë të tjerë.⁵

Po kjo gjendje mbizotëronte edhe në rrethinën e Kaçanikut dhe në Karadak, ku vepronte Divizioni 42 serb. Kështu, nga raporti i Melihate Dedës, dërguar Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste të Jugosllavisë (KK-së së PKJ-së) për Kosovën, mësojmë se kur komisari politik i Brigadës XII të këtij divizioni i kërkoi komandantit

⁴ Misin Xheladinit, një vit pas likuidimit, i konfiskuan mulliri dhe 7 ha tokë të punëshme. Të shoqes, 3 djemve dhe 5 vajzave, pra 10 anëtarëve të familjes, nuk iu la asnjë mjet për ekzistencë. Po kështu pësuan edhe familjet e të masakruarve të tjerë, të shpallur "armiq të popullit", vetëm në bazë të faktit se ishin likuiduar më parë nga repartet ndëshkimore të OZN-së (Po aty).

⁵ Kujtime të Rexhep (Bajram) Sejdijajt nga fshati Lubozhdë e komunës së Istogut, shënuar nga autori më 11. XII. 1983.

që të ndaleshin masakrat ndaj popullit të pafajshëm, ndërsa ky i fundit iu përgjigj se në sektorin e tij kishte urdhër për të vrarë 50% të shqiptarëve. Madje, Radule Ragjenoviq, delegat politik në brigadë, theksonte se vetë komandanti i tij kishte vrarë shqiptarë. Pushkatime në masë u bënë edhe në fshatrat e Karadakut të Kumanovës, ndonëse fshatarët i kishin pritur mirë partizanët dhe kishin dalë për t'i përshëndetur. Në fshatin Izvor partizanët hynin shtëpi më shtëpi dhe zgjidhnin vajzat më të bukura. Plaçkitje pati edhe në Drenogllavë, kurse në Shtërpcë edhe popullsia serbe u bind se partizanët nuk ishin ashtu siç ua kishin paraqitur veprimtarët e Lëvizjes.⁶

Në ditët e para të janarit të vitit 1945 forcat ushtarake dhe ato të OZN-së, pasi e arrestuan Gani Kryeziun, duke u thënë se do t'i dërgonin në Pejë, i nxorën nga kulla e Sylejman Kryeziut 22 luftëtarë të Ganiut dhe 4 ithtarë të tij. Në rrugë e sipër, në fshatin Hereç të Deçanit i zbritën nga kamioni dhe i mbytën që të gjithë. Dëshmitarët Malë Shyti nga Berisha dhe Zenel Ademi nga Gashi, që patën fatin të shpëtojnë, kanë lënë dëshmi rrëqethëse për këtë ngjarje tragjike.⁷

Masakra e Hereçit akuzon në mënyrë të veçantë udhëheqjen e Partisë Komuniste Shqiptare, e cila, të paktën formalisht, meqenëse pjesa më e madhe e 24 të të masakruarve pa gjyq ishin jo vetëm bashkëkombës, por edhe shtetas shqiptarë (nga fshatrat e ndryshme të Tropojës) dhe s'duhej të heshte apo të pajtohej, po sipas rregullave ndërkombëtare, të protestonte, gjë që s'mund ta bënte, sepse ishte bashkautore e krimit. Pala jugosllave u tregua më e "interesuar për nënshtetasit e vet", sepse nuk lejoi që Enver Hoxha të zbatonte vendimin për vrasjen e Kryezinjve, sepse ishin shtetas të Jugosllavisë, ndërkohë që edhe Bedri Pejanin, Selman Rizën e shumë të tjerë, Josip Broz Tito i tërhoqi në Jugosllavi për t'i gjykuar, për t'i vrarë e burgosur atje.⁸

⁶ Fehmi Rexhepi, *Infiltrimi shovinist*, "Bota e re", Prishtinë, 15 shtator 1990, f. 12.

⁷ Uran Butka, *Ringjallja*, "Rilindja", Prishtinë, 1997, f. 111 dhe 112.

⁸ *Po aty*.

Arrestime, vrasje dhe tortura u bënë edhe në Podgur. Në fshatin Arbanë (Orrobërdë) afër Banjës së Pejës, vend ky i njohur në të kaluarën për veprimtarinë e çetave kryengritëse, u ekzekutuan Metë Ejupi, Zenun Feka etj. Më keq e pësoi fshati Fierzë (Novosellë) e Pejës në të cilin, më 6 janar 1945, nga repartet e Brigadës IV kosovare u vranë 22 veta. *Shtabi i Brigadës të gjithë të ekzekutuarit, që në fakt ishin fare të paorganizuar, i raportonte si 22 ballistë të rrezikshëm.*⁶

⁶ Me urdhrin e Ilija Gjukiqit dhe Tomë Zhariqit, komandant, respektivisht komisar politik, repartet e Brigadës IV Kosovare rrethuan fshatin Novosellë të Pejës dhe kërkuan dorëzimin e 16 personave, që i kishin shpallur "armiq të popullit" dhe donin t'i pushkatonin, por ata ishin arratisur. Ndërkohë, në lagjen e Podrimçakëve ku supozohej se ishte strehuar Bajram Ramë Smakaj, i njohur si kundërshtar i pushtuesve jugosllavë, u grumbulluan repartet e kësaj brigade dhe kërkuan dorëzimin e tij. Kryefamiljari, Zenel Podrimçaku, nuk pranoi të largohej nga shtëpia e as t'i dorëzonte mysafirët e rastit, ndonëse Bajrami nuk ndodhej aty. Prandaj, në mbrojtje të vatrës dhe të nderit familjar u vranë plaku Mehmet Haxhi Podrimçaku dhe djali i të vëllait, Jahjai. Përmes vështirësive, Zeneli arriti ta nxirrte familjen nga rrethimi, por te shkolla e fshatit repartet e brigadës arritën të kapnin djalin 13-vjeçar të Jahjasë, Idrizin, dhe e pushkatuan para syve të nënës. Ndërkohë, në oborrin e shkollës së Novosellës u pushkatuan para familjeve dhe të bashkëfshatarëve edhe 19 veta, që u gjetën nëpër shtëpitë e tyre bashkë me mysafirët. Nuk u kursye as Shaban Rama, i cili ishte kthyer nga kampi i përqendrimit nazist, ku kishte lënë 4 vjet të rinisë së tij. Nuk u dëgjuan as kërkesat e nënës për të falur djalin e vogël Tahirin, që atë ditë duhej të nisej për në ushtrinë partizane. Fshati u plaçkit me bagëti e pasuri dhe në fund u dogjën edhe lamat e sanës e disa shtëpi së bashku me qentë e lidhur. Edhe Avdyl (Xhemë) Ramës që i kishte ftuar repartet e kësaj brigade në fshatin e tij, si "shpërblim", i vranë babën dhe tre djemtë e axhës. Ndërkohë, ai i veshur me uniformë partizane, me shami të kuqe rreth qafës e me pushkë në krah, jo vetëm që nuk ndërmori asgjë për shpëtimin e tyre, por vazhdonte të bënte roje. Plaçkat e grabitura I. Gjukiqi e T. Zhariqi ua dërguan si peshqesh dhe sihariq serbëve të fshatrave fqinje Brestovikë dhe Cigë, të cilët e kishin cytur brigadën e lartpërmendur për masakrimin e fqinjëve shqiptarë. Duke mos u kënaqur me kaq, kolonistët fqinjë Radomir Nikoliq dhe Pavle Bërkoviq, me ndihmën e reparteve të OZN-së, likuiduan edhe Rexhep Hajdinin e Niman Bajramin nga Novosella e Adem Ramën nga Dubova e Vogël. Në vjeshtën e atij viti fatkob për Novosellën dhe mbarë popullin shqiptar, gjatë kalimit për në Greqi u vranë edhe këta novosellas: Zenel Mehmeti, Binak Haxhia, Imer Sokoli dhe Lash Musa, kurse Ismail Jahja Muriqi u likuidua nga repartet e

Masakrat e reparteve jugosllave u shtrinë edhe në Istog, ku njësi të tëra çetnike ishin futur në radhët e Brigadës VIII kosovare, si roje partizane dhe në repartet e OZN-së (Organizacija za zaštitu naroda - Organizata për Mbrotjtjen e Popullit). Nga të gjithë këta çetnikë ishte arrestuar dhe likuiduar, pas ndërhyrjes energjike të Alush Gashit, shefi i OZN-së në Pejë, vetëm komandanti i tyre Radisav-Rale Vuliq si dhe Staleta Kërstiq, djali i vojvodës famëkeq Miliq Kërstiq, si dhe Tomislav (Tomo) Tërziq nga Llukavci i Begut. Përndryshe, organet e pushtetit në Istog tentuan ta shpëtonin R. Vuliqin, duke insistuar që ai të dërgohej në Beograd për t'u "dënuar".⁷

Nga shqiptarët, ndër të parët u pushkatua Col Sokol Bajraktari nga Uça dhe Fekë Jahaj nga Shushica, Bajram (Ramë) Grabovci nga Staradrani. Pas tyre u ekzekutuan Fazli Sylja, Feriz dhe Idriz Ahmeti nga Syneja, Adem Gashi nga Surigana (Suhogërlla), Bajram (Ramë) Zeqiraj nga Uça, Bajram Rexhepi nga Dushkaja, Sylë dhe Brahim Ahmeti nga Shushica e disa të tjerë.⁸

Në fshatin Cërrcë, repartet e Brigadës VIII kosovare arrestuan Ukë Rugovën, sepse kërkoi t'i lironin të atin Rrustën, të arrestuar nga po kjo brigadë, të akuzuar si pjesëmarrës në luftimet e zhvilluara kundër forcave të Korparmatës II të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë (UNÇJ), që po depërtonin në tokën shqiptare. Të dy, atë e bir, i pushkatuan brenda dy tri netësh të dekadës së dytë të janarit 1945, ashtu siç ndodhi edhe me Rrustem (Nimon) Kadajn e Hazir Januzajn nga Lubozhda, Idriz Lipajn nga Kamenica etj. Ndërkohë, Kadri (Keqë) Bajraj nga Istogu i Poshtëm u vra nga repartet e OZN-së në bjeshkën e Bajshës mbi Istog. Nga fshati Tomoc u ekzekutua Ali (Xhemë) Shatri dhe Nezir (Rexhë) Mulaj, ndërsa nga Kovraga Zhujë (Halit) Gjoci dhe Zenun Blakaj. Në Kullën e Popit në Istog u

OZN-së në bjeshkët e Rugovës (*Vojna Enciklopedija*, 4, Beograd, 1978, f. 1047; *Kujtimet e Haxhi Camajt* nga fshati Novosellë e Pejës, shënuar nga autori, më 12. II. 1993).

⁷ Rrustem Rugova-Daut Blakaj, *Tri varre të përbashkëta në Istog (10)*, "Rilindja", Zofingen, 9. I. 1996, f. 13

⁸ *Po aty*.

pushkatuan plaka Fanë Elezja Ahmetgjekaj nga fshati Rudicë (e vetmja femër ndër të ekzekutuarit), pastaj Pjetër Jaku nga Ranoci, Llesh (Gjon) Lleshi nga Zllakuçani, Ukë Zeneli nga Gjurgjeviku, Rexhep dhe Sadri Hoti nga Resniku, Azem Koka nga Shtupeli, me të birin Ibrahimin, Qazim Bojaj nga Kërrnica e Klinës etj. I vetmi njeri që ka ikur dhe ka shpëtuar gjallë nga Kulla e Popit është Shaban (Ukë) Hajdaj i Lubovës, fshat afër Banjës së Pejës, që arriti të arratisesh në Shqipëri, kurse i vëllai, Ademi, që ishte në një dhomë me të, u likuidua. Kufomat e të të ekzekutuarve u gjetën në Llugë të Xhamisë, buzë lumit Istog, në drejtim të fshatit Muzhevinë, në malin mbi Kishë të Gojroçit, te Zabeli i Sadikrexhëve, në grykën e përroit malor të Bollovanit përmbi Istog etj.⁹

Këto të dhëna konfirmohen edhe nga raportet e reparteve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë (UNÇSH), që u kthyen në këto anë pas largimit nga Sanxhaku, ku thuhet se "repartet serbo-malazeze pa asnjë kriter kanë vrarë njerëz. Vrasjet dhe pushkatimet janë kryer aq mizorisht, sa janë marrë fëmijë të vegjël dhe pa menduar fare, janë vrarë dhe janë lënë mbi tokë të pavarrosur". Nga ana e tij, Shtabi i Brigadës III të UNÇSH-së, theksonte se "në disa vende kufomat ishin lënë jashtë toke. Në Istog kemi gjetur 7 të vrarë, kufomat e të cilëve po i hanin qentë".¹⁰

Derisa ndodhnin këto, kryetari i Këshillit Nacionalçlirimtar (KNÇ) të Kosovës i zgjedhur në Bujan, Mehmet Hoxha, u zu keqas me Shtabin e Brigadës III të UNÇSH-së në Pejë, sepse kishte lejuar familjet për të varrosur 30 të masakruarit shqiptarë në atë qytet.¹¹

Plaçkitjet, dhuna e gjenocidi përfshiu edhe Plavën e Gucinë, si dhe trevat e tjera shqiptare në Mal të Zi, ku u dallua sidomos Brigada I e Bokës dhe ajo VI malazeze. Kundër kësaj veprimtarie të shëmtuar kishte protestuar pranë Misionit Ushtarak jugosllav edhe Tuk Jakova, i cili, sekretarit të këtij misioni, Nijaz Dizdareviqit, i pohonte se

⁹ Rustem Rugova-Daut Blakaj, *Tri varre...*, "Rilindaj", 22. XII. 1995, f. 14.

¹⁰ Lefter Nasi, *Masakrat-pjesë e strategjisë serbo-malazeze për zhdukjen fizike të rinisë shqiptare në Jugosllavi*, "Qëndresa", 1, Malmö, Suedi, 1993, f. 38.

¹¹ Myftar Memia, Kujtime, shënuar nga autori më 27. XI. 1994 në Tiranë.

”shokët tuaj malazezë tregojnë urrejtje ndaj shqiptarëve” dhe si pasojë ”urrejtja kundër Jugosllavisë është përhapur te gati tërë populli shqiptar në Mal të Zi”.¹²

Shqiptarët e këtyre trevave u shpallën ballistë e bashkëpunëtorë të okupatorit. Kundër tyre u ndërmorën ekspedita shfarosëse nga Tivari e deri në Ulqin, Plavë e Guci, Rozhajë e Pazar të Ri. Në shënjestër të OZN-së dhe të ekspeditave antishqiptare u vunë veprimtarët dhe pjesëtarët e familjeve të njohura shqiptare, të cilët u likuiduan në mënyrat më mizore.¹³ Në luftimet me repartet malazeze u vranë vëllezërit Mark e Shpend Vocërr Shala, Dedë, Nikë e Gjergj Vokli, si dhe Kolë Nikçi, Gjekotë V. Nikçi, Musë S. Hysaj, Mehmet R. Hysaj, Hasan Dani (Ulqin) e shumë të tjerë. Shpesh për të arrestuar të rrethuarit, repartet ushtarake dhe njësitë e OZN-së shfrytëzonin si pengje të afërmit ose fëmijët e viktimave. Në këto kushte detyroheshin të rrethuarit të vrisnin veten, siç bëri Shemsi Feri në Koplik, ose të dorëzoheshin, por edhe në këto raste nuk i shpëtonin ndëshkimit.¹⁴

Edhe në trevën e Ulqinit dhe të Anamalit u likuiduan shumë patriotë si Hodo beg Ulqini, dom Nikollë Tusha, Rufat Alibegaj, Hafiz Llunji, Zyhdi Fici, Rafo Gorana, Cafë Canka, Hodo beg Bushati me të birin, Ahmetin, etj. Ndërkaq, Gjon Zef Ivanaj, Tahir Nikeziqi, Cufë Brahushi, Musa Llolla, Tahir Çapriqi, Dedë Gjon

¹² Nijaz Dizdarević, *Albanski dnevnik*, Sarajevo, 1988, f. 146

¹³ U masakruan Sadik B. Balidemaj nga Martinajt si dhe 17 të tjerë, që u likuiduan në Grykën e Deçanit. Disa prej tyre ishin nga Hoti i Plavës, të familjes Haxhaj, nipa të Alush Smajlit, njërit prej udhëheqësve në betejën e njohur të Nokshiqit më 1878: Ali Caku, Shpend Rexhë Backu, Gjero Medi, Mehmet Medi, Shaqo Rexha, Nimon dhe Haxhi Curri, si dhe Rexhep e Halit Tishuku nga Isniqi i Deçanit. Krahës tyre u likuiduan edhe Pulec H. Ahmetaj, Nimon Ukë Hakaj, Azem Mulaj, Jusuf, Rexhë dhe Isa Medunaj, Hasan Hoti, Rrustem Cecunaj, Shaban, Halil dhe Malë Rexhepagaj, Ali Agaj, Man Z. Qosaj, Ibrahim Baca, Sali Jahë Musaj, Halil Markishi, Imer Hasanxhekaj, Jup Bashaj, Rashit Kendaj, Ramë Lluka, Ahmet Kuçi, Ramë Rexhë Mazi, Sahit Shahmani, Lac Maliq Sefa, Shaban Ibish Rugova etj. (Rexhep Dedushaj, *Krahina e Plavë e Gucisë nëpër shekuj*, New York, nëntor 1993, f. 286.

¹⁴ Po aty.

Nika u ndëshkuan me burgim shumëvjeçar, kurse Cafo beg Ulqini, kryetar i forcave patriotike të kësaj treve, arriti të qëndrojë 9 vite ilegal dhe më 1953 kaloi në Shqipëri, ku nga pushteti i atjeshëm u dënua me 7 vjet burgim.¹⁵

Për të realizuar më me efikasitet likuidimin e “bandave” dhe “ballistëve” shqiptarë, repartet ushtarake jugosllave krijuan një rrjet të gjerë spiunazhi. Të besuarit e regjimit evidentonin njerëzit “që posedonin armë”, caktonin llojet dhe numrin e tyre dhe përpilonin listat e “ballistëve”, që duheshin eliminuar. Të gjithë këta arrestoheshin, kryesisht natën, dërgoheshin në kampe përqendrimi ose në burgje, por shpesh pushkatoheshin sapo nxirreshin nga shtëpitë. Kundër banorëve, që u detyruan të braktisnin shtëpitë e të fshiheshin pyjeve, pasonin urdhrat për t’u konfiskuar kafshët dhe pasurinë, me pretekstin se ishin marrë me kriminalitet.¹⁶

Dhunën e ushtuar mbi shqiptarët në këto treva ishin detyruar ta pranonin edhe njësitë jugosllave e shtabet e tyre, por duke u kujdesur t’i paraqesin vetëm si veprime spontane ose individuale. Në urdhëresën e Shtabit Operativ (SHO) të Kosovës, datë 10 janar 1945, pohohej se “ka ndodhur në shumë raste që ushtarakët, si dhe rojet partizane, gjatë kontrollimit dhe mosmarrëveshjeve me popullsinë të rrahin disa individë, kështu që kanë ngjallur pakënaqësinë e fshatrave të tëra. Në këtë situatë ushtria jonë barazohet me xhandarmërinë e ish-Jugosllavisë”.¹⁷

Në një raport të Shtabit të Divizionit 46 serb, dërguar më 15 janar Shtabi Kryesor (SHK) të UNÇ-së të Serbisë, përmendej rrahja, torturimi dhe keqtrajtimi i fshatarëve shqiptarë, madje edhe vrasja e njërit prej tyre nga vetë kryeshefi i Shtabit të Brigadës XXVI, togerit Stoshijq, vetëm pse kishte pranuar se kishte 3 pushkë të fshehura.¹⁸

¹⁵ *Kush ishte Cafo beg Ulqini*, “Rilindja”, Zofingen, 15. VIII. 1995, f. 12.

¹⁶ Muhamet Pirraku, *Revoltë, kryengritje apo kundërrevolucion*, “Bota e re”, Prishtinë, 15 shtator 1990, f. 7.

¹⁷ Xhafer Shatri, *Vështrim mbi politikën serbomadhe në Kosovë*, Gjenevë (pa vit botimi), f. 92.

¹⁸ *Po aty*.

Në ndonjë rast pohohej se këto veprime u shoqëruan me grabitjen e të hollave, stolive dhe të gjërave të tjera me vlerë, ndërsa për ndërmarrjen e këtyre veprimeve mjaftonin dëshmitë e paraqitura nga elementët serbë, malazezë e maqedonas.¹⁹

Sipas Ditarit të Operacioneve, datë 7 janar 1945, rastet më drastike kanë qenë ato kur ushtarët dhe eprorët serbo-malazezë, duke bërë gara se kush ishte shenjëtar më i mirë, i vinin në thumb pushke dhe i vrisnin fshatarët shqiptarë nëpër ara ose në rrugë”.²⁰

Në zbatimin e politikës antishqiptare u mobilizuan, krahas reparteve të rregullta të ushtrisë edhe organet ushtarake të prapavijës, komandat ushtarake të qarqeve dhe komandat e vendit. Në atë kohë Kosova u nda në pesë zona ushtarake me qendrën në Prishtinë, Prizren, Pejë, Ferizaj dhe në Mitrovicë. Brenda këtyre zonave u formuan edhe komandat e vendeve. Në Zonën Ushtarake të Prishtinës, komandat e vendit u vendosën në Prishtinë, Lipjan, Janjevë dhe në Podujevë. Në Zonën Ushtarake të Pejës u formuan shtatë komanda më seli në Pejë, Baran, Istog, Gjakovë, Junik, Deçan dhe në Ponoshec. Në zonën e Prizrenit kishte katër komanda, në Prizren, Dragash

Therandë dhe në Rahovec, ndërsa në zonën e Ferizajt tri komandat e vendit i kishin selitë në Ferizaj, Gjiilan dhe në Kaçanik. Në Zonën e Mitrovicës gjithashtu u formuan tri komanda vendi me qendër në Mitrovicë, Vushtrri dhe në Skenderaj.²¹

Në këtë mënyrë në Kosovë u formuan gjithsej 21 komanda vendi, pranë të cilave ishin përqendruar reparte të përhershme ushtarake, përveç atyre reparteve të mëdha që operonin herë pas herë në mbarë territorin. Sipas udhëzimeve të SHO-së të Kosovës, komandat e vendit dhe komandat e qytetit ishin organet më të larta ushtarake dhe të gjithë përgjegjësit e zyrave të shtabeve kishin për

¹⁹ Arkivi i Institutit të Historisë Ushtarake-Beograd (më tej: *AIHU*), k. 1341, 4-1/1, Raport i Shtabit të Divizionit të 46-të, dt. 15. I. 1945, dërguar Shtabit Kryesor të Serbisë.

²⁰ *AIHU*, k. 1411, 14-9.

²¹ Lefter Nasi, *Ripushtimi i Kosovës (shtator 1944-shtator 1945)*, Tiranë, 1994, f. 164.

detyrë të ndihmonin komandat e vendit dhe të qytetit në kryerjen e detyrave të tyre. Krahës kësaj, në fillim të vitit 1945, në Kosovë u formua Krahina Ushtarake, e cila koordinonte dhe udhëhiqte punën e të gjitha institucioneve ushtarake të prapavijës.²²

Për të shuar qëndresën në Drenicë u angazhuan forca të mëdha jugosllave, të cilat përbëheshin nga 3 divizione dhe një brigadë e veçantë: Divizioni 46 serb, Divizioni 52 i Kosovës, Grupi Operativ i Brigadave dhe Brigada e Korpusit të Mbrojtjes Popullore të Jugosllavisë. Veç këtyre, kohë pas kohe në këto luftime u angazhuan edhe Divizioni 24 dhe Divizioni 29 serb, Divizioni i 41 dhe 50 maqedonas. Këto forca numëronin mbi 42 000 veta. Rol të veçantë kishte Brigada e Korpusit Mbrojtës Partizan të Jugosllavisë (KMPJ), që u formua më 26 janar 1945, me një efektiv me 1 600 luftëtarë, të zgjedhur posaçërisht dhe të njohur për qëndrimet e tyre antishqiptare.²³ Kjo brigadë i nënshtrohej vetëm të besueshmit të Mbrojtjes Popullore, përkatësisht Spasoje Gjakoviqit. Ditën e formimit, më 26 janar 1945, kjo Brigadë e dërgoi Batalionin I dhe II, ndërsa të nesërmen edhe Batalionin III, në Mitrovicë, në luftime kundër forcave të Adem Vocës. Pastaj, forcat e kësaj brigade u dërguan në Drenicë në luftimet kundër forcave të Shaban Polluzhës.²⁴

Sulmi i përgjithshëm kundër forcave të Shaban Polluzhës (rreth 4 000 veta) do të bëhej në mëngjesin e 24 janarit, kurse si sinjal do të shërbente e shtëna me top.²⁵ Për këtë qëllim, reparte të Divizionit 46 dhe të Brigadës V kosovare, natën e 23/24 janarit, bllokuan fushën e Podujevës dhe morën masa për asgjësimin e forcave të Sh. Polluzhës. Brigada XXVI serbe i sulmoi kryengritësit prapa shpine, më 25 janar 1945.²⁶

²² Zbornik podataka i dokumenata o narodnooslobodilačkom ratu naroda Jugoslavije (më tej Zbornik I, knj. 19), d. 247, f. 712.

²³ AIHU, k. 1411, 6-1/1; Kujtimet e Ahmet (Ismail) Gjocit nga fshati Kovragë, shënuar nga autori, më 27. I. 1986.

²⁴ Po aty.

²⁵ Muhamet Pirraku, *Ripushtimi jugosllav i Kosovës 1945*, Prishtinë, 1993, f. 67

²⁶ IHU, k. 1411, 1-243/5.

Nga fundi i janarit të vitit 1945, me urdhër të Shtabin Suprem të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë (SHS i UNÇJ), erdhi nga Mali i Zi në Kosovë Brigada I e Bokës, ndërsa nga Sanxhaku Brigada VI malazeze. Më 1 shkurt 1945, prej këtyre brigadave, si dhe prej Brigadës III dhe V të Kosovës u formua Grupi Operativ i Brigadave.²⁷

Repartet e dy brigadave malazeze u vendosën në Pejë, në Istog dhe në rajonin midis Rakoshit, Uçës e Suhogërlës, duke mbyllur kështu rrugën e kalimit në drejtim të Kolashinit. Tri ditë më vonë, më 5 shkurt 1945, SHO i Kosovës urdhëroi që në rajonin e Drenicës të ndërmerrej një operacion i ri kundër forcave të komanduara nga Shaban Polluzha, të cilat synonin të çanin rrethimin nga Rogozna në Kopaonik, ose në drejtim të Istogut dhe të Gjakovës. Për kryerjen e operacionit u ngarkuan edhe repartet e tjera që gjendeshin në Kosovë, Divizioni 24 dhe Divizioni 46, Brigada I, IV dhe V kosovare. Në gjysmën e parë të shkurtit 1945 në Kosovë u përqendruan edhe repartet e Divizionit 29 jugosllav.²⁸

Më 7 shkurt 1945 në mbledhjen konsultative me grupin e udhëheqësve ushtarakë dhe politikë që do të dërgohej në Kosovë, ku ishin të pranishëm Eduard Kardeli, Aleksandar Rankoviqi dhe gjenerali Velimir Tërziq, J. B. Tito konstatonte se gjendja atje ishte brengosëse. Ai kishte parasysh edhe implikimet nga kryengritja e mundshme shqiptare, rëndësinë gjeostrategjike të Kosovës, si edhe statusin e saj ende të papërcaktuar përfundimisht. J. B. Tito e frynte së tepërmi numrin e pjesëtarëve të qëndresës shqiptare, duke theksuar se në Kosovë kishte 20 000 të tillë, të cilët kishin përkrahjen e pa rezervë të popullit shqiptar. Ai konsideronte se ekzistonin dy grupe të mëdha kryengritësish, në njërin prej të cilëve gjendeshin oficerët gjermanë, kurse në tjetrin ata anglezë! Madje, sipas tij, qarqet perëndimore ishin të interesuara që Kosova të mbetej vatër e krizës dhe së këndejmi detonator për destabilizimin e Jugosllavisë.²⁹

²⁷ AIHU, k. 1411, 10-1/4; k. 225, 7-1/3, dt. 5. II. 1945.

²⁸ *Po aty*.

²⁹ Savo Drljević, *Vojna uprava na Kosmetu*, Beograd, 1986, st. 79.

Duke u nisur nga këto vlerësime, J. B. Tito, më 8 shkurt 1945, vendosi në Kosovë Administrimin Ushtarak, të cilit iu besua udhëheqja ushtarake e pushtetit civil dhe gjyqësor "deri në rregullimin e rrethanave", përkatësisht deri në aneksimin e saj nga Serbia. Administrimi Ushtarak u konceptua si riorganizim i formacioneve ekzistuese ushtarake në Kosovë dhe u shoqërua me formimin e brigadave dhe të divizioneve të reja, ndërmarrjen e masave për thyerjen sa më të shpejtë të rezistencës etj. Komandës së Administrimit Ushtarak iu dhanë autorizime të plota, ndërsa për të gjitha veprimet ajo përgjigjej vetëm përpara komandantit suprem, J. B. Tito.³⁰

Me urdhëresën e parë, nr. 30, datë 8 shkurt 1945, të J. B. Titos, në vend të Shtabit Operativ të UNÇ-së dhe AP-së të Kosovë e Metohisë u formua Shtabi i ri Operativ. Komandant i këtij shtabi u emërua shefi i Shtabit të Armatës I, koloneli Savo Dërleviq. F. Hoxha u spostua dhe u caktua zëvendëskomandant, ndërsa komisar politik u emërua nënkoloneli Gjuro Medenica. Në detyrën e shefit të Shtabit u emërua Duklan Vukotiq, zëvendëskomandant i Divizionit 52 të UNÇ-së të Kosovës. Shtabi Operativ i UNÇ-së të Kosovës u vu nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Shtabit Suprem të UNÇ-së dhe AP-së të Jugosllavisë. Me këtë urdhëresë të 8 shkurtit 1945 Kosova komandohej prej një grupi të caktuar ushtarakësh serbo-malazezë, të cilët ushtronin pushtetin politik, ekzekutiv dhe gjyqësor.³¹

Më 8 shkurt 1945 u formua (nga Brigada I, II dhe IV kosovare) Divizioni 52 i Kosovës. Divizioni numëronte 7 013 pjesëtarë. Ky formacion, së bashku me Grupin Operativ të Brigadave, Divizionin 50 me dy brigada dhe Divizionin 26 serb me tri brigada u vunë nën kontrollin e plotë të Komandës së Zonës Ushtarake, përkatësisht të Administratës Ushtarake. Dy ditë pas riorganizimit të këtyre formacioneve, më 10 shkurt 1945, në Kosovë u formuan njësitë e artilerisë, të kavalerisë, të ndërlihdjes, të xhenios dhe të komunikacionit, të cilat do të ndihmonin repartet ushtarake në

³⁰ Po aty.

³¹ Po aty.

operacionet për "spastrimin" e forcave "kundërrevolucionare" në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare.³²

Për arritjen e objektivave të parashtruara, me urdhëresën e dytë, nr. 31, të J. B. Titos të datës 9 shkurt 1945, në Kosovë u riorganizua Administrimi Ushtarak si organ i pushtetit shtetëror e ushtarak. Komandant i Administratës Ushtarake u emërua koloneli Savo Dërleviq, kurse komisar politik nënkoloneli Gjuro Medenica.³³

Administrimi Ushtarak likuidoi shumicën e këshillave nacionalçlirimtarë me arsyetimin se ishin të infektuar nga elementë kundërrevolucionarë e irredentistë dhe në vend të tyre u ngritën këshilla të reja, në të cilat mbizotëronin serbët e malazeztë. Masa u morën edhe kundër reparteve të Milicisë Popullore, rojeve partizane dhe formacioneve të tjera nën pretekstin se gjoja "ishin të lidhura me bandat dhe me reaksionin". Shumë prej tyre u çarmatosën, ose u dërguan në frontin e Sremit apo të Adriatikut, bashkë me të mobilizuarit e tjerë shqiptarë. Ndryshime u bënë edhe në Kryesinë e Këshillit Krahinor të Këshillave Nacionalçlirimtarë (KKNÇ) të Kosovës. Në këtë kryesi, me metodën e kuptimit, u futën 5 anëtarë të rinj, të gjithë serbë e malazezë. U përdorë si pretekst fakti se Fadil Hoxha, Pavle Joviçeviq dhe Ali Shukriu ishin të ngarkuar me detyra ushtarake.³⁴

³² Lefter Nasi, *Ripushtimi i Kosovës...*, f. 164.

³³ Vladimir Dedijer, *Novi prilozi za biografiju Josipa Broza Tita*, 2, "Liburnija", Rijeka-"Mladost", Zagreb, 1982, f. 113 dhe 115.

³⁴ Lefter Nasi, *Ripushtimi i Kosovës...*, f. 164.

* Zufer Musiqi nga Plava, pavarësisht nga ndihma që i ishte dhënë nga shqiptarë të fshatrave kufitare me Shqipërinë, në prill të vitit 1941, në saje të së cilës si oficer i ushtrisë jugosllave shpëtoi nga internimi dhe më vonë familja nga thika çetnike, tani udhëhiqte likuidimin e burrave, grave e fëmijëve dhe rrënimin e fshatrave shqiptare. Ai arrestoi dhe urdhëroi të vritej Isuf Gradica, njëri nga organizatorët dhe komandantët e vullnetarëve që mbrojtën Plavën, Gucinë, Rozhajën dhe Pazarin e Ri. Ai miratoi edhe vrasjen e Asim Luzhës, që ishte imam sikurse i ati i Z. Musiqit që ishte vrarë nga shovinistët malazezë më 1913, sepse nuk pranoi të ndërronte fenë dhe kombin. Z. Musiqi, së bashku me Petar Popoviqin, komandant i Brigadës së KMPJ-së, i afërm i Vuka Popoviqit të likuiduar, urdhëruan vrasjen e Shahsivar Ali Kodrës me gjithë nipin e tij dhe të gjithë atyre që u gjenden në afërsi

Ndryshimi i përbërjes kombëtare të organeve bazë e qendrore të "pushtetit popullor", nuk ishin veprime të rastësishme e të shkëputura, por ishin në përputhje me vijën e qëndrimit e udhëheqjes jugosllave, provë për vazhdimin e politikës që synonte mohimin e të drejtave të ligjshme të popullit shqiptar. Këto masa njëherazi përgatitsnin terrenin për aneksimin e Kosovës nga Serbia, përkatësisht nga Jugosllavia.³⁵

Formacionet jugosllave bashkë me ato kosovare krahës luftimeve kundër forcave atdhetare shqiptare, kryen masakra dhe veprime gjenocidale ndaj popullatës së pambrojtur shqiptare. Në këtë aspekt dalloheshin Divizioni 24 serb dhe Divizioni 46 serb, si dhe pjesët e Divizionit 41 serb, Brigada e Parë e Kosovës, komandant të cilës ishte Zufer Musiqi*, i cili urdhëroi masakrat, dhunimet, vrasjet, djegiet e shtëpive dhe të fshatrave të tëra shqiptare. Brigada e Korpusit të Mbrojtjes Popullore të Jugosllavisë, nën komandën e Pavle Brajoviqit, dy brigadat e Malit të Zi, Brigada e Bokës dhe Brigada VI malazeze, Brigada XVII maqedonase, komandant i së cilës ishte Glisha Sharanovq, njohur për terrorin dhe gjenocidin në territorin e Anamoravës dhe Karadaket, njësia e OZN-së, të cilën e përbënin pjesëtarët e Batalionit përcjellës të Shtabit Kryesor të Serbisë dhe Divizioni 52 i Kosovë e Metohisë, nën komandën e Petar Brajoviqit.³⁶

Ndërkohë vazhdoi fushata e sinkronizuar për shpartallimin e forcave atdhetare shqiptare. Shërbimi Informativ i Divizionit 46 të Serbisë në urdhëresën e tij të 26 janarit 1945, do të pohonte se grupi prej 1 000 vetash i Adem Vocës përbëhej kryesisht prej kryefamiljarëve të fshatrave të Shalës, të mobilizuar nën parullën e Lëvizjes Antifashiste. Kundër grupimit të Adem Vocës në Shalë u përqendruan Brigada XXV dhe e XXVII e Divizionit 46 serb, Brigada V kosovare dhe një bateri topash. Në luftimet përfundimtare

të ngjarjes (AIHU, k. 1411, 2/5-4; Muhamet Mjeku, Drenicë 1945, "Zëri i rinisë", 1386, Prishtinë, 19. XII. 1990, f. 3)

³⁵ Po aty.

³⁶ Muhamet Mjeku, *Lufta e Drenicës dhe Shaban Polluzha*, Prishtinë, 1991, f. 47

që u zhvilluan më 9 shkurt 1945 në kullën e Vocajve në Pasomë u likuiduan shumica e mbrojtësve të saj në krye me Adem Vocën. Në këto luftime forcat jugosllave patën 12 të vrarë e 23 të plagosur dhe midis të plagosurve ishte edhe zëvendëskomandanti i Divizionit 46, nënkoloneli Duklan Vukotiq.³⁷

Luftimet përfundimtare me forcat atdhetare të Drenicës u zhvilluan më 21 shkurt 1945. Ato i zhvilloi Brigadës IV kosovare, e cila ndërmori sulmin e përgjithshëm. Nga burimet jugosllave del se ushtria pati 30 të vrarë e 51 të plagosur, kurse nga ana e kryengritësve 19 veta dhe u zunë 20 pushkë, 3 pushkomitraloz, 5 kuaj të ngarkuar dhe 2 kutia me predhat e mortajës së lehtë. Gjatë luftimeve të rrepta që u zhvilluan aty, u plagos rëndë edhe Petar Brajeviq, komandant operacionit dhe i Divizionit 52.³⁸

Ndërkaq, shumë nga ata që u dorëzuan u likuiduan pa gjyq e shumë të tjerë u dënuan me burg shumëvjeçar. Ata që nuk u dorëzuan, qëndruan maleve dhe rezistuan derisa u likuiduan nga repartet e OZN-së dhe të ushtrisë.³⁹ Sipas raportit të prof. Ymer Berishës, të datës 2 tetor 1945, shqiptarët ishin të rrethuar nga afro 36 000 ushtarë serbë, malazezë, maqedonas, bullgarë e fatkeqësisht edhe shqiptarë. Në vazhdim ai thekson: “Në atë kohë babai gjendej në ushtrinë popullore, kurse djali ishte i mobilizuar me dhunë në ushtrinë partizane. Kjo do të thotë se shpeshherë babai luftoi kundër djalit, djali kundër babait, vëllai kundër vëllait, çfarë mjerimi! Kështu, vetëm gjatë 28 ditëve të luftës u vranë dhe u plagosën rreth 430 luftëtarë nga Drenica, u dogjën dhe u plaçkitën 450 shtëpi, ju konfiskua i tërë ushqimi e gjëja e gjallë 6 000 banorëve të Vushtrisë e të Mitrovicës me rrethina. Në ditën e rrëzimit me top të Kullës së Dvoranit, ku u plagosën për vdekje Shaban Polluzha dhe Mehmet Gradica, mori fund Lufta e Drenicës, ranë heronjtë e kësaj lufte, sepse tërë municionin e kishin shpenzuar”.⁴⁰

³⁷ AIHU, k. 1341, 1-54.

³⁸ AIHU, k. 1412, 5-1/2, Raport mbi luftimet e zhvilluara prej 10-23. II. 1945.

³⁹ Islam Dobra, *Lufta e Drenicës 1941-1945*, Prishtinë, 1995, f. 175.

⁴⁰ Raport i prof. Ymer Berishës dërguar Hadsonit, më 22. X. 1945, cituar sipas Muhamet Pirrakut, *Ripushtimi i Kosovës*..., f. 108.

Mund të përfundohet se në fillim të vitit 1945 në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare u koncentruan forca të shumta ushtarake, policore dhe një aparat shumë i dhunshëm represiv. Udhëheqja jugosllave kishte planifikuar nënshtrimin e plotë të shqiptarëve dhe me pas shpërnguljen e tyre, prandaj qysh gjatë depërtimit forcat e shumta partizane dhe struktura e OZN-së ushtruan dhunë dhe terror të paparë ndaj tyre. Prandaj, edhe kundërvënia e shqiptarëve dhe lufta për mbrojtjen e vatanit mori karakter të thuash epik. Akti i tyre i vetëmohimit dhe i sakrificës qëndron në themel të qëndresës së përgjakshme kundër politikës shoviniste, që tashmë ishte veshur me petkun komunist. Në krye të kësaj lufte u vunë prijes të thjeshtë popullore, patriotë të shquar, të cilët, mbështetur në përvojën historike, u treguan shumë më largpamës se udhëheqësit komunistë shqiptarë, këndej e andej kufirit. Qëndresa e armatosur kundër zgjedhës jugosllave, lufta për çlirim kombëtar dhe për drejtësi shoqërore, e radhiti Kosovën dhe trevat e tjera shqiptare, në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, në kampin e forcave më të avancuara demokratike të Ballkanit dhe të Evropës Lindore.

Muharrem DEZHGIU

**BALLAFAQIMI MIDIS NJËSIVE TË UNÇSH-së DHE
NACIONALISTËVE SHQIPTARË NË KOSOVË NË FUND TË
LUFTËS SË DYTË BOTËRORE**

Pas kapitullimit të Italisë dhe më pas forcat shqiptare nacionaliste në Kosovë përballuan sulme të vazhdueshme të çetnikëve serbë, që synonin të depërtonin në trevat shqiptare. Mbrojtja e trojeve etnike shqiptare mbeti detyra themelore e nacionalistëve shqiptarë. Me pretendimin se luftonin kundra komunistëve, më 12 shtator 1943, çetnikët kërkonin të futeshin në Plavë e Guci, por shqiptarët nuk e pranuan këtë kërkesë¹.

Formimi i Lidhjes së Dytë të Prizrenit krijoi mundësi që mbrojtja e trevave shqiptare nga sulmet e çetnikëve të bëhej më e organizuar. Barrën kryesore e mbanin forcat vullnetare, të organizuara në mënyrë tradicionale. Për mbrojtjen e kufirit me Serbinë, u shquan: Pajazit e Adem Boletini, Mehmet Gradica, Sali Kollundra-Gashi, Bislim Bajgora etj. Në mbrojtje të kufirit etnik u angazhuan edhe njësitë e rregullta të Ushtrisë shqiptare, të drejtuara nga ushtarakët patriotë: Fuat Dibra, Qazim Konomi, Rexhep Gjilani,

¹ Rexhep Dedushaj, *Krahina e Plavës dhe Gucisë nëpër shekuj*, New York, 1994, f. 259.

Sulejman Shkoza-Vuçiterna, Hysni Rudi, Shefqet Bylykbashi, Sabit Basha, Nazmi Budriga, Demir Korça, Gjin Martini etj. Shumica prej tyre ranë heroikisht, duke i mbrojtur kufijtë etnikë ose u masakruan nga pushteti okupues jugosllav, pas ripushtimit të Kosovës².

Në gjysmën e shkurtit 1944, prefekti i Mitrovicës i kërkonte Komitetit Qendror (KQ) të Lidhjes së Dytë të Prizrenit të dërgonte në ato rajone forca vullnetare nga Drenica e Podguri. Falë angazhimit të Isuf Boletinit, kryetar i Komunës së Rakoshit, më 15 shkurt 1944, u mobilizuan 400 vullnetarë për të luftuar në Frontin e Kolashinit, në fshatrat Rezallë e Çicevë. Më 17 shkurt 1944, filloi mësymja e përgjithshme e vullnetarëve, që i detyroi çetnikët të tërhiqeshin në drejtimin Presekë-Cikatovë-Tushicë³.

Njësitet e Truparmatës II të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë (UNÇJ), nën komandën e Peko Dapçeviçit, në maj 1944, sulmuan në befasi në kurizin e maleve Kaçuber e Smilovicë. Në mbrojtje të Smilovicës, që ishte mburojë për Rozhajën dhe Pejën, u nisën forcat vullnetare të Rugovës, të Lugut të Drinit dhe të Podgurit. Në këtë luftim ranë shumë burra të Rugovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit, midis të cilëve Sak Fuzlija, bajraktari i Rugovës, i cili nuk e lëshoi flamurin nga dora⁴.

Vetëm pas luftimeve disaditore, më 4-5 qershor 1944, forcat e Truparmatës II të UNÇJ-së arritën të merrnin Smilovën. Ndërkohë, për mbrojtjen e Pazarit të Ri u dërgua për ndihmë Batalioni “Besnik Çano”, i përbërë me vullnetarët tiranasë, durrsakë dhe shkodranë. Batalioni arriti në Murinë më 20 qershor 1944. Pas tri ditë luftimesh të rrepta, ai arriti të rimarrë fshatrat Koritë, Doliq e Uglla, ndërsa njësitet serbo-malazeze u detyruan të tërhiqeshin për në Beranë⁵.

Forcat nacionaliste shqiptare, të udhëhequr nga prefekti i Pazarit të Ri, i përzunë repartet jugosllave jashtë vendbanimeve shqiptare. Për mbrojtjen e kufirit nga sulmet e përbashkëta të

² Faton B. Mehmetaj, *Lufta e përhershme e Kosovës për Shqipërinë etnike*, 2, Rilindja, Zofingen, IV, 1969, f. 13.

³ *Arkivi Qendror Shtetëror* (më tej: AQSH), Fondi 264, Dosja 43, fleta 32.

⁴ Fazli Muriqi, “Rilindja”, 24.9.1994, f. 8.

⁵ Ibrahim Hoxha, *Goditjet serbo-malazeze dhe greke...*, f. 4.

çetnikëve dhe të njësive të UNÇJ-së në anën lindore të Kosovës, u ngrit njësiti i vullnetarëve të Hogoshtit dhe popullsia shqiptare, nën udhëheqjen e Sylë Zarbicës. Qëndresën në Kosovën Lindore e koordinonte Shtabi i Mbrojtjes Kombëtare me Mulla Idrizin në krye, i cili bashkëpunoi me komandantin e Regjimentit IV të Ushtrisë shqiptare, Fuat Dibrën. Pas luftimeve forcat partizane serbe, lëshuan Velegllavën, duke lënë 131 robër lufte në duart e forcave vullnetare shqiptare⁶.

Në rrethanat e luftës së njësive të UNÇJ-së për të ripushtuar trevat shqiptare në Kosovë, nuk kishte mbështetje propaganda e forcave komuniste shqiptare e jugosllave për bashkëpunim midis dy lëvizjeve nacionalçlirimtare të të dy vendeve. Prandaj, Komiteti Qendror i Rinisë për Mbrojtjen e Atdheut dhe të kombit shqiptar iu drejtohej në fund të tetorit 1944, shqiptarëve të mobilizuar në njësitë e ushtrisë partizane jugosllave, duke ju kërkuar të largoheshin nga rruga e gabuar dhe të bashkoheshin me batalionet e vullnetarëve shqiptarë, që po luftonin me guxim kundër njësive të divizioneve 22, 24 dhe 46 të UNÇJ-së dhe bashkëpunëtorëve të tyre⁷.

Trevat etnike shqiptare përgjatë kufirit ishin nën kërcënimin e pushtuesve shekullorë sllavë, të veshur tashmë me petkun e partizanëve të UNÇJ-së. Në këtë situatë, bashkëpunimi midis lëvizjeve nacionalçlirimtare jugosllave e shqiptare, përbënte një rrezik të paralajmëruar për të ardhmen e fatit të Kosovës e trevave shqiptare, të bashkuara, në vitet 1941-1944, me Shqipërinë.

Dominimi i Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ) mbi udhëheqjen politike e ushtarake të Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Shqipëri, do të ndihmonte Jugosllavinë për të zgjidhur, në interes të saj çështjen e Kosovës e të viseve të tjera shqiptare në ish-Jugosllavi.

⁶ Sabit Rustemi, *Shënimet e një vullnetari*, "Rilindja", Zofingen, 11. XII. 1993, f. 10.

⁷ Tahir Zajmi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit dhe lufta heroike e popullit për mbrojtjen e Kosovës*, Bruksel, 1964 f. 53.

Me fjalë të tjera, Jugosllavia do të përjashtonte çështjen e diskutimit të statusit të Kosovës në fund të luftës, pavarësisht propagandës që i referohej Kartës së Atlantikut.

“Tito, nga ana e tij, vëren studiuesi Noel Malcolm, e konsideronte me xhelozë, të drejtën e partisë së vet jugosllave, si të vetmin faktor në truallin jugosllav”⁸. Ndërsa, Partia Komuniste Shqiptare (PKSH) nuk ia njihte këtë të drejtë. Kjo e fundit nuk mund ta konceptonte çlirimin kombëtar për të gjithë shqiptarët brenda kufijve etnikë, sipas realitetit historik, që ishte krijuar pas bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, në gusht 1941. Në kuadër të bashkëpunimit midis lëvizjeve nacionalçlirimtare të Shqipërisë e Jugosllavisë, udhëheqja e PKJ-së kërkoi, që në verë të vitit 1944, pjesëmarrjen e formacioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë (UNÇSH) në luftimet për çlirimin e Kosovës e të tokave të Jugosllavisë.

Në letrën e Shtabit Kryesor të Ushtrisë Nacional Çlirimtare (UNÇ) të Kosovës, më datë 26 qershor 1944, dërguar Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së, thuhej: “Në Kosovë urrejtja shoviniste e mbjellë nga shovinistët serbomëdhenj dhe e manipuluar nga okupatorët e tradhtarët, frika nga kthimi i së vjetrës, ndikojnë që Kosova të bëhet baza më e rrezikshme e reaksionit kundër lëvizjes sonë dhe asaj suajës, por e ardhja e brigadave shqiptare në këtë trevë kishte për t’i mposhtur planet e okupatorit dhe të reaksionarëve, duke e kthyer këtë trevë prej bazës së reaksionit në bazë lirishtetërore”. Duke vazhduar më tej, letra sqaronte se: “shkaktarë që Kosova është bërë bazë e reaksionit janë hegjemonistët serbë”. Nga ana tjetër, pranohej fakti se “shumica e popullit të Kosovës nuk kishte besim tek PKJ-ja dhe tek shtabi jugosllav”⁹.

Me fjalë të tjera kërkohet që të vinin në Kosovë e në trevat shqiptare, tashmë të bashkuara me Shqipërinë, forca të Ushtrisë

⁸ N. Malcolm, *Histori e shkurtër e Kosovës*, f. 314-317.

⁹ *Arkivi Qendror i Ushtrisë* (më tej: AQU), Fondi Shtabi i Përgjithshëm, fl. 1,2,3. Letër e Sh. K. të Kosovës për Sh. P. të UNÇSH-së, 26. VI. 1944.

Nacionalçlirimtare të Shqipërisë për të ndikuar tek shqiptarët që “të besonin” te PKJ-ja dhe tek Shtabi Jugosllav.

Kërkesa e Josip Bbroz Titos për kalimin në Kosovë të brigadave shqiptare u përsërit në korrik të vitit 1944. Qëllimi i kësaj kërkesë ishte mjaft i qartë. Vetëm brigadat shqiptare mund të depërtonin në Kosovë, pa gjetur rezistencën e popullit të armatosur të Kosovës, pasi, ata nuk mund të luftonin kundër vëllezërve të tyre nga Shqipëria.¹⁰

Kështu, brigadat e UNÇSH-së me urdhër të Komandës së Përgjithshme të saj, morën pjesë në çlirimin e Dibrës. Pas çlirimit të qytetit dhe rretheve të tij, autoritetet maqedonase u ngarkuan për ngritjen e organeve të pushtetit. Veç kësaj, Shtabi Kryesor i UNÇ-së për Maqedoninë kërkonte nga Komanda e Përgjithshme e UNÇSH-së të dërgonte repartet e saj për të lehtësuar veprimet në këtë zonë,¹¹ sepse përpara forcave të UNÇ-së të Maqedonisë qëndronte si problem “likuidimi i reaksionit të Xhemës (Xhemë Gostivari-M. D.) e të Mefailit, (Mefail Zajazi-autori) për të çliruar Kërçovën e Gostivarin”¹².

Veprimet arbitrare të reparteve maqedonase në këto vise shqiptare, nën pretekstin e luftës kundër “reaksionit shqiptaromadh”, arritën deri në mohimin e të drejtave elementare kombëtare të shqiptarëve. Rrjedhojat negative të kësaj politike u manifestuan, që në atë periudhë dhe për më tepër në prani të reparteve të UNÇSH-së. Këto reparte vetëm i konstatonin dhe i raportonin rrjedhojat negative. Prof. Leter Nasi ka dokumentuar se në disa raste për shpartallimin e “reaksionit shqiptaromadh” morën pjesë në këto operacione edhe njësi të UNÇSH-së, krahas reparteve maqedonase¹³. Në pretekstin se kishin të bënin me një popullsi e cila, siç thuhej, “kishte bashkëpunuar me pushtuesin e shërbëtorët e tij kundër lëvizjes

¹⁰ AQU, *Po aty*.

¹¹ AQSH, Fondi Divizioni I, viti 1944, Kutia 2, dosja 13, fl. 56. Letër e Vidoje Smilevskit për Shtabin e Div. I të UNÇSH-së, 25 shtator 1944.

¹² *Po aty*, fl. 6. Letër e komandës shqiptare të Dibrës për Shtabin e Div. I të UNÇSH-së.

¹³ L. Nasi, *Ripushtimi i Kosovës (shtator 1944-korrik 1945)*, Tiranë 1994, f. 49.

nacionalçlirimtare” u kishin vënë zjarrin shtëpive dhe fshatrave shqiptare¹⁴. Këto veprime i kishte miratuar edhe Enver Hoxha, kur thoshte se: “Këto veprime të përbashkëta do të kenë reperkusione të thella në Kosovë, ku do të hapen perspektiva lufte të gjera, në ushtrinë glorioze të popujve të Jugosllavisë, e udhëhequr me aq shkëlqim prej komandantit të madh Marshallit Tito”¹⁵.

Më 12 shtator 1944 komandanti i përgjithshëm i UNÇSH-së urdhëroi Korparmatën I të përgatiste dhe të niste menjëherë dy brigada në Kosovë¹⁶. Britanikët vinin në dyshim nevojën e forcave jugosllave për përforsime nga UNÇSH-ja, kur kjo e fundit ishte më e vogël dhe më e dobët në këtë fazë të luftës¹⁷. Kërkesën për të dërguar brigadat në Kosovë e bënë instancat më të larta të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë*.

Nisur nga informata e Fadil Hoxhës se në Kosovë gjendeshin forca të pakta gjermane,¹⁸ rezultonte se nuk kishte nevojë të thirreshin forca prej Shqipërie për ndihmë (së paku dy brigada dhe një batalion).

Nga ana tjetër, Fadil Hoxha shprehej se rreth Kosovës kishte “njësi të mëdha ushtarake” të nacionalistëve shqiptarë përballë 100 partizanëve të ndarë në çeta. Pikërisht, në këtë raport të pabarabartë të forcave në Kosovë qëndronte shqetësimi i Titos, Joviçevićit dhe Fadil Hoxhës që kërquan ardhjen e UNÇSH-së në Kosovë. Vetëm në këtë mënyrë mund të ndryshonte raporti, në favor të forcave nacionalçlirimtare (shqiptare e jugosllave), që të asgjësonin “rrezikun” e madh të nacionalistëve shqiptarë në Kosovë.

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ AQSH, F. 41, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së, për Shtabin Maqedonas të UNÇL-së, 14 qershor 1944.

¹⁶ Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së, vëll. II, f. 160-161.

¹⁷ R. Hibbert, *Lufta Nacionalçlirimtare në Shqipëri. Fitorja e hidhur*, f. 325.

* Sekretari i PKJ-së për Kosovën, Pavle Joviçević (Rade) ka transmetuar tek Fadil Hoxha kërkesën e Titos. F. Hoxha e transmeton kërkesën tek Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së.

¹⁸ AQSH, F. 41, Viti 1944, d. 135/1. Letër e F. Hoxhës për Shtabin e Përgjithshëm të UNÇSH-së.

Njësitë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave nuk mund të vepronin në Kosovë normalisht, përveçse në mënyrë të dhunshme, për shkak të kaluarës historike në mes popullsisë shqiptare dhe ish-pushtuesve sllavë, të cilët kishin kryer masakra e politika shoviniste ndaj shqiptarëve. Nga ana tjetër, në realitetin historik të bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, ardhja e ushtrisë jugosllave në Kosovë konsiderohej akt pushtimi dhe ajo do të pritej si pushtuese.

Në Kosovë ishin organizuar dhe vepronin formacione politike e ushtarake të fuqishme si, Lëvizja Irredentiste, Lidhja e Dytë e Prizrenit etj., që kishin organizuar popullin e armatosur, për mbrojtjen e kufijve të saj. Lëvizja komuniste në Kosovë nuk kishte mbështetje te kosovarët. Ajo drejtohej nga PKJ-ja, e cila nuk jepte asnjë shpresë për zgjidhjen e çështjes shqiptare.

Sipas Shtabit të UNÇJ-së, forcat partizane shqiptare do të kishin për detyrë të pengonin konsolidimin e “njësiveve armike” (forcave nacionaliste shqiptare) dhe të shpartallonin forcat e tyre¹⁹. Titoja i thirri njësitë e UNÇSH-së “për të luftuar kundër armikut dhe reaksionit”, por pavarësisht anës formale të kërkesës, ai i përdori kryesisht në luftën kundër “reaksionit kosovar”. Me fjalë të tjera, njësitë e UNÇSH-së u thirrën nga udhëheqja jugosllave për të vënë shqiptarët nga Shqipëria kundër shqiptarëve të Kosovës.

Kalimi i formacioneve të UNÇSH-së në Kosovë (Brigada V dhe III) u bë në kohën, kur udhëheqja e PKJ-së kishte vendosur përfundimisht qëndrimin e saj për të ardhmen e Kosovës e të viseve shqiptare. Ishte vendosur nga PKJ-ja që ato t’i kalonin Jugosllavisë. Me këtë qëndrim ishte pajtuar edhe udhëheqja e Parisë Komuniste Shqiptare (PKSH). “Kosova nuk mund t’i bashkohej Shqipërisë” - shprehej Enver Hoxha²⁰.

Ndjenjat atdhetare të shqiptarëve dhe shfaqja e dëshirës për bashkim kombëtar, jo vetëm që nuk u përfillën, por u konsideruan si

¹⁹ I. Antonovski, *Formiranje i razvoj Kosovsko-Metohijskih. NOU brigada i njihova dejstva u toku Narodnooslobodilackog rata 1941-1945* në “Kosova”, nr. 4, Prishtinë, 1975.

²⁰ E.Hoxha, *Titistët*, f. 259-262. Deklarata e E. Kardelit, në Xh. Shatri, “*Vështrim i përgjithshëm*”, f. 102.

“qëndrime shqiptaromëdha” dhe që “çonin ujë në mullirin e armikut”. PKSH, një parti e re dhe e varur plotësisht prej PKJ-së, pranoi gjykimet, vlerësimet dhe zgjidhjet e ofruara nga PKJ-ja.

Veprimtaria antishqiptare e PKJ-së propagandohej si luftë kundër “reaksionit antikomunist e shqiptaromadh”. Kosova trajtohej si “vatër e reaksionit dhe e kundërrevolucionit”. Sipas PKJ-së dhe PKSH-së, po t’i bashkohej Kosova, në atë kohë, Shqipërisë, reaksioni do të forcohej dhe do të konsolidohej më tepër. Për rrjedhojë fitorja e PKSH-së dhe futja e Shqipërisë në rrugën e ndërtimit të shoqërisë komuniste do të viheshin në pikëpyetje. Lufta kundër “reaksionit shqiptar e shqiptaromadh” ishte emëruesi i përbashkët i bashkëpunimit të partive komuniste në të dy vendet, për të marrë pushtetin, të vetme në fund të Luftës. Prandaj, brigadat e Divizionit I urdhëroheshin “të asgjësohen pa mëshirë nacionalistët dhe reaksionarët shqiptarë, brenda e jashtë kufijve, pa treguar as më të voglën tolerancë”.²¹

Brigadat V dhe III shqiptare kaluan në Kosovë, përkatësisht më 4 e 18 tetor 1944. Pasi kishin shpartalluar forcat nacionaliste të Kryezinjve dhe të Muharrem Bajraktarit, vazhduan luftën kundër nacionalistëve shqiptarë në Kosovë. Veç kësaj detyre, sipas urdhrit të Korparmatës I, brigadat shqiptare do të organizonin pushtetin nacionalçlirimtar në të gjitha krahinat e Kosovës që liroheshin, të bënë mobilizimin dhe çarmatimin. Mobilizimi do të bëhej si për ushtrinë tonë, ashtu dhe për ushtrinë e Titos, pa asnjë dallim²². Lufta kundër gjermanëve për çlirimin e Gjakovës, Pejës, Prizrenit, nga 16 tetori deri më 17 nëntor 1944, pati sakrifica të shumta dhe mjaft dëshmorë nga brigadat shqiptare. Por gjithashtu, brigadat partizane goditën, sipas urdhrit që kishin marrë, “reaksionarët” kosovarë në: Dragash, Drenicë, Deçan, Junik e tjerë.

Sipas kronikës së luftimeve të Brigadës III dhe të V, më 11 tetor 1944, në Damjan u vranë 2 “bashibozukë” të Sef Sadikut dhe u

²¹ AQU, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së, d. 45, urdhër për Shtabin e Div.I të UNÇSH-së.

²² AQSH, F. 210, V. 1944, d.3, Urdhër i Shtabit të Korp. I të UNÇSH-së.

zunë 3 robër²³. Kur forcat e Brigadës III sulmuan Junikun më 20 tetor 1944 u kapën 32 “bashibozukë” (nacionalistë). Pas një luftimi të rreptë forcat e brigadës u tërhoqën në Batushë me një bilanc të hidhur, 7 të vrarë e dy të plagosur nga partizanët dhe 10 të vrarë nga nacionalistët. Më 21 tetor 1944, Brigada III filloi një operacion të gjerë në zonën e Rekës për spastrimin e postave të xhandarmërisë dhe njësitet e vullnetarëve. Më 23 tetor 1944 dy batalione të Brigadës III dhe një batalion i Brigadës V zhvilluan 4 orë luftime në Batushë. Në raportet e drejtuesve të tyre pohohej se, “armiku” (nacionalistët shqiptarë) çau rrethimin, duke lënë 10 të vrarë dhe 21 robër. Shumë humbje në të vrarë e të plagosur pati në luftimet e zhvilluara në katundin Bytyç të Junikut²⁴.

Nga sa thamë, vetëm në kronikat e ditëve të fundit të tetorit 1944, brigadat III dhe V, në bashkëpunim me forcat e Brigadës I të Kosovës, luftuan kundër forcave nacionaliste dhe banorëve që i mbështetën ato, duke i konsideruar “reaksonarë, bashibozukë, tradhtarë dhe armiq”, ashtu sikurse i cilësonin udhëheqësit e PKJ-së dhe të UNÇJ-së.

Në urdhërveprimin e përbashkët ushtarak jugosllav-shqiptar për spastrimin e forcave “reaksionare” në Drenicë, nga 5 deri 10 dhjetor 1944, përcaktohen si armiq nacionalistët dhe popullata shqiptare e Drenicës²⁵. Për çdo brigadë theksohej detyra e spastrimit. Në urdhërveprimin e Brigadës V shtrohej detyra: “Të gjitha forcat reaksionare që do të takoni të rrethohen dhe të shpartallohen me çdo kusht... të çarmatosen njerëzit e dyshimtë ... Mund të digjen shtëpitë e tradhtarëve që rezistojnë, të sekuestroni mallin e kriminelëve të arratisur.”²⁶

Më 4-6 dhjetor 1944, forcat e Brigadës V luftuan kundër forcave të Mehmet Gradicës në Dervar, Bivalak, Stroc, Beçuk e në

²³ AQSH, F. 219, V. 1944, D.9, fl. 302, Fondi i Brig. V Sulmues.

²⁴ AQSH, F.181, V.1944, D.9, Informacion nga Brig. V e UNÇSH-së.

²⁵ AQSH, F.181, V.1944, D.9. Urdhër veprimi i Shtabit Operativ për Kosovë e Metohi të Armatës Jugosllave dhe të UNÇSH-së.

²⁶ AQSH, F. 181, V.1944, D.6. Urdhër veprimi për Brig. V të UNÇSH-së.

Gradicë, duke vrarë luftëtarë nacionalistë të Kosovës²⁷. Në sektorin e Gllanasellës e në kodrat e Kamenicës, forcat e Brigadës V detyruan të dorëzoheshin 12 veta. Ky ballafaqim zhvillohej ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe të Shqipërisë. Kjo luftë bëhej sipas urdhrorit të Shtabit Madhor të Armatës V Jugosllave, nga vareshin edhe brigadat e UNÇSH-së.

Ndonëse populli i Kosovës dhe luftëtarët nacionalistë nuk donin të luftonin kundër vëllezërve shqiptarë, u shmangeshin përgjithësisht goditjeve me forcat e UNÇSH-së, forcat nacionalçlirimtare të Shqipërisë e të Kosovës ishin të urdhëruara t'i sulmonin dhe t'i asgjësonin luftëtarët nacionalistë dhe të nënshtronin popullatën, t'i çarmatosnin dhe të bënin mobilizimin ushtarak të tyre.

Në luftimet që bëri Brigada V në katundin Halinoviç, më 22 dhjetor 1944, kundër forcave nacionaliste që arrinin në 500 luftëtarë të armatosur, që sipas Halim Xhelos, komandant i Batalionit II, ka pasur të vrarë, mbasi zjarri ka qenë në befasi dhe në afërsi. Ndërsa, nga forcat nacionalçlirimtare pati 4 të vrarë dhe 9 të plagosur²⁸.

Në fund të shtatorit 1944 forcat e Brigadës XVIII i shkuan në ndihmë Brigadës III serbo-maqedonase në luftimet që zhvillonin kundër “reaksionarëve” të Xhemë Gostivarit dhe të Mefail Zajazit në rrethin e Kërçovës, që arrinin në 2 000 luftëtarë²⁹. Më 24 tetor 1944, forcat e Brigadës XVIII u ndeshën në Bllacë me një forcë nacionalistësh të ardhur nga Prizreni, ku 10 vetë prej tyre mbetën të vrarë³⁰.

Brigadat e UNÇ-së të Kosovës që u formuan, pas mobilizimit të të rinjve kosovarë, u dërguan në fronte lufte jashtë Kosovës, siç u veprua me Brigadën VII të komanduar nga Shaban Haxhia, e cila rrugës për në Srem u sulmua nga partizano-çetnikët jugosllavë dhe gati u shfaros. Kurse, luftëtarët, nën drejtimin e Shaban Polluzhës

²⁷ AQSH, F.181, V.1944, D.22, Raport i Brig. V.

²⁸ AQSH, F.181, V.1944, D.22. Njoftim i komandantit të Bat. II të Brig. V, Halim Xhelo, dhjetor 1944.

²⁹ AQSH, F.193, V.1944, D.5. Raport i P. Dumes për Shtabin e Div. VIII të UNÇSH-së.

³⁰ *Po aty*.

nuk iu bindën urdhrat për t'u larguar nga Kosova. Ai ra në Drenicë për t'u mbrojtur nga masakrat e ushtrisë serbe.

Forcat e Divizionit V dhe VI të UNÇSH-së, edhe pas mbarimit të Luftës II Botërore, qëndruan në Jugosllavi për të zbatuar urdhrat e Titos, për të goditur dhe asgjësuar çdo lëvizje të rezistencës kosovare dhe për t'i neutralizuar e nënshtuar ata që luftonin kundër ripushtimit jugosllav të Kosovës. Më 16 prill (1945) raportohej se rajoni pranë kufirit shqiptar, malet e Sharrit, Shkupi, Malet Karabrica, Brod, Kërçova, përfshirë Tetovën dhe Gostivarin deri në Dibër ishte (shpallur) zonë lufte. Kjo për shkak të informacionit alarmues që supozohej se kishte arritur kryengritja shqiptare³¹.

“Në bazë të urdhrat të marrë nga Armata V Jugosllave e cila jep të dhëna për “reaksionarët kosovarë”, drejtimin e lëvizjes së tyre si dhe drejtimet që duhet të zëmë ne me efektivat e divizionit tonë - raportonte Reiz Malile zv. komisar i Divizionit V, me të marrë këtë urdhër, vumë në ndjekje të “reaksionarëve kosovarë” Brigada V dhe një batalion të Brigada VIII qysh prej datës 27 tetor 1945. Në juglindjen tonë vepronte, për këtë mision, edhe Divizioni VI”.³²

Në luftimin e zhvilluar në vendin e quajtur Senkruse, më 29 tetor 1945, forcat e Divizionit V kanë asgjësuar rreth 68 “reaksionarë kosovarë” në zbatim të urdhrat të marrë nga Armata V Jugosllave.³³

Enver Hoxha u pajtua me urdhrat e padronëve të tij, të PKJ-së, që divizionet e UNÇSH-së të qëndronin e të vepronin në Kosovë edhe 10 muaj pas largimit të gjermanëve, për ta mbajtur Kosovën nën kontroll ushtarak dhe për të realizuar, nëpërmjet mashtimit, diktatit dhe pranisë ushtarake, bashkëngjitjen e saj me Jugosllavinë.

³¹ TNA, FO. 371/48090. Ministri britanik pranë Qeverisë jugosllave Rolph Stevenson i raporton Foreign Office për situatën e shqiptarëve në Maqedoninë Perëndimore, Beograd, 27 prill 1945, në Ana Lalaj, *Dosjet e Luftës*, Toena, Tiranë, 2014, f. 180.

³² AFA. Shtabi i Përgjithshëm, d. 447. Raport i zv. komisarit të Div. V, Reiz Malile.

³³ *Po aty*.

“Kosova, thoshte Enver Hoxha, duhet t’i mbetet Jugosllavisë. Kush është kundër kësaj politike duhet luftuar”.³⁴

Kësaj situatë i parapriu një fushatë intensive e Qeverisë jugosllave me akuza shoviniste kundër shqiptarëve, duke vjellë vërë kundër tyre. Absurditeti, siç ka pohuar akad. Ali Hadri, arriti deri atje saqë shqiptarët u akuzuan edhe si shkaktarë të disfatës dhe të kapitullimit të Jugosllavisë së vjetër³⁵. Akuzat ndaj shqiptarëve për bashkëpunim me pushtuesin, ishin preludi i terrorit komunist ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë dhe në viset e tjera etnike.

Vetëm pasi u kryen proceset e aneksimit të Kosovës, nën këtë presion ushtarak, politik dhe propagandistik, formacionet e UNÇ-së të Shqipërisë u kthyen në Shqipëri. Këtë aneksim e nënshkruan, më 8-10 korrik 1945, drejtuesit komunistë të Kosovës (të Këshillit Krahinor, të OZNA-së dhe të Shtabit Nacionalçlirimtar), por jo populli i saj. Zgjedhja e PKSH-së për të bashkëpunuar me komunistët jugosllavë, pati një fund tragjik për popullin shqiptar të Kosovës.

³⁴ E. Hoxha, Fjala e mbajtur në plenumin e PKSH-së, dhjetor 1946.

³⁵ A. Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë, 1941-1945*, f. 47.

Fehmi REXHEPI

MASAKRA E TIVARIT NË HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE

Në historiografinë e Kosovës, por edhe në atë të Jugosllavisë dhe të Shqipërisë, për Masakrën e Tivarit, deri në vitet e '90-ta pothuajse është ditur dhe shkruar shumë pak për arsye të njohura. Edhe ata që në shkrimet e veta i përmendin plotësimet e Armatës IV të Jugosllavisë me njësitet partizane, kryesisht të mobilizuara nga Kosova e përcjellin vetëm itinerarin Prizren-Shkodër-Tivar, pa hyrë në përshkrimin apo në komentimin e rrethanave të zhvilluara gjatë procesit të deportimit.

Në literaturën historike dhe publicistike në gjuhën shqipe, por edhe në atë serbe për Masakrën e Tivarit hasim në shprehje të ndryshme dhe të shumëllojshme si: masakra, ploja, incidenti, rasti, ngjarja, likuidimi, vrasja, viktimë, pushkatimi, krimi, golgota, varri me i madh shqiptar, varri ma i madh në Ballkan, golgotë holokausti, e deri të shprehja gjenocid.

Të dhënat e para jo të plota zyrtare për Masakrën e Tivarit, të thëna nga një udhëheqës i lartë partiak në nivel të Serbisë e Jugosllavisë, i hasim në diskutimin e Aleksandër Rankoviqit që bëri në Kongresin Themelues të Partisë Komuniste të Serbisë i mbajtur më 8-12 maj të vitit 1945, në Beograd.

Është me interes të potencohet se derisa në Kongresin Themelues të Partisë Komuniste të Serbisë, pra derisa ishte ende e freskët Masakra e Tivarit, flitet dhe pranohet si një “gabim i tmerrshëm”, ky rast më pas heshtet në përgjithësi pothuajse deri në përfundim të Luftës së Ftoftë gjegjësisht deri në shpërbërjen e Jugosllavisë në vitet ‘90-të të shekullit të kaluar kur u riaktualizua nga historiografia në Kosovë dhe në Shqipëri.

Aleksandër Rankoviqi, mban arealin e një antishqiptari, sipas të gjitha gjasave është i pari dhe i fundit udhëheqës partiak dhe shtetëror i Serbisë që e pranon fajin publikisht, sa do që mundohet ta minimizojë numrin e të vrarëve. Ai në Kongresin Themelues të komunistëve serbë e bëri këtë derisa ende po vazhdonin luftimet kundër forcave gjermane në viset veriperëndimore të Jugosllavisë, duke pranuar vetëm 430 të vrarë.

Si e trajtoi Aleksandër Rankoviqi Masakrën e Tivarit në Kongresin e komunistëve serbë?

Në ditën e katërt të Kongresit, më 11 maj 1945, ai duke replikuar në diskutimin e Dushan Mugoshës-sekretar i Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit, duke u munduar t’iu hedhë tërë fajin udhëheqjes kosovare, pos tjerash tha: *“...Shoku Mugosha, deklaroi së konsiderohen heronj në Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit ata të cilët vendosin të kritikojnë dhe tha se kjo është shenjë e një farë prapambeturi e këtyre njerëzve. Unë mendoj, së kjo është para së gjithash shenjë e punës jo të drejtë e marrëdhënieve jo të drejta të udhëheqësve tanë ndaj tyre. Mendoj se në radhë të parë kjo është pasojë e një farë frike që sundon te ata njerëz e në veçanti te shqiptarët, për të cilët u fol shumë dhe në lidhje me të cilët u evidentuan disa gabime. Ne do të gabonim nëse këtu në këtë tubim partiak nuk i paraqesim disa gabime të tmerrshëm të cilat janë kryer ndaj shqiptarëve, për të cilët këtu folëm shumë. Ju e dini që në Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit është caktua detyra e mobilizimit. Mobilizimi është zbatuar por organizata partiake, udhëheqja partiake në Kosovë e Dukagjin nuk i mori të gjitha masat*

*që të sigurohet mobilizimi i drejtë, pra që të paraqitën vullnetarisht në ushtrinë tonë, ta kuptojnë së është obligim i tyre që t'i përgjigjen thirrjes së ushtrisë sonë dhe të marrin pjesë në luftë kundër okupatorit dhe tradhtarëve të vendit”.*¹

Më pas Aleksandër Rankoviqi, në vazhdim të diskutimit do të konstatojë se në Kosovë pos tjerash: “...Ndodhën ngjarje të tilla të cilat më së miri flasin edhe për shovinizëm edhe për lokal-patriotizëm dhe në përgjithësi mbi qëndrimin jo të drejtë të komunistë ndaj masave. Gjatë përcjelljes-deportimit të një numri shqiptarësh për plotësimin e njësive të Armatës IV ndodhi një incident i cili nuk ishte i tillë që nuk mund të lokalizohej që pasojat të mos mund të zvogëloheshin. Unë nuk do të hyjë në detaje. Një shqiptar i revoltuar në një përcjellës, hoqi pushkën dhe e vrau. E vrau shokun tonë luftëtar. Por, shokët tonë që në vend se tërë ngjarjen ta zgjidhin, që të mos nxitë grindje, ata kanë dashtë t'i dënojnë, kanë dashtë të zbatojnë reprezalje, deshën të pushkatojnë 40 shqiptarë për një luftëtarë tonin të vranë. Shpërtheu revolta. Disa shqiptarë filluan të hedhin bomba. U hodhën ndoshta disa bomba. Ndërsa, udhëheqësit tonë hapën zjarr dhe vranë 300 shqiptarë. Ky është shembull në të cilin patjetër duhet të mësojmë dhe ne që punojmë me ushtrinë dhe ne që punojmë në teren. Unë mendoj se ajo është çështje e tillë e cila na sjellë dëme të mëdha e që shkatërron jo vetëm autoritetin e ushtrisë sonë por edhe të partisë sonë, shkatërron autoritetin e udhëheqësve tanë...”²

Në vazhdim ai përmend edhe rastin e masakrimit të ushtarëve shqiptarë në Goricë, duke ia lënë fajin për të gjitha këto udhëheqësve politikë të Kosovës. Ai konstaton së: “...Rasti i dytë, që gjithashtu është pasojë e burokratizmit dhe e krimeve të pajustificueshme është që disa shqiptarë nga ai kontingjent u vendosën në lokalet ku më parë ishte një magazinë-baroti. Edhe aty u ngulfatën 130 njerëz, ja këto janë shembuj në të cilat duhet mësuar. Janë shembuj me të cilët

¹ *Osnivački Kongres KP Srbije*, Institut za Istoriju Radničkog Pokreta Srbije, Beograd 1972, f. 157.

² *Po aty*, f. 157-158.

duhet edukuar udhëheqja jonë. Shqiptarët kanë humbur besimin, kjo është e qartë, dhe nuk e kanë humbur për shkak së e ka ndjerë në lëkurën e tyre Jugosllavinë e vjetër, por e kanë humbë edhe për shkak të gabimeve të cilat i kryen udhëheqësit tonë ndaj tyre. E gjithë kësaj, ka mund t'i iket vetëm nëse udhëheqja jonë në Kosovë do ta kishte kryer me rregull mobilizimin dhe do ta kishte kryer me rregull transportin e ushtarëve. Megjithatë, ata ju kanë lënë në duar disa ushtarëve, komandave të vendit, disa burokratëve, disa njerëzve të pa ndërgjegjshëm...”.³

Më duket mjaft me interes të potencohet edhe fakti se në këtë diskutim Aleksandër Rankoviqi, e atakon duke e akuzuar Dushan Mugoshën, i cili gjatë diskutimit të tij ishte ankuar edhe për administratën dygjuhësore në Kosovë. Me këtë rast, Aleksandër Rankoviqi shton se: *“...Shoku Dushan Mugosha, gjithashtu foli për pjatën e dyfishtë, që nënkupton dygjuhësinë, ja ky është shovinizëm në praktikë.”*⁴

Trajtimi i Masakrës së Tivarit nga historiografia në Kosovë

Në vitet ‘90-të të shekullit të kaluar, kur filloi demokratizimi i jetës politike nëpërmes procesit të pluralizmit politik, u krijua një klimë e re më e favorshme edhe për trajtimin e temave të nxehta historike të cilat në monizëm ishte e pamundur që të trajtohen. Në këtë grup të temave hynë edhe Masakra e Tivarit e cila filloi të bëhet temë shqyrtimi e historianëve.

Ndër autorët e parë që në këtë periudhë merret me trajtimin e Masakrës së Tivarit në historiografinë e Kosovës është dr. Muhamet Pirraku, i cili në librin e tij, *“Ripushtimi jugosllav i Kosovës 1945”*⁵, një kapitull të veçantë atë të IX (f. 121-138), e titullon *Masakër në Tivar më 1 prill 1945*, ku në mes të tjerash konstaton se:

³ *Po aty*, f. 158.

⁴ *Po aty*.

⁵ Muhamet Pirraku, *Ripushtimi jugosllav i Kosovës 1945*, Prishtinë 1992.

*“Mobilizimi, rekrutimi i dhunshëm, dhe deportimi i shqiptarëve jashtë Kosovës ishte formë e gjenocidit mbi popullin shqiptar”.*⁶

Për Masakrën e Tivarit një libër të veçantë e boton edhe dr. Hakif Bajrami, me titull *“Tragjedia e Tivarit”*⁷, mirëpo të dhënat që sjellë ky autor për Masakrën e Tivarit janë të paargumentuara qoftë me dokumente relevante, qoftë me atë të dorës së dytë. Ai sjellë shumë ekzagjerime pa mbulesë. Në mes të tjerash, Hakif Bajrami shkruan: *“Të vrarët nuk janë numëruar. Vetëm në rrugët (2 380), por edhe ata që kishin mbetur në ndertës (afro 400), edhe ata që ishin vendosur pranë deponisë (nga 730) që të gjithë (e së pari këta të fundit), ishin bërë ployë. Lidhur me këtë, dokumentet e ruajtura të veprimtarisë së Brigadës X Malazeze vërtetojnë së në Tivar, brenda tri orësh ishin likuiduar afro 4 100 shqiptarë të mobilizuar si plotësim kinse për brigadat e Armatës IV të Jugosllavisë”.*⁸

Një trajtim më të vëmendshëm dhe më përmbledhës për Masakrën e Tivarit e bënë edhe studiuesi nga Tirana dr. Lefter Nasi, në veprën e tij *“Ripushtimi i Kosovës shtator 1944-korrik 1945”*⁹, ku në kuadër të titullit *“Mobilizimi i të rinjve shqiptarë dhe Masakra e Tivarit”* (f. 173-179), trajton këtë çështje me peshë për historiografinë tonë. Autori mbështetet në historiografinë jugosllave, dëshmitarët e ngjarjeve, Arkivin Qendror Ushtarak (AQU), në kujtimet e pjesëmarrësve të mobilizuar si dhe në ndonjë autor e publicist që flet për këtë ngjarje.

Me Masakrën e Tivarit, merret edhe dr. Muhamet Shatri në monografinë, *“Kosova në Luftën e Dytë Botërore”*.¹⁰ Ai në një kapitull të veçantë flet për terrorin dhe gjenocidin në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare gjatë muajve mars-qershor 1945, ku në mes tjerash trajton edhe Masakrën e Tivarit si dhe likuidimin e

⁶ *Po aty*, f. 121.

⁷ Hakif Bajrami, *Tragjedia e Tivarit*, Prishtinë 1993.

⁸ *Po aty*, f. 204.

⁹ Lefter Nasi, *Ripushtimi i Kosovës shtator 1944-korrik 1945*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë-Instituti Historisë në Tiranë, Tiranë 1994.

¹⁰ Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë 1997.

shqiptarëve në brigadat kosovare nga ana e kuadrit komandues të këtyre njësive që në tërësi ishin serbo-malazeze.

Po ashtu, informacione për Masakrën e Tivarit hasim edhe në librin e autorit të kësaj kumtese, me titull “Gjilani me rrethinë në Luftën e Dytë Botërore”¹¹, ku në një kapitull të veçantë, ofrohen të dhëna për masakrat e njësive partizane në territorin e gjerë të Gjilanit, por edhe jepen të dhënat edhe për Masakrën e Tivarit dhe dimensionin e saj historik si ngjarje e veçantë dhe shumë e dhimbshme për shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Sa ishte numri i të vrarëve në Masakrën e Tivarit?

Një problem shumë me rëndësi për të ardhur deri te e vërteta për masakrën e Tivarit është edhe saktësimi i numrit të të vrarëve dhe i të plagosurve si dhe i atyre që e përjetuan atë tmerr. Të dhënat për numrin e të vrarëve në Tivar janë të ndryshme dhe kontradiktore. Ai varet nga burimet që autorët iu referohen. Ende nuk ka një listë të plotë dhe të saktë të atyre që u vranë në këtë masakër, por as para dhe pas saj. Kjo mungesë e pasaktësisë vije për shkak se organet ushtarake dhe shtetërore i kanë fshehur të dhënat për opinion, ngase arkivat serbe e jugosllave në të cilat besohet se duhet të ekzistojnë të dhënat vazhdojnë të jenë të mbyllura për studiuesit shqiptarë.

Në fakt duhet të ceket se shumica e pjesëmarrësve të mbetur gjallë, por edhe e atyre që kanë shkruar për këtë ngjarje dhe deri në vitet e ‘90-ta ka qenë temë e ndaluar për arsye të njohura politike. Ata tani në kujtimet dhe shkrimet e tyre nuk hezitojnë edhe t’i zmadhojnë të dhënat për viktimat, e kjo ndoshta mund të arsyetohet për faktin se këto shkrime, por edhe këto deklarata e kujtime të shkruara janë dhënë dhe janë shkruar në periudhën pas shthurjes së sistemit komunist në Jugosllavi e sigurisht që ka ndikuar edhe urrejtja e madhe, por edhe frustrimi disa dekadash që akterët nuk

¹¹ Fehmi Rexhepi, *Gjilani me rrethinë në Luftën e Dytë Botërore*, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë 1998.

kanë mundur dhe nuk kanë guxuar t'i shpalosin mendimet e veta për hir të pasojave politike, por edhe dënimeve të paimagjinueshme.

Shumë autorë dhe disa publicistë e ekzagjerojnë numrin e të vrarëve në Masakrën e Tivarit të vitit 1945. Rasti është *sui generis*, pra i veçantë në historinë e luftërave sepse nuk ka raste në botë që eprorët dhe oficerët t'i vrasin ushtarët e vetë pa ndonjë gjyq, qoftë edhe ai gjyq formal. Nisur nga ky argument mendojmë se është detyrë dhe nder i historianëve që të nxjerrin numrin e saktë të viktimave të Masakrës së Tivarit. Aq më tepër kur kjo masakër është frymëzuar nga ndjenjat e racizmit antishqiptar. Edhe ky fakt shton nevojën për t'u marrë me seriozitetin e duhur studiuesit e kësaj ngjarje tragjike të historisë së popullit shqiptar.

Disa autorë shkruajnë se janë vrarë 1 700-2 000, disa 3 000, e disa edhe 4 000, si dhe rasti me eklatant është ai i Hakif Bajramit, i cili pa asnjë mbështetje dokumentare thekson se në Tivar u vranë mbi 7 100 shqiptarë. Këto shifra me duket janë të ekzagjeruara, sepse po të nisemi nga fakti se të gjithë të mobilizuarit që janë vrarë në Tivar janë trajtuar më pas si dëshmorë të rënë në Luftën Nacionalçlirimtare. Faktet flasin se gjithsej statusin e dëshmorit të LNÇ-së në Kosovë e kanë gëzuar mbi 6 200 veta të të gjitha nacionaliteteve që jetonin në Kosovë e që shumica prej tyre siç dihet ishin serbë e malazezë. Shtrohet pyetja sikur të ishin vrarë 4 000 apo 7 100 në Tivar, atëherë ku mbetën pjesëtarët e tjerë të LNÇ-së në Kosovë që kanë rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore në të gjitha fushëbetetj anekënd Kosovës dhe viseve të tjera në ish-Jugosllavi.

Për të shuar një mal paqartësish dhe për të ardhur deri te e vërteta e ngurtë për numrin e të masakruarve në Tivar më 1945, do të ishte mirë të ndërmerret një angazhim i Institutit të Historisë, që të vjelë të dhënat arkivore në arkivat shqiptare dhe jugosllave, duke i krahasuar me të dhënat në terren, për të ardhur deri te një e vërtetë e përafërt, sepse e vërteta absolute nuk ekziston.

Haki KASUMI

MASAKRA E TIVARIT - SHKAQET DHE PASOJAT

Në përfundim të vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945 zhvillimet e operacioneve të Luftës së Dytë Botërore në këtë pjesë të Gadishullit Ballkanik ishin intensive, jo ndërmjet blloqeve ndërluftuese, por ndërmjet grupeve etnike, civilizimeve dhe ideologjive të popujve të këtyre viseve.

Fqinjët, të cilët e konsideronin veten të fortë në mënyra dhe forma të ndryshme, pa zgjedhur mjete, vepronin në realizimin e planeve dhe projekteve të tyre nacional-shoviniste, raciste dhe gjenocidale. Në këtë drejtim dalloheshin sidomos forcat nacionaliste serbo-malazeze, të cilat pas amnistisë së përgjithshme të çetnikëve nga Kryesia e Këshillit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë (KAÇKJ), në nëntor të vitit 1944,¹ nën maskën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare bënë krime të njëpasnjëshme ndaj popullatës shqiptare, duke filluar me masakrën në Preshevë, Gjilan, Ferizaj, Drenicë, ku kryen masakra ndaj popullatës civile shqiptare. Forcat nacional-shoviniste antishqiptare vazhduan veprimet e tyre me përmasa edhe më të mëdha prej një kohe në kohën tjetër. Planet e

¹ Hakif Bajrami, *Tragjedia e Tivarit*, Prishtinë, 1993, 114- 117; Hakif Bajrami, *Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës (1844- 1995)*, Prishtinë 1995, 145.

tyre kriminale kishin të bënin me vrasjen në masë sa më të madhe të shqiptarëve dhe shtimin dhe zgjerimin e presioneve të llojllojshme. Këto veprime mbështeteshin edhe në dy projektet famëkeqe të Vasa Çubriloviçit (të 7 marsit 1937 dhe atë të 3 nëntorit 1944).² Këto programe iniciuan mizori mbi shqiptarët dhe u bënë edhe platforma të të ashtuquajturës Lëvizja Nacionalçlirimtare e Jugosllavisë, e cila udhëhiqte luftën. Sipas idesë ultraraciste të Çubriloviçit, dy janë mënyrat për spastrimin etnik të shqiptarëve: “t’i zhdukim ose t’i shpërngulim”.³ Në zbatim ishte vu mënyra e tretë, që ishte kombinimi i dy të parave dhe i’u shtua edhe vrasja në masë e shqiptarëve nga forcat e armatosura të ashtuquajtura partizane.

Këto dhe rrethana të krijuara në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare në këtë kohë të vështirë të luftës e kishin rënduar edhe më tepër gjendjen e përgjithshme. Ndikim të fuqishëm negativ ushtroi edhe urdhri për mobilizimin e më se 30 000 shqiptarëve për “nevoja të Armatës Jugosllave, në Serbi, Vojvodinë, Bosnje e Hercegovinë, Kroaci e Slloveni” dhe dërgimin e tyre në “front” për të plotësuar radhët e Armatës IV Jugosllave, të cilin e kishte dhënë Shtabi Suprem i Armatës Jugosllave dhe të cilin e zbatuan shtabet operative të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë (UNÇJ), përfshirë edhe atë të Kosovës, si dhe shtabet e Divizioneve V e VI të UNÇ-së të Shqipërisë.⁴ Njëkohësisht nga Kosova do të largoheshin shumica e brigadave partizane të Kosovës, ku kishte edhe ushtarë shqiptarë. Kështu, përpos forcave prej 15 260 luftëtarëve, që kishte Brigada VII e Kosovës, duhej të shkonin në drejtim të Vërshacit e të Sremit edhe 10 000 rekrutë të mobilizuar shqiptarë, kurse për nevojat e Armatës IV të AJ-së në Kroaci e Slloveni do të niseshin gjatë marsit dhe prillit

² Vasa Qubriloviq, *Elaborati për shfarosjen e shqiptareve (7 mars 1937)*; Hakif Bajrami, *Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës (1844-1995)*, Prishtinë, 1995, 139.

³ Vasa Qubriloviq, *Problemi i pakicave kombëtare në Jugosllavinë e re, Elaborati III (Kapitulli shqiptarët)*; Si shënimi 1, f. 157).

⁴ Uran Butka, *Masakra e Tivarit dhe përgjegjësia e shtetit shqiptar*, Tiranë 2011, 45.

të vitit 1945 edhe rreth 13 000 rekrutë shqiptarë të posa mobilizuar.⁵ Këta shqiptarë do të dërgoheshin si të mobilizuar, të paarmatosur të përcjellë nga rojet jo shqiptare të cilët ishin të armatosur deri në dhëmb, përmes rrugës Prizren-Kukës-Shkodër-Tivar-Dubrovnik-Split. Nga ana e Shtabit Suprem të Jugosllavisë u përdor taktika e largimit nga Kosova e forcave ushtarake të saj, por edhe e të gjithë rekrutëve të mobilizuar me dhunë.

Kështu u urdhërua Shtabi Operativ i Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe i Aradhave Partizane (UNÇ-së e AP) të Kosovës e Metohisë (Dukagjinit), që disa brigada kosovare ta linin Kosovën dhe të zhvendoseshin në Vojvodinë e në Bosnjën Lindore, për t'ua lënë vendin aradhave të ushtrisë jugosllave, si edhe forcave të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë. Brigada e VI dhe e VII kosovare kishin respektuar urdhrin dhe ishin nisur. Kësaj të fundit iu kishte bashkangjitur edhe Brigada e Shaban Palluzhës,⁶ që luftonte me flamurin shqiptar, pa yllin e kuq. Fillimisht Shabani nuk donte të largohej nga Drenica, sepse do ta linte atë pa mbrojtje. Pas përpjekjeve dhe presionit nga udhëheqësit e lartë partizanë të Kosovës ajo pranoi të nisej të shkonte në drejtim të Sremit, por me kusht që të kthehej menjëherë nëse vritej qoftë edhe një shqiptar i vetëm i pafajshëm në Drenicë. Rrugës për në Podujevë kishte arritur lajmi se kishin nisur masakrat në Drenicë nga forcat e Brigadës 27 serbe.⁷ Shaban Palluzha ashtu si kishte thënë edhe veproi, u kthye në Drenicë.⁸

Në kushtet dhe rrethana e krijuara në Kosovën e kësaj periudhe filloi edhe mobilizimi i dhunshëm i rekrutëve shqiptarë kudo ishin ata. Pasi ishin grumbullua shumë rekrutë shqiptarë kolona e parë, ashtu si ishte planifikuar, u nis nga Prizreni për në Shkodër më 24 mars 1945, në ora 7:00. Në bazë të të dhënave ushtarake kjo kolonë kishte 2 600 shqiptarë të mobilizuar të paarmatosur, që

⁵ *Po aty*, 45.

⁶ AVII Beograd, NOB. K1341-4-2/1; Uran Butka, *Vepër e cituar*, f. 45; Hakif Bajrami, *Si e okupoi Kosovën Jugosllavia*, Libri 3, Prishtinë, 2015, 77.

⁷ Islam Dobra, *Lufta e Drenicës 1941- 1945*, Prishtinë 1995, 221.

⁸ Si shënimi 1, 182-183; Uran Butka, *vepër e cituar*, 52.

shoqëroheshin nga 30 udhëheqës të brigadave dalmatine dhe një batalion i Brigadës 27 serbe.⁹ Me trajtim shtazarak dhe me masa të rrepta arritën në Shkodër më 27 mars, ndërsa në mbrëmje 2 390 rekrutë shqiptarë të cilët iu dorëzuan Divizionit IX. Ata në Tivar arritën më 30 mars 1945 në ora 13:00. Në ndërkohë rekrutët e kësaj kolone, sipas planeve ushtarake, ishin nda në tri eshalone. Eshaloni i parë ishte nisë për Dubrovnik, i dyti ishte sulmua në selinë ku ishin vendosur dhe po pritnin për t'u deportuar në vijën e frontit të Adriatikut.¹⁰ Ngjashëm ishte vepruar edhe me rekrutët e eshalonit të tretë.

Kolona e dytë ishte nisur më 26 mars 1945 në ora 6:00 të mëngjesit, ndërsa në përbërje kishte 2 400 rekrutë shqiptarë të shoqëruar nga Brigada 27 serbe dhe një batalion. Trajtimi gjatë rrugës ishte mizor dhe vrastar. U inskenuan shumë skena provokuese dhe u vranë njerëzit pa ndonjë shkas. Tmerri makabër ndodhi në Tivar ku u vranë me armë zjarri me qindra njerëz të paarmatosur.¹¹

Kolona e tretë përbëhej kryesisht prej shqiptarëve të viseve shqiptare në Maqedoni (Gostivar, Tetovë, Kumanovë dhe Shkup). Kishte në përbërje 2 700 rekrutë të gjithë shqiptarë të paarmatosur, që nga Prizreni u nisën më 27 mars 1945 në ora 6:00 të mëngjesit nën përcjelljen e një batalioni të Brigadës 27 të Serbisë.¹² Ata provuan peripeci dhe vuajtje të shumta, por më së rëndi e pësuan në kalimin e lumit Buna, ku u inskenua kinse, shoqëruesin serb e hedhën në lum shqiptarët.¹³ Edhe këtu mbetën të vranë disa qindra rekrutë shqiptarë.

Gjithashtu, edhe në muajin prill u deportuan tri kolona rekrutësh shqiptarë,¹⁴ të cilët përjetuan tmerrin dhe shumë prej tyre u

⁹ Si shënimi 4, 119; Hakif Bajrami, *vepër e cituar*, 193.

¹⁰ *Po aty*, 131

¹¹ *Po aty*, 135- 147; Islam Dobra, *Lufta e Drenicës 1941- 1945*, 227; Hakif Bajrami, *vepër e cituar*, 196.

¹² Si shënimi 1, 211- 212; Islam Dobra, *vepër e cituar*, 227.

¹³ *Po aty*, 213; Si shënimi 4, 233.

¹⁴ *Po aty*, 215; Si shënimi 4, 245.

vranë mizorisht dhe lanë eshtrat e tyre nëpër humnera të rrugës së tmerrit kah u detyruan të kalonin.

Si pasojë e planeve dhe veprimeve kriminele të njësiteve ushtarake serbo-malazeze, përkatësisht jugosllave, në Masakrën e Tivarit, brenda dy muajsh u vranë, u mbytën, u helmuan dhe u zhdukën në tragjedinë e Tivarit rreth 3 500 rekrutë shqiptarë të mobilizuar të paarmatosur, por të gatshëm që t'i bashkëngjiteshin luftës kundër pushtuesit gjerman të viseve shqiptare dhe të viseve fqinje serbe, malazeze e maqedonase. Shifrat e numrit të viktimave të kësaj tragjedie shqiptare sillen prej 300 (burimet serbe-jugosllave), ndërsa ato shqiptare arrin deri në 7 000 rekrutë të paarmatosur të vrarë e të masakruar në forma e mënyra të ndryshme. Pjesa tjetër, disa mijëra që mbetën gjallë, u traumatizuan dhe mbetën me pasoja të rënda shëndetësore deri në vdekje.

Qerim LITA

RRETHANAT POLITIKE E USHTARAKE NË TREVAT VERILINDORE SHQIPTARE, NËNTOR 1944-NËNTOR 1945

Krimet e njërive komuniste jugosllave ndaj popullsisë civile shqiptare

Zhvillimet politike e ushtarake pas kapitullimit të Bullgarisë (8 shtator 1944) në trevat verilindore shqiptare, dëshmuar se udhëheqja e Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ), përkatësisht e Partisë Komuniste të Maqedonisë (PKM), se përmes parullave demagogjike, tentonin të krijojnë përçarje brenda strukturave politike e ushtarake shqiptare, që në atë kohë kishin krijuar një bashkim të fuqishëm, si politik po ashtu edhe ushtarak. Kjo u pa gjatë muajit shtator, në luftimet e rrepta në mes brigadave komuniste jugosllave dhe forcave vullnetare shqiptare, ku, për kundër faktit se forcat komuniste jugosllave dominonin si për nga numri i ushtarëve, po ashtu edhe për nga armatimi, ata nuk arritën t'i pushtonin tokat e liruara shqiptare. Të vetëdijshëm për këtë, komandanti i Shtabit të Përgjithshëm (SHP) të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Maqedonisë (LNÇM), Mihajllo Apostollski, në pjesën e dytë të shtatorit, udhëtoi për Sofje, ku arrin marrëveshje me udhëheqësin e PKB-së¹, që brigadat partizane

¹ Partia Komuniste e Bullgarisë.

bullgare të vendosen në Maqedoni. Sipas marrëveshjes, këto brigada duhej të vepronin nga Kriva Pallanka në drejtim të Kumanovës. Veç kësaj, Apostollski, me pëlqimin e udhëheqjes komuniste bullgare në Sofje, bënë mobilizimin e ushtarëve të ish-armatës fashiste bullgare me prejardhja nga territori i Maqedonisë. Për këtë, SHP i LNÇM-së, më 27 shtator 1944, njoftonte Shtabin e Zonës IV Operative, se: “Gjeneral Apostollski në Sofje ka bërë pranimin e të gjithë maqedonasve të cilët kanë qenë në ushtrinë bullgare, i ka armatosur me armatim sovjetik dhe ka bërë organizimin e shumë njësive”.²

Më herët, midis SHP-së të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë (LNÇJ) dhe atij të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Shqipërisë (LNÇSH), ishte arritur marrëveshje që në këto treva të vendoseshin brigadat partizane shqiptare³. Dërgimi i brigadave partizane shqiptare në krahinat e lartpërmendura ishte kërkesa e kamotshme e kreut udhëheqës të PKJ-së, andaj nuk ishte e rastit që menjëherë pas kësaj marrëveshjeje të pasojnë urimet e përzemërta si nga SHP-ja e LNÇM-së, po ashtu edhe nga vetë Tito, drejtuar Enver Hoxhës. Në letrën përshëndetëse që SHP-ja e LNÇM-së ia dërgoi Enver Hoxhës, veç tjerash, thuhej: “Ne krenohemi dhe ia urojmë emërimin Komandantë Suprem dhe gradën Gjeneral-kolonel shokut Enver Hoxha, dhe i dëshirojmë sukses në luftën heroike që po zhvillon populli shqiptar dhe ushtria e saj heroike të LNÇ-së nën udhëheqjen e djemve më të mirë të popullit shqiptarë...”.⁴ Ndërsa, Tito, në letrën e tij, fillimisht shprehë “krenarinë e admirimit për luftën këmbëngulëse dhe të pakursyer të patriotëve shqiptarë për lirinë kombëtare kundër okupatorëve fashistë dhe veglave të tyre..”, për të vazhduar: “Ndërmjet vëllazërimit me armë lindi dashuria e madhe midis popujve të Jugosllavisë dhe forcave çlirimtare të Shqipërisë..”.⁵

² Државен архив на Република Македонија (më tej ДАРМ), Ф. Главен Штаб на НОВ и ПОМ на Македонија, 27. IX. 1944 г. С. Г. Врановци.

³ AQSH, F. 41/AP, D. 135, v. 1944, fl. 6.

⁴ AQSH, F. 41/AP, D. 135, v. 1944, fl. 7.

⁵ AQSH, F. 41/AP, D. 135, v. 1944, fl. 2.

Ashtu siç edhe pritej, posa u vendosën brigadat partizane shqiptare, njësitë ushtarake komuniste jugosllave ndërmorën një aksion të tmerrshëm kundër popullsisë shqiptare, që nga Struga e deri në Kumanovë, me ç'rast vranë dhe masakruan qindra shqiptarë të pafajshëm, mijëra të tjerë arrestuan, duke i vendosur nëpër kampet e përqendrimit, nëpër kazermat ushtarake e lokalitete tjera, siç ishin: Monopoli i Duhanit në Tetovë, kazermat ushtarake në Kërçovë e Gostivar, pastaj shkollat në Saraqinë e Grupçinë⁶, kampet e përqendrimit në Vaksincë e Preshevë etj.⁷ Veprimet e tilla kryheshin me urdhër të udhëheqjes së lartë politike e ushtarake maqedonase.

Këtë më së miri e dëshmon urdhëresa e lëshuar më 18 nëntor 1944 nga ana e Shtabit të Korpusit XV të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Maqedonisë (LNÇM), në të cilën kërkohej nga brigadat partizane të Divizionit 48, ku merrte pjesë edhe Brigada IV Shqiptare, që: “më datën 19 nëntor 1944 të bëjnë bllokadë në qytetin e Gostivarit”, pastaj të grumbullojnë e tërë popullatën mashkullore, që ishte e aftë të mbajë armatim dhe t'i vendosin nëpër llogore në ndonjë ndërtesë ku do ta “gjeni ju që është e përshtatshme për atë çështje”. “Në të njëjtën kohë të grumbullohej i gjithë armatimi, municioni, si dhe arsenalit tjetër ushtarak”. Është me interes të shpaloset edhe pjesa e dytë e urdhëresës së mësipërme, në të cilën thuhej se aksionin duhej ta kryenin tri brigadat maqedonase, ndërsa brigada shqiptare të vendosej në kazermën e qytetit për të pushuar. Ja se çfarë thuhej në të: “Nga hekurudha Gostivar-Kërçovë deri te rruga Gostivar-Dibër do ta kryejë Brigada 15; nga rruga Gostivar-Dibër deri te rruga Gostivar-Tetovë do ta kryejë Brigada VI; nga rruga Gostivar-Tetovë deri te hekurudha Gostivar-Kërçovë do ta kryejë Brigada I; regjionin deri te distanca e Brigadës së Parë bllokimin do ta kryejë Brigada 15; Brigada IV do të vendoset në kazermë e qytetit të Gostivarit për pushim dhe përmes rojës do ta sigurojë vetveten”.⁸

⁶ Lefter Nasi, Ripushtim i Kosovës - shtator 1944 korrik 1945, Tiranë 1994, f. 131-133.

⁷ ДАРМ. 1. 267. 2. 9127/1-6.

⁸ ДАРМ.1. 254. 1. 6576/1-33.

Sjelljet çnjerëzore të njësive komuniste jugosllave detyruan popullsinë e pambrojtur shqiptare t'i lëshojnë vatrat e tyre për t'u vendosur në vende më të sigurta. Shtabi i Brigadës XVII, më 16 nëntor njoftonte se në fshatrat: Strimë, Riovcë, Gllazhnjë, Goshincë, Dumanocë dhe Izvor, qëndrojnë rreth 10 000 shqiptarë të arratisur nga fshatrat: Nakushtak, Vishticë, Ropalcë, Mateçë, Hotël, Likovë, Orizare dhe Sllupçan,⁹ kurse pjesa tjetër, si Llojan, Vaksincë, Miratoc, gjeti strehim në Shurdhan etj¹⁰.

Një ngjarje tjetër që tronditi thellë opinionin e gjerë shqiptar ishte masakra e kryer në fshatin Bllacë të Shkupit, më 18 nëntor 1944, nga ana e Brigadës XVI, ku nga të dhënat tashmë të konfirmuara u masakruan 210 burra të këtij fshati. Pushkatimi i tyre u krye me pretekst se ato nuk e kishin dorëzuar armatimin, respektivisht, siç thuhet në raportin e shtabit të brigadës: “për shkak sjelljes së keqe luftëtarët tanë aq shumë reagueshan, sa që me një mund të madh arritëm ta pengojmë kasaphanën e vërtetë ndaj shqiptarëve, por megjithatë në këtë drejtim nuk u arrit shumë, sepse luftëtarët depërtuan deri te vendi ku shqiptarët ishin të vendosur, ku arritën të ndajnë një numër shumë të madh dhe të njëjtit i ekzekutuan”¹¹.

Brigadat komuniste serbo-maqedonase, nga 20 nëntori, depërtuan në territorin e sotëm të Kosovës dhe të Preshevës edhe atë: Brigada XVI qëndronte në fshatrat shqiptare midis Bllacës dhe Kaçanikut, Brigada XVIII, në regjionin e Ferizajt, ndërsa Brigada XVII në territorin midis Mateçit dhe Preshevës. Në anën tjetër, një pjesë e forcave vullnetare shqiptare në numër prej rreth 4 000 ushtarësh shtriheshin në përfundim të Preshevës¹², respektivisht fshatrat: Kurbali, Rincë, Runicë, Strimë, Brezë, Mjak dhe në verilindje në drejtim të Podgraxhës, ndërsa një pjesë tjetër vepronte në territorin Kaçanik-Nerodime-Ferizaj.

⁹ ДАРМ. 1. 291. 1. 6926/1-2.

¹⁰ ДАРМ.1. 292. д. 9139. 16 новембар 1944 год.

¹¹ ДАРМ. Ф. 292. док бр. .6926, 20. XI. 1944 год..

¹² ДАРМ.1. 267. Пов. Бр. 152, 24. XI. 1944 год.

Në rrethana kur brigadat komuniste serbo-maqedonase zbatonin një gjenocid të paparë mbi popullatën civile shqiptare, te krerët nacionalistë shqiptarë u paraqitën dy mendime që binin ndesh njëra me tjetrën. Përderisa krerët nacionalistë shqiptarë, që vepronin në regjionin e Kaçanikut, Nerodimes dhe Ferizajt, e panë të arsyeshme të futeshin në bisedime me të deleguarin e Shtabit të LNÇJ-së për Kosovë, për formimin e brigadave partizane shqiptare, të cilat do ta mbronin popullatën nga çfarëdo lloj krimi i mundshëm nga ana e brigadave maqedonase, në anën tjetër, krahu që vepronte në Karadak, refuzonte çfarëdo lloj bisedimesh, me autoritetet e Brigadës XVII, madje ata kërkonin që forcat komuniste serbo-maqedonase të tërhiqen nga territoret shqiptare, sepse në të kundërtën do të sulmoheshin.¹³ Ky qëndrim u mor në Kuvendin e organizuar më 23 nëntor 1994 në fshatin Raincë.¹⁴

Rreth këtyre ngjarjeve Shtabi i Divizionit të Kumanovës, më 24 nëntor, i raportonte Shtabit Kryesor (SHK) të LNÇJ-së për Maqedoni, ku ndër të tjerave paralajmëronte “rrezikun” nga “krijimi i brigadave shqiptare”, nga shkaku se ato po krijohen, siç thuhet në të: “me direktivën e të deleguarit të Shtabit për Kosovë dhe Metohi, pa shkuar fare në çarmatosjen e përgjithshme të shqiptarëve”. Kjo për mendimin e tyre “sjellë një pasqyrë të shëmtuar nga shkaku se qëndrimi i shqiptarëve në sektorët tjerë dhe siç jemi ne të njoftuar, të gjitha ato forca të tyre mbajnë lidhje për një sulm të përbashkët kundra njësive tona, menjëherë pasi të tërhiqen njësitë bullgare”.¹⁵

Dy ditë pas këtij raporti, Shtabi i Përgjithshëm i LNÇJ-së për Maqedoni lëshoi një urdhëresë në të cilën iu kërkuar Shtabit të Divizionit të Kumanovës që me brigadat e veta më 28 nëntor të kryejë një aksion të përgjithshëm mbi fshatrat shqiptare të Kaçanikut, Ferizajt, Vitisë, Gjilanit, Kumanovës dhe të Preshevës. Krahas brigadave të atij divizioni, në aksion do të marrin pjesë edhe Brigada XII e Divizionit 42 dhe dy batalione të Divizionit 50. Më tej, SHK-ja

¹³ *Po aty.*

¹⁴ ДАРМ. 1. 267. Пов. Бр. 6540. 26.XI.44 год., Куманово.

¹⁵ ДАРМ. 1. 267. Пов. Бр. 152.24. XI. 1944 год.

e LNÇJ-së për Maqedoni urdhëronte që “gjatë marshimit ose luftimeve në qoftë se haset në ndonjë rezistencë armiqësore, të gjithë ata shqiptarë, të cilët janë të armatosur, si edhe ata të cilët e kanë fshehur armatimin dhe gjatë kontrollimit zbulohen aty për aty të ekzekutohen”. “Të gjitha vendbanimet” - vazhdonte urdhëresa - “ku do të depërtoni detajisht të kontrollohen dhe të gjithë meshkujt nga mosha prej 16 deri 50 vjeç t’i merrni nëpër llogore dhe t’i koncentroni në territoret e brigadave të juaja”.¹⁶

Për rrjedhojë, më 29 nëntor, në orët e hershme të mëngjesit, brigadat e Divizionit të Kumanovës dhe të Divizionit 42, sipas urdhëresës së lëshuar, marshuan në vendbanimet shqiptare edhe atë Brigada XII në fshatrat Kurbali, Mjak, Brezë, ndërsa Brigadat XVI dhe XVIII nga Ferizaj në drejtim të Vitisë. Gjatë këtij marshimi, nën pretekstin e çarmatosjes së popullatës dhe të shtypjes së “reaksionit”, u vranë, masakruan e u arrestuan qindra banorë shqiptarë të fshatrave që shtriheshin midis Ferizajt, Kaçanikut dhe Gjilanit.¹⁷ Sipas të dhënave që i ofronte Shtabi i Divizionit të Kumanovës, numri i të vrarëve ishte mbi 200, ndërsa 100 të tjerë ishin arrestuar si edhe ishin djegur dhe plaçkitur shumë fshatra.¹⁸

Një masakër e ngjashme si ajo Bllacës, u krye në fshatin Izvor nga ana e Brigadës XVII. Ngjarja tragjike ndodhi më 29 nëntor pas një marrëveshje paraprake midis parisë së fshatit dhe Shtabit të kësaj brigade, një batalion u fut në fshat. Me pretekst se fshatarët e Izvorit, paskan përgatitur një atentat ndaj Shtabit të këtij batalioni, u arrestuan të gjithë meshkujt e këtij fshati në numër 44 vetash dhe që të gjithë përnjëherë u ekzekutuan. Njëkohësisht i jepet zjarri fshatit.¹⁹

Krimet dhe masakrat partizane ndaj popullsisë civile shqiptare e shtynë nënkryetarin e Frontit Popullor të Republikës Federale të Maqedonisë, Hasan Shukriun, të reagojë, i cili në mbledhjen që u mbajt më 7 dhjetor 1944 vuri në dukje për disa ngjarje “të

¹⁶ ДАРМ.1. 267. Пов. Бр. 6540, 26. XI. 44. год., Куманово.

¹⁷ ДАРМ. 1. 267. Пов. Бр. 113. 29. XI. 1944 год.: по ату , Пов.Бр.115. 30.XI.1944 год.; Lefter Nasi, vepër e cituar f. 142-151.

¹⁸ ДАРМ. 1. 267. 24. 3. XII. 1944 год. Куманово.

¹⁹ По ату.

pakëndshme dhe arbitrare” nga ana e forcave partizane, ndaj popullsisë shqiptare, ku ndër të tjerash tha se “në fshatin Sopot të Kumanovës janë vrarë 66 fshatarë, edhe pse ky fshat nga e kaluara u ka ndihmuar partizanëve, në fshatin Malishevë janë vrarë 42 persona, në fshatin Izvor 40 vetë, fshatin Vaksincë 16 vetë. Në Tetovë janë burgosur 5 000 vetë prej të cilëve 17 vetë kanë vdekur nga uria....” etj. Pas këtij referimi të Hasan Shukriut, në mbledhje u soll vendimi që: “të lëshohet një qarkore në të cilën do të sqarohej se cili mund të burgos, të gjykojë, të kryej kontroll etj., e cila do të dërgohet deri te ushtria, OZN-së (Organizacija za Zaštitu Naroda - Organizata për Mbrojtjen e Shtetit Q. L.), Presidiumi”²⁰.

Mirëpo, përkundër këtij vendimi, pushteti komunist maqedonas vazhdonte dhunën dhe terrorin ndaj popullsisë shqiptare. Gjyqi Ushtarak i Qarkut Ushtarak të Shkupit më 14 janar 1945 dënoi më vdekje dhe humbje të të drejtave qytetare dhe konfiskimin e pasurisë këta qytetarë: Ramadan Qazim Azizi nga fshati Matejçe i Kumanovës, i moshës 30-vjeçare; Asan Zeqir Azizi nga fshati Matejçe, i moshës 30-vjeçare; Sadik Ramiz Jakupi nga fshati Matejçe, i moshës 40-vjeçare; Bexhet Musli Dalipi nga fshati Matejçe, i moshës 45-vjeçare; Jusuf Ismail Neziri nga fshati Matejçe, i moshës 45-vjeçare; Abdulla Ebip Abdullahu nga fshati Hotle, i moshës 36-vjeçare, për shkak se ka qenë një ndër udhëheqësit shpirtëror i forcave balliste në rajonin e Kumanovës, si dhe se ka qenë i emëruar si prefekt i këtij rajoni nga ana e “reaksionit shqiptaromadh” dhe se gjoja ka kryer shumë krime; Osman Selim Hiseni nga fshati Matejçe, i moshës 47-vjeçare; Shaip Rexhep Memeti nga fshati Vaksincë, i moshës 28-vjeçare; Jusuf Xhemail Imeri nga fshati Vaksincë, i moshës 23-vjeçare; Ahmet Beqir Abdullahu nga fshati Llopatë, i moshës 26-vjeçare; Hajri Islam Sadiku nga fshati Vishticë, i moshës 50-vjeçare; Musa Hasan Eshtrefi nga fshati Matejçe, i moshës 32-vjeçare; Jusuf Zyber

²⁰ ДАРМ. Ф. НФ на Македонија, 1.34.9/33-34, Протокол од заседанието на Секретариатот на Главниот Одбор на НОФ на Македонија, одржано на 7.XII.1944 год.

Nuredini nga fshati Matejçë, i moshës 58-vjeçare; Jashar Feta Jashari nga fshati Matejçë, i moshës 49-vjeçare; Bajram Idriz Beqiri nga fshati Matejçë, i moshës 38-vjeçare; Halit Abdulla Shabani nga fshati Matejçë, i moshës 58-vjeçare; Raim Beqir Fazliu nga fshati Matejçë; Halit Shukri Hebibi nga fshati Likovë, i moshës 56-vjeçare dhe Osman Hiseni nga fshati Matejçë, i moshës 47-vjeçare²¹.

Paralel me këto masa antinjerëzore, pushteti i ri komunist maqedonas, karshi faktorit ndërkombëtar, në muajin dhjetor do të mbajë tubime në vendbanimet shqiptare, ku popullatën shqiptare e nxjerrin me dhunë në sheshet e qyteteve, ku do të flasin edhe disa komunistë shqiptarë. Në janar të vitit 1945, Liri Belishova, anëtare e Byrosë Politike e KQ-së të PKSH-së, e cila në Shkup mori pjesë në Konferencën e Rinisë Ballkanike, fjalimin e saj do ta ketë në frymën e vëllazërim-bashkimit, pa asnjë fjalë kritike ndaj sjelljeve të ushtrisë jugosllave ndaj popullit shqiptar, duke u shprehur me fjalët: “Vëllazërimin tonë me rininë jugosllave e kemi forcuar në luftën për Dibrën dhe në luftërat e territoreve të tjera të Jugosllavisë. Ne kemi bërë kumari në burgjet, për kundër provokimeve të shumta për të na detyruar të luftojmë kundër njëri-tjetrit, ta ngremë Ushtrinë tonë Nacionalçlirimtare kudër Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Mareshalit Tito. Edhe përkundër të gjitha atyre përpjekjeve ne nuk qëndruam kundër njëri-tjetrit, simpatia-dashuria e rinisë shqiptare ndaj rinisë jugosllave sot është shumë e madhe”.²²

Themelimi i Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare në Shkup

Për dallim nga komunistët shqiptarë, intelijenca e atëhershme shqiptare e pa më se të domosdoshme themelimin e një organizate ilegale shqiptare, qëllimi final i së cilët do të ishte: “çlirimi dhe bashkimi i tokave të robëruara shqiptare me Shqipërinë”.²³ Ndër

²¹ ДАРМ. Фонд. 468. кут. 2, па numër.

²² ДАРМ. Фонд. 468. кут. 2, па numër.

²³ ДАРМ. 1. 1101, 6. 12/523-578.

shkaqet më të rëndësishme, përveç krimit dhe masakrimit të popullsisë shqiptare nga njësitë pushtuese ushtarake jugosllave, që e shtynë inteligjencën shqiptare të veprojë ilegalisht, duhet veçuar edhe: “mohimin e së drejtës për vetëvendosjes të shqiptarëve në Kosovë dhe në viset veriperëndimore të Maqedonisë”,²⁴ si dhe përpjekjet e disa pushtetarëve të qytetit, që në Shkup të mos hapen shkolla shqipe, por vetëm ato turke, sepse sipas tyre “në qytetin e Shkupit nuk ka shqiptarë, por vetëm turq”.²⁵

Duhet të vëmë në dukje faktin se shqiptarëve jo vetëm se ju mohua e drejta e vetëvendosjes, por madje atyre ju morën edhe disa të drejta të pakta qytetare e kombëtare, që ju ishin garantuar me vendimet e ASNOM-it (Antifašističko Sovranje Oslobodjenja Makedonije - Këshilli Antifashist i Çlirimit Kombëtar të Maqedonisë) siç ishin përdorimi i lirë i flamurit kombëtar, pjesëmarrja proporcionale në këshillat popullorë, përdorimi i gjuhës shqipe dhe përfshirja e barabartë e shqiptarëve në administratën e komunave ku ata jetonin etj. Mosdhënien e këtyre të drejtave autoritetet komuniste të Shkupit e arsyetonin gjoja nga “pakënaqësia e popullsisë maqedonase në viset perëndimore të Maqedonisë”, e cila siç vihej në pah “qe dyfishtë e robëruar gjatë okupacionit shqiptar”, andaj ajo “me një rezervë të madhe i pranon këto ndryshime dhe ndihet si e distancuar”. Ky rezervim i popullsisë maqedonase, sipas anëtarit të ASNOM-it, Jordan Ballazheski, ka ardhur për shkak se “nëpër objektet shtetërore krahas flamurit shtetëror qëndrojnë edhe flamujt shqiptarë; shqiptarët në mënyrë të barabartë marrin pjesë gjatë zgjedhjeve të këshillave nacionalçlirimtare, qofshin të qyteteve apo të fshatrave; ata e parashtrojnë çështjen që në plenum dhe nëpër këshillat ekzekutive të kenë më shumë përfaqësues të tyre; e shtrojnë çështjen edhe të vetë administratës, e cila duhet të udhëhiqet paralel me administratën tonë (maqedonase - vërejtja jonë), prandaj kërkojnë edhe numër të njëjtë të nëpunësve në administratë; nëpër

²⁴ *Po aty*, Тречи дан сузења 28 јануара 1947 год. Опис 4. стр. 526-527.

²⁵ *Po aty*, f. 524.

²⁵ *Po aty*.

institucionet shtetërore në detyrë kanë ngelë të gjithë nëpunësit shqiptarë të regjimit të kaluar të cilët kanë ardhur nga Shqipëria e vjetër.etj”.²⁶ Sipas Bllazheskit, që të ndërpritet politika, siç e potencon ai “shqiptaromadhe”, në këtë pjesë, nga ana e Presidiumit të ASNOM-it, duhet të ndërmerren këto masa urgjente: “të shkarkohen nëpunësit shqiptarë të cilët kanë ardhur nga Tirana; që Turqve t’u jepen më shumë poste dhe të drejta, të cilët tash për tash nuk mund të vijnë në shprehje nga Shqiptaro Mëdhenjtë; dhe, njëkohësisht të drejtat dhe obligimet të jepen, jo sipas numrit të popullsisë, por sipas pjesëmarrjes në luftën nacionalçlirimtare”.²⁷

Grupi nismëtar për themelimin e Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare (ONDSH) në Shkup, i përbërë prej: Azem Maranës, Hasan Bilallit, Mahmut Dumanit, Hysni Qemal Ejupit, Qemal Qazimi, Nebi Veli Jonuzi dhe Nuredin Ibraimi, pas katër takimeve të mbajtura në shtëpitë e Hysni Qemal Ejupit dhe të Nebi Veli Jonuzit, në muajin janar të vitit 1945 formojnë Organizatën Nacional Demokratike Shqiptare.²⁸ Ata, veç tjerash, hartojnë edhe programin e organizatës që përfshinte katër pika:

1. Organizata Nacional Demokratike Shqiptare (ONDSH), ka për qëllim bashkimin e Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore me Shqipërinë.

2. Që kjo të arrihet, është e domosdoshme që ONDSH-ja të bashkëpunojë me organizatat simotra që veprojnë në Kosovë dhe Shqipëri. Nisur nga ky fakt, ONDSH-ja, respektivisht udhëheqja e saj, do të angazhohet që sa më parë të vendosë kontaktet me forcat nacionaliste në Kosovë dhe Shqipëri. Në kuadër të kësaj, kjo udhëheqësi do të përpiqet të vendosë lidhje edhe me Konsullatën e Britanisë së Madhe dhe atë të Turqisë në Shkup.

²⁶ ДАРМ.1.157.3.73/261, До Президиумот на АСНОМ, Скопје, 7.XII.1944 г., Јордан Блажески, член на АСНОМ.

²⁷ *Po aty.*

²⁸ ДАРМ.Ф.УДБ-РСВР.Д.198.Док.9.,18.09.1946/1-10 Deklarata e Azem Maranës dhënë para UDB-së për qytetin e Shkupit; ДАРМ.Ф.УДБ-РСВР.Д.5113.Док.1.21.01.1947 година - Скопје, стр.1-10.

3. ONDSH-ja merr për sipër të punojë pandërprerë me popullatën shqiptare në Maqedoni me qëllim të frymëzimit kombëtar, sidomos kjo politikë duhet të zbatohet në Shkup e rrethinë, ku disa qarqe antishqiptare këtu në Shkup me të madhe punojnë në turqizimin e popullatës shqiptare.

4. Për t'iu kundërvënë kësaj fryme antikombëtare, e domosdoshme është që të punohet pandërprerë me të rinjtë shqiptarë, si edhe me prindërit e tyre, duke i bindur ata se shpëtimi i vetëm për kombin shqiptar është arsimimi i gjeneratës së re, sepse vetëm kështu mund t'i kundërvihemi armikut tonë shekullor.²⁹

Ndër vendimet tjera më të rëndësishme që u mor në aktin e themelimit të organizatës ishte “të depërtohet në Brigadën VII Shqiptare të Maqedonisë”, e cila në atë kohë qëndronte në rajonin e Kumanovës e të Preshevës, me qëllim që kjo brigadë të refuzonte shkuarjen në luftën e Sremit dhe të nxiste rebelimin e saj për t'iu bashkuar revoltës së Shaban Polluzhës”.³⁰ Një vendim i tillë, siç do të deklarojë Azem Marana para trupit gjyqësor në Shkup, erdhi për faktin se: “... ata qenë mobilizuar me dhunë, dhe qëndronin në Kumanovë” dhe se nuk ishin mirë të pajisur me veshmbathje. “Për këtë shkak” - shton Marana - “kemi biseduar, se si t'u ndihmojmë që ata të kthehen nëpër shtëpitë e veta...”.³¹ Mirëpo, me gjithë përpjekjet që bënë anëtarët e organizatës, kjo nuk u realizua, sepse së shpejti, të njëjtit me urdhër të SHP-së së LNÇM-së, nga Kumanova u dërguan për në Prizren, e më pas për të vazhduar në Shkodër dhe në bregdetin e Adriatikut, ku një pjesë e madhe e tyre u vranë gjatë rrugëtimit.

Jehona e formimit të NDSH-së në trojet shqiptare

Menjëherë pas formimit të NDSH-së drejtuesit e saj mbajtën edhe dy mbledhje tjera, në të cilat është debatuar për mënyrën e

²⁹ Qerim Lita, *Personaliteti i Azem Maranës dhe KQ i NDSH-së në Shkup* (2), Fejton i Flakës, 3 shtator 2002, f. 16.

³⁰ ДАРМ. Ф. УДБ-РСВР, Д. 198, Док..2. 25.07.1946 год. Скопје, л.1.

³¹ ДАРМ.1.1101.6.12/523-578.

afirmimit dhe zgjerimit të organizatës, lidhjet e saj me organizatat simotra në Kosovë dhe Shqipëri, si dhe me grupet e armatosura shqiptare të cilat vepronin në viset e ndryshme shqiptare, për krijimin e një fondi kombëtar etj.³² Duhet të vëmë në dukje faktin se një debat i ngjashëm ishte zhvilluar edhe në mbledhjet e mëhershme, në të cilat ishte arritur pëlqimi që vendosjen e lidhjes me guerilen shqiptare në Shqipëri ta bëjë Mahmut Dumani, si dhe krijimi i Fondit Kombëtar, për të cilin përgjegjës ishte caktuar Nebi Jonuzi. Gjithashtu, ishte përkrahur propozimi i Mahmut Dumanit, që për një afat të shkurtë kohor të grumbullohen së paku 5 milionë leva.

Si formë më e përshtatshme dhe më e sigurt për zgjerimin e NDSH-së ishte zgjedhur krijimi i tresheve, respektivisht, secili anëtar për fillim të përfshijë nga tre anëtarë të rinj, të cilëve si detyrë do t'u jepej të krijojnë treshe tjera e kështu me radhë. Për rrjedhojë Azem Marana në Shkup formoi shpejt treshin e parë të përbërë prej: Hamdi Sulejmanit, Nebi Jonuzit dhe Sherif Halitit.³³ Me ndihmën e Hamdi Sulejmanit, që në popull njihej si Hamdi Terzija, Azemi vendosi lidhje edhe me Çetën e Armatosur që vepronte në Karshiakë të Shkupit, të cilës i printe Shaban Pelivani. Fillimisht, kjo çetë pati një numër të kufizuar të ushtarëve, mirëpo me kalimin e kohës asaj ju bashkëngjiten edhe disa atdhetarë të shquar shqiptarë, midis të cilëve duhet veçuar: Kalosh Hamdinë nga Reçani i Gostivarit, Gafur Satapetkun, Hisë Emrullaun, Shefqet Latif Gërçecin, Sait Asllanin nga fshati Satapetkë e shumë të tjerë.³⁴

Ndërkohë, Hasan Bilalli kishte arritur t'i përfshijë në organizatë Qemal Skënderin, Mexhit Zyberin, Xhemal Fazli-Ferrën dhe Rexhep Dautin.³⁵ Me futjen në organizatë të këtyre figurave, përfundimisht u vendosën lidhjet me çetat e armatosura që vepronin në Kopilaçe, të cilave u prinin atdhetarët e njohur shqiptarë Sul

³² ДАРМ.Ф.УДБ-РСБР.д.5113.

³³ ДАРМ.1.1101.6.13/258-324

³⁴ Shaban Satapetka - komandant i çetës vullnetare të Lidhjes II të Prizrenit në Karshiakë të Shkupit, deklaratë dhënë autorit në Stamboll 27.12.2002.

³⁵ ДАРМ. 1. 1101. 6. 12/641-665; *Po aty*, 6. 15 / 776-804.

Hotla, Hasan Kabashi dhe Din Hoxha.³⁶

Zgjerimi i NDSH-së në këtë periudhë, falë aktivitetit të bujshëm të Azem Maranës dhe Hasan Bilallit, shtohet dita ditës. Kështu, Hasan Bilallit dhe Hafiz Mexhit Zyberit në mesin e muajt qershor në Shkup, mbajtën mbledhje me Mulla Mustafë-Gjilanin, Demir Shabanin dhe Shefqet Arnaqijën, të cilët, pasi Hasan Bilalli ua sqaroi qëllimin e themelimit, pranuan të anëtarësoheshin në NDSH, duke u betuar se do të punonin për të deri në vdekje.³⁷ Po nga Hasan Bilalli, në organizatë u përfshinë edhe treshi i përbërë nga Xhavit Abdulla Selimi, rrobaqepës nga Grushina e Shkupit, Bajram Bajrami, mësues në Shkollën Filllore “Liria” në Shkup dhe Abdylyqerim Seiti nga Ohri, në atë kohë me detyrë sekretar i Bashkësisë Fetare Islame në Shkup.³⁸

Në kuadër të këtij aktiviteti, radhëve të NDSH-së do t'i bashkëngjiten edhe Rexhep Dauti nga Tanusha, i cili ishte komandant policie në Tanushë, Mulla Hajdar Kurtishi nga Orizarja e Kumanovës, ish-komisar politik i aradhave ushtarake të Sul Hotlës dhe mik i ngushtë i tij, Tefik Tanisheci, Demir Ferati nga Malina, Sami Shabedini nga Orizarja e Kumanovës, Zylbear Ajvazi nga Tanusha, Spiro Harilla-Theodosi nga Korça, i cili kishte ardhur si kuadër arsimor, fillimisht në Ohër, Manastir e më pas punoi si mësues në fshatin Krushapekë të Shkupit, Mehmed Bushi - oficer matjanë i cili ishte ushtarak në Tetovë e në Gostivar, Jetish Vishi nga Vitia e Kosovës - mësues në fshatin Zhelinë të Tetovës, mik i ngushtë i Azem Maranës, Nexhmedin Besimi - jurist i diplomuar, nga Pirroku i Tetovës dhe bashkëmendimtar me Azem Maranën, Hafiz Hetem Tairi nga Reçica e Madhe të Tetovës dhe shumë të tjerë.³⁹

Një ngjarje tjetër me peshë kombëtare do të ndodhë në maj të vitit 1945. Në këtë kohë Mamut Dumani, udhëtoi për Shqipëri, ku

³⁶ *Po aty.*

³⁷ Qerim Lita, “Kontribut i H. Mexhit Zyberit në organizimin e NDSH-së në rajonin e Karadakut”, Flaka, Shkup, 06.03.2003. f. 6.

³⁸ ДАРМ. 1. 1101.6.16/251-324.

³⁹ ДАРМ. 1. 1101.6.3/12-18.

mbajti takime të rëndësishme me gueriljen shqiptare të krahinës së Dibrës dhe të Lumës. Vizita e tij në këto krahina shqiptare pati jehonë të madhe. Shqiptarët me të madhe flitnin për ndryshimin e shpejtë në Shqipëri. Lidhur me këtë, Qemal Sejfulla-Orak nga Dibra, i raportonte Komiteti Qendror (KQ) të PKM-së për parullat që lëshoheshin në atë qytet, ku veç tjerash ai shkruante: “Kohët e fundit është ngjallë së tepërmi reaksioni shqiptaromadh. Kështu, në rrethin e Dibrës nuk lëshohen vetëm parulla shqiptaromëdha, por edhe përpiqen t’i organizojnë shqiptarët.... Shqiptarët separatistë lëshojnë parulla se si do të jetë Shqipëria. Ushtria shqiptare këtu do të ngelë përgjithmonë, duke përcaktuar kufijtë e Shqipërisë, të cilat shkojnë deri në Preshevë dhe Kumanovë..”⁴⁰

Aktivitete të bujshme në atë kohë pati edhe Muharrem Bajraktari, i cili në korrik të vitit 1945, i shkruante një letër Mefail Zajazit, me të cilën e njoftonte atë për themelimin e NDSH-së dhe njëkohësisht kërkonte nga ai që “të rregulloni fuqinë e të pritni një urdhër të dytë me të cilin do t’ju kërkojmë të kaloni kufirin ose të filloni veprimet në vendin tuaj...”⁴¹

Organizime ilegale politiko-ushtarake do të zhvillohen edhe në territorin e gjerë të Tetovës. Fronti Popullor vinte në dukje: “Në rajonin e Tetovës qëndrojnë grupe ilegale të armatosura, të cilat strehohen nëpër territoret e fshatrave të tyre, por nuk tregojnë kurrfarë aktiviteti të armatosur, apo zhvillime politike”, mirëpo, siç thuhej në vazhdim të informatës: “Ekziston rreziku që këto grupe jo të rrezikshme të lidhen me bandat e Muharrem Bajraktarit, i cili kohët e fundit ka arritur të lidhet me Tetovën nëpërmjet disa oficerëve shqiptarë të brigadës shqiptare ...”!⁴²

⁴⁰ ДАРМ. 1. 427. 4. 20/135-139.

⁴¹ ДАРМ-оделение Скопје.1.81.8/32

⁴² ДАРМ. Ф. ГШ на НФМ. 3.186/287-308

Përleshjet dhe likuidimet e “pushtetit popullor” ndaj gueriles shqiptare

Ndërkohë që drejtuesit e NDSH-së të Shkupit bënë përpjekje për t'i organizuar shqiptarët, në anën tjetër, pushteti “popullor” vazhdonte me torturimin e popullsisë civile shqiptare, gjithnjë në emër të “Vëllazërim-bashkimit”. Viktimë e kësaj politike do të jetë fshati Korritë dhe popullsia civile e saj. Forcat ushtarako-policore, më 29 mars 1945, rrethuan fshatin me pretekst se aty qëndronte Xhemë Gostivari me forcat e veta. Pasi u siguruan se Xhema nuk strehohej në Korritë, u futën në fshat, duke i tubuar të gjithë meshkujt e fshatit, dhe dy nga dy i lidhën për t'i dërguar në llogoret e Gostivarit. Në mesin e tyre ishte edhe plaku 78-vjeçar Skënder Puhilla. Në llogore masakrohen: Xhemal Idrizi, Emin Murati, Zulfli Limani dhe Jahja Hajdari. Të tjerët pas disa ditësh lirohen, ku gjatë udhëtimit për në Korritë në fshatin Vollkovi masakrohen Ibrahim Ahmeti, bashkë me djalin dhe nipin, dhe tre gurgurnicas: Bajram Haliti, Ahmeti i Nazallarëve dhe Hashim Bejluri. Këta masakrohen prej serbëve të Vollkovisë, që u printe Dragja e Jovës, i cili ishte komandant policie ...!⁴³

Ngjarjes tragjike të Korritës do t'i prijë një luftë paraprake, e zhvilluar në stanet e Novosellës së Tetovës mes forcave të Xhemë Gostivarit dhe forcave partizane. Këta të dytët për kalimin e Xhemës kah Bogovina njoftohen prej një informatori të tyre dhe menjëherë futen në fshatin Bogovinë ku i tubojnë fshatarët te shatërvani në mes të fshatit. Me urdhër të komandantit, Sedek Jovçev, pushkatohet Iljaz Bogovina, një patriot i shquar i kësaj ane. Luftimet mes dy forcave armike do të zhvillohen, siç u theksua më sipër, te stanet e Novosellës. Xhemë Gostivari me forcat e veta arrin të çajë rrethimin, duke kaluar nëpër Gradec, Çegran e vendoset në Korritë. Aty, pasi pushojnë, e lëshojnë fshatin për të shkuar në drejtim të Simnicës. Në luftimet e Novosellës nga ana partizane pati tre të vranë dhe tre të

⁴³ Zylqifli Aliu, i lindur me 10.08.1933, Korritë, djali i Shaban Korritës, deklaratë dhënë autorit më 17.06.2002, Shkup.

plagosur, kurse forcat e Xhemës nuk patën asnjë humbje.⁴⁴ Lidhur me luftimet e Novosellës organizata e rinisë maqedonase për Gostivarin njoftonte organin e vetë republikan se më 27 mars 1945, forcat e Xhemë Gostivarit kanë vra tre partizanë. Në vazhdimin e këtij njoftimi jepej ceremonia e varrimit, e cila, siç thuhej, ishte zhvilluar në prani të 6 000 vetëve. Në mesin e tyre kishin marrë pjesë edhe Sali Lisi dhe Nexhat Agolli. Më pas në njoftim thuhej: “Duke ikur mbrëmë forcat e Xhemës, që numërojnë 100 vetë në mes të Tetovës dhe Gostivarit, kanë vra tre partizanë, të cilët heroikisht kanë luftuar kundër forcave armiqësore të Xhemë Hasës”.⁴⁵

Disa ditë më vonë në Tetovë nga ana e Gjyqit Ushtarak u zhvillua një proces gjyqësor kundër nëntë shqiptarëve, nga të cilët gjashtë u dënuan me vdekje-pushkatim. Për vendimet e marra nga ky proces gjyqësor, më 19 prill njoftonte gazeta maqedonase “Nova Makedonija”, në të cilën thuhej: “Më 11 prill 1945 Gjyqi Ushtarak në Tetovë solli vendim me të cilën u dënuan këta persona: 1. Femi Aqifi nga fshati Turçan, i moshës 22-vjeçare, dënohet me vdekje, me pushkatim; 2. Imer Esad Mero nga fshati Sërbinovë, i moshës 45-vjeçare, me vdekje-pushkatim; 3. Shaip Nuredinin nga fshati Gurgurnicë, i moshës 40-vjeçare, dënohet me vdekje, me pushkatim; 4. Osman Koka, nga qyteti i Tetovës, i moshës 33-vjeçare, dënohet me vdekje, me pushkatim; 5. Mexhit Rexhepi i fshatit Novosellë, i moshës 20-vjeçare, dënohet me vdekje, me pushkatim; 6. Xhelil Jakupi, nga fshati Sllatinë, i moshës 25-vjeçare, dënohet me 5 vjet burg të rëndë; 7. Shaip Shabani nga fshati Elez, i moshës 33-vjeçare, dënohet me vdekje me pushkatim; 8. Abdyl Xheladini nga fshati Reçan, i moshës 60-vjeçare, me 2 vjet burg të rëndë; dhe 9. Lirohet Isak Useini nga fshati Shipkovicë...”⁴⁶

Po i njëjti gjyq, më 25 prill të atij viti, në Kërçovë dënoi: Sezo Hamid Sadikin nga fshati Kollare, me vdekje me pushkatim; Veli Hasan Shabanin nga fshati Zajaz, me vdekje me pushkatim; Qemal

⁴⁴ *Po aty.*

⁴⁵ ДАРМ.Ф. СММ. 1.213/472

⁴⁶ “Нова Македонија, Скопје, 19.04.1945, ф. 2.

Eshtrefin nga Kërçova, me vdekje me pushkatim; Beqir Hasan Muharremi nga fshati Zajazi, me 15 vjet burg të rëndë; Rexhep Sadikin nga Kërçova, me 6 vjet burg; Ramadan Dalipi nga fshati Zajaz, me 5 vjet robëri, ndërsa lirohet Esad Ramadani nga Kërçova.⁴⁷

Në kuadër të këtyre masave pushteti komunist maqedonas në maj të vitit 1945 pushkatoi dy personalitetet kryesore të dijes dhe nacionalizmit shqiptar të kësaj ane, Shaip Kamberin, avokat dhe ish-kryetar i Bashkisë së Tetovës, dhe Kadri Saliun, avokat dhe ish-kryetar i Bashkisë së Gostivarit.⁴⁸ Sipas dëshmitarëve okularë “OZNA-ja maqedonase këta dy personalitete i mori dhe i dërgoi te centrali afër lumit Pena (Shkumbin) ku dhe i dogjën për së gjalli...”!⁴⁹

Shërbimi Sekret Maqedonas, OZN-ja, gjatë muajit prill kishte hartuar një plan për likuidimin edhe të komandantit legjendar të forcave ushtarake vullnetare shqiptare. Shefi i sigurimit të OZN-së për Tetovë, Gostivar dhe Kërçovë kishte informata të sigurta se ku qëndronte Xhemë Gostivari, mirëpo ai ishte i vetëdijshëm se me pushkë nuk mund të mposhtet ky kolos i madh shqiptar, prandaj nëpërmjet informatorëve të vetë, i thërret miqtë e Xhemës, Nazif, Ali, Abdulla dhe Riza Gorjanin, duke u premtuar atyre se nëse e sjellin kokën e Xhemës do t’ua falnin “gabimet” që kishin bërë si ballistë dhe se po u besonte poste në pushtet në fshat dhe në qytet.⁵⁰ Autori i monografisë “*Xhemë Hasa - ushtarak dhe demokrat*”, Begzat Begzati, thekson se vrasje (tradhtia) e Xhemë Gostivarit ka ndodhur më 2 prill 1945, mirëpo sipas disa të dhënave tjera, kjo duhet të kishte ndodhur mes datave 4-5 maj të këtij viti.⁵¹ Edhe gazeta “Nova Makedonija” në numrin festiv të 7 majit 1945, njoftonte për vrasjen e “kaçakut Xhemë Hasa”. Sipas “Nova

⁴⁷ *Po aty*, 04.05.1945, f. 4.

⁴⁸ *Po aty*, 03.06.1945, f. 2.

⁴⁹ Ismen Vebi Shaqiri, i lindur 03.07.1929, Tetovë, deklaratë dhënë autorit për likuidimin e Shaip Kamberit, Tetovë, 26.10.2003.

⁵⁰ Begzat Begzati, *Xhemë Hasa - ushtarak demokrat*, monografi. Botimi i dytë, f. 134-138.

⁵¹ Zulqifli Aliu, *Po aty*.

Makedonska”, “mes datës 3-4 maj forcat e Batalionit të Parë pranë Brigadës III kanë vrarë banditin e njohur Xhemë Gostivari...”.⁵² Sido që të jetë, vrasja e Xhemë Gostivarit nuk ishte siç vinin në dukje mediet e atëhershme maqedonase, në luftë e sipër, por ajo erdhi si rezultat i tradhtisë së miqve të tij.⁵³

Pas vrasjes së Xhemë Gostivarit gjendja e përgjithshme e sigurisë në viset shqiptare nuk do të qetësohet. Përkundrazi, atdhetarët shqiptarë, të cilët me fuqitë e tyre vepronin në Karadak, Dërven, Tetovë, Gostivar e Kërçovë, të indinjuar nga vrasja mizore e komandantit të tyre, ndërmorën një sërë aksione luftarake kundër forcave ushtarake jugosllave. Nga raporti i Ministrisë së Punëve të Brendshme, dërguar Qeverisë së Republikës Federale të Maqedonisë, kuptojmë se midis datës 14-16 maj 1945, do të zhvillohet një betejë e rreptë ndërmjet fuqive vullnetare shqiptare të udhëhequr nga Arif Kapiteni dhe ushtrisë jugosllave, në regjionin e Radushës dhe Dvorcës.⁵⁴

Kongresi (III) i NDSH-së në Kopilaçe

Në gushtin e vitit 1945 Shtabi Suprem i Kosovës, i Adem Gllavicës, ftoi një takim të përfaqësuesve të gueriljes shqiptare dhe të organizatave të NDSH-së. Takimi u mbajt në Kopilaçe, më 15-16 gusht, midis Moravës së Epërme e Karadakut të Shkupit.⁵⁵ Disa ditë para se të mbahej Kongresi, komitetit të Shkupit, i erdhi një letër nga

⁵² “Нова Македонија - Убијен је качакот Џемо - numri festiv 5, 6, 7 maj 1945, f. 7.

⁵³ Begzat Begzati, *Po aty*.

⁵⁴ ДАРМ.. I. 159. Пов.Бр. 199, 19. VII.1945 г., Скопје. До Председателството на Народна Влада на Д.Ф.Македонија: ПРЕДМЕТ: гонење на разни профашистички банди.

⁵⁵ Muhamet Pirraku, *Mulla Idrizi Gjilani dhe mbrojtja popullore e Kosovës Lindore 1941-1951*, Prishtinë 1995, f. 323; Daut Bislimi *Një vështrim historik i Organizatës së NDSH-së LPLTSH-së*, Shkup 1997, f. 49; Sabile Keçmezi- Basha, *Lëvizja ilegale patriotike shqiptare në Kosovë (1945-1947)* Prishtinë 1998, f. 58; Qerim Lita, *Personaliteti i Azem Maranës dhe KQ i NDSH*, (3) fejtton i “Flakës”, Shkup 04.09.2002, f. 16.

Hysen Tërpeza, në të cilën kërkohet që drejtuesit e organizatës t'i caktojnë delegatët e Kongresit. Burimet arkivore na bëjnë me dije se komitetin e NDSH-së së Shkupit e përfaqësuan: Qemal Skënderi, Mexhit Zyberi, Rexhep Dauti dhe Xhemal Fazli Fera.⁵⁶

Mbledhja u mbajt në shtëpia e Zylbehar Kopilakut, siç konstaton Qemal Skënderi. Në mbledhje, foli Hysen Tërpeza, i cili, ndër të tjera i njoftoi delegatët e Kongresit, për lidhjet e vendosura me komitetet e NDSH-së në Gjilan, Prishtinë, Prizren dhe së fundi edhe në Shkup. Më pas ai tha se para disa dite kishte marrë një letër nga Muharrem Bajraktari, në të cilën i shkruante atij se në Shqipëri është themeluar Komiteti për Bashkimin Kombëtar, ku janë përfshirë të gjitha shtresat antikomuniste si ballistët, zogistët, nacionalistët etj., dhe se “Britania e Madhe dhe SHBA-të, nuk e pranojnë qeverinë e Enver Hoxhës”.⁵⁷ Pas tij folën Luan Gashi, Adem Gllavica dhe Ibrahim Kelmendi. Mbledhja i zhvilloi punimet në një periudhë dyditore dhe për shkak të rëndësisë që pati për lëvizjen e rezistencës shqiptare në përgjithësi, do të konsiderohet si Kongresi III i Ballit Kombëtar. Oratorët e zënë ngoje, siç shihet nga të dhënat që dalin nga hetuesia dhe nga procesi gjyqësor kundër 19 anëtarëve të KQ-së së NDSH-së, në janar-shkurt të vitit 1947, i raportuan Kongresit për aktivitetin e komiteve shqiptare në Itali dhe Greqi dhe për lidhjet e udhëheqjes së lëvizjes së rezistencës shqiptare në viset nën robërinë jugosllave me Mit’hat Frashërin në ekzil.⁵⁸ Referatin për gjendjen aktuale politike e paraqiti Luan Gashi, kurse referatin për gjendjen e luftëtarëve të lirisë në malet e Kosovës e paraqiti Adem Gllavica. Duhet shtuar këtu se në Kongres foli edhe Qemal Skënderi, i cili, veç tjerash, i njoftoi të pranishmit për aktivitetin e organizatës në Shkup, që siç vuri në pah: “ka për qëllim bashkimin e Kosovës dhe të Maqedonisë Perëndimore me Shqipërinë”.⁵⁹

⁵⁶ ДАРМ.1.1101.6.3/776-804.

⁵⁷ ДАРМ.1.1101.6.15/776-804.

⁵⁸ ДАРМ.1.1101.6.14/666-775; ДАРМ. 1.1101.6.15/776-884; ДАРМ.Ф. УДБ-PCBP.Д.5113, *по аты*.

⁵⁹ ДАРМ.Ф.УДБ.-PCBP, Д.5113, *по аты*.

Kongresi i Kopilaçes mori vendime të rëndësishme: emërimi i Lëvizjes së Rezistencës me emrin Lëvizja për Lirimin e Tokave Shqiptare, për shkak se emri i “Ballit është komprometuar në sytë e aleatëve si organizatë profashiste gjatë Luftës së Dytë Botërore (në gjysmën e dytë të vitit 1943), dhe kjo së paku për nga botëkuptimet e anglo-amerikanëve ...”. Lëvizja me emër të ri duhet t’i bashkojë të gjitha organizatat dhe rrymat politike antikomuniste dhe antijugosllave nën një flamur, atë të çlirimit dhe të bashkimit të Shqipërisë etnike. Tash për tash, Balli këtë punë nuk mund ta realizojë.⁶⁰

Ndër vendimet e tjera të Kongresit I (III) të Lëvizjes për lirimin e tokave shqiptare janë: Komiteti Qendror i NDSH-së në Shkup është organi politik më i lartë i lëvizjes për lirimin e tokave shqiptare dhe lidhje e vetme e lëvizjes me komitetet shqiptare në Greqi dhe në Itali si dhe me guerilen shqiptare, ballistët, të cilët quhen ushtri popullore demokratike shqiptare. Kongresi emëroi Shtabin e Përgjithshëm të luftës, me të cilin udhëheqin: Hysen Tërpeza, Luan Gashi, Hysen Xhakri, Rexhep Okllapi, Shaban Haliti, Sul Hotla dhe Din Hoxha. Në shtabin e luftës ishin edhe Adem Gllavica, i ngarkuar për propagandën, si edhe Ibrahim Kelmendi dhe Luan Gashi. Ibrahim Kelmendi do të delegohet për propagandë në Shkup, kurse Luani në viset e Suharekës e të Prizrenit. Kongresi aprovoi platformën për një thirrje që Shtabi Suprem i Ushtrisë Popullore Demokratike Shqiptare të Kosovës duhet t’ia lëshonte popullit. Lidhur me këtë, Adem Gllavica, pa humbur kohë, e ftoi Abdulla Musliun, kryetar i Këshillit të rrethit në Ferizaj, Ibrahim Graincën-Cërnillën, komandant i rojës partizane në Babush, dhe disa personalitete tjera në zë lidhur me çështjen e botimit dhe përhapjes së proklamatës, sipas vendimit të Kopilaçës. Pas diskutimeve për këtë qëllim në malet e Mirashit Abdullahu e mori përsipër botimin dhe shpërndarjen e kësaj proklamate. Shumëzimin e saj duhej ta bënte Komiteti Qendror i NDSH-së në Shkup.⁶¹ Nga të dhënat të sigurta nga hetuesia ndaj

⁶⁰ ДАРМ.1.1101.6.15/776-804.

⁶¹ Daut Bislimi, *vep. e cit.*, f. 49-51; Muhamet Pirraku, *vep. e cit.*, f. 323-325.

Azem Maranës, Abdulla Musliu në Shkup erdhi në fillim të muajit tetor 1945, ku u takua me Azemin, të cilin e informoi se urgjentisht duhej të mbahej një takim, në të cilin duhet të marrin pjesë edhe Hasan Bilalli dhe Abdylqerim Saiti, mësues nga Ohri, i cili në atë kohë ishte sekretar i Mexhllisit të Bashkësisë Islame në Shkup. Takimi i paralajmëruar u mbajt në shtëpinë e Azemit, në të cilën kanë marrë pjesë personat e lartpërmendur. Me kërkesë të Abdulla Musliut, Azem Marana lexoi me zë proklamaten, dhe pasi ranë dakord e shumëfishuan në disa kopje.⁶²

Në proklamata, përveç tjerash, theksohej gjendja e shqiptarëve në Jugosllavinë mbretërore gjatë okupimit dhe në atë kohë, ku vihej në dukje se nuk kishte kurrfarë ndryshimi, shqiptarët ishin të përndjekur dhe të torturuar nga regjimi i okupatorit serbo-çetnik. Popullit shqiptar iu vu me dijeni se falë tradhtisë së Fadil Hoxhës, Mehmet Hoxhës dhe Rifat Berishës u masakruan 3 000 shqiptarë në Tivar “Për dhjetë muaj” - thuhej më tej në proklamata - “sistematikisht dhe në mënyrë më barbare, gjoja se do t’i marrin në ushtri kanë depërtuar mbi 70 000 shqiptarë, djem më të mirë e më të zgjedhur nga Kosova, të cilët janë detyruar t’i mbyllin shtëpitë e tyre dhe familjet e tyre i kanë lënë në mjerim më të skajshëm”.⁶³ Duke ju kundërvënë kësaj, në këtë proklamata fuqimisht hidhej poshtë çdo lidhje e imponuar e Kosovës me Serbinë dhe me Jugosllavinë dhe decidivisht konstatohet se populli shqiptar “nën Jugosllavinë, mbi gjysma e kombit që jeton në viset etnike kompaktësisht në 85%-100% shqiptarë nuk pranojnë asnjë lidhje me Beogradin” dhe se dëshira e vetme e shqiptarëve, që përbën shumicën absolute në Kosovë është “BASHKIM ME SHQIPËRINË”. Kjo ka qenë dhe është dëshira e vetme e kombit shqiptar në Kosovë, mirëpo “çlirimtarët” nuk e pranojnë këtë të drejtë të kombit: “të drejtën për

⁶² ДАРМ.Ф.УДБ-ПСВР.Д.198, док.35,25.12.1946 год., л.3, deklarata e Azem Maranës, lidhur me takimin e tij me Abdulla Musliun.

⁶³ Архив на Скопје, 1.81.8/566-570, списи кои се однесуваат на доказната постапка и натамошното движење на казната против 2-ро обвинетиот Азем Идриз Морана, учител роден во село Моране околина Драчевска а живеел во Скопје.

të jetuar me vëllezërit e vet për nga gjaku e gjuha”, të cilën ata e quajnë “shoviniste, imperialiste dhe fashiste. Diçka që nuk ndodhë në Evropë lejohet të zbatohet në Ballkan. Shumica të jetë në robëri, ndërsa pakica në liri. Kjo ndodhë me shqiptarët, shumica e së cilës gjendet nën robërinë e huaj jugosllave”.⁶⁴ Duke u ndalur në zgjedhjet e paralajmëruara për në muajin tetor të vitit 1945, në të cilat duhej të përcaktoheshe regjimi i ardhshëm i Jugosllavisë, në proklamatë shprehimisht thuhej: “Mos merrni pjesë në zgjedhjet që dëshirojnë të na fusin me forcë. Këto zgjedhje nuk janë për ne. Në kundërshtim me parimet demokratike zgjedhjet që do të pasojnë (që duhet t’i kemi) neve na i mohojnë. Populli i Kosovës nuk do të merr pjesë në këto zgjedhje sepse nuk janë të vetat. Ne pranojmë të votojmë: që të bashkohemi me Shqipërinë: ”Në fund të proklamatës, apelohej tek vëllezërit shqiptarë që ta ndihmojnë “ushtrinë e shenjtë për ÇLIRIMIN E KOSOVËS DHE BASHKIMIN ME SHQIPËRINË”, sepse siç vihej në pah: “Lirinë askush nuk na e falë. LIRIA fitohet me gjak dhe me mund”, andaj “ndihmojuni vëllezërve tanë të cilët gjenden nëpër male”, sepse “ekzistimi i tyre në mal paraqet sigurinë tuaj nëpër qytete dhe fshatra”.⁶⁵

Veprimtaria politiko-ushtarake e KQ të NDSH-së në Shkup, korrik-nëntor 1945

Pasi i përfundoi punimet Kongresi I (III), Ibrahim Hakiu-Kelmendi u vendos në Shkup. Ai këtu erdhi që të ndihmojë në organizimin sa më të mirë të komitetit dhe ta paraqet rrugën e veprimtarisë së udhëheqjes, e cila nga deklarata e Qemal Skënderit, dhënë para organeve të hetuesisë, më 20 shtator 1946, kuptojmë se e njëjta ishte orientuar në dy drejtime edhe atë “përfshirja e figurave të shquara shqiptare në organizatë”, dhe “vendosja e lidhjeve me përfaqësitë diplomatike në Shkup, siç janë konsullata angleze dhe ajo turke”. Kjo e fundit për Kelmendin, ishte më se e domosdoshme

⁶⁴ *Po aty.*

⁶⁵ *Po aty.*

sepse “organizata nuk mund të ekzistojë nëse nuk vendoset lidhja”.⁶⁶ Për rrjedhojë, me kërkesë të tij, KQ-së së NDSH-së organizoi disa takime, në të cilat u shtruan edhe disa çështje tjera, si situata politike e brendshme dhe ajo ndërkombëtare, mundësia për hapjen e ndonjë radiostacionit, nëpërmjet të cilit Komiteti Qendror do të lidhej me Komitetin e Barit dhe me zonën operative në Greqi, zgjerimi i organizatës në grupe të mëdha, si dhe koordinimi i KQ-së me grupet e armatosura që vepronin në Kosovë dhe Maqedoninë Perëndimore.⁶⁷ Më së shumti u bisedua për zgjedhjet e përgjithshme republikane, të cilat ishin paralajmëruar të mbaheshin në vjeshtë, për çka Kelmendi kërkoj nga udhëheqja e NDSH-së, që të zhvillojë fushatë kundër këtyre zgjedhjeve.⁶⁸

Takimet ishin tejet sekrete, ndërsa, krahas Kelmendit, morën pjesë anëtarët më të besueshëm të organizatës, si: Azem Marana, Hasan Bilalli, Qemal Skënderi, Mexhit Zyberi, Xhemal Fera, Xhavit Abdulla Selimi, Hysniqemal Ejupi e ndonjë tjetër. Pas disa përpjekjeve, KQ-ja e NDSH-së arriti të vendosë lidhje me dy konsujt e lartpërmendur, falë Zhozef Bërkiçit,⁶⁹ një kroat i cili punonte në konsullin anglez në Shkup, si dhe Xhavit Selimit. Menjëherë pas kësaj Ibrahim Hakiu shkroi dy letra. Letra e parë ju dërgua konsullit anglez, në të cilën ai e njoftonte atë se rajonet shqiptare në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore dëshirojnë të bashkohen me Shqipërinë dhe se për këtë arsye “mijëra njerëz janë duke luftuar me shpresë të madhe se do të kenë përkrahje prej faktorit perëndimor, para së gjithash prej aleancës anglo-amerikane”.⁷⁰ Ndërsa, në letrën drejtuar konsullit turk, Ibrahim Hakiu-Kelmendi, ia paraqiti gjendjen faktike të popullatës turke, e cila siç thuhej në të: “Jo që e mbështet

⁶⁶ ДАРМ-оделение Скопје, 1.81.8/39-41, Продолжење на саслушањето, 20.IX.1946 год., Скопје.

⁶⁷ ДАРМ.1.1101.6.12/641-665; Revista “Globi”, *Shpalime: procesi gjyqësor kundër aktivistëve të NDSH-së* në vitin 1947 në Shkup, 2 Shkup, dhjetor 1994, f. 17-20.

⁶⁸ ДАРМ-оделение Скопје, *po aty*.

⁶⁹ ДАРМ.Ф.УДБ-РСВР.Д. 1882, док. 5, л. 12.

⁷⁰ Revista “Globi”, *po aty*, nr. 5, Janar, 1995, f. 18.

politikën shqiptare, por nëpërmjet disa elementeve të mbështetur nga pushteti totalitar komunist në Maqedoni, me të madhe propagandojnë turqizimin e shqiptarëve”. Më pas, Kelmendi i drejtohet diplomatit turk me fjalët: “Ndikimi juaj sidomos të rinia turke, duhet të jetë i madh, andaj brenda mundësive tuaja kërkojmë që të ndikoni tek ata që ta mbështesin politikën tonë, e cila përputhet me interesin turk”.⁷¹

Letrën që iu shkrua konsullit turk Emin Vefa Geçek do ta dërgojë Xhavit Abdulla Selimi, i cili pas një jave do të takohet me diplomatin turk në selinë e tij, nga i cili mori këtë përgjigje gojore: “Thuaju miqve tuaj se nuk duhet urrejtje mes turqve dhe shqiptarëve, pra duhet të veprojmë bashkërisht kundër autoriteteve jugosllave. Në Jugosllavi, shqiptarët dhe turqit janë myslimanë dhe se duhet të bashkohen e jo të urrehen...”.⁷²

Është me rëndësi të theksohet se deri në këtë periudhë turqit, për dallim nga shqiptarët, ishin më të privilegjuar dhe si të tillë shërbenin si mashë e pushtetit komunist maqedonas. Të dhënat arkivore bëjnë të ditur se elementi turk në administratën shtetërore dhe në pjesën legjislative ekzekutive të pushtetit merrte pjesë me një përqindje shumë më të madhe se shqiptarët. Vetëm në Këshillin e ri Ekzekutiv të Shkupit i konstituuar më 17 prill 1945, nga gjithsejtë 17 anëtarë, turqit përfaqësoheshin me 5 përfaqësues, ndërsa shqiptarët pa asnjë përfaqësues të tyrin.⁷³ Një dukuri e tillë ishte e pranishme edhe në sferën e arsimit e të kulturës. Azem Marana, në ditën e tretë të procesit gjyqësor, publikisht deklaroi se gjatë hapjes së shkollave fillore, në fillim të dhjetorit 1944, organet e pushtetit “popullor” nuk lejuan të hapen shkolla shqipe në qytetin e Shkupit, por vetëm ato turke me arsyetim se “popullsia e besimit mysliman nuk është shqiptare, por turke...”.⁷⁴

⁷¹ ДАРМ. 1.1101.6.3/12-18; Qerim Lita, *Personaliteti i Azem Maranës dhe KQ i NDSH-së në Shkup* (3), Fejton i “Flakës”, 04.09.2002 f. 16, Revista “Globi”, po aty, nr. 10, f. 33-34

⁷² ДАРМ.1.1101.6.12/579-640; ДАРМ.Ф.УДБ-PCBP.Д.5113, po aty; “Globi”, po aty, Qerim Lita, *Po aty*.

⁷³ ДАРМ.1.427.4.3/22-50

⁷⁴ ДАРМ.1.1101.6.12/523-578; Qerim Lita.

Në fillim të muajit tetor, Ibrahim Hakiu-Kelmendi, kërkoi nga KQ-ja e NDSH-së që të thirret një mbledhje urgjente, e cila u mbajt në shtëpinë e Qemal Skënderit në prani të 9 anëtarëve kryesorë të organizatës. Arsyeja për mbledhjen ishte letra e Hysen Tërpezës dërguar Ibrahim Kelmendit, në të cilën kërkohet që anëtarët e KQ-së së NDSH-së të Shkupit të shkojnë në Kopilaçe për t'u takuar me trupat e Sul Hotlës, ku do të mbahej një mbledhje, në të cilën do të sillej vendim që KQ-ja e NDSH-së bashkohej me forcat e armatosura e të kalojë në Greqi.⁷⁵

Letra e Hysen Tërpezës dërguar KQ-së së NDSH-së në Shkup në fakt ishte kërkesa e Muharrem Bajraktarit dhe e Mit'hat Frashërit drejtuar Shtabit Suprem të Kosovës, të tubuar rreth Adem Gllavicës, që forcat e rezistencës shqiptare antijugosllave dhe antikomuniste të kalonin në Greqi, për të hyrë në shërbim të planeve globale anglo-amerikane për destabilizimin dhe për rrëzimin e pushteti komunist në Shqipëri dhe në Jugosllavi, kurse çështja e çlirimit dhe e bashkimit të tokave shqiptare të aneksuara prej Jugosllavisë do të "vijë si pasojë e ndryshimeve të sistemit në dy vendet fqinjë, të Shqipërisë dhe Jugosllavisë"! ⁷⁶

Kah mesi i tetorit 1945 Bajram Begunca me 100 ushtarë nga Kopilaça niset për Greqi. Çetës së Bajram Beguncës iu bashkëngjijt edhe anëtari i KQ-së së NDSH-së, Xhemal Ferra-Bllaca. Bajram Begunca me forcat e veta mori drejtimin në: Llokme, Dërmjak, Bllacë, Nigishtan për të kaluar në Karshiakë, respektivisht në bjeshkët e Satapetkës, ku qëndronte Çeta e Shaban Satapetkës. Ndërkohë që bëheshin përgatitjet për t'u nisë në drejtim të Kërçovës, udhëheqja e KQ-së së NDSH-së nga Shkupi dërgoi një letër në të cilën kërkohet që forcat ushtarake mos të lëshojnë vendin sepse është në kundërshtim me programin e organizatës. Pas kësaj, një pjesë e ushtarëve të Bajram Beguncës, në mesin e tyre edhe Xhemal Ferra, vendosin të mos kalojnë në Greqi.⁷⁷

⁷⁵ ДАРМ.1.1101.6.12/579-640; Globi, Shkup, Nr. 2, nëntor 1994, *po aty*, f. 17-18.

⁷⁶ *Po aty*.

⁷⁷ Shaban Satapetka, *po aty*; Qerim Lita "Xhemal Bllaca dhe NDSH-ja" kumtesë e

Lajmi për tërheqjen e forcave të armatosura shqiptare i kishte arrit edhe Mefail Shehut-Zajazit. Në kuadër të kësaj Mefail Zajazi njoftoi ushtarët se “më 26 tetor duhet t’i presim lumjanët dhe kosovarët dhe bashkërisht të kalojmë në Greqi”.

Në atë kohë UDB-ja maqedonase kishte informata të sigurt për lëvizjet që i bënin forcat e Mefailit. Këto informata i merrte prej një ish-ushtari të Mefailit, i cili disa ditë më parë u ishte dorëzuar forcave partizane. Në datën e caktuar, Mefail Zajazi me mbi 100 ushtarë vendoset mbi Llapkin-Doll në vendin e quajtur Hedha, ku ishte në pritje të forcave shqiptare që duheshe të vinin nga Luma dhe Kosova. Ndërkohë që forcat e Mefailit pritnin ardhjen e çetave shqiptare, papritmas, ata rrethohen prej partizanëve dhe si pasojë shpërtheu një lufta e rreptë. Në luftimet disaorëshe vritet Mefail Shehu, i quajtur Mefail i Madh, dhe disa ushtarë tjerë. Meqë forcat shqiptare ishin në rrezik, me urdhër të Mefailit të Vogël, ata tërhiqen dhe gjatë tërheqjes arrijnë të vrasin disa partizanë.⁷⁸

Edhe grupi i Hysen Tërpezës dhe Hasan Kabashit nga gjysma e nëntorit u nis për Greqi. Këtij grupi u ishin bashkuar edhe disa grupe të gueriljes që vepronin në viset të Zhegovcit, Kopilakut, Ferizajit dhe Kaçanikut. Pas shumë peripecive, më 29 dhjetor 1945, edhe ky grup kaloi në Greqi.⁷⁹ Për kalimin e Hysen Tërpezës në Greqi KQ-ja e NDSH-së në Shkup u njoftua prej letrës që e dërgoi Tefik Halid Shemsiu, i cili shkruante se: “Hysen Tërpeza me forcat e veta ka arrit në Greqi, ku është emëruar komandant brigade, që vepron në rrethin e Lerinit dhe Volosit...!”⁸⁰

Pas kalimit të një pjese të forcave të armatosura shqiptare në Greqi, organizimi politik dhe luftarak në këtë kohë u dobësua, por nuk u shua. Ndjekja që bëhej nga ana e Sigurimit Shtetëror gjithnjë e më tepër po merrte kahje të shfarosjes së trurit dhe ndërgjegjes

lexuar në Tribunën shkencore në Kaçanik më 10.04.2004 kushtuar 58-vjetorit të themelimit të Komitetit të NDSH-së në Kaçanik.

⁷⁸ Nexhmedin Rrushiti - Luftëtar i çetës së Mefail Zajazit,, deklaratë dhënë autorit në Kërçovë më 26.09.2002.

⁷⁹ Daut Bislimi, vep. e cit. f. 53.

⁸⁰ Globi, *po aty*, num. 2, f. 18.

shqiptare. Në këto kushte KQ-ja e NDSH-së vazhdoi punën ku deri në mbarim të vitit arriti të sigurojë dy radiostacione në Tetovë dhe Pejë, që nevojiteshin për lidhjet e drejtpërdrejta me Komitetin e Barit dhe zonën operative në Greqi.⁸¹

Në përmbyllje të këtij punimi studimor po i referohem një pjese të letrës së prof. Ymer Berishës dërguar, më 22 tetor 1945, shefit të Misionit Ushtarak Britanik në Shqipëri, gjeneralit Hadgson, ku, veç tjerash, thuhej: “Populli i Kosovës, i cili asnjëherë nuk ka qenë i armatosur aq fuqishëm dhe aq mirë si në këtë kohë, duke e parë se partizanët në atë kohë kanë qenë për shkaqe politike të ndihmuar nga britanikët, nuk iu kundërvu, sepse asnjëherë nuk besonte se ata do të guxojnë nga aleatët, të bëjnë atë terror dhe ta gjakosin popullin, siç e kanë bërë ata...”. Më pas Berisha në letër e përshkruante hollësisht terrorin sllavo-komunist, gjatë periudhës nëntor 1944-shtator 1945: “Nuk janë kursyer as partizanët shqiptarë... të cilët janë vrarë ose zhdukur në luftërat e shteteve tjera ballkanike. Shumica e tyre janë vrarë si njerëz të dyshimtë nga vetë partizanët, kur e kanë filluar kryengritjen në Kosovë. Numri i të vrarëve saktësisht nuk mund të dihet. Dihet vetëm ajo se në Mal të Zi brenda 24 orëve janë vrarë 1 670 shqiptarë, në Dubrovnik 5 600, në rrugën Prizren-Shkodër 700...etj.”. Këtë letër të gjatë profesor Berisha e përfundonte me këto fjalë: “I tërë populli i Kosovës, i cili numëron më shumë se 950 000 banorë, është i gatshëm që në sinjalin e dhënë të çohet në këmbë që të luftoj kundër partizanëve. Me armë në dorë do të çohen edhe të vjetrit edhe rinia, meshkuj dhe gra, me pushkë, me sëpatë, me thikë dhe do të luftoj për të shpëtuar nga ajo robëri e poshtër, e cila ka zhdukur aq familje, popull, e që e ka gjakosur dhe tronditur botën. Shkëlqesi, ai popull i lutet aleancës liridashëse anglo-amerikane, që të intervenoj atje ku duhet, për ta ndërprerë terrorin partizanë në Kosovë... Dëshira e atij populli është që të votojë një Shqipëri të lirë dhe demokratike dhe në këtë

⁸¹ *Po aty*, f. 17.

shpresojmë me bindje të plotë, që neve aleanca anglo-amerikane do të na e pranoj...”.⁸²

Letra e prof. Berishës, ishte shkruar në kohën kur tek krahu udhëheqës i rezistencës shqiptare u paraqitën dy mendime të ndryshme. Sipas një grupi, që i prinin Hysen Tërpeza, Muharrem Bajraktari dhe Ibrahim Kelmendi, gjithë struktura politike e ushtarake e NDSH-së duhej të kalojë në Greqi. Prej andej, me ndihmën e aleatëve perëndimorë, do të organizonin një kryengritje, e cila për fillim do të shtrihej në shtetin shqiptar dhe pasi të vendoset demokracia atje, kryengritja do të përfshinte edhe në tokat shqiptare nën sundimin e Jugosllavisë komuniste. Për dallim nga ky mendim, grupi e dytë i udhëhequr nga Azem Marana, Gjon Sereçi, Mahmut Dumani, Mehmet Bushi, Hasan Bilalli, Qemal Skënderi etj., ishin të mendimit që struktura politiko-ushtarake e rezistencës shqiptare, nuk guxonte të kalojë në Greqi.

⁸² ДАРМ.Ф.ВИИ.М. 349.

Marenglen KASMI

POLITIKA GJERMANE NDAJ KOSOVËS 1943-1944

Politika gjermane ndaj Kosovës në vitet 1943-1944 nuk bazohej në ndonjë interes të veçantë territorial apo ideologjik dhe duhet vlerësuar jo e veçuar, por në një kontekst të përgjithshëm me politikën nacional-socialiste ndaj Shqipërisë, para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Kapitullimi i Italisë nga lufta dhe si pasojë edhe lëshimi i frontit të Evropës Juglindore nga ushtria italiane, detyroi Komandën e Lartë të Wehrmacht të merrte masa të shpejta për mbrojtjen e kësaj vije fronti, ndaj edhe të ndërhyrjeve të mundshme ushtarake të aleatëve anglo-amerikanë në Ballkan. Si pasojë, në fillim të shtatorit 1943, trupat gjermane pushtuan Shqipërinë dhe si rrjedhim edhe gjithë Kosovën.

Politika gjermane ishte, para së gjithash, e interesuar që nëpërmjet premtimeve për garantimin e pavarësisë dhe krijimin e Shqipërisë së Madhe të fitonin mbështetjen e popullsisë shqiptare dhe të mbanin kësajsoj të pushtuar këto troje sa ishte e mundshme me sa më pak forca ushtarake. Kësajsoj, nuk munguan edhe premtimet se, vetëm tani, dhe me gjermanët, shqiptarët mund të realizonin ëndrrën e tyre të madhe, bashkimin e Kosovës me Shqipërinë.

Nëse vlerësojmë dokumentet gjermane të kohës, bie në sy që thuajse gjithmonë përdoren termat “Shqipëria e vjetër” dhe “Shqipëria e re”. Pra, pavarësisht propagandës, Shqipëria nuk konsiderohej në të vërtetë si një e vetme dhe e vetëkuptueshme në formën e saj natyrale, por si një krijim artificial për interesa të Gjermanisë. Këtë gjë e vërteton edhe një raport i ministrit të Plotfuqishëm për Evropën Juglindore, Neubacher, i cili më 19 shtator 1943 raporton në Berlin se ai kishte ndërhyrë në tekstin e hartuar nga Komiteti Kombëtar për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë - sigurisht nën tutelën gjermane - i cili do të publikohej në kanalet e informacionit të kësaj kohe. Ndër të tjera, në tekstin origjinal thuhej: “[...] që Shqipëria e pavarur brenda kufijve të saj etnikë është shndërruar nga ëndërr në realitet”.¹ Pas ndërhyrjes së Neubacher, në thirrje do të shkruhej: “[...] gjithë shqiptarët brenda kufijve etnikë e përfshijnë këtë ditë plot me shpresë për të ardhmen e tyre kombëtare”.² Neubacher e argumenton këtë ndryshim si më poshtë: “Unë (d.m.th. Neubacher - M. K.) e ndryshova këtë fjali sepse, në të theksohej përfshirja e territoreve të reja (nën Shqipërinë - M. K.) në kurrizin e Serbisë. Kësisoj - vazhdon Neubacher më tej - kërkesa e pashmangshme e shqiptarëve për bashkimin e trojeve të tyre etnike shndërrohej në një ëndërr”.³ Siç shkruan Neubacher, fjala “kufij etnikë” duhet të qëndronte në këtë thirrje vetëm për efekt propagandistik.

Më tej, një synim tjetër po kaq i rëndësishëm ishte edhe përvetësimi i kromit shqiptar, si një nevojë emergjente e ekonomisë gjermane të luftës. Ky interes ishte shfaqur kahershëm, që kur pas pushtimit të Jugosllavisë, sipas Marrëveshjes së Vjenës, më 21 prill 1941, Kosova do të bashkohej me Shqipërinë, me qëllim që të parandalohej shndërrimi i irredentizmit të shqiptarëve etnikë në një

¹ PA/AA Büro des Staatssekretär, Albanien 3. April 1940-15. Juni 1944, Telegram sekret i Neubacher Nr. 1466 i datës 20.9.1944 (data e mbërritjes) - *Politisches Archiv des Auswärtigenamts (PA/AA)/ Arkivi Politik i Ministrisë së Punëve të Jashtme Berlin*, Gjermani.

²Po aty.

³Po aty.

lëvizje antigjermane.⁴ Por, në të nuk u përfshinë Trepça, Mitrovica dhe Vuçitërna, të cilat mbetën nën administrimin ushtarak gjerman. Pas kapitullimit të ushtrisë italiane, Wehrmacht gjerman, përqendroi në Prishtinë në Divizionin 100 të Këmbësonisë Malore. Këto trupa ishin nën komandën operative të Korparmatës XXI Malore të Wehrmacht gjerman.

Në kuadër të përgatitjes së pushtimit, Kosova u vlerësua nga gjermanët si vendi i duhur për të mbështetur “lëvën e politikës” së pushtimit. “[...] *Gjërat janë ndryshe në Shqipërinë e re - raportonte më 12 shtator 1943 Neubacher. Aty - vazhdonte ai më tej - jetojnë më të mirët në pikëpamje racore, më të vendosurit politikisht dhe elementët më të përshtatshëm ushtarakisht të popullit shqiptar. Kjo popullsi e ka të qartë që, bazuar në premtimet që Aleatët i kanë bërë Jugosllavisë dhe Greqisë, ajo (d.m.th. Kosova - M. K.) qëndron ose bie me Gjermaninë*”.⁵

Siç lexohet ky qëndrim bazohej pikësëpari te mendimi se shqiptarët e Kosovës do ta mirëprisnin këtë pushtim si një të keqe më të vogël në krahasim me sundimin serb, që mund të vendosej më pas nëse Gjermania do të humbiste luftën.

Në kuadër të përgatitjes së pushtimit ministri i Jashtëm gjerman, von Ribbentrop, urdhëroi ish-oficerin austriak të Luftës së Parë Botërore dhe për shumë vite më vonë nëpunës në Legatën Gjermane në Tiranë, Franz von Scheiger (Franc fon Scheiger), një njohës shumë i mirë i gjuhës dhe kulturës shqiptare dhe me shumë miq shqiptarë, të vishte uniformën e majorit dhe si efektiv i Divizionit 100 të Këmbësonisë së Lehtë Gjermane të përqendruar në Kosovë, të nisej urgjent për në Shqipëri, i pajisur me rreth 6 kg napolona ar, si dhe para britanike⁶. Nga ana e tij, von Scheiger kërkoi t'i sigurohej edhe një ngarkesë prej 100 kg kafe dhe 50 kg raki për bajraktarët e Veriut, e cila do të porositej enkas në Lisbonë,

⁴ Noel Malcolm, *Kosova - një histori e shkurtër*, Prishtinë-Tiranë 2001, f. 303.

⁵ PA/AA Büro des Staatssekretär, Albanien 3. April 1940-15. Juni 1944, telegram sekret i Neubacher, Beograd, 12 shtator 1943.

⁶ PA/AA Büro des Staatssekretär, Albanien 3. April 1940-15. Juni 1944, shënim për ambasadorin Ritter dhe Sekretarin e Shtetit von Steengracht, më 1 shtator 1943.

meqenëse ishte e vështirë të sigurohej në Gjermani.⁷ Siç shihet, ky veprim tregon se von Scheiger ishte vërtet një njohës i mirë i shqiptarëve dhe zakoneve të tyre.

Historiani gjerman B. Kühmel, bazuar në dokumente të kundërzbulimit gjerman ushtarak, mendon se von Scheiger mori menjëherë kontakt me politikanë shqiptarë antiitalianë dhe si pasojë edhe e këtyre takimeve, më 16-19 shtator 1943 u mbajt Lidhja e Dytë e Prizrenit. Misioni kryesor i Lidhjes ishte ruajtja e trojeve etnike nga ripushtimi jugosllav pas largimit të ushtrisë gjermane.⁸ Edhe raportimet e Neubacher e mbështesin këtë tezë të Kühmel kur ai njofton se: “ne kemi vendosur atje (d.m.th. në Kosovë - M. K.) shqiptarë të besuar, politikisht të provuar, si edhe një trupë të kualifikuar kundërspiunazhi [...]”.⁹

Personaliteti më i spikatur në këtë takim ishte, pa dyshim, Xhafer Deva. Ai menjëherë pas kapitullimit italian u lidhë me Neubacher në Beograd, i cili organizoi udhëtimin e Devës për Tiranë me avionin e tij personal.¹⁰

Gjithsesi, pavarësisht se Lidhja ishte një organizatë progjermane dhe krijimi i saj ishte përshëndetur nga Neubacher, me kalimin e kohës, e sidomos kur ajo drejtohej nga Bedri Pejani, herëherës ajo shndërrohej në një problem për politikën gjermane. Shkaku kryesor i këtyre problemeve shikohej te dëbimi në masë i serbëve nga Kosova, gjë që sipas gjermanëve, përveç dëmtimit që i bënte kjo gjë bashkëpunimit gjermano-serb, shkaktonte edhe probleme ekonomike, sociale etj. Por, nga ana tjetër, nacionalizimi i theksuar i Pejani ishte mjaft popullor në Kosovë dhe kjo gjë e pengonte

⁷ PA/ AA Pol. I.M. (12), Detyra e Ministrit të Jashtëm e datës 1 shtator 1943, f. 291400.

⁸ Bernhard Kühmel: *Deutschland und Albanien, 1943-1944. Die Auswirkungen der Besetzung und die innenpolitische Entwicklung des Landes*, Bochum 1981 (Inauguraldissertation zur Erlangung eines Doktors der Philosophie in der Abteilung für Geschichtswissenschaft der Ruhr-Universität Bochum), f. 169.

⁹ PA/AA Büro des Staatssekretär, Albanien 3. April 1940-15. Juni 1944, Telegram sekret i Neubacher, Beograd, 12 shtator 1943.

¹⁰ Bernhard Kühmel, *Deutschland und Albanien 1943-1944*, f. 171.

fuqizimin e lëvizjes komuniste në Kosovë dhe qëndresën proaleate.¹¹ Sigurisht që kjo gjë ishte tejet e rëndësishme për gjermanët në këtë fazë të vështirë të luftës së tyre.

Është i pakundërshtueshëm fakti se politikës gjermane nuk i interesonte se çfarë do të ndodhte me shqiptarët pas lufte. Ajo ishte e interesuar të realizonte pikësëpari qëllimet e saj gjatë luftës, pra qetësi në pikëpamje ushtarake, vjeljen e nëntokës shqiptare etj., çka arrihej me shqiptarët një paqësim politik. Që politika gjermane nuk ishte e interesuar në të ardhmen e shqiptarëve pas lufte e vërteton edhe fakti që në tetor 1944 Komanda Gjermane në Mitrovicë kujdesej për të ruajtur bashkëpunimin shqiptaro-serb, sigurisht për interesin e saj. Kësisoj më 29 tetor 1944 raportohet një mbledhje e shefit të kundërzbulimit në Mitrovicë, nënkolonel Warnstorff (Varnshtorf) me çetnikun dhe komandantin e korpusit Markoviç, ministrin e Brendshëm Deva, një major, Ali, dhe përfaqësuesin e Neubacher, Gstöttenbauer (Gshtëtenbauer). Synimi kryesor i gjermanëve ishte futja në luftë përkrah njëri-tjetrit e formacioneve shqiptare dhe serbe kundër armikut të tyre të përbashkët.¹²

Shqiptarët e Kosovës nën Armën SS: Krijimi i Divizionit SS “Skanderbeg”

Nga dokumentet gjermane të konsultuara nuk rezulton ndonjë plan i gjermanëve për një mobilizim të përgjithshëm të shqiptarëve të Kosovës. Po ashtu, edhe përfundimi se ideja e rekrutimit të Divizionit SS “Skanderbeg” doli nga diskutimet e zhvilluara nga autoritetet gjermane dhe Bedri Pejës,¹³ është i gabuar. Ideja për ngritjen e formacioneve shqiptare nën Armën SS zë fill qysh në shtator 1943. Ashtu si edhe në vendet e tjera të pushtuara, ideja për krijimin e një force ushtarake vendase u hodh menjëherë pas

¹¹ Bernd Fischer, *Shqipëria gjatë luftës 1939-1945*, Tiranë 2004, f. 309.

¹² BA/MA RH19 VII/27, Kriegstagebuch der Führungsabteilung Oberkommando Heeresgruppe E, Monat Oktober 1944, raportim i datës 29.10.1944.

¹³ Noel Malcolm, *Kosova - një histori e shkurtër*, f. 322.

pushtimit, por u ndërpre përkohësisht si pasojë e propagandës dhe këmbënguljes së Neubacher për të ruajtur në dukje pavarësinë shqiptare. Po ashtu, një arsye tjetër e mosrealizimit të këtij plani ishin edhe kontradiktat e shumta që shkaktoheshin si pasojë e “përplasjes së kompetencave” ndërmjet instancave ushtarake gjermane në Shqipëri, konkretisht e gjeneralit gjerman për Shqipërinë dhe përfaqësuesit të Himmler në Shqipëri, Brigadenführer-SS¹⁴ Josef Fitzthum (Jozef Fitctum).

Në një telegram që Kaltenbrunner (Kaltenbruner), shef i Policisë së Berlinit, i dërgonte Neubacher më 17 shtator 1943, ndër të tjera, i shkruante atij se Himmler kishte: “urdhëruar në mënyrë kategorike ndërprerjen e çdo rekrutimi vullnetarësh për njësitë e Armës SS në Shqipëri ...”.¹⁵

Natyrisht që gjermanëve ju duheshin forca për të ruajtur krahët nga lëvizja partizane, sepse siç shprehet edhe Neubacher: “çdo pushkë e Wehrmachtit gjerman nevojitet në ruajtjen e bregdetit”.¹⁶ Kështu që Neubacher i kërkon me këmbëngulje Himmler që rreth 4 000 shqiptarë (të Kosovës) të inkuadruar në një Divizion SS (boshnjak - M. K.) në Francë, të dërgohen në Shqipëri dhe si formacione shqiptare SS të kryejnë detyra të veçanta ruajtje e sigurimi. “Formalisht këta trupa duhet të jenë në dispozicion të ministrit të Brendshëm, i cili do t’i përdorë ata sipas dëshirave tona”, njoftonte Neubacher në Berlin.¹⁷ Kjo kërkesë fillimisht nuk do të plotësohej. Këto forca shqiptare ishin të shpërndara në njësitë boshnjake dhe nuk konsideroheshin si të afta për të vepruar të pavarura, megjithëse Himmler mendonte se këta ushtarë shqiptarë

¹⁴ Brigadenführer (*Brigadenfyrrer*) - gradë e lartë e Armës-SS, e barasvlershme me gjeneral brigade.

¹⁵ PA/AA, Inland II g, 296, Waffen SS, Albanien, Aufstellung von SS-Formationen 1943-1944.

¹⁶ PA/AA Büro des Staatssekretär, Albanien 3. April 1940-15. Juni 1944, Telegram sekret i Neubacher, Beograd, 30 shtator 1943.

¹⁷ PA/AA Büro des Staatssekretär, Albanien 3. April 1940-15. Juni 1944, Telegram sekret i Neubacher, Tiranë, 25 shtator 1943.

premtimin të bëheshin ushtarë shumë të mirë pasi të përfundonin stërvitjen përgatitore.¹⁸

Pavarësisht urdhrit të sipërpërmendur të shefit të Armës SS, Himmler për të ndaluar rekrutimin e shqiptarëve, Komanda e Lartë e Wehrmacht nuk e zbatoi atë dhe, si pasojë, rezultoi se në tetor 1943 janë formuar pesë batalione shqiptarësh, me rreth 4 800 burra. Po ashtu, në Kosovë ishin rekrutuar nga Wehrmacht (jo nga Arma SS) rreth 6 000 shqiptarë me nënshtetësi jugosllave, nga të cilët 2/3 vinin nga sanxhaku dhe 1/3 nga territoret e Kosovës, të cilët nuk ishin veshur ende, por që ishin pajisur me armatim italian.

Pa marrë parasysh këto zhvillime, në fillim të vitit 1944, pasi u pa qartë se qeveria shqiptare dështoi në ngritjen e një force ushtarake qeveritare, ndërsa për trupat gjermane ngritja e forcave të tilla ishte tepër të nevojshme në luftën kundër partizanëve, Hitler miratoi krijimin e Divizionit SS “Skanderbeg”.¹⁹

SS Brigadenführer Fitzthum, i cili në literaturën shqiptare të para viteve 1990 paraqitet si prototipi i nazistit, simboli i së keqes dhe thuhet sinonimi i figurës së Drakulës në filmat horror të Evropës Perëndimore,²⁰ ishte pikërisht ai që u ngarkua me ngritjen e kësaj force ushtarake. Person tjetër kyç për ngritjen e këtij divizioni ishte ministri i Brendshëm shqiptar Xhafer Deva. Këshillat për kujdesin që duhej të tregohej në mobilizimin e kësaj force, sigurisht që i jepte Neubacher, i cili shprehej i sigurt për suksesin ushtarak dhe politik që do të kishte krijimi i këtij divizioni kundër bandave komuniste.²¹ Suksesi do të ishte më i madh nëse marshimi i këtyre trupave në qytetet kryesore do të shoqërohej me një propagandë të sofistikuar. Po ashtu u morën masa të kujdesshme në lidhje me uniformën që duhej të kishte ky divizion.

Qeveria shqiptare mori përsipër nxjerrjen e një urdhri sipas së cilit në Kosovë do të kryhej rekrutimi i burrave të lindur ndërmjet

¹⁸ PA/AA Büro des Staatssekretär, Albanien 3. April 1940-15. Juni 1944, Inland II 28006/43g, sekret.

¹⁹ PA/AA, Inland IIg, 296, 1943/44, H 298851.

²⁰ Bernhard Kühmel, *Deutschland und Albanien*, S. 296.

²¹ PA/AA, Inland IIg, 296, 1943/44, H 298816.

viteve 1920 e 1924. Po ashtu, shqiptarët e Kosovës që ishin të burgosur duhej të liroheshin dhe të integroheshin në divizionin e ri. Vazhdonte të këmbëngulej, gjithashtu, që myslimanët shqiptarë që ishin inkuadruar si vullnetarë në Divizionin SS me numër 13 (divizioni boshnjak - M. K.) duhej të krijonte bazën e Divizionit të ardhshëm SS shqiptar.

Për rekrutimin e shqiptarëve ishte e interesuar edhe Lidhja e Dytë e Prizrenit. Mirëpo, komandanti i Divizionit, gjenerali Schmidhuber (Shmidhuber), e përgënjeshtroi impenjimin e Lidhjes së Prizrenit dhe të kryetarëve të bashkive për të organizuar rekrutimin, duke e marrë vetë meritën e krijimit të kësaj force. Është i pamohueshëm pasiviteti i prefektëve dhe kryetarëve të bashkive për rekrutimin e shqiptarëve nën Armën SS, ishte në një farë mënyre një shenjë që ata i jepnin popullsisë që të mos e merrnin seriozisht këtë rekrutim dhe ta konsideronin atë si diçka të parëndësishme dhe ta injoronin. Vetëm njerëz nga shtresa e varfër shfaqën interes për t'u rekrutuar, sepse e shihnin atë si një mundësi punësimi për të siguruar jetesën, ndërkaq që djemtë e bejlerëve, agallarëve dhe tregtarëve të pasur, u liruan nga detyrimi për rekrutim nëpërmjet njohjeve ose korrupsionit.²² Megjithatë, deri më 25 shtator 1944 për rekrutim u paraqitën 11 398 shqiptarë, nga të cilët u konsideruan të aftë 9 275 vetë. Prej tyre u inkuadruan në divizion vetëm 6 491 shqiptarë.²³

Rekrutimet u bënë në zonat e Kosovës, Maqedonisë dhe Mitrovicës. Ekzistojnë disa të dhëna, pavarësisht se qeveria shqiptare nuk i konfirmonte, ku dëshmohet se në këtë divizion janë rekrutuar edhe shqiptarë nga Shqipëria, ndonëse numri i tyre ishte i vogël.²⁴

I parë në pikëpamje ushtarake dhe organizative urdhri për krijimin e këtij divizioni ishte vlerësuar mbi kërkesa të gabuara. Shqiptarët nuk kishin pasur asnjëherë trupa të organizuara ushtarake sipas perceptimit gjerman për një forcë të rregullt ushtarake. Njësitë

²² BA/MA RS 3-21/1, Zusammenfassender Bericht über die Aufstellung und den Zustand der 21 Waffen-Gebirgs-Division der SS - Skanderbeg", f. 2.

²³ BA/MA, RS 3-21/1, S. 3.

²⁴ BA/MA, XXII. A.K, 59643/4, F. 79 (Raport i datës 02.05.1944).

ushtarake shqiptare të deriatëhershme, përfshirë edhe milicinë shqiptare të krijuar gjatë pushtimit italian, paraqisnin vetëm një krijesë ushtarake në dukje. Atyre u mungonte çdo strukturë e brendshme solide ushtarake. Mangësia e parë kryesore e këtyre trupave ishte mungesa e disiplinës, të cilën ushtarakët italianët jo vetëm që nuk u munduan ta përmirësonin, por përkundrazi e kultivuan më tej atë. Po ashtu, kontingjenti i shqiptarëve që u afruan për rekrutim ishte i dobët dhe i paarsimuar, të cilët ishin motivuar më tepër se gjithçka tjetër nga rroga që do të merrnin.

Gjatë luftimeve që kreu ky divizion kundër partizanëve, ra në sy përgatitja e lartë e partizanëve, si edhe armatimi dhe veshja e tyre. Në misionin e parë luftarak ndaj partizanëve gjermanët vunë re se luftonin kundër një trupe e cila nuk kishte tashmë asgjë të përbashkët me banditët, por shfaqej si një trupë e mirëfilltë ushtarake, e rregullt, e disiplinuar, e veshur njësoj me uniforma angleze dhe që drejtohej nga oficerë me cilësi të larta ushtarake.²⁵ Madje, si pasojë e mungesës së pajisjeve drejtuese në Divizionin “Skënderbeg”, Schmidhuber pranon, se “trupat e tij kishin ndërruar rolet me banditët”.²⁶

Edhe përkundër këtyre dobësive nuk mund të mohohen disa suksese të vogla që arriti Divizioni në fund të muajit maj 1944. Për këtë arsye Fitzthum i propozonte Himmler krijimin e një divizioni të dytë SS në Shqipëri.²⁷ Madje, Vehbi Frashëri u propozoi gjermanëve marrjen përsipër nga qeveria shqiptare të një pjese të shpenzimeve që nevojiteshin për krijimin e kësaj force, nëse gjermanët premtonin se ky divizion nuk do të vepronte jashtë “Shqipërisë së Vjetër”.²⁸

Është e vetëkuptueshme se sa i rëndësishëm ishte për qeverinë shqiptare ky projekt, sidomos kur mund të parashikohej tërheqja e gjermanëve nga Shqipëria dhe qeveria do të kishte në këtë mënyrë

²⁵ BA/MA, RS 3-21/1, S. 3.

²⁶ BA/MA, RS 3-21/1, S. 3.

²⁷ Bernhard Kühmel, *Detuschland und Albanien*, f. 310.

²⁸ *Po aty*.

një forcë të armatosur në dispozicion, pavarësisht formatit të saj jo të plotë.

Divizioni “Skënderbeg” veproi kryesisht në rajonin kufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi. Ai mori pjesë në disa operacione kundër partizanëve. Synimi i operacionit “Endlich” (*Më në fund*) ishte asgjësimi i forcave partizane në rajonin e Gjakovës. Gjatë këtij operacioni u shkatërrua një fushë aviacioni, e cila përdorej nga aleatët anglo-amerikanë për të furnizuar partizanët vendas. Prej 11 deri më 27 qershor 1944, një batalion i përforcuar i Divizionit “Skanderbeg” mori pjesë në operacionin “Falkenauge” (Syri i skifterit). Në nëntor Divizioni, tashmë i riformatuar në Grupregjimentin “Skanderbeg”, u transferua nga Prishtina në rajonin e Krlevës. Më vonë ai do të rigrupohej përsëri, por tashmë nën komandën e Divizionit 7 malor SS “Prinz Eugen”.

Përfundimisht vlen të theksohet se krijimi i Divizionit SS “Skanderbeg” nuk përbënte ndonjë rast të veçantë apo tipar dallues të marrëdhënieve pushtuese, politike dhe ushtarake ndërmjet Gjermanisë dhe Shqipërisë. Kjo për shkak se gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore, Gjermania rekrutoi në Armën SS shumë ushtarë apo njësi e reparte të tjera nga shtete të huaja në tërë hapësirën e paanë të pushtimit dhe jo vetëm në Ballkan, por thuajse në gjithë vendet që ajo pushtoi. Në këtë kuadër edhe në Ballkan u rekrutuan forca të tilla si në Shqipëri, Bosnje, Kroaci, Bullgari etj.

Krijimi i Divizionit “Skanderbeg” i shërbente më së shumti gjermanëve, por edhe qeverive kolaboracioniste shqiptare. Gjermanët i përdorën forcat e divizionit shqiptar në territore të largëta për qeverinë e Tiranës, kryesisht në Kosovë, dhe ata nuk mundën thuajse asnjëherë t’i shërbenin vërtet drejtpërdrejt qeverisë së Tiranës brenda Shqipërisë shtetërore.

Kjo gjë tregon qartë se këto forca më tepër duhej t’u shërbenin gjermanëve sesa qëllimit të propaganduar gjatë procesit të rekrutimit. Sipas propagandës gjermane qeveria shqiptare do të kishte një forcë të armatosur e cila do të luftonte kundër komunistëve dhe rrjedhimisht do të pengonte ardhjen e tyre në pushtet pas largimit të gjermanëve nga Shqipëria. Siç u tha më sipër, komunizmi lidhej në

Kosovë me pansllavizimin, cylaqë drejtpërdrejt e favorizonte krijimin e këtij divizioni. Kjo propagandë pati rezultat te shtresat e varfra dhe të paarsimuara të vendit, të cilët, duke e besuar atë çka thuhej, u paraqitën pranë zyrave të rekrutimit. Po ashtu pati edhe të tjerë të cilët pranuan të veshin uniformën SS, të shtyrë vetëm nga nevoja ekonomike. Gjermanët arritën të krijonin te kjo shtresë besimin se vetëm nën kujdesin e tyre mund të sigurohej Shqipëria e Madhe dhe Kosova të shpëtonte përfundimisht nga sundimi serb.

Historiografia e huaj, kryesisht ajo serbe, e akuzon këtë divizion për kryerje të masakrave të mëdha ndaj popullsisë serbe në Kosovë. Shifrat e dhëna për viktimat janë të diskutueshme. Këto veprime të ndërmarra, të cilat në raste të caktuara morën edhe ngjyrimë kriminale, bazoheshin në urrejtjen e akumuluar dhe vuajtjet ndër shekullore të shqiptarëve nga vrasjet, plaçkitjet dhe politika shkombëtarizuese serbe ndaj shqiptarëve në Kosovë.

Pikërisht kjo urrejtje u përdorë dhe u shfrytëzua mjeshtërisht nga politika gjermane në trevat shqiptare, këndeje dhe andej kufirit. Neubacher, me të drejtë, ishte shprehur që në fillim të pushtimit se, në Kosovë ata do të gjenin përkrahjen më të madhe. Edhe pasi gjermanët ishin larguar nga Shqipëria, ata vazhdonin të kishin në Kosovë mbështetjen e popullsisë, pjesa më e madhe e së cilës luftonte me fanatizëm kundër ardhjes në pushtet të komunistëve, sidomos të atyre sllavë. Përvoja historike do të tregonte se ata kishin të drejtë. Pas fitores së Titos dhe vendosjes së regjimit komunist në Jugosllavi, Kosovës jo vetëm që nuk iu dha e drejta e premtuar e vetëvendosjes, por do të vuante edhe për disa dhjetëvjeçarë, deri në vitet 1998-1999, kur e hodhi tej sundimin serb.

Zelije SHALA

ORGANIZIMI I VULLNETARËVE PËR MBROJTJEN E KUFIJVE TË KOSOVËS, MË 1944-1945

Gjendja e tensionuar në kufijtë e Kosovës më 1944 ndikoi në formimin e reparteve vullnetare, të cilat do të ngarkoheshin në ruajtjen e paprekshmërisë të vijave kufitare të Shqipërisë etnike. Kjo u bë edhe për shkak të sulmeve të shpeshta që ndërmerrnin bandat çetnike dhe brigadat partizane. Reparte vullnetare shqiptare u formuan në tërë Kosovën, ndërsa rajoni i Suharekës ishte zona që dha mjaft vullnetarë për mbrojtjen e kufijve shqiptarë.

Rreziku në rritje e sipër nga forcat çetnike dhe partizane në tërë territorin e Kosovës ndikoi që përfaqësuesit e viseve të kërcënuara të kërkonin ndihmë edhe nga Krahina e Lumës¹. Për këtë qëllim në prill të vitit 1944 atje u dërgua një delegacion i përbërë nga Hamdi Llausha, Ahmet agë Suhareka dhe Jashar Alishani, të cilët i shoqëroi Sheh Ali Bogdani. Ata u takuan me Muharrem Bajraktarin në Domaj² për t'iu ofruar ndihma materiale dhe vullnetarë të tjerë. Kjo kërkesë nuk u plotësua kurrë qoftë nga nacionalistët, qoftë nga rrethet e atëhershme qeveritare. Të ballafaquar me këto rreziqe, shqiptarët e Kosovës u detyruan të organizoheshin ashtu si mundën

1 Shefqet Hoxha, *Muharrem Bajraktari e misionet britanike 1943-44*, Tiranë 2000, f.38.

2Po aty.

dhe ditën, gjithnjë duke pasur synim parësor ruajtjen e tërësisë tokësore të Kosovës. Ndihma nuk do të vijë nga asnjë anë, sepse sipas të dhënave konstatojmë që edhe gjermanët ua kishin lënë duart e lira të vetorganizimit dhe të vetëmbrojtjes qoftë të kufijve qoftë të territorit në tërësi.

Vullnetarët e Komunës së Suharekës u organizuan nga atdhetarët e dalluar, si: Mulla Nura, Jakup Peçani, Sadri Azemi dhe të tjerë. Vendluftimi i këtyre grupeve të rrethit të Suharekës, për mbrojtjen e kufirit quhet “Livadhet e Gjakut” në rrethin e Rozhajës dhe Kollashinit. Në këtë pjesë të kufirit të Shqipërisë etnike u zhvilluan përleshje të rrepta që zgjatën përafërsisht dy muaj³. Fatkeqësisht, në këto luftime pati të vrarë nga ana e grupeve vullnetare; në pjesën e Kollashinit ranë Ali Sadri Llugagjiu dhe Rrahman Sinan Kolgeci, e pati edhe disa të plagosur.⁴

Përparimi shumë i shpejtë i brigadave partizane-sllave në drejtim të kufijve të Kosovës, veçanërisht nga ana e Dragashit, i shtyri organizatorët e vullnetarëve që pjesën më të madhe të ushtarëve dhe armatimin t’i dërgonin për ta mbrojtur Dragashin.⁵ Rezistenca e vullnetarëve shqiptarë në mbrojtje të Shqipërisë etnike e shtyri gjeneralin Tito dhe udhëheqjen e lartë të Shtabit Suprem të UNÇJ-së të përdornin taktikë me qëllim të marrjes sa më të lehte të territorit të Kosovës. Pra, duke përdorur dredhi, Shtabi Supremi i UNÇJ-së të Jugosllavisë i bëri kërkesë, në fillim të tetorit 1944, Shtabit Suprem të Shqipërisë, e cila e miratoi kërkesën dhe i dërgoi për në Kosovë, Brigadën III dhe V të Shqipërisë.⁶ Faktikisht këto brigada u përdorën për të shtypur qëndresën e kosovarëve⁷ përballë

3 Dëshmi e Zarife S. Emrullahut, në shtatorin e vitit 1999. Të gjitha dëshmit janë marrë nga Z. Sh.

⁴ Dëshmi nga Faik Muça, arsimtar, 2001.

5A.K. Fondi gjykata ushtarake Prizren: Lënda penale viti 1945-47:nr.l-173 nr. Kutia 1.

⁶ Fadil Hoxha, Materiale punimet nga Simpoziumi: *Njësitet e armatosura të Kosovës 1941-45*, Prishtinë, 1974.

7A.K.Fondi Gjykata ushtarake Prizren: Lënda penale viti 1945-47:nr.l-173 Nr. Kutia I.

partizanëve sllavo-komunistë. Dhe, së bashku brigadat partizane jugosllave dhe ato shqiptare bënë sulmin e papritur më 5 tetor 1944 në Dragash, i cili me atë rast dhe u “çlirua”⁸, ndërsa më 6 tetor u morë edhe i tërë rrethi i Gorës. Pastaj, aradhat partizane e kaluan Drinin dhe depërtuan drejt Gjakovës dhe Tropojës. Prej 5 deri më 14 tetor Brigada I dhe e IV Kosovare dhe Brigada e III dhe e V e UNÇ-së të Shqipërisë zhvilluan luftime të pandërprera për pushtimin apo siç thuhej “çlirimin” e territorit në jug të Prizrenit dhe të Gjakovës.⁹ Pasi që morën komunat Zym, Damjan, Vogovë, Ponoshec dhe tërë Malësinë e Gjakovës d.m.th. nënprefekturën e Tropojës vazhduan depërtimin drejt Prizrenit, Gjakovës dhe Pejës.¹⁰

Vullnetarët shqiptarë, të cilët ishin rreshtuar në mbrojtje të kufijve të Kosovës, u tërhoqën sepse duke vërejtur se divizionet shqiptare me flamurin kombëtar që kishte yllin mbi shqiponjën dykrenore nuk deshën të luftonin ngase për ta, të luftosh kundër flamurit që e vunë në ballë për të luftuar armiq të tërë, ishte sikur t’i shpallje luftë kombit shqiptarë në tërësi.¹¹ Në këtë mënyrë u lanë terren të lirë brigadave partizane për ta marrë qytetin e Prizrenit më 17 nëntor 1945 dhe Suharekën.¹² Në Suharekë vendoset për një kohë të shkurtër Brigada V e Shqipërisë dhe kërkoi vullnetarë, ku arriti të merrte disa njerëz dhe u nisë për në Sanxhak.¹³ Në Komunën e Suharkës, për një kohë të shkurtë veproi brigada partizane e udhëhequr nga Rifat Berisha, brigadë kjo që njihej për mbrojtjen e devotshme të popullit shqiptar në mënyrë që të shpëtonte nga maltretimet dhe masakrimet e mëdha të serbo-malazezve. Mirëpo, një veprim i tillë i Rifat Berishës me shokët e tij nuk ju pëlqeu atyre që kishin qëllime tjera dhe jo mbrojtjen e popullatës shqiptare. Për

⁸ Fadil Hoxha, Materiale punimet nga Simpoziumi: *Njësitë e armatosura të Kosovës 1941-45*, Prishtinë 1974.

⁹ *Po aty*.

¹⁰ *Po aty*.

¹¹ Dëshmi e Xhemajli Shalës, Mushtisht, 2001.

¹² *Po aty*.

¹³ Dëshmi e Ragip Berishës, Suharekë, 2000.

këtë arsye kjo brigadë u transferua në Shtime,¹⁴ ndërsa në Suharekë erdhi Brigada V famëkeqe Malazeze, në krye me Gojko Medenicën, i cili më vonë u emërua edhe shef i UDB-së për meritat që tregoi në kryerjen e krimeve në këto anë.¹⁵

Me gjithë rezistencën e organizuar nga këto grupe, nuk u arrit që të ndalohej depërtimi i bandave çetnike dhe brigadave partizane. Kur ato u futën në brendi, Hasan Bllaca, kryetar i komunës së atëhershme të Duhllës, bëri një organizim të ri të vullnetarëve të komunës së Duhllës, duke u përpjekur që të shpëtojë çka mund të shpëtohej. Me propozimin e Qeverisë shqiptare, ndërmoi masa për ta siguruar Grykën e Carralevës nga sulmet sllave-komuniste. Për ta mbrojtur këtë zonë duhej të përgatiteshin rreth 50 deri 60 roje, të cilët duhej të qëndronin tërë kohën aty.¹⁶ Problem në vete ishte se këto grupe nuk kishin armatim të mjaftueshëm, sepse pjesa më e madhe e armatimit ishte dërguan më herët për ta mbrojtur Dragashin.¹⁷

Brigadat partizane, të prira nga ata të cilët rridhnin nga kuzhina e akademisë serbe, me të hyrë në Kosovë dogjën në çdo anë për të lënë mbrapa vetës vetëm shkrumb e hi, duke dashur kështu që të treten njëherë e mirë gjurmët shqiptare të këtyre anëve. Sllavokomunistët e shfrytëzuan rastin të hakmerreshin për gjoja “zullumet që i kanë bërë shqiptarët mbi popullin tonë gjatë këtyre katër viteve”.¹⁸ Pushteti i asaj kohe mbeti në duar të partizanëve serbokomunistë, të cilët në rrethin e Suharekës, ashtu si edhe në tërë Kosovën, filluan me arrestime, torturime e vrasje të të gjithë atyre, që sipas tyre quheshin “kundërshtarë” të regjimit të ri jugosllav.

Kur u vendos brigada malazeze, në komunën e Suharekës, serbët lokalë ndërmorën një sërë aksionesh për të zhdukur,

¹⁴ Dëshmi e Zarife Emërllahut, bashkëshortja e atdhetarit Sadri Enërllahut, 1999, Mushtisht.

¹⁵ *Po aty.*

¹⁶ A.K.Fondi Gjykata ushtarake Prizren: Lënda penale viti 1945-47:nr.1-173 Nr. Kutia I.

¹⁷ A.K.Fondi Gjykata ushtarake Prizren: Lënda penale viti 1945-47:nr.1-173 Nr. Kutia I.

¹⁸ Brahim Graica, *Kujtimet e mia*, Faksimil. I. H. Prishtinë.

përndjekur njerëz që i konsideronin të papërshtatshëm, si për ata, ashtu edhe për pushtetin e ri i cili po vendosej në Kosovë. Kështu vepruan edhe me Sadri Emrullahun dhe 17 bashkatdhetarë të tjerë, të cilët i arrestuan dhe e dërguan në burgun e quajtur “Podrumi i Vuqes”, në Suharekë.¹⁹ Që masakrimi dhe tortura ndaj tyre të bëhej pa u vërejtur nga qytetarët e tjerë, ata i futën në shtëpinë e Marisë (kjo shtëpi ndodhet edhe sot pas postës së vjetër). Kjo shtëpi ishte e përgatitur për gjëra të tilla sepse në katin përdhes serbo-malazezët kishin vendosur lodra dhe këngëtarë, ndërsa në podrum i kishin ngujuar të arrestuarit. Përderisa muzika dëgjohej poshtë në nëntokën e zezë torturoheshin shqiptarët e mjerë dhe thirrjet e tyre mbyteshin nën tingujt e muzikës së katit të parë. Kjo torturë udhëhiqej nga Gojko Medenica, i njohur si kriminel i veshur në petkun e partizanit.²⁰ Këta 18 të arrestuar, u pushkatuan në mesnatën e 7 janarit, pra agun e 8 janarit të vitit 1945.²¹

Pushkatime dhe vrasje të ngjashme ndodhnin gati për çdo natë pasi e deshën lirinë e popullit të përvuajtur. Shumë fshatra mbetën pa veprimtarët e tyre të guximshëm, sepse dora gjakatare e komunizmit sllav ua shoi jetën, e një fat të tillë pati edhe Shaban Nuha, nga Maçiteva. Ai u ftua kinse në bisedime në fshatin Vraniq, por nga atje ai u kthye në arkivol.²² Pati shumë të tjerë të cilët, sikur që ishin Rexhep Idriz Aliu, Rexhë Shaban Aliu, Latif Zeqiri dhe të tjerë, të cilëve një plumb në kokë ua ndërprente veprimtarinë, lirinë dhe jetën.²³ Edhe pjesëtarët e fshatit Reqan, si: Muhamet Veseli, Nuhi Muharremi, Ramë Muharremi, Mehmet Qazimi, Abdyl, Hanife dhe Kadri Veseli, Hamëz Destani, Abdyl Rama dhe Ahmet Hoxha.²⁴ Të gjithë këta njiheshin pishtarë të lirisë, por kësaj dore gjakatare nuk i

¹⁹ Dëshmi e Zarife Emërllahut, bashkëshortja e atdhetarit Sadri Enërllahut, shtator 1999, Mushtisht.

²⁰ *Po aty.*

²¹ *Po aty.*

²² Dëshmi nga Halil Krasniqi, 2000, Macitevë.

²³ *Po aty.*

²⁴ Dëshmi nga Sadri e Arben Veselaj, 2002, Reqan.

shpëtoi as i riu nga fshati Studençan, Nazif Abedin Gashi, i cili nuk kishte marrë pjesë në asnjë lëvizje apo ballafaqim me pushtetin, sepse mosha e kishte privuar nga kjo e drejtë.²⁵ Në fshatin Papaz, ishin të njohur Rahim Maksutaj, Brahim Maksutaj, Sadik Bardheci, Adem Bardheci dhe Sadri Maksutaj. Ky grup bashkëpunoi me Imer Devetakun.²⁶ Këta u ndihmuan nga fshatarët që të përballojnë urinë dhe motin e ftohtë, por më e dalluara ishte Zelfije Maksutaj. Ajo nuk i shpëtoi syrit të pushtetarëve serbë të asaj kohe. Për veprimtarinë e saj Zelfija u lidhë për lisi në oborrin e saj dhe nga ajo kërkuan që t'i jepte shokët e saj, por këtë ajo nuk e bëri kurrë as edhe atëherë kur u arrestua dhe iu nënshtrua torturave të rënda.²⁷ Edhe në fshatin Mushtish Etem Islami ishte njëri i përzgjedhur nga pushteti serbo-sllav që të njollosej dhe të shpallej si bashkëpunëtor i okupatorit. Ai akuzohej se në periudhën e sundimit gjerman kishte shërbyer si xhandar dhe me këtë rast kishte torturuar e rrahur serbët dhe kishte marrë ryshfet nga vëllai i partizanit të burgosur Milan Kërstiq. Për këto fakte të kurdisura, Etem Islami, dënohet me 5 vjet burg me punë të detyruar, i konfiskohet gjysma e pasurisë si dhe i izolohet familja nga të gjithë të njohurit për sa kohë do ta vuante ai dënimin.²⁸

Dënime të tjera pati edhe në emër të spekulimit e matrapazllëqeve. Kështu nga Pushteti Popullor dënohet Zeqir Mehmeti nga Bllaca, i cili nuk e kishte përkrah LNÇ-në dhe ishte i njohur për aktivitetin kundër saj.

Pas vitit 1945 nacionalistëve filloi t'u ngushtohej rrethi i veprimtimit. Udhëheqësit e organizatave të këtyre veprimtarëve u detyruan të kërkonin strehim nëpër fshatra të ndryshme. Grupi i përbërë nga Rexha i Avdylit (Budakovë), Qorr Ilazi (Reçak), Kadri Avdyli (Buzhalë), u strehua në Vërshec.²⁹

Këto padrejtësi dhe ky okupim i egër që i bëhej Kosovës i

25 Dëshmi nga Maksut Jupaj, arsimtari Studençan, 2000.

²⁶ Emrush Maksutaj, kryetar i fshatit Papaz, 2000.

27 Emrush Maksutaj, kryetar i fshatit Papaz, 2000.

28 A.K.Gjykata e Popullore Prizren, Lëndë penale, 50/45.

29 Marrë nga Jahiri Brahimi dhe Besim Daka, arsimtarë, Vërshec 2000.

shtyri shqiptarët që të organizoheshin rreth lëvizjes Nacional Demokratike të Kosovës e cila u shtri në të gjitha qytetet dhe fshatrat e Kosovës. Atdhetarët nga Komuna e Suharekës ishin të lidhur me degën e Partisë Nacional Demokratike të Prizrenit, e cila udhëhiqej nga Halim Spahiu dhe bashkëpunëtorët e tij: Tahir Dedja, Rifat Krasniqi e të tjerë.³⁰ Formimi i Komitetit Nacional Demokratik të shqiptarëve në Prizren u bë në maj të vitit 1945, i cili pati ndikim në përshejtimin e organizimit të mirëfilltë dhe në qershor të 1945, u mbajt mbledhja konstituive në shtëpinë e Tahir Dedës.³¹ Anëtarët e degës së Suharekës si Sadik Peçani dhe Qamil Jemini, pas një veprimtarie të bollshme, u kapën nga forcat partizane, ku në Gjyqin e Popullit iu shqiptua dënimi me nga 20 vjet burg dhe punë të detyrueshme.³²

Duke qenë se gjendja po vështirësohej një pjesë e mirë e shqiptarëve që ishin në gjendje të luftonin u inkuadruan në brigadat partizane të Kosovës, kryesisht në fillimi i vitit 1944, sepse kështu dëshironin të shpëtonin atë kur dihet fakti se partizanët veç filluan të vendosin pushtetin e tyre nëpër komuna të Kosovës dhe të kundërshtojë këtë pushtet tani ishte vonë dhe rrethanat e krijuara nuk lejonin një zgjidhje tjetër më fatlume.³³

Një pjesë e atyre që nuk dëshironin në asnjë mënyrë të përkrahin këtë pushtet ende vepronin në territoret e Suharekës, të cilët në një mënyrë apo tjetër, gëzonin një përkrahje edhe të disa kryetarëve të komunave dhe në këtë valë prin kryetari i Duhlës Osman Rexhepi. Këtë përkrahje e dëshmon më së miri edhe letra e 13 marsit 1945 që e dërgonte Qazim Bajraktari, përmes korrierit të komunës së Duhlës, Rustem Tahirit, për kryetarin Osman Rexhepi me ç'rast i kërkohej kryetarit që të takoheshin në shtëpinë e Ibrahim Bllacës. Në këtë takim morën pjesë udhëheqësit e Këshillit të

30 E vërteta mbi komitetet Nacional Demokratike Balliste, në: „Rilindja” 21 tetor 1945, Prizren nr. 14.f. 2.

31 A.K.Gjykata e Qarkut Prizren, Lëndë penale P-9-, 1945.

32 A. K.Gjykata e Popullore Prizren: Lëndë penale. 50/45.

33 Dëshmi e Ragip Berishës, Suharekë, 2001.

Bllacës, ku u bisedua kryesisht për përgatitjen e një ushtrie shqiptare. Kjo ushtri, që mendohej të krijohej, sipas Qazim Bajraktarit duhej të jetë: “ushtri që të mos ju shkojë partizanëve, por të vijë me ne, ngase neve kemi lidhje me të gjithë parinë e Kosovës, si dhe me Malësinë e Gjakovës, Lumës si dhe me vetë anglezët”. Ai në mes tjerash u shpreh gjithashtu: “Unë ushtrinë e kam në gjendje gatishmërie, por sa ta filloni ju luftën ne do të vijmë të gjithë. Po ashtu, i kam informuar edhe ata të Kravasarisë”.³⁴

Në rrethanat e krijuara edhe Qazim Bajraktari kishte ftuar në shtëpinë e Sherif Mehmetit, Nazif Mehmetin, Veli Sahitin, Hamdi Sahitin, Murat Sainin, Selim Brahimin, Hasan Bajramin, Sinan Xhemën, Bexhet Sainin, Adem Nebihin, Zeqir Xheladinin, Sali Zeqirin, Xhemshit Sainin, Ali Xhemshit, Ruzhdi Balijs.³⁵ Në takim u lidhë “Besa” në mes të të pranishmëve. Pas këtij akti të shprehjes së moralit dhe dëshirës për ta luftuar të keqen Qazim Bajraktari, Hasan Bllaca, Xhemshit Saini dhe Sherif Mehmeti, vendosën të shkonin në Bllacë për të kërkuar nga paria e fshatit riorganizimin e forcave për luftë kundër partizanëve. Udhëheqësit nacionalistë arritën të organizoheshin në tërë Kosovën, ku nga secili rreth ishin të gatshëm 200 veta. Në këtë Shtab ishin përfshirë: Qazim Bajraktari, Hamit Bislimi nga Lladroviqi, Mulla Adem Hoxha nga Millanoviqi, Sherif Mehmeti nga Grejçevci, kurse shtabet e krijuara në terren do të udhëhiqeshin nga Alush Smajli nga Lloznica, Ukë Sadiku nga Gjurgjevik. Ata, sipas të dhënave pritnin urdhrin nga Shtabi Kryesor, që nuk u realizua asnjëherë.

Një pjesë e kosovarëve u rreshtuan në aradhat partizane që nga fillimi për ta luftuar armikun e përbashkët, por ata gjithnjë kishin frikë nga tradhtia që mund t’ju bëhej më pastaj. Premtimet që i kishin marrë, mbështeteshin në atë se trojet shqiptare do të bashkoheshin, por kësaj teorie ata nuk i besonin fare ose shumë pak. Ata ishin të

³⁴ A.K.Fondi: Gjykata Ushtarake-Prizren , Viti 1945/47. Nr.Lëndës: 1-173. Nr.i Kutisë: I. Deklaratë e Hasan R Bllaca.

³⁵ A.K.Fondi: Gjykata Ushtarake-Prizren , Viti 1945/47. Nr.Lëndës: 1-173. Nr.i Kutisë: I. Procesverbal i Osman Rexhepit.

gatshëm që nëse ky premtim nuk përmbushet do të përpiqeshin që atë ta realizonin.³⁶ Kjo ndrojtje e shqiptarëve që kishin rrokë armët dhe ishin bashkuar në aradhat partizane kosovare, në mënyrën më të tmerrshme u bë realitet.

Për të përligjur futjen nën kthetrat serbe të Kosovës dhe Administrimin Ushtarak serbo-jugosllav të 8 shkurtit 1945, më 10 korrik 1945, organizohet Sesioni i Dytë i Këshillit Nacionalçlirimtarë për Kosovë e Dukagjin në Prizren, me ç'rast pjesëmarrësit nën tytën e armëve u bënë dëshmitarë të aneksimit të Kosovës nga Serbia. Në Konferencën e Prizrenit, që u mbajt për shkëputje të Kosovës nga Shqipëria dhe bashkim me Jugosllavinë, në mesin e të dërguarve nga trevat e tjera të Kosovës ishte edhe përfaqësuesi prej Suharekës, Ibrahim Ukë Thaçi,³⁷ që ishte kundër bashkimit me sllavët.

Mbledhja e Prizrenit cilësohej si akt vetëvendosje, por në realitet ishte vetëm një hedhje poshtë e shkëputjes së Kosovës nga Jugosllavia. Prandaj, në tërë Kosovën shovinistët serbë filluan të aplikonin projektin e përgatitur që në vitin 1941 mbi likuidimin e njerëzve më eminentë.³⁸ Një veprim i tillë ndodhi edhe në Suharekë me rrethinë. Personalitetet më të njohura të komunës së Suharekës, si Mulla Nura dhe Qazim Bllaca, u arrestuan më 24 dhjetor 1944. Mulla Nura lirohet për mungesë provash më 16 korrik, por me akuzat e reja ai dënohet përsëri në vitin 1949 me 9 vjet, por fatkeqësisht vdes në burgun e Nishit, ndërsa Qazim Bllaca dënohet, por dënimi iu caktua ta vuante në Shqipëri, me arsyetimin që veprimtaria e tij ishte e përqendruar në Tiranë.³⁹

Sllavo-komunistët e shfrytëzuan rastin të hakmerreshin për gjoja “zullumet që i kanë bërë shqiptarët mbi popullin tonë gjatë

36 A.K.Fondi: Gjykata Ushtarake-Prizren, Viti 1945/47. Nr. Lëndës: 1-173. Nr. i Kutisë: I. Deklaratë e Hasan R Bllaca.

³⁷ Dëshmi e Ragip Berishës, Suharekë, 2001.

³⁸ Dëshmi e Ragip Berishës, Suharekë, 2000.

³⁹ Parim Kosova, Veprimtaria atdhetare e Mulla N. Gjinocit, në: “Shqipëria Etnike” Nr. 5, Prizren -Orosh 2007, f. 456.

këtyre katër viteve”.⁴⁰ Pushteti i asaj kohe mbeti në duar të partizanëve serbo-komunistë, të cilët në rrethin e Suharekës, ashtu si edhe në tërë Kosovën, filluan me arrestime, torturime e vrasje të të gjithë atyre që sipas tyre quheshin “kundërshtarë” të regjimit të ri jugosllav.

Edhe përkundër asaj që pushteti sllavo-komunist përdorte masa mizore ndaj kosovarëve të pambrojtur nuk mbeti pjesë e Kosovës që nuk u organizuan të mbrohej, por edhe të fitonte të drejtat legjitime të cilat u zhduken me paraqitjen e forcave “çlirimtare” të Jugosllavisë.

⁴⁰ Brahim Graica , *Kujtimet e mia*, Faksimil. I. H. Prishtinë.

Mrika LIMANI

AVANCIMI I TRUPAVE PARTIZANE KRAHAS TËRHEQJES SË TRUPAVE GJERMANE NË TERRITORIN E KOSOVËS NË FUND TË 1944

Lufta e partizanëve në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore kishte fillimisht natyrë guerile. Ajo karakterizohej nga tri tipare themelore: jo-rregullsi (në kontekst të luftës konvencionale), mobilitet të shtuar të trupave partizane¹ dhe prani e theksuar e ideologjisë politike tek partizanët.² Një mënyrë e tillë luftimi nga ana e partizanëve i dha këtyre mundësi që të sfidonin fillimisht në mënyra modeste pushtetin e vendosur gjerman, të cilat sulme u intensifikuan posaçërisht në fund të vitit 1944 gjatë tërheqjes së këtyre të fundit.

¹ Carl Schmitt, *Theory of the Partisan: Intermediate Commentary on the Concept of the Political* (New York: Telos Press Pub., 2007), 13. Schmid bën diferencimin mes luftimit konvencional dhe atij jo të rregullt përkundër “aktiv Kriegsstand”. See Juerg H. Schmid, *Die völkerrechtliche Stellung der Partisanen im Kriege* (Keller, 1957), 101.

² Fadil Hoxha, *Kur pranvera vonohet (Fragment nga ditari - 1943)* (Prishtinë: Rilindja, 1965), 65. Shih gjithashtu Milovan Djilas, *Memoir of a Revolutionary* (New York: Harcourt Brace Jovanovich, 1973), 93

Viti 1944 paraqet periudhën përfundimtare të luftës në regjionin e Kosovës, e cila fazë u karakterizua me ndërrim të pushteteve nga ai gjerman në pushtetin komunist. Në bazë të të dhënave historike, është vërtetuar se në fillim të marsit të 1944, trupat partizane mbanin një nivel pushteti mbi territoret kryesore malore të Dukagjinit, e cila përkon me periudhën kur forcat gjermane së bashku me shqiptarët në qeveri mbanin një nivel pushteti mbi rrugët kryesore dhe qendrat urbane të territorit të Kosovës. Në fillim të vitit 1944 regjioni i Kosovës ishte i ndarë në mes të dy grupeve që mbizotëronin territorin e Kosovës: ato zona ku gjermanët dhe shqiptarët në qeveri kishin nivel relativ të madh pushteti mbi qendrat urbane e që manifestohej me një prezencë të dukshme të ushtrisë së tyre, e që kryesisht ishin regjione gjeografike të rrafshëta, dhe ato zona ku forcat guerile kishin një nivel kontrolli mbi regjionet malore.

Ndryshimi i kahjes së luftës në nivel botëror u reflektua edhe në rrjedhën e ngjarjeve në Kosovë. Kështu, përgjatë verës së 1944 aleatët iniciuan disa sulme ajrore me cak qendrat urbane kryesore nën kontrollin gjerman. Më 28 dhe 29 qershor, aleatët bombarduan Prizrenin, ku si pasojë u vranë 50 civilë, që u numëruan si viktimat kolaterale. Sulmi shkatërroi thellë rrugët kryesore që lidhnin Prizrenin me Shkodrën, dhe Gjakovën me Suharekën, sulm ky i cili kishte për qëllim që të dëmtojë agjilitetin e transportit për gjermanët.³ Më 13 gusht të po atij viti, aleatët bombarduan Pejën, i cili sulm supozohet të ketë vrarë 1 000 civilë dhe 500 të tjerë të jenë lënduar.⁴ Një sulm tjetër ajror u iniciua në shtator të 1944 në Mitrovicë,⁵ mirëpo bombardimi i Pejës deri më atë kohë shënon sulmin më të madh që kishte ndodhur në regjionin e Kosovës në raport me sulmet e të gjithë ndërluftuesve të përfshirë në luftë.

Përkundër disfatës së afërt të gjermanëve, marrja e pushtetit në nivel lokal për partizanët nuk ishte një detyrë e lehtë, pavarësisht

³ *Lidhja e Prizrenit*, 2.7.1944.

⁴ *Lidhja e Prizrenit*, 20.8.1944. Shih dhe AQSH, F. 153, V. 1944, D. 141, fl. 5.

⁵ *Lidhja e Prizrenit*, 10.9.1944.

përkrahjes që po e fitonin muajt e fundit të luftës në Kosovë.⁶ Kjo mund të shpjegohet edhe përmes faktit që në këtë periudhë trupat partizane ushtruan dhunë ndaj civilëve, siç është rasti me sulmin në minierën e kromit në Gjakovë, ku kidnapuan 40 minatorë (nën pretekstin se janë kolaboratorë me gjermanët).⁷ Në këto rrethana, vendasit nguruan më shumë të përkrahnin luftën e tyre, e cila para se gjithash për vendasit shqiptarë kishte konotacion me lëvizje politike dhe ushtarake sllave.⁸ Burimet historike dëftojnë së qysh në shtator të 1944 partizanët ishin të pranishëm në qendrën urbane të Gjakovës, por që nuk kishin kontroll të plotë mbi qytet. Të dhëna të tilla shpjegojnë gradualitetin e avancimit të tyre në regjione të rrafshëta krahas atyre malore, në të cilat regjione vepronin më lehtë këta të fundit.

Gjatë tetorit të 1944 sulmet e trupave partizane u shpeshtuan kundrejt trupave gjermane, e posaçërisht trupave gjermane që po largoheshin nga Gjakova. Kështu, më 24 tetor të 1944 Divizioni 12 i partizanëve luftoi me fragmente të ushtrisë gjermanë në afërsi të Gjakovës, ku si pasojë 60 partizanë u raportuan të vdekur në luftime, e disa të tjerë u morën robër.⁹ Burimet gjermane raportojnë se edhe 120 partizanë të tjerë u vranë në luftime përgjatë tetorit në periferinë e Gjakovës, por megjithatë burimet në fjalë nuk japin të dhëna sesa gjermanë u vranë përgjatë këtyre luftimeve.¹⁰ Është evidente që burimet jugosllave dhe ato gjermane i minimizojnë humbjet e tyre, andaj dhe në disa raste është e vështirë të thuhet se cili grup ndërluftues ishte fitimtar i luftimeve. Megjithatë, duke i marrë

⁶ Aktiviteti i partizanëve në Kosovë u intensifikua shumë më vonë në krahasim me regjionet e tjera në Jugosllavi. Shih Jozo Tomasevich, *War and Revolution in Yugoslavia, 1941-1945: Occupation and Collaboration*, vol. 2 (Stanford, California: Stanford University Press, 2001), 70.

⁷ *AIHP*, NAW, T 311, roll 193, 000173, origjinali në gjermanisht. Është fjala për minierën e Devës.

⁸ Thomas Taylor. Hammond, *The Anatomy of Communist Takeovers* (New Haven: Yale University Press, 1975), 256.

⁹ *AIHP*, NAW, T311, roll 196, 0453, origjinali në gjermanisht.

¹⁰ *AIHP*, NAW, T311, roll 196, 000470-471, origjinali në gjermanisht.

parasysh ndodhitë e fundvitit 1944, nuk vihet në diskutim se gjermanët veç më ishin buzë disfatës. Në anën tjetër, gjatë po të njëjtës periudhë, partizanët nuk ishin aq të fuqishëm sa ishin më parë në Rrafshin e Dukagjinit,¹¹ kjo ngaqë njësitet ekzistuese kishin avancuar në Rrafshin e Kosovës për të luftuar me pjesët e mbetura të ushtrisë gjermanë dhe vullnetarët shqiptarë.¹²

Guerilët partizanë në ndërkohë filluan të rrisin kontrollin e tyre mbi Rrafshin e Kosovës përgjatë periudhës shtator-tetor 1944, ndërsa në po të njëjtën periudhë forcat partizane po sulmoheshin në Rrafshin e Dukagjinit, e posaçërisht në Malësinë e Gjakovës, vend ky i cili më herët ishte konsideruar bastion i forcave partizane. Ngjarjet e kësaj periudhe janë të një interesi të veçantë ngaqë portretizojnë shkëmbimet mes kontrollit dhe pushtetit ushtarak të dy grupeve protagoniste të luftës në dy regjione gjeografike të Kosovës. Kështu

¹¹ Ali Hadri, *Gjakova në lëvizjen nacionalçlirimtare* (Prishtinë: Bashkësia Krahinore e Punës Shkencore dhe Kuvendi i Komunës së Gjakovës, 1974), 82.

¹² Aktiviteti i vullnetarëve shqiptarë në sinkronizim me ushtrinë gjermane ishte pjesë esenciale e vendosjes së administratës gjermane në Kosovë. Edhe pse vullnetarët në të shumtën e rasteve ishin tejet lokal sa i përket interesit vetanak të ruajtjes së fshatit apo regjionin të tyre të ngushtë të banimit, ata ishin thelbësor në instalimin e një lloj barrikade kundër trupave partizane - e kjo duke qenë synimi përfundimtar i trupave gjermane. Shih *AIHP*, NAW, T 313, roll 200, 7462096, origjinali në gjermanisht. Sa i përket ndërlidhshmërisë së qeverisë gjermane me grupet vullnetare shqiptare, një shpjegim të shkëlqyer kanë bërë tre autorët në vijim, të cilët në hulumtimin e tyre të vullnetarëve (ose të adresuar ndryshe si *milicë*) bëjnë krahasime empirike të situatave dhe ngjarjeve historike dhe regjionale që përkojnë plotësisht me ndodhitë historike rreth efektivitetit të vullnetarëve shqiptarë si njësi të përforcimit të pushtetit qeveritar të huaj. C. Jentzsch, S. N. Kalyvas, and L. I. Schubiger, "Milicias in Civil Wars", *Journal of Conflict Resolution* 59, no. 5 (August 1, 2015): 755–69. Punimi i parë mirëfilli shkencor që trajton këtë çështje është ai i Martin Broszat, "Albanische Milizen Im Zweiten Weltkrieg," *Gutachten Des Instituts Für Zeitgeschichte*, no. 2 (1966): 343. Mund të argumentohet se formimi i njësiteve të Lidhjes së Dytë të Prizrenit (ai i Kreshnikëve dhe Vullnetarëve) paraqesin rastin më tipik të organizimit të trupave lokale për rrënjëzimin e administrimit gjerman. Në anën tjetër, është e një interesi të posaçëm historik krahasimi i Këmishëzinjve dhe Milicisë Vullnetare Shqiptare me njësitet e mëvonshme të organizuara gjatë administrimit gjerman në kontekst të aspiratave kombëtare shqiptare kundrejt vëzhgimit fillestar si vegla kuislinge.

pra, kur trupat partizane kishin kontroll dhe prezencë më të madhe ushtarake në Malësinë e Gjakovës, trupat gjermane ishin të vendosura në Rrafshin e Kosovës, posaçërisht në Mitrovicë dhe Prishtinë. Deri në tetor të 1944 partizanët, tashmë më të shtuar në numër, kishin mbledhur fuqi të mjaftueshme që të sulmojnë drejtpërsëdrejti trupat gjermane, siç vërehet më së miri me ndodhitë e 7 tetorit të 1944 në Runik të Mitrovicës. Sipas dokumenteve të lëshuara nga Komanda e aradhes së Ibrit, prej trupave që luftuan në anën e gjermanëve u vranë 108 sosh.¹³ Sërish të forcuar, trupat partizane nisën edhe një sulm tjetër ndaj gjermanëve në Mitrovicë më 9 tetor, me të cilin rast sulmuan një vagon që po barte artilerinë gjermane, sulm i cili përfundimisht solli vdekjen e 19 gjermanëve.¹⁴

Derisa qysh nga maji i 1944, aleatet po shënon fitore krahas gjermanëve në Frontin Perëndimor, ngjashëm edhe Ushtria e Kuqe kishte mposhtur gjermanët në shtetet Baltike, dhe madje në gusht kjo e para kishte hyrë në Rumani. Si rrjedhojë, me të ardhur tetori, trupat gjermane veç më kishin filluar tërheqjen nga Greqia, Maqedonia dhe Shqipëria, gjegjësisht Armata e Grupit E. Destinacioni i paracaktuar i ushtrisë ishte tërheqja nga Selaniku, përmes hekurudhës nëpërmjet Kosovës në Stani Tërg të Mitrovicës nga ku do të vazhdonin për në Novi Pazar e më tutje në veri. Plani tërheqës do të përmbushej përmes disa krahëve. Krahu Langer do të siguronte regjionin prej Podujevës në drejtim të Kurshumlisë,¹⁵ ndërkaq Bredou do të siguronte aksin Bujanoc-Gjilan-Prishtinë. Përafërsisht 6 000 shqiptarë siguruan aksin Bujanoc-Merdar.¹⁶ Ndërkaq, krahu

¹³ Zbornik DNOR, ser.I, vol.19, dok. 203.

¹⁴ Zbornik DNOR, ser.I, vol.19, dok. 203.

¹⁵ Izber Hoti, *Forcat e armatosura në Kosovë 1941-1945* (Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë, 1998), 60-61. Shih dhe Vojnoistorijski institut, Velimir Terzić, *Završne operacije za oslobođenje Jugoslavije, 1944-1945*. (Beograd, 1957), 197.

¹⁶ Erich Schmidt-Richberg, *Der Endkampf Auf Dem Balkan - Die Operationen Der Heeresgruppe E von Griechenland Bis Zu Den Alpen*, 1955, 41. Një burim madje thotë se deri më 23 tetor në aksin Pakashticë -Prepolc (Podujevë) ishin rreshtuar diku 10 000 ballistë, por shifra mbetet diskutabile. Shih Vojnoistorijski Institut, *Završne operacije za oslobođenje Jugoslavije, 1944-1945*, 198. Një burim tjetër i

“Skenderbeg” do të siguronte tërheqjen e trupave gjermane në rajonin e Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit.¹⁷

Përgjatë muajve tetor-nëntor prezenca e trupave gjermane u rrit vëllshëm në Rrafshin e Kosovës.¹⁸ Megjithatë duke qenë që prezenca e tyre ishte e përkohshme, partizanët veç më kishin fituar kushte të favorshme kundrejt trupave gjermane. Në këtë periudhë madje edhe bullgarët, tashmë nën urdhrat e një qeverie prokomuniste, iu bashkuan aleatëve në luftë kundër gjermanëve. Tri armata bullgare avancuan nga Sofja përmes Nishit dhe Shkupit për të bllokuar tërheqjen e trupave gjermane. Bullgarët luftuan së bashku me Divizionin e Dytë Proletar në Merdare kundër Divizionit 22 të Këmbësorisë gjermane dhe shqiptarëve vullnetarë. Humbjet gjermane ishin më të mëdha se atyre të trupave partizane, ku ranë në luftime 50 gjermanë dhe 8 partizanë, ndërkaq u plagosën 20 prej tyre dhe 15 u konsideruan të humbur.¹⁹ Megjithëkëtë, trupat gjermane dhe shqiptarët arritën që të mbledhin forcën dhe të mbronin edhe një sulm tjetër të lëshuar nga partizanët që zgjati prej 28 tetorit deri më 29 tetor, në luftime ndërmjet Divizionit 24 Partizan serb të cilët sulmuan shqiptarët që po mbronin aksin Bujanoc-Shkëmbi i Uglarit. Burimet e mbetura jugosllave raportojnë që si pasojë e këtij sulmi të

nxjerrur nga ky i pari gjithashtu referon një shifër të madhe të shqiptarëve që po luftonin kundër forcave partizane për periudhën 9.11.1944, gjegjësisht 10 000 deri 15 000 trupa në detyrë për Wehrmachtin. Shih Hubert Neuwirth, *Widerstand Und Kollaboration in Albanian 1939-1944*, Albanische Forschungen, vol. 27 (Wiesbaden: Harrassowitz Verlag, 2008), 135-136.

¹⁷ Vojnoistorijski institut, *Završne operacije za oslobođenje Jugoslavije, 1944-1945.*, 201.

¹⁸ Në tetor të 1944 komanda e Grupit “E” u bart në Mitrovicë nga ku u koordinua tërheqja e trupave gjermane. Në periudhën tetor-nëntor kanë kaluar në Rrafsh të Kosovës njësitet e Grupit të Regjimentit të Divizionit 181, Divizioni 1 i Regjimentit të 122 Artilerik, Shtabi i 779 Artilerik, një çetë e Sektorit të 501 Motorik të feldxhandarmërisë, dy batalione nga Korpusi 68 dhe Korpusi 21 i Armatës “E”. Grupi “Langer” dhe “Bredov” u formuan më 14.10.1944, kur shtabi i Armatës “E” u vendos nga Mitrovica në Stani Tërg. Hoti, *Forcat e armatosura në Kosovë 1941-1945*, 59-60.

¹⁹ *Zbornik DNOR*, Ser.I, vol.14, dok. 109

jenë vrrarë 250 shqiptarë dhe 118 partizanë, ndërkaq 350 shqiptarë dhe 209 partizanë mbetën të plagosur.²⁰ Deri në nëntor të 1944 trupat gjermane veç më ishin tërhequr nga Mitrovica, Prishtina dhe Lipjani, me ç'rast iu liruan territoret pushtetit komunist.

Ky ndryshim i kontrollit midis forcave guerile dhe forcave gjermane u vërejt dukshëm në tetor të 1944, posaçërisht në Rrafshin e Kosovës. Tërheqja e trupave gjermane ia liroi plotësisht territorin partizanëve për të instaluar pushtetin e tyre. Megjithatë, edhe pasi që trupat gjermane u tërhoqën, forcat partizane u detyruan të luftojnë me trupat e mbetura vullnetare shqiptare dhe grupet e tjera nacionaliste në Kosovë. Disa grupe nacionaliste vazhduan të luftonin me forcat partizane deri në gjysmë të 1945.

²⁰ *Zbornik DNOR*, Ser.I, vol.15, dok. 180.

Haxhi ADEMI

**INTERPRETIMI I LITERATURËS HISTORIOGRAFIKE
SHQIPTARE PËR RIPUSHTIMIN JUGOSLLAV TË
KOSOVËS DHE LUFTËN E DRENICËS (1944/1945)**

**Ripushtimi jugosllav i Kosovës dhe aneksimi i saj
nga Serbia**

Para se të trajtohet çështja e ripushtimit të Kosovës sipas historiografisë shqiptare, shkarazi do të japim informacione bazike se si Kosova në vend që të fitojë të drejtën e vetëvendosjes dhe bashkimit me shtetin shqiptar, siç edhe u shprehën në Rezolutën e Konferencës së Bujanit, u ripushtua nga Jugosllavia, konkretisht nga Serbia.

Për më tepër, aneksimi i Kosovës dhe i hapësirave të tjera shqiptare nga ana e Jugosllavisë është përgatitur qysh gjatë përpjekjeve që u bënë për realizimin e marrëveshjes midis Këshilli Nacional Çlirimtar i Jugosllavisë (KNÇJ) dhe qeverisë mbretërore të Jugosllavisë në emigracion. Bisedimet e realizuara ndërmjet tyre u konkretizuan me “Marrëveshjen Tito – Shubashiq” (16 prill 1944) që u zhvilluan në bazë të vendimeve të Konferencës së Moskës, Teheranit dhe Jaltës, të cilat shprehën interesat e Fuqive të Mëdha

për ndarjen e sferave të interesit në Ballkan, duke mos përjashtuar dhe Jugosllavinë.¹

Kjo marrëveshje pati për pasojë aneksimin e Kosovës nga Serbia akt që u zyrtarizua në Kuvendin e Prizrenit, që i zhvilloi punimet në korrik të vitit 1945. Megjithëse sipas studiueses Sabile Keçmezi-Basha, ky kuvend nuk ishte as i pari dhe as i fundit, i cili solli vendime që Kosova të aneksohej nga Serbia e Jugosllavia. Pra, sipas saj, Kuvendi i Prizrenit kërkonte vetëm formalisht “*verdict të popullit*”, ndërsa aneksimi i Kosovës kishte filluar qysh më herët.²

Pas vendosjes së administratës ushtarake në Kosovë, më 18 shkurt 1945, në mbledhjen që është mbajtur në Beograd është bërë dhe plani përfundimtar për aneksimin e Kosovës.³ Problemi i aneksimit të Kosovës në kuadër të Republikës së Serbisë është shtruar edhe në mbledhjen e Jashtëzakonshme të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Serbisë, që është mbajtur në Beograd nga 7-9 prill 1945. Në anën tjetër, kjo çështje nuk është diskutuar fare në Kosovë, ku qe vendosur Administrata Ushtarake.⁴

Studiuesja Ana Lalaj ka ofruar dokumente britanike që kanë të bëjnë me Kosovën e vitit 1945. Kështu, regjistrimet britanike flasin për vendosjen e Administratës Ushtarake në Kosovë, për mobilizimin e meshkujve shqiptarë kosovarë nga 16-60 vjeç, për masakrën e Tivarit e deri tek aneksimi i Kosovës. Këto dokumente kanë fiksuar procedurat manipuluese të ndjekura nga Beogradi për aneksim, që nga mbledhja e parë e ASNOS (Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar i Serbisë), 7 – 9 prill 1945, tek lajmi që Radio

¹ Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1997, f.301-313.

² Sabile Basha-Keçmezi, *Shqipëria, pikë referimi për forcat nacionaliste në Kosovë, 1944-1945*, Studime për Historinë Ushtarake, Instituti i Studimeve të Historisë Ushtarake, 2014, f.137.

³ M. Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore...*, f.302.

⁴ Lefter Nasi, *Ripushtimi jugosllav i Kosovës, (shtator 1944-1945)*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 1994, f. 101.

Beogradi dha më 10 prill 1945, ora 13.30 e deri tek heshtja e Këshillit Nacionalçlirimtar të Shqipërisë.⁵

Kështu, historiografia shqiptare, por jo vetëm, në etapa të ndryshme të historisë, varësisht nga rrethanat e jashtme dhe të brendshme, politike, ekonomike, e kulturore ka arritur rezultate të vyeshme në disa periudha sikundër që ka ngecur në disa të tjera. Natyrisht, që si rezultat i rrethanave të sipërthëna, edhe çështjet apo temat e caktuara historike janë trajtuar nga dimensione të ndryshme, duke shfrytëzuar qasje të ndryshme, të cilat kanë quar në rezultate diametralisht të kundërta.

Ndër çështjet më të diskutuara në historiografinë shqiptare, që rezultatet e saj në periudhën komuniste me atë postkomuniste janë diametralisht të kundërta janë: çështja e ripushtimit të Kosovës (1944-45), e që në periudhën e diktaturës komuniste andej dhe këtej kufirit konsiderohej si çlirimi i Kosovës, pastaj Konferenca e Bujanit, platforma e të cilës u bë një “temë tabu”, që për 50 vjet askush nuk guxoi të shkruante për të⁶, etj. Mirëpo, në historiografinë komuniste ka tema të anatemuara, për arsye po ashtu të sipërthëna më lart, të cilat ose janë trajtuar fare sipërfaqësisht, duke mohuar rolin dhe rëndësinë e tyre në histori, ose nuk janë përmendur në asnjë punim. Një çështje e tillë është padyshim Lufta e Drenicës apo Lufta me në krye Shaban Polluzhën, që në historiografinë komuniste, nuk është trajtuar thuajse në asnjë punim.

Ndër historianët dhe studiuesit më të njohur të cilët trajtuan problematika të periudhës së Luftës së Dytë Botërore në përgjithësi dhe të çlirimit (ripushtimit) të Kosovës në veçanti janë: në Kosovë janë akademik Ali Hadri, historianët Fehmi Pushkolli, Izber Hoti, Seit Lipa, Muhamet Shatri, Fehmi Rexhepi, SabileBasha-Keçmezi, Sabit Syla etj., ndërsa në Shqipëri janë: Xhelal Gjeçovi, Muharrem

⁵ Ana Lalaj, *Dosjet e Luftës*, Botimet Toena, Tiranë, 2014, f. 172.

⁶ Lefter Nasi & Ana Lalaj, *Mbi qëndrimin e udhëheqjes së PKJ dhe të PKSH ndaj vendimeve të Konferencës së Bujanit*, Studime Historike, 1993 (1-4), Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë& Instituti i Historisë, Tiranë, 1997, f. 133.

Dezhgiu, Tahir Mala, Myftar Memia, Ana Lalaj, Lefter Nasi, Paskal Milo, Ndreçi Plasari, Kasem Biçoku, Marenglen Kasmi etj.,

Mirëpo, duhet të theksohet fakti se ka pasur historianë dhe studiues të cilët kanë shkruar vepra apo trajtesa historike edhe në periudhën e komunizmit edhe pas viteve 90-të. Dhe për më tepër të njëjtët autor, çështjet e njëjta i kanë trajtuar në dimensionë të ndryshme.

Të gjitha veprat apo trajtesat historike të këtyre historianëve, andej dhe këtej kufirit dhe të dy periudhave historike, do të trajtohen më hollësisht për të parë dhe ballafaquar arritjet e tyre shkencore, në mënyrë që të vijmë më pranë të vërtetës historike rreth çështjes së çlirimit apo ripushtimit të Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore.

Trajtimi i ripushtimit jugosllav të Kosovës nga historiografia shqiptare në periudhën komuniste (1945 – 1990)

Historiografia shqiptare në periudhën e komunizmit me gjithë rrethanat e përgjithshme politike ka shënuar hapa të fuqishëm drejt konsolidimit të saj. Pra, sipas disa studiuesve, gjatë viteve 50-të e 60-të të shek.XX, u vunë bazat e një historiografie të mirëfilltë nga një kuadër profesional. Megjithatë, fakti që themelet e historiografisë shqiptare u vunë në të dy anët e kufirit, në periudhën e sistemit komunist nënkupton kufizime të ndjeshme të saj.⁷ Historiografia shqiptare gjatë kësaj periudhe u zhvillua, siç e theksuam më lart edhe tek popullsia shqiptare që jetonte në territoret e ish-Jugosllavisë, ngase gjatë viteve 60-ta dhe 70-tëu krijuan institucionet më të larta të cilat bartën barrën e shkrimit të veprave historike. Por zhvillimi i shkencës së historisë në veçanti, ishte mjaft i vështirë, për faktin se popullsia shqiptare iu nënshtrua teorisë marksiste-leniniste, si dhe ideologjisë së krijimit të një kombi të ri jugosllav, që në fakt nuk kishte asgjë të përbashkët me historinë, kulturën dhe traditën

⁷ Emine Arifi-Bakalli, *Çështje nga historia moderne dhe bashkëkohore*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2011, f. 133.

shqiptare.⁸ Në periudhën e sistemit komunist, derisa veprat e botuara nga institucionet shqiptare në Kosovë dhe në viset e tjera të ish Jugosllavisë, rishikoheshin dhe censuroheshin nga pushteti jugosllav, në anën tjetër, në Tiranë, veprat e botuara në këtë periudhë karakterizohen me ngjyrimet politike të kohës. Pra, regjimi komunist eliminoi jo vetëm rivalët politikë, por edhe mendimet dhe idetë alternative.⁹

Vlen të theksohet se interpretime të ndryshme të ngjarjeve me rëndësi në historiografinë shqiptare janë permanente, për të gjitha periudhat kohore dhe për të gjitha çështjet e trajtuara, andaj nuk bën përjashtim as çështja të cilën e kemi objekt studimi. Andaj, sipas studiuesve, edhe sot e kësaj dite ka mëdyshje se a u çlirua apo u ripushtua Kosova. Këto mëdyshje, natyrisht që lidhen ngushtë me zhvillimin e luftës kundërfashiste në Kosovë. Mirëpo, nisur nga fakti se në periudhën kohore në të cilën janë botuar këto vepra, mendimi dhe opinionin ndryshe, nënkupton kundërshtimin e pushtetit serb në Kosovë, ndërsa në Shqipëri, kundërshtimin e Partisë së Punës, andaj edhe lëshimet e tilla janë të njohura.¹⁰

Mirëpo, për këtë problematikë dhe periudhë kohore (1941-1945) dhe çështjen e “çlirimit” (ripushtimit) të Kosovës si dhe pjesëmarrjen e shqiptarëve në Lëvizjen Nacionalçlirimtare (LNÇ) të

⁸ Izber Hoti, *Në udhëkryqet e historisë dhe të historiografisë shqiptare*, Instituti i Historisë, Prishtinë 2003, f.276.

⁹ Dritan Egro, *Historia dhe Ideologjia, Një qasje kritike studimeve osmane në historiografinë moderne shqiptare* (nga gjysma e dytë e shek. XIX deri më sot), Maluka, Tiranë, 2007, f. 113.

¹⁰ E njëjta gjendje ishte edhe tek historiografia komuniste në Maqedoni, e cila nuk ishte aspak objektive, ngase ndiqte direktivat e partisë komuniste. Kështu, kontradiktore janë edhe shkrimet historike rreth çlirimit të Tetovës. Kjo ngase në Historinë e Popullit Shqiptar, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Toena: Tiranë, 2008, vëll. IV, thuhet: “Në mesin e nëntorit 1944, popullsia e Tetovës, e mbështetur nga forcat e Brigadës IV Shqiptare, u ngrit në kryengritje, çarmatosi policinë dhe më 16 nëntor vendosi pushtetin nacionalçlirimtar”, ndërsa, historiografia komuniste maqedonase, ka thurur legjenda që aspak nuk kanë të bëjnë me realitetin. Shembull tipik është historiani Boro Çaushev-i, kur shkruan punime rreth “Çlirimit të Tetovës”.

Jugosllavisë, kontributin më të madh në historiografinë shqiptare të periudhës së komunizmit e ka dhënë dr. Ali Hadri. Në veprën e tij jepen informacione të bollshme rreth trajtimit të problematikës së pjesëmarrjes së kombësisë shqiptare në LNÇ të Jugosllavisë. Për më tepër, në një punim me titull *“Specifika e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës 1941-1945”*, publikuar në revistën “Kosova”, nr. 2, botuar nga Enti i Historisë së Kosovës më 1973, studiuesi Hadri, ndër të tjera thotë: *“Popujt e Kosovës i kanë dhënë kontribut LNÇ të Jugosllavisë. Ai është i rëndësishëm jo vetëm për shkak se pushtuesi nuk ka pasur as këtu prapavijë të sigurtë, por edhe për shkak se një numër i madh njerëzish nga kjo krahinë kanë hyrë në UNÇJ, kanë marrë pjesë në luftimet për çlirimin definitiv të vendit [...]. Nga fundi i vitit 1944 e gjer në maj të vitit 1945, UNÇ e Kosovës dhe e Metohisë kishte nëntë brigada, të cilat bashkë me njësitet ushtarake të prapavijës kishin afër 50.000 luftëtarë, gjë që është kontribut i rëndësishëm i popujve të kësaj krahine Luftës Nacionalçlirimtare”*¹¹. Nga ky artikull shkencor, vërehet qartë që vetëm përdorimi i prapashtesës “Metohi”, nga autori dëshmon për mungesën e pavarësisë profesionale nga ana e organeve shtetërore, pa hyrë më tej në përmbajtjen e tekstit. Ndërsa, Fadil Hoxha ishte një autor tjetër, që njëherit ishte edhe në pozitat më të larta të asaj kohe në Kosovë, në një punim të botuar në revistën “Kosova”, nr.9-10, të Institutit të Historisë së Kosovës, ndër të tjera thotë: *“Është e vërtetë se edhe në Kosovë është ditur mjaft mirë për vijën e bashkimit dhe të vëllazërimit dhe për luftën e okupatorit dhe shërbëtorëve të tij. Kjo ishte pikënisje e LNÇ dhe e çdo komunisti [...]. Frika nga kthimi i së vjetrës ishte gjithnjë prezente. Vetëm pas arritjes në Kosovë, të artikullit të Titos ‘Çështja nacionale në Jugosllavi në dritën e LNÇ-së’, në fillim të vitit 1943, të cilin nëpër mbledhje filluam ta studiojmë, ta përpunojmë dhe ta popullarizojmë në masa, u bë e*

¹¹ Ali Hadri, *Specifika e lëvizjes nacionalçlirimtare të Kosovës 1941-1945*, “Kosova”, nr. 2, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1973, f. 21 dhe në punimin me temë *Linja e PKJ në formimin e fuqive të armatosura revolucionare të LNÇ-së dhe zbatimi i saj në kushtet specifike të Kosovës*, Instituti i Historisë së Kosovës, nr.9-10, Prishtinë, 1980-1981, f. 26.

qartë se me anë të luftës së armatosur po luftojmë për çlirimin nacional dhe social, për barazinë e shqiptarëve, serbëve, malazezëve dhe të tjerëve dhe se në këtë mënyrë po viheshin themelet e bashkësisë kosovare, d.m.th., themelet e autonomisë".¹² Ndërsa, sa i përket pjesëmarrjes së popullsisë së Kosovës në LNÇ, autori thotë se janë 50 mijë shqiptarë, që në proporcion me numrin e banorëve, i bie që çdo i njëmbëdhjeti qytetar i Kosovës të ishte në radhët që autori e quan Ushtria e famshme Nacionalçlirimtare e Titos.¹³ Megjithëse Lëvizja Nacionalçlirimtare dhe lufta e armatosur në Kosovë masivizohen në fazën përfundimtare të çlirimit të vendit, sepse pikërisht në atë kohë përfshihen në to edhe masat shqiptare fshatare, të cilat e përbënin pjesën dërrmuese të popullsisë.¹⁴

Për vendosjen e pushtetit ushtarak në Kosovë, në shkurt të 1945-ës, historiani AliHadri në një artikull botuar në revistën "Kosova" të Institutit të Historisë së Kosovës, në vitin 1980-1981, ndër të tjera shtron një varg pyetjesh rreth kësaj çështjeje, që ka provuar më pas t'iu japëshpjegime të hollësishme disa prej tyre. Megjithëse autori trajton me mjaft guxim këtë temë tejet delikate, duke hedhur disa pyetje të rëndësishme, ajo që të bie në sy është pyetja "*pse ndryshoi përbërja e Shtabit që ekzistonte para vendosjes së pushtetit ushtarak, i cili udhëhoqi me sukses luftën përfundimisht me çlirimin e Kosovës*". Një autor tjetër që mendon se Kosova është çliruar më 1944, është edhe FehmiPushkolli, i cili në një punim në revistën "Kosova" nr. 13-14, të botuar më 1985, ndër të tjera shkruan: "*Krahina e Kosovës dhe Metohisë u çlirua në nëntor të vitit 1944, por lufta nuk kishte përfunduar, prandaj forcat e UNÇJ dhe AP të Kosovës dhe të Metohisë vazhduan luftën në drejtim të frontit të Sremit dhe në drejtim të Malit të Zi*".¹⁵

¹² Fadil Hoxha, *Forcat e armatosura revolucionare të Luftës Nacionalçlirimtare të Kosovës më 1941-1945, I*, Instituti i Historisë së Kosovës, nr.9-10, Prishtinë, 1980-1981, f. 5-6.

¹³ *Po aty*, f. 14.

¹⁴ *Po aty*, f. 24-25.

¹⁵ Fehmi Pushkolli, *Formimi i Komitetit Nacional të shqiptarëve të Kosovës dhe të Metohisë dhe veprimtaria e tij deri në korrik të vitit 1945*, "Kosova", nr.13-14,

Po ashtu, historiani Izber Hoti, në një punim, kur flet për të rinjtë antifashistë të Prishtinës dhe rrethinës, ndër të tjera, thotë se pas çlirimit të Prishtinës, rinia antifashiste u tubuan dhe zgjodhën Komitetin e Ri të vendit e të rrethit. Pra, edhe ky autor e quan çlirim aktin e largimit të forcave nazifashiste dhe triumfin e forcave të LNÇ-së.¹⁶ Që aktin e ripushtimit të Kosovës më 1944, historiografia e periudhës komuniste e quan çlirimin e Kosovës, e dëshmon edhe sesioni shkencor me titull “Njësitët e armatosura të lëvizjes nacionalçlirimtare të Kosovës 1941-1945” organizuar nga Instituti i Historisë Prishtinë, mbajtur më 14-15 dhjetor 1974. Esenca e të gjitha punimeve ishte, që falë Luftës Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë, gjegjësisht të Kosovës, erdhi deri tek çlirimi i vendit nga pushtuesit.¹⁷

Nga çfarë u tha më lart del që historiografia komuniste shqiptare, konstatonte se në këtë periudhë është çliruar Kosova. Këtë e dëshmon më së miri ky pasazh: *“është e njohur lufta heroike e partizanëve të Ushtrisë nacionalçlirimtare shqiptare, jo vetëm për çlirimin e Kosovës, por edhe të shumë krahinave të tjera të Jugosllavisë”*.¹⁸

Për më tepër në hyrje të librit *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, botuar më 1969, ndër të tjera thuhet: *“Një rëndësi e madhe për studimin e problemeve të historisë së re dhe të sotme të Shqipërisë kanë veprat dhe fjalimet e udhëheqësve të Partisë dhe të shtetit tonë, në të cilat u bëhet një analizë e thellë shkencore këtyre*

Instituti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1985, f. 141.

¹⁶ Izber Hoti, *BRKJ dhe rinia përparimtare e Prishtinës dhe rrethinës 1919-1945*, “Kosova”, nr.8, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1979, f. 196. Rreth “çlirimit” të qyteteve të Kosovës, për më tepër shih: Shaban Hashanin, Fehmi Rexhepin, Drita Halimi-Statovcin, etj., ku flasin, ndër të tjera, për çlirimin e Ferizajt, të Gjilanit, etj., në nëntor të vitit 1944.

¹⁷ Seit Lipa, *Kontribut shkencor 30 vjetorit të çlirimit të Kosovës*, “Kosova”, nr. 3, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1974, f. 523.

¹⁸ Tahir Mala e Myftar Memia, *Disa momente të luftës nacionalçlirimtare në Malësinë e Gjakovës dhe ndihma e saj në zhvillimin e lëvizjes nacionalçlirimtare në Kosovë*, “Studime Historike”, nr. 1, Tiranë, 1970, f. 47.

problemeve”¹⁹. Nga ky pasazh nënkuptojmë që historiografia e periudhës komuniste më shumë bazohet tek rezultatet “shkencore” që bëheshin në zyrat e Partisë së Punës, sesa në punën e pavarur të studiuesve shkencorë. Ndërsa, historiografia shqiptare në Kosovë përballej me vështirësi të shumta, ngase puna shkencore ishte identifikuar si veprimtari antishtetërore. Seleksionimi që iu bëhej çështjeve të ndjeshme historike, siç është shembull Lufta e Drenicës më 1945, kontrolli i plotë i shtypit dhe propaganda në favor të regjimit, kishin si qëllim të pengonin të vërtetën për historinë dhe historiografinë shqiptare. Pra, në periudhën e Jugosllavisë totalitare, ku çdo gjë ishte e politizuar, nuk shpëtoi as historiografia shqiptare, e cila u kontrollua dhe u pengua nga organet shtetërore. Ky politizim u shfaq në faktin se gjithë zhvillimi i proceseve historike duhej lidhur vetëm me faktorin serbo-sllav, me rolin e shtetit dhe luftën e tyre për çlirim.²⁰ Andaj, në historiografinë shqiptare të periudhës komuniste dominon teza se Kosova u çlirua, pas largimit të forcave gjermane nga Kosova më 1944.

Trajtimi i ripushtimit jugosllav të Kosovës nga historiografia shqiptare në periudhën postkomuniste (1990 – 2015)

Meqë trajtuam më lat mangësitë e historiografisë shqiptare në kohën e komunizmit, më poshtë do të trajtojmë veprat e botuara nga fillim vitet 90-të, që për objekt studimi kanë çështjen e ripushtimit të Kosovës më 1944 dhe Luftën e Drenicës.

Kështu, mund të konstatojmë që në fillim se hapa të dukshëm ka shënuar historiografia shqiptare gjatë viteve 90-të të shek. XX dhe më tej, ku janë publikuar disa monografi e punime shkencore të

¹⁹ *Historia e popullit shqiptar II*, Universiteti Shtetëror i Tiranës & Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, Enti i Botimeve Shkollore i RSS Reparti- Prishtinë, 1969, f. 7-31.

²⁰ Sabile Keçmezi – Basha, *Trajtimi i figurës së Isa Boletinit në historiografinë shqiptare*, Konferenca Shkencore “*Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*”, Instituti i Historisë “AliHadri”- Prishtinë, Instituti i Historisë- Tiranë dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve- Shkup, Prishtinë, 2015, f. 38.

rëndësishme, artikuj të shumtë me vlera shkencore, vepra, kumtesa e trajtesa që shënojnë kthesë në historiografinë shqiptare, që për temë trajtimi kishin çështjet e sipërthëna.

Ndryshimet e mëdha që ndodhën pas rënies së komunizmit në Shqipëri e më gjerë, ndikuan në të gjitha fushat e tjera, ku natyrisht nuk bën përjashtim fusha e shkencës, gjegjësisht shkencës së historisë.²¹ Qasjet e reja të hulumtimit, të studimit, të shqyrtimit e të trajtimit të së kaluarës ishin të nevojshme, për më tepër të domosdoshme, ngase, historiografia e mëparshme, siç e kemi theksuar më parë, ballafaqohej me subjektivitetin dhe njëanshmërinë, që ndikoi mjaft në lindjen dhe zhvillimin intelektual të historianëve në veçanti dhe të shkencës së historisë në përgjithësi. Këto mangësi të historiografisë shqiptare të periudhës së komunizmit gjatë viteve 90-të duhej të tejkaloheshin nga studiuesit e rinj, jo vetëm historianë, ngase tani rrethanat kërkonin dhe shtronin nevojën e rishkrimit të historisë, por natyrisht me metoda, ide, qasje, burime dhe pikëpamje të reja.²²

Ndërveprat e para të periudhës postkomuniste, që për objekt studimi kishte çështjen e ripushtimit të Kosovës në përfundim të Luftës së Dytë Botërore ishte vepra e historianit Lefter Nasi “Ripushtimi i Kosovës, shtator 1944 – korrik 1945”, botuar nga Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë dhe nga Instituti i Historisë në Tiranë më 1994, pastaj u botua punimi shkencor me titull “Vetëvendosja e Kosovës në dritën e Lëvizjes Antifashiste” e historianit Muhamet Pirraku etj.²³

Pra, përpjekjet e para për të ndriçuar të vërtetën historike rreth ripushtimit të Kosovës në këtë periudhë janë të këtyre autorëve, të cilët nëpërmjet veprave të sipërthëna ofrojnë fakte për ripushtimin e Kosovës, duke hedhur idenë e deriatëhershme, të ngulitur nga

²¹ Izber Hoti, *Në udhëkryqet e historisë dhe të historiografisë shqiptare*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2003, f.272.

²² *Po aty*, f. 233.

²³ Muhamet Pirraku, *Vetëvendosja e Kosovës në dritën e Lëvizjes Antifashiste*, “Gjurmime Albanologjike” (Seria e shkencave historike), nr.21, Prishtinë, 1991, f.7-38.

historiografia komuniste se Kosova është çliruar nga forcat nacionalçlirimtare më 1944.

Më pas, do të trajtojmë edhe vepra të tjera që për objekt studimi kanë çështjen e ripushtimit të Kosovës (1944-1945), e që janë botuar pas rënies së komunizmit, nga historianë dhe studiues të ndryshëm, që si rezultat i krijimit të rrethanave të reja politike janë të zhveshura nga dogmat marksiste, nga paragjykimet e nga diktati i partisë-shtet. Të tilla janë vepra e prof. Muhamet Shatrit “*Kosova në Luftën e Dytë Botërore*”, e cila paraqet përpjekjen e parë serioze në historiografinë shqiptare postkomuniste për trajtimin e gjithanshëm të çështjes së Kosovës dhe shqiptarëve gjatë viteve të luftës.²⁴

Për çështjen e “çlirimit” (ripushtimit) të Kosovës kemi edhe artikullin e Kasem Biçokut²⁵, i cili po ashtu jep fakte dhe gjykime të reja rreth ripushtimit të Kosovës në fund të luftës. Po ashtu, në një punim të botuar në revistën “Kosova”, të vitit 2005, historiani Izber Hotitrajton çështjen e ripushtimit të Kosovës më 1944, duke dhënë informacione të detajuara për “çlirimin” në fakt, pushtimin e të gjitha qyteteve të Kosovës. Më tej, ai vjen në përfundimin se me ripushtimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare, u demaskua Partia Komuniste e Jugosllavisë (PKJ) dhe Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSH), ngase nuk u mbajtën të gjitha premtimet që i dhanë popullit shqiptar për çlirim dhe bashkim kombëtar.²⁶ Ndërsa, historiani Muhamet Shatri, argumenton qëndrimin e tij se Enver Hoxha karshi çështjes së Kosovës, kishte qëndrim të njëanshëm dhe tejet joserioz. Për të dëshmuar këtë ai ofron një thënie të Enver

²⁴ Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore 1941-1945*, Instituti i Historisë Prishtinë, Prishtinë, 1997. f. 17-339,

²⁵ Kasem Biçoku, *Lufta Çlirimtare Antifashiste – luftë e të gjithë shqiptarëve*, Sesion shkencor kushtuar “Çështjes kombëtare shqiptare gjatë Luftës Çlirimtare Antifashiste”, organizuar nga Instituti i Historisë i Tiranës dhe Instituti i Historisë i Prishtinës, Studime Historike, 1993 (1-4), Tiranë, 1997, f. 124.

²⁶ Izber Hoti, *Kosova dhe viset e tjera etnike shqiptare nga kapitullimi i Italisë fashiste deri në fund të nëntorit 1944*, Kosova, nr. 26, Instituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë, 2005, f. 219-223.

Hoxhës: “*Pra, vetë popullsitë në mes tyre në Kosovë do të merren vesh dhe do të vendosin se nga të shkojnë*”.²⁷

Studiuesi Shatri më tej thekson që zhvillimi i ngjarjeve më vonë tregoi se edhe pse shqiptarët e Kosovës e shprehën qartë vullnetin e tyre për bashkim me Shqipërinë, edhe pse luftuan kundër Jugosllavisë, e cila i skllavëroi në vitet 1944-1945, PKSH dhe Enver Hoxha nuk e shtruan këtë problem për diskutim me PKJ e as në forumet ndërkombëtare të pasluftës.²⁸ Në anën tjetër, Deklarata e Konferencës së Jaltës në shkurt 1945 vulosi përfundimisht restaurimin e Jugosllavisë në kufijtë e paraluftës, duke i lënë shqiptarët nën Jugosllavi.²⁹

Për qëndrimin e Enver Hoxhës karshi çështjes së Kosovës janë bërë disa punime nga historianë të ndryshëm ku përveç Muhamet Shatrit³⁰, kemi edhe punim nga Hamit Kaba³¹, NdreçiPlasari³² etj.

Një çështje tjetër që është trajtuar në dimensionet të ndryshme dhe nga këndvështrime diametralisht të kundërta nga historiografia shqiptare është çështja e largimit të forcave gjermane nga Kosova. Kontradiktore janë mendimet rreth asaj se është ripushtuar apo është çliruar Kosova, pas largimit të këtyre forcave. Për këtë problematikë detaje të reja sjell studiuesi Marenglen Kasmi në veprën “Pushtimi gjerman i Shqipërisë 1943-1944”.³³ Kështu, në historiografinë shqiptare, në veçanti në atë të Kosovës, më parë ka dominuar teza e diskutueshme se në nëntor të vitit 1944, Kosova u çlirua falë luftës që zhvilloi Lëvizja Nacionalçlirimtare. Mirëpo, një pjesë e

²⁷ Muhamet Shatri, *Mbi qëndrimin e PKSH-së ndaj çështjes së Kosovës në vitet 1941-1945*, Kosova, nr. 26, Instituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë, 2005, f. 245.

²⁸ Po aty.

²⁹ Hamit Kaba, *Kufijtë e Shqipërisë në projektet e Aleatëve të Mëdhenj gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Studime Historike, nr.3-4, Tiranë, 2015, f. 223.

³⁰ M. Shatri, *Mbi qëndrimin e PKSH-së...*, f. 249.

³¹ H. Kaba, *Kufijtë e Shqipërisë...*, f. 245.

³² NdreçiPlasari, *Politika e udhëheqjes së PKSH dhe e Enver Hoxhës ndaj çështjes së Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Studime Historike, 1992 (1-4), Tiranë, 1995, f.79.

³³ MarenglenKasmi, *Pushtimi i Shqipërisë 1943-1944*, (Një këndvështrim në dritën e dokumenteve gjermane), Botime Filara, Tiranë, 2013.

studiuesve që këtë problematik e trajtuan në mënyrë kritike, ka një mendim më ndryshe, duke u mbështetur në argumente të reja, prandaj konstatojnë se *“Kosova dhe trevat shqiptare për rreth nuk u çliruan, por u ripushtuan nga forcat partizane jugosllave e bullgare”*.³⁴

Me gjithë këto kontradikta, mund të konstatojmë që në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore nuk mund të flitej fare për çlirim, por për ndërrim pushtuesish, madje nuk mund të flitej e as të mendohej barazia kombëtare si dhe barazia klasore, sepse fundi i vitit 1944 dhe fillimviti 1945, janë vite të ripushtimit të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare nga ana e sllavëve të jugut dhe kështu nuk mund të flitej fare as për luftë çlirimtare, as për ndonjë lloj revolucioni çfarëdo qoftë ai. I të njëjtit mendim është historiani Izber Hoti, i cili në një vepër shkencore trajtoi në mënyrë objektive dhe të argumentuar çështjen e ripushtimit të Kosovës nga Serbia më 1944.³⁵

Trajtimi i Luftës së Drenicës nga historiografia shqiptare

Sa i përket Luftës së Drenicës, mund të themi se historiografia shqiptare nuk e ka trajtuar në mënyrën dhe dimensionin e duhur këtë ngjarje të rëndësishme të historisë shqiptare. Kjo është arsyeja që studiuesi Izber Hoti këtë fakt e quan *“heshtje dhe ndriçim të mangët”*, ngase rezistenca e Drenicës, sipas tij, është njëra ndër çështjet që deri më tani më së paku, është studiuar, shqyrtuar, trajtuar dhe vlerësuar në historiografinë shqiptare në përgjithësi dhe në atë kosovare në veçanti. Po ashtu, në historiografinë shqiptare për Luftën e Drenicës janë përdorur edhe nocione të ndryshme, si: revoltë, lëvizje, kryengritje, rezistencë, etj. Por, nuk duhet mohuar fakti se nuk është njësoj si të thuhet Revolta e Drenicës, Lëvizja e Drenicës,

³⁴ M. Shatri, *Çlirim apo ripushtim jugosllav i Kosovës dhe trojeve të tjera etnike më 1944*, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore (Përmbledhje studimesh), Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë & Instituti i Historisë, Tiranë, Prishtinë, 2014, f. 241.

³⁵ Izber Hoti, *Orientime dhe qëndrime politike te shqiptarëve në Kosovë*, Shtëpia botuese Faik Konica, Prishtinë, 2010, f. 52-53.

Rezistenca e Drenicës apo Kryengritja e Drenicës. Për më tepër, ka ndonjëautor që këtë luftë e quan edhe rezistencë kundërrevolucionare, shprehje dhe dallime këto të mëdha që ndryshojnë në filozofinë e historisë.³⁶ Jo vetëm për Luftën e Drenicës, por edhe për prijësin e saj, Shaban Polluzhën, nuk janë botuar punime shkencore për të ndriçuar të vërtetën historike deri në fillim të viteve 90-të.³⁷

Për këtë problematikë studiuesi Ali Hadri thotë, që pas çlirimit të Kosovës, një pjesë e brigadave kosovare nbeti në këtë terren, ndërsa pjesa tjetër u nis drejt Sremit e Trieshtës për çlirimin përfundimtar të vendit. Sipas Hadrit *“Ka fundi i vitit 1944 fuqitë reaksionare organizuan rezistencën kundër revolucionare në Drenicë dhe në disa vende tjera. Këto sulmuan Ferizajin, Gjilanin dhe Mitrovicën, duke penguar formimin e pushtetit popullor. Në një situatë të tillë komandanti suprem i UNÇJ, mareshali Tito, më 8 shkurt 1945, lëshoi urdhrin që në Kosovë të vendoset Pushteti Usharak, derisa të mos asgjësohet rezistenca kontrarevolucionare e fuqive reaksionare, gjë që u arrit qysh në mars të vitit 1945”*.³⁸

Në anën tjetër internimet, terrori, burgosjet individuale e kolektive, dhunimet e gjenocidi i ushtruar mbi popullsinë shqiptare, mbështeteshin në urdhëresën e Shtabit Kryesor të Serbisë, i cili më 2 dhjetor 1944 kishte dhënë urdhër për spastrimin e Drenicës dhe viseve përreth saj nga “bandat shqiptare” dhe nga “njësitet e armatosura prej tradhtarëve shqiptarë”.³⁹

³⁶ Izber Hoti, *Në udhëkryqet e historisë dhe të historiografisë shqiptare...*, f. 230-238.

³⁷ Sadri Rexhepi, *Vështrim historik në 64-vjetorin e rënies heroit kombëtar Shaban Polluzhës*, E Djalhta Shqiptare në Mbrojtje të Shqipërisë etnike - (8). Sesioni VII shkencor, Shqiptarët gjatë viteve 1878-1948, organizuar nga “Trojet e Arbrit”, Shkup 26 korrik 2009, Prizren 2010, f.660.

³⁸ Ali Hadri, *Historia e popullit shqiptar II*, Universiteti Shtetëror i Tiranës & Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, Enti i Botimeve shkollore i RSS Reparti-Prishtinë, 1969, f.811.

³⁹ FazliHajrizi, *Drenica dhe Lutanët e Turifecit*, Lumi i Bardhë, Mitrovicë, 2006, f. 237.

Për dhunën dhe terrorin mbi popullsinë civile shqiptare na sjell detaje studiuesi Lefter Nasi, kur thotë që ajo ishte bërë dukuri e zakonshme nga ana e pushtuesit serbo-sllav, andaj shqiptarëve u është imponuar *Revolta e Drenicës*.⁴⁰ Në fakt si rezultat i rrethanave të krijuara *fundi i vitit 1944 dhe fillimi i vitit 1945 në male dhe në vise të Kosovës mbetën disa grupe të mëdha e të vogla shqiptarësh të cilat nuk kishin besime në njësitet e UNÇJ-së dhe të UNÇSH-së*. Këto grupe u krijuan si rezultat i rrethanave dhe shumë nga këta kundërshtuan vendosjen e “pushtetit popullor”.⁴¹ Po ashtu edhe pas viteve 90-të disa studiues këtë ngjarje e quajnë Kryengritje. Kështu, sipas studiueses Sabile Basha-Keçmezi “*Kryengritja e Drenicës e vitit 1945 është shuar me gjak. Madje ajo jep edhe të dhëna për numrin e shqiptarëve që janë kthyer nga rruga që shkonte në drejtim të Sremit, që sipas saj kapnin shifrën tetë mijë, të cilët të prirë nga Shaban Polluzha janë kthyer në Drenicë*”.⁴²

Ndërsa, sipas studiuesit Sabit Syla, “*Lufta e Drenicës është karakterizuar si luftë për çlirim kombëtar, andaj ajo bëri një kthesë të madhe dhe ndryshoi kursin e Lëvizjes sonë Kombëtare, duke qenë sfiduese për pushtuesin serbo – sllav*”.⁴³

Organizimi i Brigadës së Drenicës

Për gjendjen në Drenicë historiani Islam Dobra ndër të tjera thotë që “*gjendja e tillë e krijuar në Drenicë dhe jo vetëm, shkaktoi njëindinjtë të thellë si tek popullsia shqiptare ashtu edhe te krerët e prijësit e asaj ane. Për t’i bërë ballë situatës së rëndë të krijuar në vend, në dhjetor të vitit 1944 u formua Brigada e Drenicës me*

⁴⁰ LefterNasi, *Ripushtimi i Kosovës, Shtator 1944 - Korrik 1945*, Akademia e Shkencave e Republikës sëShqipërisë, Instituti i Historisë,Tiranë, 1994, f. 151-160.

⁴¹ Izber Hoti, *Forcat e armatosura ne Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1998, f.157.

⁴² Sabile Basha- Keçmezi, *Vazhdimësia e patriotike e organizatave ilegale 1945-1989*, Kosova, Nr.22/23, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2003, f.285-286.

⁴³ Sabit Syla, *Drenica në fund të Luftës së Dytë Botërore*, Studime për historinë e ushtarake, Instituti i Studimeve të Historisë Ushtarake, Tiranë, 2014, f.71.

komandant Shaban Polluzhën".⁴⁴ Ndërsa sipas MehmetRukiqit Brigadën e përbënin gjashtë batalione, të gjitha batalionet përbëheshin nga tri kompani.⁴⁵ Mirëpo, informacione më ndryshe jep historiani NezirÇitaku, i cili në veprën e tij, ndër të tjera, thotë që Brigada e Drenicës u formua pa uniformë ushtarake në përbërje prej 2.500 vetave, të radhitur në katër batalione, që më vonë është rritur në shtatë batalione. Batalionet ndahen në çeta dhe në kompani. Kështu në kuadër të batalionit kishte nga 4 kompani, ndërsa kompanin e përbënin 4 toga.⁴⁶

Mangësitë e grupit të Drenicës,⁴⁷ sipas studiuesit Izber Hoti ishin se ai nuk kishte lidhje të nevojshme me botën e jashtme dhe për më tepër nuk gjeti përkrahje as nga shteti amë. Fatkeqësisht, forca e jashtme me të cilën ishin të lidhur disa nga udhëheqësit e bartësit e kësaj lëvizjeje ishin nazifashistët.⁴⁸ Por, sipas Islam Dobrës, para se të fillonte Lufta e Drenicës në Kullën e Hoxhë Binakut (Mullah Januzit) misionarët anglez kishin qenë dy herë.⁴⁹

Shqetësuese tej mase, si për popullsinë ashtu dhe për Brigadën, ishte çështja e statusit të Kosovës. Në këtë kontekst, Brigada e Drenicës, e njohur ndryshe edhe si "Brigada e Shaban Palluzhës" kishte këto qëllime parësore: ndalimin e menjëhershëm të dhunës e terrorit serb në Drenicë e vise të tjera të Kosovës, respektimin e të drejtës së popullit shqiptar për vetëvendosje – bashkim me

⁴⁴ Islam Dobra, *Lufta e Drenicës 1941-1945 dhe NDSH në Kosovë deri më 1947* (Ribotim me zgjerim dokumentar), Shoqata për Ndrichimin e Historisë Kombëtare Shqiptare, Prishtinë, 1997, f. 158.

⁴⁵ Mehmet Rukiqi, *Tahir Berisha*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008, f. 152-153.

⁴⁶ NezirÇitaku, *Drenica në shekuj*, Ulqin, 2007, f. 354.

⁴⁷ Në veprën e Islam Dobrës, *Lufta e Drenicës 1941-1945...*, spikatën këta krerë të grupit të Drenicës: Shaban Polluzha, Mehmet Gradica, Rexhep Xheli, Miftar Bajraktari, Azem Aruqi, Feriz Boja, Hamëz Istogu, Hazir Xhaka, Mulla Ilias Broja, Rifat Maloku, Sadik Lutani dhe Ukë Sadiku.

⁴⁸ I. Hoti, *Në udhëkryqet e historisë ...*, f. 238.

⁴⁹ Islam Dobra, *Krekë dhe prijës të Lëvizjes kombëtare nga Drenica prej gjysmës së shekullit XIX deri pas Luftës së Dytë Botërore*, Botues - Shoqatat e ndriçimit të Historisë Kombëtare-shqiptare, Prishtinë, 1996, f. 213-214

Shqipërinë dhe largimin e menjëhershëm të forcave partizano - çetnike nga vendi etj.. Për të realizuar këto qëllime, mjet i vetëm mbeti lufta, e cila do të jetë e ashpër ndërmjet forcave të Brigadës së Drenicës dhe forcave pushtuese jugosllave. Në këtë luftë të zhvilluar në janar-mars të vitit 1945 kundër Brigadës së Drenicës e udhëhequr nga Shaban Polluzha, morën pjesë: Brigada e Parë e Kosovës dhe Metohisë, me Zufer Musiqin në krye; Brigada e Bokelit, e njohur me emrin famëkeq “Bokelska”, e 6-ta malazeze; pastaj ajo e KNOJ-it, brigadat IV dhe V të Kosovës. Madje në Luftën e Drenicës u inkuadruan edhe brigadat serbe e maqedonas⁵⁰ etj.

Të dhëna kontradiktore të historiografisë shqiptare për numrin e të vrarëve të Luftës së Drenicës

Sipas Islam Dobrës, Lufta e Drenicës, u zhvillua në janar-mars 1945.⁵¹ Ndërsa historiani Muhamet Shatri, jep të dhëna të detajuara për numrin e forcave ushtarake. Kështu, mbështetur në një raport të prof. Ymer Berishës, të datës 2 tetor 1945, forcat ushtarake që luftuan kundër forcave shqiptare të Drenicës, Vushtrrisë dhe Mitrovicës përbëheshin nga afër 36.000 ushtarë serbë, malazezë, maqedonas, bullgarë dhe fatkeqësisht edhe shqiptarë. Për më tepër, në këtë luftë për vetëm 28 ditë u vranë dhe u plagosën rreth 430 luftëtarë nga Drenica, u dogjën dhe u plaçkitën 450 shtëpi, iu konfiskua i tërë ushqimi e gjëja e gjallë 6.000 banorëve të Vushtrrisë e të Mitrovicës me rrethinë.⁵² Ndërsa, sipas të dhënave që na ofron studiuesi Muhamet Mjeku, mbështetur në të dhënat e Komandantit të Administratës Ushtarake, SavaDërljeviq, ishin mbi 40.000 luftëtarë të huaj.⁵³ Po ashtu, sipas studiuesit Xheladin Shala, kundër

⁵⁰ S. Syla, *Drenica në fund të Luftës së Dytë Botërore*, f.77.

⁵¹ Islam Dobra, *Krerë dhe prijës tëLëvizjes kombëtare nga Drenica prej gjysmës së shekullit XIX deri pas Luftës së Dytë Botërore...*, f.229.

⁵² M. Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore 1941-1945...*, f. 274-275.

⁵³ Muhamet Mjeku, *Kosova në dimrin e vitit 1945*, Neë York, f. 207.

Kryengritjes së shqiptarëve në Drenicë u angazhuan forca të mëdha partizano-çetnike, rreth 40.000 sosh.⁵⁴

Ndërkohë, sipas historianit Islam Dobra, mbështetur në një raport të dhënë nga organet ushtarake, deri më 12 shkurt 1945, Formacioni i Drenicës kishte pësuar këto humbje: të vrarë 393 veta, të plagosur 313, robër të zënë 490, të zënë pa armë 264, të dorëzuar 1.087 dhe prapavijës iu dorëzuan 700 veta. Deri në datën e sipërthënë janë zënë 988 pushkë e mitraloza të rëndë me 70.000 fishekë të llojeve të ndryshme e disa predha dore e pajime të tjera. Sipas raportit ushtria kishte këto humbje: 82 të vrarë, 117 të plagosur dhe 700 të dezertuar.⁵⁵ Megjithatë, sipas hulumtimeve të bëra në Institutin Usharak në Beograd, sipas historianit në fjalë, raporti i humbjeve ushtarake nuk përputhet me të dhënat e lartpërmendura. Sipas regjistrave të të vrarëve dhe të plagosurve, humbjet ushtarake vetëm për Divizionin e 52-të na dalin shumë më të mëdha. Nga dy regjistrat e të vrarëve e të plagosurve dalin 413 ushtarë të vrarë e 8 të plagosur e nëse llogarisim mesataren e 22 regjistrave që ishin, na del se humbjet ushtarake sillen mbi 2.000 apo 3.000 ushtarë të vrarë.⁵⁶

Sipas studiueses Basha-Keçmezi në Drenicë dhe në shumë vende të tjera të Kosovës, në fund të Luftës së Dytë Botërore ushtrohej gjenocid, andaj, sipas saj në historinë e Kosovës vitet 1944-45, do të kujtohen nga popullsia shqiptare si vitet më të përgjakshme në historinë e Kosovës. Kjo për faktin se u pushkatuan mijëra vetë, shumë të tjerë të zhdukur pa gjurmë, mbi 30 mijë u futën në burgje dhe u vendosën në kampe dhe qindra e mijëra emigruan jashtë atdheut.⁵⁷

⁵⁴ Xheladinë Shala, *Vrasja e personaliteteve shqiptare gjatë viteve 1943-1949*, E Djathta Shqiptare në Mbrojtje të Shqipërisë etnike - (8). Sesioni VII shkencor, Shqiptaret gjatë viteve 1878-1948, organizuar nga "Trojet e Arbërit", Shkup 26 korrik 2009, Prizren 2010, f. 264-274.

⁵⁵ I. Dobra, *Lufta e Drenicës...*, f. 291.

⁵⁶ *Po aty*, f. 291-292.

⁵⁷ Sabile Keçmezi – Basha, *Reagimet e forcave nacionaliste në Kosovë ndaj vendimeve të Kuvendit të Prizrenit 1945*, Studime Historike, Viti LXI(XLIV), 1-2, Tiranë, 2007, f.137-138.

Në anën tjetër, historiani Bedri Muhadri, e cilëson Luftën e Drenicës, luftë të përgjakshme, ngase siç shprehet ai ishte situata e pasigurisë së madhe të popullsisë së Drenicës. Por, plaçkitjet, dhuna e terrori i ushtruar në Drenicë nga forcat partizane - çetnike u shpagua nga luftëtarët e Drenicës. Kështu në Prekaz, qysh në fillim të luftës (së Drenicës) u likuidua Shtabi Partizan - Çetnik, i cili kishte bërë terror e masakra në Drenicë e më gjerë⁵⁸, po ashtu luftime u zhvilluan në fshatrat Aqarevë, Ticë dhe Rezallë etj. Për heroizmin e tyre historiani Syla ndër të tjera shprehet *“luftëtarët e Drenicës, kishin luftuar grykë më grykë, duke lënë të vrrarë shumë pjesëtarë të forcave ushtarake partizane – çetnike.”*⁵⁹

Në anën tjetër, regjimi komunist i Titos, manipulonte me opinionin ndërkombëtar se *“shqiptaret e Kosovës me vullnetin e tyre i bashkohen Serbisë Federative”*. Por, është e rëndësishme të ceket se faktori ndërkombëtar nuk reagoi as kur është vendosur pushteti ushtarak (shkurt-maj 1945), as kur u shtyp me gjak *“kundërrevolucioni në Drenicë”* dhe as kur u organizua Masakra e Tivarit, kur u zhdukën në mënyrën më çnjerëzore 3.600 ushtarët rekrutë të paarmatosur shqiptarë të Kosovës.⁶⁰

Sipas hulumtimeve në Arkivin Qendror Shtetëror (AQSH), në fillim të dhjetorit të vitit 1944, me kërkesën e Shtabi Operativ (SHO) të Kosovës, formacioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë (UNÇSH) e atyre kosovare iu desh të përshkonin zonën e Drenicës. Gjithnjë sipas SHO të Kosovës, gjendja në Drenicë paraqitej shumë e vështirë ngase këtu siç thuhet në dokument *“Reaksioni ishte me baza të forta”*. Madje, thuhet që krahina e Drenicës ishte qendër e reaksionit, në të cilën ishin ngritur në

⁵⁸ Bedri Muhadri, *Sefer Mikushnicave printar i lëvizjes çlirimtare në Drenicë 1941-1945*, E Djathta Shqiptare në Mbrotjtje të Shqipërisë etnike - (8). Sesioni VII shkencor, Shqiptarët gjatë viteve 1878-1948, organizuar nga “Trojet e Arbërit”, Shkup, 26 korrik 2009, Prizren 2010, f. 415-416.

⁵⁹ S. Syla, *Drenica në fund të Luftës ...*, 79

⁶⁰ Fazli Hajrizi, *Mitrovica dhe Shala e bajgore në fokusin e historisë, (Ngjarje, personalitete historike, arsimore dhe kulturore)*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2011, f. 461-463.

kryengritje 700 persona.⁶¹ Të dhënat nga SHO e Kosovës nuk paraqesin saktë gjendjen reale në këtë rajon. Madje, në realitet në Drenicë, forcat e UNÇ, gjetën një gjendje krejt ndryshe nga ajo që pretendonte UNÇJ.⁶²

Meqë nuk kishin mbrojtje nga faktori ndërkombëtar, sipas studimeve të Lefter Nasit, popullsia e Drenicës ishte e detyruar të tërhiqej në pyje për t'u vetëmbrojtur.⁶³ Pra, që të shpëtonin nga ndjekjet e persekutimet shumë fshatarë braktisën katundet e dolën në male, ku nga aty, filluan të sulmonin repartet e ushtrisë jugosllave të vendosura në qytete. Kjo revoltë nuk ishte e nivelit lokal, ngaqë u shtri në shumë qytete si në Ferizaj (fillimi i dhjetorit 1944), në Gjilan (dhjetor 1944), në Drenicë (dhjetor 1944 shkurt 1945), në Mitrovicë (janar 1945). Sipas studimeve të bëra nga studiuesi i lartpërmendur numri i të revoltuarve arriti në rreth 30.000 veta.⁶⁴

Në këto rrethana tejet të vështira për popullin shqiptar, u miratua Rezoluta për bashkëngjitjen e Kosovës me Serbinë Federale, që binte ndesh me aspiratën e shqiptarëve të cilët ishin shprehur hapur për vetëvendosje dhe bashkimin me shtetin e tyre amë, pra me Shqipërinë. Duhet vënë në dukje se “çlirimi” i Kosovës, siç e quante pushtimin LNÇ-ja dhe “pushtimi sllav” i saj, siç e quanin kundërshtarët e LNÇ-së, në forma dhe në mënyra të ndryshme u kundërshtua nga një pjesë e madhe e popullit shqiptar. Si rezultat, në Kosovë filluan grupet e organizuara kundër LNÇ-së e “pushtetit popullor” të kohës, të cilat masivizoheshin çdo ditë e më shumë. Vlen të përmendet këtu organizata Komiteti Demokratik Shqiptar, që

⁶¹ Lefter Nasi, *Aspektet nga veprimtaria e formacioneve të UNÇSH në Kosovës e në Jugosllavi (tetor 1944-mars 1945)*, Studime Historike, nr. 1, Tiranë, 1991. f.49-63

⁶² *Historia e Popullit shqiptar IV, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990*, Instituti i Historisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Toena, Tiranë, 2008, f.146.

⁶³ L. Nasi, *Aspektet nga veprimtaria e formacioneve të UNÇSH në Kosovës e në Jugosllavi (tetor 1944-mars 1945)*, f.49-63.

⁶⁴ *Historia e Popullit Shqiptar IV, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990...*, f.341.

u formua në frymën kombëtare, në momente tejte të vështira politike.⁶⁵

Në këtë punim do të përmendim edhe një vepër shkencore të botuar më 1998 nga historiani Izber Hoti, me titull “Forcat e Armatosura në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore”. Studimi në fjalë trajton në mënyrë të detajuar Luftën e Drenicës, e cila nuk ishte trajtuar nga historiografia komuniste andej dhe këtej kufirit.⁶⁶

Për më tepër, historiani Fehmi Rexhepi, në një artikull shkencor thotë se pas çlirimit të Kosovës nga fashizmi forcat shoviniste partizane-çetnike, që kishin depërtuar në të gjitha segmentet e organeve të PKJ-së të cilat nuk mund të pajtoheshin me gjendjen e krijuar, ngase duhej të realizoheshin në praktikë vendimet e Bujanit, filluan të depërtonin në trojet shqiptare, duke inskenuar edhe konflikte të armatosura, si shkas për të ushtruar më pas dhunë e terror mbi popullin shqiptar. Në këto kushte, populli i Kosovës (shqiptar-H. A.), edhe një herë, që nga tetori i 1944-ës e deri në pranverë të 1945-ës, u masakrua pamëshirshëm, këtë herë nga njësitë partizane të UNÇJ-së. Në një situatë të tillë, që ishte e padurueshme, populli shqiptar u detyrua të bëjë rezistencë spontane, e cila u përhap thuajse në të gjitha viset e banuara me shqiptarë në ish-Jugosllavi, rezistencë e cila në disa vise (konkretisht në Drenicë H. A.), mori përmasat e një kryengritjeje popullore.⁶⁷ Madje në bazë të disa raporteve, në rastin e ndërhyrjes së Ushtrisë Shqiptare dhe Jugosllave, thuhet se “të gjithë ballistët luftuan kundër nesh, duke vazhduar më tej se, me çlirimin e Kosovës, filloi lufta në Drenicë”, ku afër 12.000 veta u çuan kundër UNÇJ-së. Në këtë raport, si organizata reaksionare përmendeshin edhe “Besa Kombëtare” dhe organizata tëtjera që vepruan, me përfaqësues Ymer Berishën,

⁶⁵ *Po aty.*, f. 169.

⁶⁶ I. Hoti, *Forcat e Armatosura në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Instituti i Historisë Prishtinë, Prishtinë, 1998, f.189.

⁶⁷ Femi Rexhepi, *Lufta e shqiptarëve për vetëvendosje e bashkim kombëtar gjatë Luftës së Dytë Botërore*, në: *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore (Përmbledhje studimesh)*, Instituti i Historisë-Prishtinë dhe Instituti i Historisë-Tiranë, Prishtinë, 2014, f. 148.

MarieShllakun etj. Është e rëndësishme të cekët së në këtë raport Shaban Polluzha cilësohet si kryetar i ushtrisë rebele.⁶⁸

Në fund, mund të themi, se Lufta e Drenicës, zhvilluar në fillim të vitit 1945, fillimisht në Llap, Artakoll, Shalë e më gjerë, kishte karakter mobilizues të një lufte të përgjithshme kombëtare, për çlirim e vetëvendosje të fatit të popullit shqiptar. Ajo nuk kishte karakter lokal apo rajonal, nuk ishte spontane, lëvizje, kryengritje, rezistencë apo revoltë, por ishte luftë me një karakter gjithëkombëtar e organizuar nga prijës për çlirim e bashkim me shtetin amë Shqipërinë.⁶⁹

⁶⁸ Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939 - 1981*, Prishtinë: "Instituti i Historisë - Prishtinë", 2012, f. 105-106.

⁶⁹ S. Syla, *Drenica në fund të Luftës ...*, f. 81.

